



Muhammed Xhevàd Mugnijeh

FIKHU I IMAM

XHA'FERR SADIKUT

(Paqja goftë mbi të!)

X

Titulli: **Fikhu i Imam Xha`ferr Sadikut** (*Paqja qoftë mbi të!*) X

Autori: **Muhamed Xhevàd Mugnijeh**

Përktheu: **H. Selim Stafa** (*Allahu e mëshiroftë!*)

Recensent: **H. Vullnet Merja**

Redaktoi: **Jerida Kulla**

Perkujdesja garfike: **Sabrie Feza**

Kapaku: **Sabrie Feza**

Botoi: **Shoqata FLLADI**

بسم الله الرحمن الرحيم

MARTESA

Predikimi

Është veprim i pëlqyer (mustehab) të bëhen dy predikime, një predikim, kur bëhet kërkesa për martesë dhe predikimi tjetër para aktit të martesës. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) tregon se disa vetë i thanë Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Duam të martojmë filanin me filanen dhe dëshirojmë që për atë, filanin, të na mbash një predikim.”

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) predikimin e bëri në kohën që gruaja kërkohet për burrin. Predikimin ai e filloi duke lavdëruar Allahun e Madhëruar, Allahun e Gjithëpushtetshëm dhe duke porositur për devotshmëri e për bindje ndaj Tij.

Më pas tha: “(Elhamdu lil’lâh ue subhanall’lâh, ùsijkum bi takvall’lâhi ue tâatihi)- Filani, i biri i filanit, ka kërkuar filanen, të bijën e filanit. Nga gjendja ai është ashtu siç e njihni, përkatësia familjare e tij për ju nuk është e panjohur. Për filanen ai ka

derdhur shumë e kurorës që ju e dini. Ktheni përgjigje për të mirë dhe për këtë falënderoni Allahun. Uroni trashëgimi për atë. Paqja e bekimi i Allahut qoftë për Muhamedin e për familjen e tij!"

Autori i librit "El Mesalik" ka thënë: "Është mustehab që predikimi të bëhet para lidhjes së aktmartsesës. Gjithashtu, është mustehab që predikimi të fillohet me fjalën "el hamdu lil'lah" - "Falënderimi e lavdërimi janë vetëm për Allahun e Lartësuar".

Pastaj këndohen dy dëshmitë: "Esh'hedu en là ilàhe il'lall'lah ue esh'hedu en'ne Muham'meden abduhu ue resùluhù" - "Dëshmoj se nuk zot tjetër përveç Allahut, gjithashtu dëshmoj se Muhamedi është rob i Allahut dhe i Dërguari i Tij".

Pastaj këndohen salavatet për Profetin e për familjen e tij: "All'lahum'me sal'li alà Muham'medin ue alà àli Muham'med - "O Allah dhuro paqe e bekim për Muhamedin e për familjen e tij!"

Pastaj, në vijim të predikimit, porositet për devotshmëri ndaj urdhreve të Allahut (takvall'lah) dhe bëhen lutje për çiftin. Është veprim i pëlqyer që në lutjet për çiftin të kërkohet ndërmjetësimi i Profetit dhe pas tij, lutjet e Imamëve (*Paqja qoftë mbi ta!*).

Gjithashtu, është musthab të mbahet një predikim para fejesës prej gruas e prej kujdestarit të saj. Edhe kujdestari e ka detyrim mustehab të mbajë një predikim. Përveç këtyre fjalëve që u thanë, në lidhje me predikimin, predikimi reduktohet edhe vetëm me fjalën: "El hamdu lil'lah" - "Falënderimi e lavdërimi janë vetëm për Allahun!".

Imam Zejnul Abidijni (*Paqja qoftë mbi të!*) në predikimin e martesës, nuk shtonte më shumë se këto fjalë: “El hamdu lil’lâh, ue sal’lall’lâhu alâ Muhm’medin ue àlihi, ue estagfirull’lâh” - “Falënderimi e lavdërimi janë vetëm për Allahun. Paqe e shpëtim për Muhamedin e për familjen e tij. Kërkoj faljen e mëkateve.” Pastaj shtonte: “Ne të martojmë me kushtin e Allahut të Lartësuar.”

Madje Imam Zejnul Abidijni (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kush falënderon e lavdëron Allahun, (kush thotë “El hamdu lil’lâh”) në të vërtetë ai ka bërë fejesën.”

Edhe Dëshmori i dytë (Shehijdu Thanij), në librin “El Mesalik”, ka thënë: “Edhe sikur të lesh pa e bërë predikimin, akti i martesës të të gjithë dijetarët e fesë është i vlefshëm, me përjashtim të Dàud Edh Dhàhirij.

Martesa ka dy farze: Formula dhe burri e gruaja, kurse shuma e kurorës, nuk është as farz e as kusht për vlefshmërinë e aktit të martesës.

1- Formula

Në formulën e martesës është kusht: Fjala e kërkesës dhe e pranimit prej të fejuarës dhe prej të fejuarit, ose e atij që i zëvendëson këta të dy, si kujdestari ose i prokuruari. Martesa nuk plotësohet pa miratim të ndërsjellë dhe pa shqiptim praktik të fjalëve kërkesë-pranim, pra, martesa nuk lidhet as me shenjë e as me të shkruar, kur është fuqia për të folur. Pikërisht me këtë veçori dallon kontrata e martesës prej kontratave të tjera.

Ne shtrojmë pyetjen: Përse vetëm me fjalë? A është fjala mjet për të zbuluar miratimin dhe vullnetin dhe, kur ne sigurohemi për ekzistencën e vullnetit e të miratimit, a është e barabartë fjala e thënë me fjalën e pathënë?

Pyetjes i përgjigjemi se qëllimi i fjalës te martesë është angazhim për martesën dhe për kushtet e saj, në atë mënyrë që nuk mbetet më vend për t'u larguar prej detyrimeve të martesës në asnjë gjendje. Pra, është plotësisht si firmosja e njërit prej akteve të marrëdhënieve tregtare, ose si nënshkrimi i një marrëveshjeje mes dy shteteve, madje martesë është më e rëndësishme se marrëdhëniet tregtare dhe marrëveshjet ndërmjet dy shteteve, sepse kontrata e martesës është një dokument me rëndësi të madhe për bashkëshortët, ashtu si është shprehur qartë në ajetin 21 të sures "En Nisa":

“وَأَخَذَ مِنْكُمْ مِيثَاقًا غَلِيظًا”

“...dhe ato kanë marrë prej jush një besë të fortë.”

Ashtu siç bisedojnë dy vetë që i japin besën njëri-tjetrit, apo dy shtete zgjedhin fjalët për premtimet reciproke zyrtare, derisa të arrihet nënshkrimi i marrëveshjes, kështu qëndron puna edhe mes të fejuarit e të fejuarës, domethënë nuk realizohet dokumenti besë e angazhimi i ndërsjellë mes tyre pa shqiptimin e fjalëve, të cilat, te martesë janë në pozitën e firmosjes. Kur secili prej të dyve të shqiptojë fjalët e martesës, në të vërtetë, ai ka marrë përsipër detyrimet e tij dhe e ka lidhur martesën me besën e tij, ose, thënë më drejt, e ka lidhur veten me zinxhirët e me prangat e martesës.

Fjalë e veçantë

Fukahatë kanë rënë në një mendim të përbashkët se kërkesa në kontratën e përhershme të martesës bëhet vetëm me fjalët: “Të vura kurorë dhe u martova me ty”.

Madje një grup fukahash janë shprehur se kontrata e martesës lidhet vetëm me këto dy fjalë, ashtu siç thuhet në fjalën e Allahut të Lartësuar:

“ فَلَمَّا قَضَىٰ زَيْدٌ مِنْهَا وَطَرًا زَوَّجْنَاهَا ”

“...dhe pasi Zejdi e vendosi atë që kishte menduar ndaj asaj, Ne ta kurorëzuam ty atë...” (Sure “El Ahzab”, ajeti 37) dhe ajeti tjetër:

“ وَلَا تَنْكِحُوا مَا نَكَحَ آبَاؤُكُمْ مِنَ النِّسَاءِ ”

“dhe mos u martoni me gratë me të cilat ishin martuar prindërit tuaj.” (Sure “En Nisa”, ajeti 22)

Këtu, qëllimi i përdorimit të fjalës “martesë” është kontrata e martesës.

Fukahatë kanë mendime të ndryshme për ndodhjen e martesës së përhershme, me fjalën “met’ta’tu”.

Madje një grup fukahash kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit “El Mesalik”, i cili është shprehur për mosndodhjen e kësaj martese me këto fjalë, sepse baza është paprekshmëria e nderit të burrit e të gruas. Por prej kësaj shprehjeje del jashtë martesa e lidhur me vetëdije, me fjalët e formulës: “Të vura kurorë dhe u martova me ty.”, kështu që fjalët e tjera mbeten në pozitën e ndalimit.

Veç kësaj, duhet të shtohet se te martesë ndihet aroma e adhurimit të suksesshëm, bazuar mbi urdhrin e ligjvënësit. Autori i librit “El Mesalik” ka thënë: “Martesa bazohet mbi ihtijatin, atëherë për shoqërim duhet të ecet, derisa të vërtetohet ligjërisht shkaku i zgjidhjes.”

Për sa i përket pranimin, mjafton të shqiptohet vetëm fjala që tregon qartë miratimin, si për shembull: “Pranova.” “Miratova”.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “S’ka asnjë kundërshtim e asnjë komplikim për arritjen e miratimit me këto dy fjalë. Kur gruaja i thotë atij: “Martova veten me ty.” dhe ai thotë: “E pranova kurorën.”; ose ajo thotë: “Vura kurorë me ty.” dhe ai thotë: “E pranova martesën.”, martesë është e vlefshme, sepse fjalët metaforë kanë zënë vendet e njëra-tjetrës.

Gjithashtu te ne s’ka as kundërshtim e as komplikim se në kontratën e martesës, ashtu si në të gjitha kontratat e tjera, lejohet edhe fjala e thënë fare shkurt, si për shembull: “Pranova.”

3- Formula thuhet në kohën e shkuar

Fukahatë më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit “El Mesalik”, i cili është shprehur se martesë e përhershme lidhet vetëm nëse fjalët e formulës thuhet në kohën e kaluar, domethënë “U martova.” dhe jo “Martohem”.

Shumë fukaha, ndër të cilët, autorët e librave “El Mesalik”, “El Xheuahir”, shejkh El Ensarij, në librin “Mulhakàtul Mekàsib”, autori i librit “El Urvetul Vuthka”, autori i librit “El Mustemsek”

dhe të tjerë veç këtyre, janë shprehur për lidhjen e martesës, edhe kur formula nuk thuhet në kohën e shkuar.

Autori i librit “El Mesalik”, atyre që e kanë vënë kusht shqiptimin e formulës së martesës në kohën e shkuar, u është përgjigjur me fjalët që ka mbështetur autori i librit “El Xheuahir” dhe shumë të tjerë përveç tij.

Dëshmori i dytë, në librin “El Mesalik”, ka thënë: “Qëllimi i kontratës së martesës është që të tregojë qëllimin e brendshëm dhe fjala është ajo që e zbulon këtë qëllim të brendshëm, prandaj çdo fjalë që tregon për këtë qëllim, merret në konsideratë, pikërisht për qëllimin e brendshëm. Ata që kanë thënë se formula e martesës, e thënë në kohën e shkuar, është e qartë për ndërtimin e kontratës së martesës dhe është e ndaluar në kontratat e tjera, sepse në kohën e shkuar, origjina e fjalës është njoftim dhe jo ndërtim. Por ata e kanë bërë detyrim mbi vete që atë fjalë ta bëjnë ndërtim me rrugën e citimit, ndryshe fjala nuk njofton asgjë, por ajo shpjegohet me fjalë të jashtme krahasuese dhe duke e bashkuar fjalën krahasuese, megjithëse kjo është e mundur të shpjegohet edhe me kohët e tjera të foljes përveç kohës së shkuar.”

Shejkh El Ensarij, në librin “Mulhakatul Mekasib”, ka thënë: “Prej Ehli Bejt (Paqja e Allahut qoftë mbi ta!) ka ardhur se martesë e përkohshme lejohet edhe me fjalën “Martohem me ty kundrejt shumë” dhe meqenëse lejohet në martesën e përkohshme, vetëkuptohet që lejohet edhe për martesën e përhershme, për shkak se mes dy llojeve të martesave nuk ka asnjë dallim, pasi të dy llojet ka një kontratë të detyrueshme.”

Ja edhe transmetimi që theksoi shejkh El Ensarij: “Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur se si duhet t’i thotë burri gruas në martesën e përkohshme. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Ti i thua: “Martohem me ty përkohësisht, me librin e Allahut dhe me Sunetin e Profetit, për këtë shumë, deri në këtë kohë. Nëse ajo thotë: “Po.”, domethënë, ajo është e kënaqur. Ajo tanimë është gruaja jote dhe për atë grua ti ke përparësi ndaj të gjithë njerëzve.”

4- Jo në gjuhën arabe

Fukahatë kanë një fjalë të përbashkët se kontrata e martesës plotësohet edhe në gjuhë të tjera përveç gjuhës arabe, kur nuk e di arabishten. Por fukahatë kanë kundërshtime mes tyre, kur burri e di arabishten.

Fukahatë më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit “El Hadaik” për mosplotësimin e kontratës së martesës në gjuhë të tjera, përveçse në gjuhën arabe. Një grup fukahash, ndër të cilët shejkh El Ensarij dhe sejjid El Hakijm, janë shprehur për lidhjen e kontratës së martesës edhe në gjuhë të tjera.

Në pjesën e nëntë të librit “Mustemsekul Urveh”, të autorit El Hakijm, thuhet: “Ndërtimi i kontratës së martesës, bazuar te lejimi i shqiptimit të formulës në gjuhë tjetër, përveç arabishtes, ashtu siç ka ardhur prej Ibn Hamzasë, nuk është larg, madje kjo është e detyrueshme.”

Shejkh El Ensarij, në librin “Mulhakatul Mekasib”, ka thënë: “Nuk ka argument për të marrë në konsideratë vetëm

gjuhën arabe, kurse ai që ka thënë se akti i martesës nuk vërtetohet për arabin që e thotë formulën në gjuhë tjetër e jo në arabisht, megjithëse ka fuqi ta thotë në gjuhën arabe, është fjalë e papranueshme, sepse fuqia s'ka të bëjë fare me kuptimin e fjalëve."

Gjithashtu, fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se martesë nuk lidhet me të shkruar¹ dhe memeci që ka fuqi të lëshojë prokurë, prej tij mjafton të dalë një shenjë që tregon qartë se ai ka qëllim martesën, kur memeci nuk di të shkruajë. Nëse memeci di të shkruajë, atëherë është më e pëlqyeshme të jenë së bashku shkresa dhe shenja, që lë të kuptohet qëllimi.

Prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) tregohet se ai është pyetur për një memec, i cili as nuk di të shkruajë e as nuk dëgjon. Si do ta divorcojë ai gruan? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: "Me atë shenjë që njihet prej punëve të tij."

¹ Sej'jid El Hakijm, në librin "El Mustemsek", prej autorit të librit "El Kauaid" dhe prej autorit të librit "Xhamiul Mekasid" ka cituar fjalën e këtyre dy autorëve, të cilët kanë thënë: "Me fjalën e përbashkët të fukahave, s'ka dyshim se formula e martesës me shkrim nuk është e mjaftueshme." Autori i librit të dytë të cituar, e ka shpjeguar fjalën "shkrim", duke thënë se shkrimi mbetet shkrim, kur dihet se martesë nuk ndodh me shkrim. Sej'jid El Hakijm i është përgjigjur këtij shpjegimi me këto fjalë: "Shkresa si shkresë nuk është asgjë, por s'ka asnjë pengesë prej të shkruarës, kur ajo e tregon qëllimin fare qartë." Kjo është fjala e sej'jid El Hakijm dhe prej fjalës së tij ne kuptojmë se martesë, sipas mendimit të tij, ndodh edhe me shkrim, kur e shkruara e tregon qëllimin fare qartë.

5- Pa shkëputje

Fukahatë më të dëgjuar janë shprehur se thënia pa shkëputje e kërkesës dhe e pranimit është kusht për lidhjen e kontratës së martesës, në atë mënyrë që, kur ka një ndarje të gjatë kohe mes kërkesës e pranimit, kontrata nuk realizohet.

Sej'jid El Hakijm, në pjesën e nëntë të librit "El Mustemsek", ka thënë: "Vlefshmëria e kontratës së martesës nuk qëndron në shpejtësinë e menjëhershme, as në bashkimin e kuvendit, edhe sikur të këtë një ndarje të gjatë."

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "S'ka argument për marrjen në konsideratë, bashkimin e kuvendit në kontratën e martesës e as në ndonjë kontratë tjetër."

Në pjesën e tretë, në kapitullin "Kushtet e kontratës", në paragrafin "Vijueshmëria", kemi thënë: "Detyrimi është qëndrimi i vullnetit të paraqitësit të kërkesës, derisa të vijë pranimi." Kjo do të thotë se në konsideratë vihet qëndrimi i ofertës, ose i kërkesës dhe mostërheqja e paraqitësit të ofertës prej ofertës së tij para ardhjes së pranimit, kurse koha ndarëse mes kërkesës e pranimit është e barabartë, qoftë kur ka ndarje në kohë, qoftë kur nuk ka ndarje në kohë.

6- Varësia

Fukahatë më të dëgjuar janë shprehur se varësia e prish kontratën e martesës, si për shembull, kur gruaja thotë: "Unë martohem me ty, nëse është dakord filani.", ose: "Nëse do të ndodhë kështu..." Në këtë gjendje, kontrata e martesës prishet dhe

s'ka argument për ata që janë shprehur në favor të kësaj çështjeje përveç hamendjes se kontrata, çdo kontratë, është detyrim që ndikimet e saj të renditen në çast dhe nuk ka mundësi të shtyhet për në të ardhmen.

Për këtë çështje ne kemi folur në pjesën e tretë, në kapitullin "Kushtet e kontratës", në paragrafin "Varësia".

Ne e kemi bërë pa vlerë këtë hamendje, megjithëkëtë kemi shprehur rezervë në lidhje me kontratën e martesës, sepse kjo e fundit ka dallim prej kontratave të shkëmbimit nga disa anë që i bashkohen asaj me disa punë ndaluese.

7- Më përpara dhe më vonë

Baza është që kërkesa të jetë prej të fejuarës dhe pranimi prej të fejuarit dhe ajo ose kujdestari i saj, të thotë: "U martova." dhe ai, ose kujdestari i tij, thotë: "Pranova."

Pra, fukahatë më të dëgjuar kanë lejuar shqiptimin e pranimit para kërkesës dhe ai thotë: "Ti e martove veten tënde me mua, me këtë." dhe ajo thotë: "U martova me ty.", ose "Pranova."

Dëshmori i dytë, në komentin e librit "El Lum'ah", ka thënë: "Kontrata është ofertë dhe pranim, kurse përbërja është si të vijë mbarë, por pa prishur qëllimin. Kontrata e martesës, në krahasim me kontratat e tjera, është më shumë se kërkesë, e cila vjen prej gruas. Por gruaja, në shumicën e rasteve, ka turp të flasë e para, prandaj këtu ajo është e falur dhe, nisur nga ky fakt, disa fukaha pretendojnë se këtu lejimi për të thënë më përpara kërkesën, gëzon fjalën e përbashkët të fukahave."

Është e mjaftueshme që pranimi të jetë edhe vetëm me fjalën “Po.”, ashtu siç thuhet në transmetim e përcjellë prej Eban bin Tagleb, prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili ka thënë: “Kur gruaja thotë “Po”, pas fjalës së burrit, ajo është e kënaqur dhe tanimë ajo është gruaja jote dhe për atë grua ti ke përparësi ndaj të gjithë njerëzve.”

Është e mjaftueshme që dy kontraktuesit të thonë atë që dinë më mirë, kur nuk kanë mundësi të thonë formulën e martesës e të kurorëzimit, si për shembull, njëri prej atyre të dyve thotë: “Ti u martove.”, në vend që të thotë: “Unë u martova.”, me kusht që secili prej atyre të dyve të ketë dijeni për qëllimin e tjetrit.

Autori i librit “Esh Sheràiu” dhe autori i librit “El Xheuahir” kanë thënë: “Kur njëri prej dy kontraktuesve nuk ka mundësi të shqiptojë fjalët e formulës së martesës e të kurorëzimit, flet ashtu si di më mirë, pasi supozohet që secili prej tyre ka dijeni për qëllimin e tjetrit.”

8- Kushti i përzgjedhjes

Fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët me dëshminë e autorit të librit “El Xheuahir”, i cili është shprehur se përzgjedhja nuk është e vlefshme as në martesën e përhershme e as në martesën e ndërprerë.

Kur burri ose gruaja vënë kusht në brendinë e kontratës prishjen e martesës, ose të heqjes dorë prej martesës brenda një kohe të caktuar, kushti priset, sepse martesa nuk pranon që dy kontraktuesit të prishin atë që kanë nënshkruar me dorën e tyre.

Por fukahatë kanë mendime të ndryshme, nëse bashkë me kushtin prishet edhe kontrata, apo është prishur vetëm kushti dhe jo kontrata. Fukahatë më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit “El-Xhevahir”, i cili është shprehur edhe për prishjen e kontratës. Vetë autori i librit “El Xhevahir” thotë: “Fjala më e përhapur në mesin e fukahave, madje në këtë unë nuk gjej ndonjë kundërshtim në lidhje me pavlefshmërinë e kushtit, sepse dihet që kontrata e martesës nuk e pranon përzgjedhjen, pasi në përzgjedhje ka mangësi të adhurimit. Gjithashtu, prishja e martesës është e kufizuar me të metat që janë treguar me tekst, ashtu siç do të vijë më poshtë. Pikërisht për këtë, prishja nuk mund të ndodhë, ashtu siç mund të ndodhë në kontratat e shkëmbimit, për shkak se vënia kusht e përzgjedhjes, në kontratën e martesës, mohon kërkesën e kontratës së treguar prej argumenteve ligjore. Nisur nga ky fakt, kushti i përzgjedhjes është prishës për kontratën e martesës.”

Një grup fukahash, ndër të cilët Ibn Idrijsi, sejjid El Asfehànij në librin “El Uesijleh”, sejjid El Jezdiy në librin “El Urvetul Vuthkà”, sejjid El Hakijm në librin “El Mustemsek”, kanë thënë: “Prishet vetëm kushti, kurse kontrata është e vlefshme.”

Ne mbështesim këtë mendim, sepse për kontratën e martesës ka një pozitë të veçantë, të ndryshme nga të gjitha kontratat.”

9- Dëshmitarët

Të gjithë fukahatë, përveç Ibn Ebij Ukajlit, ndajnë një mendim të përbashkët se prania e dëshmitarëve në martesën e

përhershme është veprim i pëlqyer (mustehab) dhe nuk është veprim i detyrueshëm (vaxhib). Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Në mesin e fukahave dihet se prania e dëshmitarëve nuk është në shkallën e vaxhibit, sepse fjala që prania e dëshmitarëve është vaxhib, është fjalë e deformuar.”

Kjo do të thotë se dëshmitarët janë një kusht i shtuar, pasi baza është mosqenia e dëshmitarëve, derisa të vërtetohet me argument, por argument për këtë nuk ka. Dihet se ka tekst të transmetuar me rrugën e Ehli Sunetit dhe me rrugën e shi’ave që thotë: “S’ka martesë veçse me praninë e kujdestarit dhe të dy dëshmitarëve.”

Por ky transmetim, me dëshminë e autorit të librit “El Xheuahir” dhe të autorit të librit “El Mesalik”, është i shkallës “Daijf”-“Dobët”. Dëshmori i dytë, në librin “El Mesalik”, ka thënë: “Përzgjedhja është marrë në konsideratë prej kritikuesve të hadithit për këtë tekst, të cilët, hadithin e kanë gjetur të shkallës “Daijf”-“Dobët”.

Aftësia e dy kontraktuesve

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se mendja, mosha e pjekurisë seksuale dhe aftësia për të dalluar punët është kusht për të fejuarin dhe për të fejuarën, përveçse kur janë së bashku me kujdestarin, për të cilin do të flitet më poshtë.¹

¹ Në lidhje me caktimin e moshës së pjekurisë seksuale për mashkullin e për femrën kemi folur në kapitullin “Ndalimi”, në paragrafin “I vogli dhe shenjat e arritjes së pjekurisë seksuale”.

Është unike thënia e autorit të librit “El Xheuahir” se fjalët e të çmendurit dhe fjalët e të voglit, në raport me kontratat janë si zërat e bagëtisë, por të gjitha veprimet e të çmendurit me periudha kohe, janë të vlefshme, nëse ato kryhen gjatë kohës kur ai është në gjendje normale. Edhe dehja, humbja e ndjenjave dhe gjumi, trajtohen me dispozitën e çmendjes, kurse shakaja nuk është asgjë, ashtu siç ka thënë Imam Rizai (*Paqja qoftë mbi të!*).

Gjithashtu, fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se qëndrimi në vetmi e të fejuarit me të fejuarën është prej punëve që bëhen shkak për punë haram dhe për punë relativisht haram.

Gjithashtu, fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se është vaxhib qëllimi, miratimi dhe zgjedhja. Kur kontrata e martesës bëhet me imponim dhe më pas i imponuari e miraton, ose e lejon, kontrata është e vlefshme.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Kur hiqet imponimi dhe arrihet miratimi, kjo është e mjaftueshme për vlefshmërinë.”

Shejkh El Ensarij, në librin “El Mekasib”, ka thënë: “Thënia më e përhapur ndër fukahatë e mëvonshëm se, kur i imponuari e miraton veprimin që i bënë atij, kontrata është e vlefshme, madje kjo thënie gëzon fjalën e përbashkët të fukahave, sepse kontrata e martesës tanimë është një kontratë e vërtetë me të gjitha efektet e saj.”, domethënë se kontrata ekzistonte, por krahas asaj ekzistonte edhe penguesi për zbatimin e saj dhe, me heqjen e penguesit që ishte imponimi, kontrata është vepruese me të gjitha ndikimet e saj.”

Nuk merret në konsideratë miratimi i atij që bën humor, as i të shkujdesurit, as i atij që është në gjumë dhe as i atij që humb

ndjenjat pas kalimit të penguesit, për shkak se këta njerëz nuk kanë dijeni për efektet e kontratës, kur kanë shqiptuar fjalët e formulës së kontratës së martesës.

Bazuar mbi këtë shpjegim, sikur një grua të pretendojë se ajo është detyruar të lidhë kontratën e martesës, ose kur ky pretendim vjen nga ana e burrit dhe që të dy, pas kontratës, kanë bërë jetë bashkëshortore dhe kanë fjetur bashkë si dhëndër e nuse, ose është marrë shuma e kurorës (mehr), apo janë kryer veprime të tjera që tregojnë miratimin, në këtë gjendje, nuk pranohet ankesa e atij që pretendon pavlefshmërinë e kontratës për shkak të imponimit.

Në një transmetim të ardhur prej Ehli Bejtit (*Paqja e Allahut qoftë mbi ta!*) thuhet: “Kur e dehura marton veten e saj dhe, pasi qartësohet e miraton dhe pohon martesën, martesë është kryer.”

Fukaha të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit “El Urvetul Vuthka”, i cili është larguar prej këtij transmetimi, kurse autori i librit “El Mesalik” ka thënë: “Tani ti ke mësuar se kusht për vlefshmërinë e kontratës së martesës është qëllimi për martesë, por i dehuri, si rezultat i pijes, ka arritur cakun që humb edhe mendjen, për rrjedhojë, për të dehurin nuk mund të flitet më për qëllimin e tij, prandaj martesë e tij është e pavlefshme, si të gjitha kontratat e tjera, qoftë kjo për mashkullin, qoftë për femrën. Për të gjitha këto, kjo është thënia më e fuqishme që kërkojnë rregullat e ligjit të fesë dhe, duke qenë kontratë pa vlerë, nuk sjell dobi lejimi i asaj kontrate pas daljes prej efektit të dehjes, sepse lejimi nuk bën të vlefshëm atë që në bazë ka ndodhur e pavlefshme.”

Siç shihet, transmetimi është në kundërshtim me këtë që u tha, kurse disa të tjerë e kanë mbartur kuptimin e këtij transmetimi në rastin kur dehja nuk ka rritur cakun e humbjes së mendjes. Gjithsesi, lënia e këtij transmetimi do të qe më e pëlqyer.

Mendjelehtit nuk i lejohet të lidhë kontratë martese për veten e tij, sepse martesa kërkon veprime pasurore, si shumën e kurorës dhe shpenzime për jetesë, mirëpo mendjelehti është i ndaluar të kryejë veprime pasurore, por ai lejohet të lidhë kontratë martese për veten e tij vetëm në qoftë se e lejon kujdestari.

Gjithashtu, mendjelehti nuk lejohet të jetë i prokuruar prej një tjetri në procedurën e formulës së kontratës së martesës, edhe nëse ka lejen e kujdestarit.

Autori i librit “El Mustemsek” ka thënë: “Me fjalën e përbashkët të fukahave, pasi këtë e kërkojnë argumentet e pakushtëzuara.”

I prokuruari marton vetveten

Kur ti prokuron dikë që ai të martojë filan grua me një person të caktuar, i prokuruari nuk lejohet që atë grua ta martojë me ndonjë person tjetër përveç personit për të cilin është prokuruar dhe, nëse i prokuruari vepron në kundërshtim me prokurën, ai është person që merret me punët e të tjerëve pa pasur autorizim.¹

¹ Më sipër, në kapitullin “Prokurimi” është thënë se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që i ka thënë një tjetri: “Bëj fejesën e filanes për mua.” Pasi ai e bën fejesën për atë, ai e mohon këtë fejesë. Si duhet të

Nëse gruaja divorcon pa caktuar me emër, por thotë: “Ai më martoi me një burrë.”, në këtë gjendje, fukahatë, ose shumica e tyre, kanë thënë se për të prokuruarin nuk lejohet që ai të martohet me atë grua, sepse gjendja dëshmon se ajo kishte shfaqur vullnetin të martohej me një tjetër dhe jo me të prokuruarin, prandaj, në këtë gjendje, merret në konsideratë ajo që mësohet prej fjalës së gruas, pasi fjala që ajo thotë, shpreh vullnetin e saj, qoftë edhe me anë të shembujve krahasues të fjalëve e të gjendjes.

Kur ti e lejon të prokuruarin në mënyrë të qartë që gruan në fjalë ai ta martojë për prokuresin, si për shembull, ti i thua të prokuruarit: “Më marto mua me filanen.”, ose i prokuruari ka leje të përgjithshme, pa caktimin e gruas, si për shembull, ti si prokures i thua të prokuruarit: “Më marto me cilën grua të duash ti.”, a i lejohet këtij të prokuruari të marrë përsipër procedurën e kontratës së martesës me kërkesën dhe pranimin dhe të thotë: “Martova filanen për kaq shumë të kurorës.” dhe “Pranova martesën për veten time.”?

Një grup prej fukahave të mëdhenj, ndër të cilët autorët e librave “Esh Sheràiu”, “El Mesalik”, “El Xheuahir” dhe “El Urvetul Vuthkà”, janë shprehur për lejimin dhe mospengimin, pasi është e mjaftueshme ndryshueshmëria ndërmjet kërkuesit e pranuesit me anë të nënkuptimit dhe opinionit. Për sa i përket transmetimit prej të cilit kuptohet moslejimi, ky transmetim është me gradë përcjellësish “Dobët”, domethënë se nuk përbën

veprohet në këtë situatë? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “I prokuruari gjobitet me gjysmën e shumës së kurorës.” Më pas e ka shpjeguar këtë dispozitë se i prokuruari la pas dore të dëshmonte kundër atij. Fukahatë më të dëgjuar janë mbështetur mbi këtë transmetim dhe me përmbajtjen e këtij transmetimi kanë dhënë sentencë (fetvâ).

argument, ashtu siç ka thënë autori i librit “El Mesalik”, ose transmetimi është mbartur për rastin e imponimit, ose për gjendje të tjera që mund të mbartet kuptimi i këtij transmetimi, ashtu siç ka thënë edhe autori i librit “El Urveh”.

Autori i librit “El Xheuahir ka thënë: “Lejimi është i ngjashëm me bazat e medh’hebit (shkollës juridike) dhe me rregullat që përftohen prej argumenteve përfshirëse për supozimin që transmetimi nuk është i vlefshëm për shkak të ndërprerjes në vargun e përcjellësve, si dhe për shkak se ka fare pak fjalë. Përveç kësaj, transmetimi është atakuar edhe për saktësinë e vargut të përcjellësve.”

Ne jemi bazuar mbi këtë mendim, pasi supozohet që prokuruesi e ka realizuar plotësisht vullnetin e gruas objekt i prokurës. Kjo prokurë është e ngjashme me rastin kur dy burra prokurojnë një të tretë që të bëjë veprimet formale mes atyre të dyve, pasi ata kanë rënë dakord për pikat kryesore.

Gruan e martojnë pa e pyetur

Një burrë i ka thënë Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Takohem me një grua në një vend të thatë, ku s’ka asnjë njeri dhe unë i them asaj: ‘A ke burrë?’ Ajo thotë: ‘Jo.’

Pastaj unë atë e marr për grua. A është e drejtë kjo martesë?”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Po, ajo mund të besohet në fjalën që thotë.”

Një burrë tjetër i tha: “Isha në rrugë, ndërkaq shikoj një grua të bukur, por nuk isha i sigurt, nëse ajo kishte burrë, apo ishte prej lavireve. A mund të besoj në fjalën e saj?” Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Kjo nuk të takon ty, pasi, në të vërtetë, detyra jote është që të besosh në fjalën e saj.”

Një i tretë tha: “Unë u martova me një grua dhe pyeta për të. Nga pyetjet rezultoi se për atë grua kishte fjalë.”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Përse pyete? Ju nuk keni detyrë të kontrolloni e të vëzhgoni.”

Një burrë ka pyetur Imam Rizain, nipin e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), për një burrë që është martuar me një grua, por i ka rënë në kokë se ajo ka burrë. Ç’duhet të bëjë ai? Imam Rizai është përgjigjur: “Si mendon ti, sikur ai t’i kërkojë gruas dokument, a do të gjente ajo dikë që të dëshmonte se ajo s’ka burrë?”¹

Fukahatë kanë punuar me këto transmetime, duke shtuar se bazë në punën e myslimanit është vlefshmëria.

¹ Kjo nuk është e veçantë vetëm për fik’hun xhaferij, sepse edhe medh’hebet e tjera thonë që gruaja besohet, kur nuk ka kundërshtues. Në librin “El Ishbàhu uen nedhàir”, të autorit Es Sujùtij, thuhet se gruas së divorcuar tri herë, i pranohet ankesa, kur ajo pohon se personi për të cilin ishte hallall, e ka prekur. Kjo grua është hallall për burrin e parë. Madje në librin “El Mugnij”, botimi i tretë, në faqen 274, thuhet: “Kur gruaja pretendon se filani është martuar me të, pretendimi i saj nuk dëgjohet, nëse është vetëm pretendim martese dhe nuk ka shtuar pretendimin për shumën e kurorës, ose për shpenzimet e jetës. Për këtë janë shprehur disa fukaha të Ehli Sunetit.

I prokuruari gabon emrin

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një të prokuruar që gabon emrin e gruas dhe e quan jo me emrin e saj, por me një emër tjetër. A ka problem? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Për këtë s’ka problem, pasi kuptohet që të dyja palët kanë dijeni për qëllimin.”

* * *

KUSHTET

Kushtet që burri ose gruaja i vënë njëri-tjetrit në brendinë e kontratës, janë disa llojesh:

1- Burri ose gruaja vë kusht që tjetri të këtë një cilësi, për shembull, burri vë kusht që gruaja të jetë e virgjër dhe jo e martuar më parë; ose gruaja vë kusht që burri të jetë i përkushtuar në zbatimin e fesë dhe të mos jetë tolerues në fenë e tij. Kushti është i vlefshëm dhe kontrata bëhet e detyrueshme, krahas realizimit të kushtit. Është vërtetuar përzgjedhja e prishjes së kushtit, kur kushti vonohet.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që, kur është martuar, i thotë gruas së tij se ishte prej X fisi. Por, në të vërtetë, ai nuk është i atij fisi. Si duhet të veprohet në këtë rast? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Martesa prishet.”

2- Burri ose gruaja vë kusht prishjen e martesës, ose heqjen dorë prej saj pas tri ditësh, ose më shumë, ose më pak ditë. Në këtë rast, te fukahatë më të dëgjuar prishet kushti dhe kontrata e martesës, sepse martesa nuk pranon prishje të dyanshme. Kjo

çështje u trajtua më sipër në kapitullin “Martesa”, në paragrafin “Kushti i përzgjedhjes”.

3- Kushti është në kundërshtim me kërkesat e me natyrën e kontratës, si për shembull, gruaja vë kusht që burri të mos e prekë atë në mënyrë absolute dhe që ajo të jetë për burrin plotësisht si një grua e huaj. Në këtë rast, kushti është pa vlerë dhe kontrata është e vlefshme, duke ditur që ky kusht e bën të pavlefshme kontratën, përveç martesës, pasi për martesën ka një dispozitë të veçantë, sepse qëllimi me martesën është më i lartë se marrjedhëniet.

4- Kushti është në kundërshtim me ligjin, si për shembull, gruaja vë kusht që burri nuk do të martohet me grua tjetër, ose burri nuk do ta divorcojë atë, ose burri nuk do t'i sjellë asaj shemrën, ose gruaja vë kusht që burri të mos mbajë lidhje me të afërmit e tij.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Me fjalën e përbashkët të fukahave, kontrata është e vlefshme dhe prishet kushti, sipas fjalës së Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Kush vë kusht tjetër përveç Librit të Allahut, kushti nuk është i lejueshëm, as kur është në favorin e tij, as kur është në dëmin e tij.”

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që martohet me kushtin që gruaja të ketë në dorë marrëdhëniet intime dhe divorcin. A është i drejtë kushti që ka vënë gruaja? Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Gruaja ka kundërshtuar Sunetin dhe ka marrë një të drejtë që nuk i takon.”

Pastaj Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) gjykoi që burri ka detyrim të japë shumën e kurorës dhe marrëdhëniet intime e divorci janë në dorën e burrit.

5- Burri vë kusht në favor të gruas e kundër vetes së tij: nëse ai nuk i jep të plotë asaj shumën e kurorës, në një kohë të caktuar, kur ajo është gruaja e tij, nuk ka më martesë. Në këtë rast, është e vlefshme kontrata dhe shuma e kurorës, kurse kushti është i pavlefshëm. Gjithashtu, gruaja nuk ka të drejtën e përzgjedhjes, sepse vonimi i kushtit ose pamundësia për realizimin e kushtit nuk e bën të detyrueshme përzgjedhjen në martesë, në kundërshtim me të gjitha kontratat tregtare, me përjashtim të rastit, kur kushti është detyrim të jetë cilësi e veçantë në njërin prej dy bashkëshortëve.

Këtë gjë e përmendën në pikën e parë të këtij paragrafi.

Imam Bakiri, babai i Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që martohet me një grua, për një afat të caktuar dhe, nëse ai i sjell gruas shumën e kurorës deri në afatin e caktuar, ajo është gruaja e tij dhe, nëse ai nuk e sjell shumën e kurorës, ai s'ka rrugë që ajo të jetë gruaja e tij. Ky ishte kusht që ata kishin vënë mes tyre në kohën e bërjes së kurorës. Imam Bakiri gjykoi se burri e ka në dorë të shkojë te gruaja e tij dhe rrëzoi kushtin që ata kishin vënë.

6- Gruaja i vë kusht burrit që ai të heqë dorë vetëm për një lloj kënaqësie, si për shembull, vetëm të mos kryejë marrëdhënie intime dhe burri të ketë të drejtën që të shijojë të gjitha kënaqësitë që ofron gruaja. Shtrohet pyetja: A është i vlefshëm ky kusht?

Një grup fukahash, ndër të cilët autorët e librave: “Esh Sheràiu”, “El Mesalik” dhe “El Xheuahir”, janë shprehur për vlefshmërinë e kushtit dhe për detyrimin për mbajtjen e besës për kushtin e vënë. Kjo është e barabartë, qoftë kur është martesë e përhershme, qoftë kur është martesë e ndërprerë, sepse gruaja nuk ka vënë kusht mos shijimin e kënaqësisë me të gjitha llojet, por ajo, në të vërtetë, ka vënë kusht diçka të veçantë dhe për një qëllim të arsyeshëm, sepse marrëdhëniet intime janë vetëm një prej qëllimeve të martesës dhe vetëm një prej efekteve të saj dhe nuk janë objekti i martesës. Është e lejueshme martesa me një grua me të cilën nuk mund të kryhen marrëdhënie intime. Gjithashtu, është e vlefshme që edhe gruaja të martohet me një burrë impotent, kur ajo është përshtatur me të metën e impotencës.

Është pyetur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) për një grua që i ka thënë një burri: “Martohem me ty, me kusht që të më prekësh e të më shikosh ku të duash dhe të shijosh në mua gjithçka shijon burri me gruan e tij, por marrëdhënie intime me mua nuk do të kryesh, sepse kam frikë skandalin.” Si duhet të veprojë ky burrë? Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Ai burrë, prej asaj gruaje, do të shijojë vetëm ato kënaqësi që ajo ka vënë kusht.”

Nëse pas kësaj ajo e lejon burrin të kryejë edhe marrëdhënie intime, kjo është e lejueshme.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë të martuar me një grua, me kusht që të mos hyjë te ajo, por më pas ajo e lejon. Si duhet të veprojë ky çift? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Nëse pas ndalimit ajo e lejon, për këtë s’ka asnjë problem.”

Edhe autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Kushti është si ndaluesi, por krahas supozimit për lejim, bie edhe penguesi, domethënë mbetet vetëm kërkesa e objektit, e cila e bën të detyrueshme kërkesën, që është martesë. Madje edhe sikur burri të mëkatojë e të veprojë në kundërshtim me kushtin, ai nuk është kurvar, veç kësaj atij i atashohet edhe fëmija, ashtu siç është e qartë.”

Fukaha të tjerë kanë thënë se kushti është i vlefshëm në martesën e përhershme dhe është i pavlefshëm në martesën e ndërprerë. Ne jemi me ata që janë shprehur për vlefshmërinë e kushtit në martesën e përhershme dhe në martesën e ndërprerë, sepse teksti është i pakushtëzuar, ndërsa vënja e kushteve është arbitraritet, por edhe qëllimet prej martesës janë të shumta, prandaj mjafton dëshira vetëm për disa prej këtyre qëllimeve.

7- Kushti është vënë që burri të mos e nxjerrë gruan jashtë vendit të saj, ose ta vërë atë të banojë në një vend, ose në një banesë të caktuar. Në këtë rast, është detyrim mbajtja e besës për kushtin e vënë, për shkak se rregulli i përfutur prej hadithit “Besimtarët janë në kushtet e tyre” është përgjithësues. Gjithashtu, edhe Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), kur është pyetur për një burrë që është martuar me një grua dhe asaj i ka vënë kusht që nuk do ta nxjerrë jashtë vendit të saj, është përgjigjur: “Kjo është detyrim për atë.”

Pretenduesi i kushtit

Kur gruaja ose burri pretendon një kusht të njohur të shtuar mbi kontratën, por tjetri e mohon, pretenduesi ka detyrim të sjellë argument dhe mohuesi ka detyrim të betohet, sepse origjina është mosekzistenca e kushtit, derisa të vërtetohet e kundërta.

* * *

PERTENDIMI PËR MARTESË

Një burrë pretendon martesë me një grua dhe gruaja e mohon, ose kur gruaja pretendon martesë me një burrë dhe burri e mohon, në këtë gjendje, pretenduesi ka detyrim të sjellë argument dhe mohuesi ka detyrim të betohet. Kur mohuesi betohet, gjykatësi merr vendim mohimin e martesës, ose e anashkalon pretendimin dhe, në lidhje me këtë pretendim, nuk arrihet as vërtetim negativ e as vërtetim pozitiv. Në këtë gjendje, pretenduesi ka detyrim t'i përmbahet kërkesave të martesës dhe efekteve që rrjedhin prej pohimit e prej njohjes së saj, sepse pohimi i njerëzve të mençur kundër vetvetes është i lejueshëm.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Nëse pretenduesi është burri, ai nuk mund të martohet me një grua të pestë dhe as me të ëmën e me vajzën e asaj gruaje me të cilën ai ka kryer marrëdhënie intime, as me motrën e saj, plotësisht sikur ajo të ishte gruaja. Përveç kësaj, ai ka detyrim që, sipas mundësisë, t'i paguajë gruas shumë e kurorës.”

Për sa i përket shpenzimeve për jetesë, ato nuk janë detyrim për burrin, për shkak se nuk ka mundësi, pasi mundësia është shkak që e bën detyrim shpenzimin për jetesë. Nëse

pretenduese është gruaja, asaj nuk i lejohet të martohet me një burrë tjetër, as të bëjë ndonjë veprim, kryerja e të cilit realizohet vetëm me lejen e burrit.”

Në vijim, autori i librit “El Xheuahir thotë: “Sikur burri mohues të jetë shprehur në formën e divorcit, si për shembull, ai thotë: ‘Nëse ajo është gruaja ime, atë unë e kam divorcuar.’, që nga fjalët e burrit rezulton se asaj i mohohet martesë ekzistuese, prandaj, në këtë gjendje, për këtë grua lejohet që ajo të martohet me një tjetër, por në mënyrë të prerë asaj nuk i lejohet të martohet me babain ose me djalin e burrit që i mohoi asaj martesën, për shkak se ajo më parë ka pohuar atë që detyrimisht e bën haram martesën e asaj me ata burra.”

Sikur të supozohet se pretenduesi i martesës heq dorë prej pretendimit të tij dhe thotë: “Isha i gabuar në pretendimin tim.” dhe për këtë ai përmend një shkak të arsyeshëm, merret në konsideratë fjala e tij, edhe sikur tërheqja e tij prej pretendimit të jetë mohim pas pohimit, sepse mohimi nuk lejohet pas pohimit, kur është i gërshetuar me të drejtën e tjetrit. Por, kur mohimi është në përputhje me atë çka thotë tjetri, ky mohim është i lejueshëm, veçanërisht për gjëra që nuk dihen veçse prej mohuesit. Sikur çështja të merret nga ana e kundërt dhe mohuesi të pohojë martesën me atë grua, pohimi i dalë prej tij pranohet, sepse pohimi pas mohimit nuk është në kundërshtim me pretenduesin, madje është në përputhje të plotë me të.

Autori i librit “El Urvetul Vuthka”, në kapitullin “Martesa”, ka thënë: “Sikur një grua të pretendojë se filan burrë është burri i saj dhe burri e mohon, bën edhe betimin ligjor, por më pas heq dorë prej mohimit që bëri dhe pohon, dëgjohet pohimi

i tij. Por, kur del ndonjë pengesë për mohimin e tij, atëherë vendoset që ata të dy të jenë burrë e grua.”

A vërtetohet martesë për shkak se janë së bashku?

Herë pas herë në gjykata ngrihen pretendime për martesë dhe, në shumicën e rasteve, prokurori ka hetuar se ata të dy banojnë në të njëjtën lagje, ashtu siç banon zakonisht burri dhe gruaja, madje për të vërtetuar martesën sillen edhe dëshmitarë. Në këtë gjendje, a vërtetohet apo nuk vërtetohet martesë?

Përgjigje:

Gjendja, nga ana e jashtme, kërkon daljen e vendimit për martesë, derisa të vërtetohet e kundërta, domethënë, derisa të vërtetohet që ata të dy jetojnë së bashku, sepse edhe qëndrimi së bashku tregon për ekzistencën e martesës. Kjo anë e jashtme e fjalës “së bashku” e bën të detyrueshme pranimin e fjalës së pretenduesit, derisa të mësojmë se ai është gënjeshtar. Por vërtetimi i gënjeshtres së atij që pretendon martesën, është çështje shumë e vështirë, pasi dihet se Imami ka thënë se dëshmia në martesë nuk është kusht.

Megjithatë, kjo anë e jashtme është në kundërshtim me origjinën, që është mosnëdhje e martesës, sepse për çdo ngjarje ka një dyshim për ekzistencën e asaj ngjarjeje, por baza është mosnëdhja e ngjarjes, çka e bën të detyrueshme të kërkohej vërtetimi nga ana e kundërshtarit të pretenduesit. Nëse ai nuk ka mundësi të sjellë argument, mohuesi betohet dhe pretendimi lihet.

Kjo është e drejta që kërkojnë rregullat ligjore, për të cilët fukahatë e imamive kanë rënë në një fjalë të përbashkët, se, kur ana e jashtme është në kundërshtim me origjinën, ka përparësi origjina dhe nuk gjykohet sipas anës së jashtme, me përjashtim të rasteve kur është bindja e plotë, ose kur sillet argument. Por për këtë çështje, argument nuk ka.

Patjetër, kur mësohet se ka ndodhur formula e kontratës dhe nuk ka dyshim se ajo ka ndodhur sipas mënyrës që e bën të vlefshme ose të prishur, padyshim që vendimi merret për vlefshmërinë, edhe nëse dyshimi është në origjinën e ndodhjes së kontratës dhe në asnjë gjendje nuk ka mundësi të zbulohet ekzistenca e kontratës për shkak se ata të dy jetojnë në të njëjtën lagje.

Mbase dikush pyet: Në të vërtetë, rregulli për mbartjen e veprimit të myslimanit në vlefshmërinë, e bën të detyrueshme të veprohet sipas fjalës së atij që pretendon martesën, duke i dhënë përparësi hallallit mbi haramin dhe të mirës mbi të keqen. Veç kësaj, ne jemi të urdhëruar të mbartim të gjitha punët në të cilat lejohet vlefshmëria e prishja, por ama jemi të urdhëruar të anulojmë anën e prishjes dhe të sistemojmë efektet e vlefshmërisë.

Përgjigje:

Mbartja e çështjes që po trajtojmë për vlefshmërinë, nuk vërteton martesën, por vërteton që ata të dy nuk kanë bërë ndonjë veprim haram duke qenë së bashku, apo banojnë në të njëjtën ndërtesë, por edhe mosbërja veprim haram është fakt më përgjithësuese që këtu të jetë martesë, ose një dyshim që ka

ndodhur mes tyre, si për shembull, kur ata të dy kanë menduar se ai veprim është hallall dhe më pas ka rezultuar se ai veprim është haram.

Sqarimet në lidhje me këtë çështje do të trajtohen në kapitullin “Martesa e dyshimtë”. Vetëkuptohet që e përgjithshmja nuk vërtetohet të veçantën. Kur ti thua se në shtëpi gjendet një kafshë, por në shtëpi nuk vërtetohet prania e një kali, ose e një sorkadheje, gjithashtu edhe në çështjen tonë, kur një burrë e një grua janë afër njëri-tjetrit dhe ne nuk e dimë shkakun se përse ata të dy janë afër, ne nuk mund të themi që ajo është grua, madje duhet të themi që ata të dy nuk mëkatuan, sepse afërsia mund të jetë prej martesës, por mund të jetë edhe e dyshimtë.

Për sqarim të mëtejshëm, le të shikojmë shembullin e mëposhtëm: Së bashku me ty është duke ecur një person dhe dëgjon që ai foli një fjalë, por nuk e more vesh, nëse fjala e tij ishte sharje apo ishte përshëndetje. Në këtë gjendje, ti nuk ke të drejtë ta komentosh atë fjalë si sharje, ashtu siç nuk e ke detyrim të kthesh përshëndetjen, domethënë jemi në një gjendje, kur ti nuk sigurohesh dot për ekzistencën e asaj fjale. Ti je i bindur se fjala që ai nxori nga goja ishte përshëndetje, por dyshove, nëse me atë fjalë ai kishte qëllim përshëndetjen e vërtetë, apo ajo fjalë ishte një lloj tallje. Në këtë gjendje, është detyrim të kthehet përshëndetja, duke e mbartur kuptimin e saj mbi vlefshmërinë dhe duke anuar në favor të së mirës mbi të keqen.

Në një gjendje të tillë, nëse e mbartim qëndrimin së bashku mbi vlefshmërinë, nuk vërtetohet ekzistenca e kontratës, por, kur ne dimë që kontrata ekziston dhe dyshojmë në vlefshmërinë e asaj kontrate, atëherë pa asnjë ngurrim e mbartim mbi vlefshmërinë.

Sido që të jetë gjendja, vetëm qëndrimi së bashku, nuk është asgjë, por, kur ajo i bashkon pretendimit edhe një shkak tjetër, i cili e përforcon më shumë pretendimin e saj, çështja është në dorën e gjykatësit dhe në sigurinë e në vlerësimin e tij, me kusht që, thjesht, qëndrimi së bashku të mos merret argument i pavarur për gjykimin e tij.¹

Kjo është në analogji me vërtetimin e martesës. Për sa i përket fëmijëve, mbartja mbi vlefshmërinë kërkon gjykimin që ata janë të ligjshëm në të gjitha gjendjet, sepse qëndrimi së bashku mund të jetë ose prej martesës, ose prej ndonjë dyshimi, por fëmijët e ardhur prej marrëdhënies së dyshimtë, janë si fëmijët e ardhur prej martesës në të gjitha efektet ligjore. Për të gjitha këto, sikur një grua të pretendojë se filani është burri i saj ligjor dhe fëmija është i tij, por burri e mohon dhe njeh vetëm atësinë për fëmijën, njohja e tij pranohet, sepse ka mundësi që ai fëmijë të jetë prej një marrëdhënieje intime të dyshimtë.

Për rrjedhojë, kjo çështje ose plotësohet bazuar në faktin që dëshmia nuk është kusht në kontratën e martesës, ashti siç thonë imametë, ose plotësohet bazuar mbi fjalën e të gjitha medh'hebeve që janë shprehur se ai që pretendon martesën, ka detyrim të sjellë dëshmitarë që ata të dëshmojnë me emër. Kur pretenduesi e ka të pamundur të sjellë dëshmitarët për shkak se ata kanë vdekur, ose për shkak se nuk ndodhen aty, do të vijë fjala që u tha më sipër.

¹ Fjalët e fukahave në librin "El Bulgah" janë trajtuar si çështje dore, kurse në librat "Esh Sheraiu" dhe "El Xheuahir", në kapitullin "Martesa", tregohet se qëndrimi së bashku, me anën e tij të jashtme, zbulon martesën dhe kjo nuk është larg.

Patjetër duhet të theksohet se qëndrimi së bashku nuk vërteton martesën, krahas armiqësisë e konfliktit, por, kur s'ka armiqësi, ne i rendisim të gjitha efektet e martesës, si trashëgimia, etj, ashtu siç veprohet sipas të gjitha medh'hebeve.

Pretendimi për një grua të martuar

Kur një burrë ka pretendim për një grua se ka lidhur martesë me atë para burrit të dytë, pretendimi i tij nuk dëgjohet, përveçse kur sjell argument. Nëse nuk sjell argument, pretendimi i tij hidhet poshtë, pra, nuk merret në konsideratë pohimi për martesën, edhe sikur gruaja të thotë të vërtetën. Gjithashtu, gruas nuk i kërkohet betim, nëse ajo mohon, sepse ajo, në të vërtetë, drejtohet kundër mohuesit, i cili, sikur të pohojë atë çka mohoi, patjetër që me pohimin që ai bëri, do të gjykohej kundër tij, në atë mënyrë se nuk lejohet gjykimi për martesën, kur gruaja pohon martesën dhe nuk kërkon betim. Është shumë e përhapur në mesin e fukahave dëshmia e autorit të librit “Mulhakatul Urveh” se çdo çështje që nuk kërkon dhënien në dorë, krahas pohimit, nuk kërkon betimin krahas mohimit.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që është martuar me një grua, vetëm pasi e ka pyetur gruan: “A ke burrë?” Ajo i është përgjigjur: “Jo.” Më pas vjen një burrë tjetër dhe thotë se ajo është gruaja e tij. Ndërkaq gruaja e mohon që është gruaja e pretenduesit. Ç' duhet të bëjë burri? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Ajo është gruaja e tij, derisa pretenduesi të sjellë argumentin.”

Martesa e gruas para përfundimit të pretendimit

Kur një burrë pretendon martesën me një grua dhe gruaja e mohon, a lejohet për këtë grua të martohet, para se të përfundojë pretendimi dhe para se ajo të ndahet nga ky pretendim?

Autori i librit “El Urvetul Vuthka”, si dhe El Hakijmi në librin “El Mustemsek”, në vëllimin 9, kanë thënë se kjo është një e drejtë e gruas, sepse ajo është e çliruar para gjykimit të saj për martesë dhe punët personale ajo i ka nën zotërimin e saj.

Shtrohet pyetja: Por si, në një kohë, kur në martesën e saj ka një humbje për të drejtën e pretenduesit, i cili është në procesin e vërtetimit të së drejtës së tij. Për rrjedhojë, pretendimi i tij nuk rrëzohet me rrëzimin e pretendimit¹, sepse martesa e gruas me një tjetër nuk është veprim në të drejtën e tjetrit, pasi e drejta e tij qëndron më lart për shkak të subjektit që trajtohet.

* * *

¹ Rrëzimi i pretendimit në gjykatat e ligjit të fesë, si dhe heqja dorë përfundimisht prej pretendimit, janë veprime që e bëjnë rrëzimin të detyrueshëm dhe mbyllin rrugën për një pretendim të dytë. Me këtë rregull punojnë gjykatat e ligjit të fesë në Liban. Bazuar në kërkesat e sentencës (fetvasë) së sejjid El Hakijm, këto gjykata nuk janë gjykata të ligjit të fesë. Patjetër duhet të merren në analogji me atë që ka parasysh zakonisht sejjidi.

GRATË E NDALUARA

(me të cilat burri nuk mund të martohet)

Allahu i Gjithëpushtetshëm thotë në Librin e Tij:

”وَلَا تَنْكِحُوا مَا نَكَحَ آبَاؤُكُمْ مِنَ النِّسَاءِ إِلَّا مَا قَدْ سَلَفَ ۚ إِنَّهُ كَانَ فَاحِشَةً وَمَقْتًا وَسَاءَ سَبِيلًا. حُرِّمَتْ عَلَيْكُمْ أُمَّهَاتُكُمْ وَبَنَاتُكُمْ وَأَخَوَاتُكُمْ وَعَمَّاتُكُمْ وَخَالَاتُكُمْ وَبَنَاتُ الْأَخِ وَبَنَاتُ الْأُخْتِ وَأُمَّهَاتُكُمُ اللَّاتِي أَرْضَعْنَكُمْ وَأَخَوَاتُكُمُ مِنَ الرِّضَاعَةِ وَأُمَّهَاتُ نِسَائِكُمْ وَزَوَّاتُكُمُ اللَّاتِي فِي حُجُورِكُمْ مِّنْ نِّسَائِكُمُ اللَّاتِي دَخَلْتُم بِهِنَّ فَإِنْ لَّمْ تَكُونُوا دَخَلْتُم بِهِنَّ فَلَا جُنَاحَ عَلَيْكُمْ وَحَلَائِلُ أَبْنَائِكُمُ الَّذِينَ مِنْ أَصْلَابِكُمْ وَأَنْ تَجْمَعُوا بَيْنَ الْأُخْتَيْنِ إِلَّا مَا قَدْ سَلَفَ ۚ إِنَّ اللَّهَ كَانَ غَفُورًا رَّحِيمًا. وَالْمُحْصَنَاتُ مِنَ النِّسَاءِ إِلَّا مَا مَلَكَتْ أَيْمَانُكُمْ ۚ كِتَابَ اللَّهِ عَلَيْكُمْ ۚ وَأُحِلَّ لَكُمْ مَا وَرَاءَ ذَلِكَ”

“Mos i merrni ato gra që kanë qenë gratë e baballarëve tuaj, përveç rasteve që tashmë kanë kaluar. Vërtet, kjo është vepër e keqe dhe rrugë e shëmtuar. Ju ndalohet martesë me nënat tuaja, me bijat tuaja, me motrat tuaja, me hallat tuaja, me tezet tuaja, me bijat e vëllezërve dhe bijat e motrave, me nënat (gratë) që ju kanë dhënë gji, me motrat tuaja, që kanë thithur prej një gjiri, me nënat e grave tuaja, me vajzën e gruas suaj që gjendet nën kujdestarinë tuaj, nëse me atë grua keni pasur marrëdhënie bashkëshortore; e, nëse nuk keni pasur marrëdhënie

bashkëshortore, atëherë nuk ka pengesa. Ju ndalohet martesë me gratë e bijve tuaj dhe t'i bashkoni dy motra, përveç rasteve që tashmë kanë kaluar. Pa dyshim, Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë. (Ju ndalohet martesë) edhe me gratë që gjenden nën kurorë, përveç atyre që i zini robëresha. Ky është urdhri i Allahut. Ju janë lejuar të tjerat, me kusht që t'i kërkonit me pasurinë tuaj për martesë e jo për jetë të përkohshme. Grave, me të cilat kaloni jetë bashkëshortore, jepuni dhuratat e detyrueshme (për jetesë). S'ka gjynah për ju, me pëlqimin e të dyja palëve, që ta shtoni apo ta pakësoni sasinë e dhuratës së premtuar. Se, Allahu, me të vërtetë, është i Gjithëdijshtëm dhe i Urtë. (Sure "En Nisa", ajetet 22-24)

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur në lidhje me marrëdhëniet intime që Allahu ka bërë haram në Kuran dhe për marrëdhëniet intime që ka bërë haram i Dërguari i Allahut (*Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) në Sunetin e tij.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: "Allahu i Gjithëpushtetshëm ka bërë haram prej marrëdhënieve intime tridhjetë e katër kategori, shtatëmbëdhjetë prej të cilave në Kuran dhe shtatëmbëdhjetë në Sunetin e Profetit (*Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*)."

Në Kuran ndalohet kurvërimi, për cilën Allahu thotë në Librin e Tij:

“وَلَا تَقْرُبُوا الزُّنَىٰ”

“Mos iu afroni kurvërimin...” (Sure "El Isra", ajeti 32)

Allahu i Lartësuar ka ndaluar rreptësisht martesën me gruan e babait dhe për këtë Ai thotë: **“Mos i merrni ato gra që kanë qenë gratë e baballarëve tuaj, përveç rasteve që tashmë kanë kaluar. Vërtet, kjo është vepër e keqe dhe rrugë e shëmtuar. Ju ndalohet martesa me nënat tuaja, me bijat tuaja, me motrat tuaja, me hallat tuaja, me tezet tuaja, me bijat e vëllezërve dhe bijat e motrave, me nënat (gratë) që ju kanë dhënë gji, me motrat tuaja, që kanë thithur prej një gjiri, me nënat e grave tuaja, me vajzën e gruas suaj që gjendet nën kujdestarinë tuaj, nëse me atë grua keni pasur marrëdhënie bashkëshortore; e, nëse nuk keni pasur marrëdhënie bashkëshortore, atëherë nuk ka pengesa. Ju ndalohet martesa me gratë e bijve tuaj dhe t’i bashkoni dy motra, përveç rasteve që tashmë kanë kaluar.”**

Janë të ndaluara marrëdhëniet intime, kur gratë janë në periudhën e menstruacioneve, derisa ato të pastrohen. Për këtë, Allahu i Lartësuar thotë:

“وَلَا تَقْرُبُوهُنَّ حَتَّى يَطْهُرْنَ”

“...dhe mos iu afroni atyre (grave), derisa ato të pastrohen...”
(Sure “El Bekare”, ajeti 222)

Gjithashtu, marrëdhëniet intime janë të ndaluara kur jeni në Itikaf. Për këtë çështje, Allahu i Lartësuar thotë:

“وَلَا تُبَاشِرُوهُنَّ وَأَنْتُمْ عَاكِفُونَ فِي الْمَسَاجِدِ”

“...dhe mos kryeni marrëdhënie intime me gratë kur ju jeni të izoluar (në Itikaf) në xhami...” (Sure “El Bekare”, ajeti 187)

Kurse ndalimet në Sunetin e Profetit (Paqja dhe bekimi i Allahut goftë mbi të dhe mbi familjen e tij!) janë: kryerja e

marrëdhënieve intime në Ditët e Ramazanit. Është e ndaluar martesë me gruan pas vetëmalkimit (el liân), kur burri akuzon gruan për tradhti bashkëshortore pa dëshmitarë, por me betim e vetëmalkim të ndërsjellë të burrit e të gruas.

Gjithashtu, është e ndaluar martesë me gruan të cilës burri i ka thënë që është e divorcuar dhe ajo është duke qëndruar të plotësojë kohën ligjore të pritjes (id'det). Janë të ndaluara marrëdhëniet intime, kur burri ka veshur Ihramin (për Haxh). Burri në Ihram e ka haram të martohet vetë e të martojë të tjerët.

Gjithashtu, janë të ndaluara marrëdhëniet intime me gruan së cilës burri i ka thënë që e ka në vend të nënës, para se ai të bëjë shlyerjen; është e ndaluar martesë me një idhujtare; është e ndaluar martesë me një grua të divorcuar, që është në kohën e pritjes dhe që burri i ka thënë asaj nëntë herë je e divorcuar; është e ndaluar martesë me një skllave, kur ke gruan e lirë; është e ndaluar martesë me një grua prej ithtarëve të librave të mëparshëm, që janë nën besën e shtetit islam, kur ke gruan myslimane; është e ndaluar martesë me mbesën, kur ke grua hallën, ose tezen e saj; është e ndaluar martesë me një skllave, pa lejen e pronarit të saj, si dhe martesë me një skllave, kur burri ka fuqi të martohet me një të grua të lirë; është e ndaluar kryerja e marrëdhënieve intime me robëreshat e luftës para se të kryhet pjesëtimi i robëreshave; është e ndaluar martesë me skllaven me dy pronarë, gjithashtu, edhe me skllaven e blerë, para se ajo të pastrohet (të kalojë një menstruacion), si dhe me skllaven që e ka blerë lirinë e saj, duke i paguar pronarit të vet me këste shumë e caktuar.

Në këtë transmetim, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka përmendur edhe rastet kur është haram kryerja e marrëdhënieve intime, siç është gruaja në kohën e menstruacioneve, etj. Gjithashtu, ai ka përmendur edhe rastet kur është haram martesë, siç ishte martesë me nënën, etj.

Ndaluesit

Gruaja për të cilën bëhet qëllim të lidhet kontrata e martesës, është kusht të jetë pa pengesa për të bërë një kontratë të vlefshme, domethënë të ketë të gjitha kushtet pozitive, si për shembull, mendja, të ketë arritur moshën e pjekurisë seksuale, di të orientohej dhe është e lirë nga të gjitha ndalesat. Ndalet janë dy llojesh: përkatësi familjare dhe shkak. Shkak është dy llojesh, shkak që e bën gruan të ndaluar përgjithmonë, si për shembull, gruaja e babait, ose nusja e djalit, si dhe shkak që e bën gruan të ndaluar përkohësisht, si për shembull, martesë me motrën e gruas.

Po japim tani hollësisht rastet:

a) Përkatësia familjare

Përkatësia familjare ka lidhje me lindjen e njeriut prej një tjetri, ose kanë lidhje dy vetë deri te një i tretë dhe përfundon me të afërmin, në atë mënyrë që, në pikëpamjen e traditës, ai është prej të afërmeve me të cilët nuk lejohet martesë. Përkatësia familjare është shtatë kategori:

1- Nëna, që përfshin edhe gjyshen prej babait dhe gjyshen prej nënës.

2- Bijat, që përfshijnë bijat e djalit, bijat e vajzës dhe më poshtë.

3- Motrat prej babait, motrat prej nënës dhe motrat prej një nënë e prej një babe.

4- Hallat, që përfshijnë hallat e prindërve dhe hallat e gjyshërve.

5- Tezet, që përfshijnë tezet e prindërve dhe tezet e gjyshërve.

6- Bijat e vëllait edhe më poshtë.

7- Gjithashtu, edhe bijat e motrave.

Bazë për këtë është ajeti 23 i sures “En Nisa”. Për sa u përket kategorive të grave të ndaluara me shkakun, ato janë të shumta, disa prej të cilave do t’i përmendim në vijim:

b) Krushqia

Krushqia është një lidhje që ndodh për shkak të martesës dhe që kërkon ndalimin e martesës me disa të afërm të gruas, ose të burrit, në veçanti dhe si tërësi sipas sqarimit vijues:

1- Djali e ka haram përgjithmonë të martohet me gruan e babait të tij, edhe nëse ato janë disa sipas kontratës. Me tekst e me fjalën e përbashkët të fukahave, kjo është e barabartë, qoftë kur babai ka kryer ose jo me marrëdhënie intime me gratë që ka vënë kurorë.

Prej teksteve, për këtë çështje kemi ajetin e lartpërmendur në krye të kapitullit: “Mos u martoni me gratë me të cilat ishin martuar prindërit tuaj...”. Martesa është një e vërtetë e saktësuar në kontratën e martesës.

2- Për babain është përgjithmonë haram gruaja e djalit, me fjalën e përbashkët të fukahave dhe me tekst, edhe nëse janë disa. Prej teksteve kemi fjalën e Allahut të Lartësuar në ajetim e mësipërm: “...si dhe gratë e djemve tuaj natyralë...”

3- Është e ndaluar përgjithmonë martesa me nënën e gruas edhe më sipër. Por vallë, a është e ndaluar thjesht për shkak të kontratës së martesës me vajzën e saj, apo nëna e gruas është haram për burrin e vajzës, vetëm nëse ai ka kryer marrëdhënie intime me vajzën e saj?

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Në lidhje me këtë çështje, flasin dy transmetime. Një prej këtyre dy transmetimeve është transmetim dhe fetva, e cila e bën haram martesën me nënën e gruas thjesht për shkak të kontratës së martesës. Madje në librin “El Gun’jeh” dhe në librin “En Nàsirij’jàt”, thuhet se kjo çështje gëzon fjalën e përbashkët të fukahave, sepse fjala e Allahut: “**...dhe gratë e nënave tuaja...**” është përgjithësuese. Njëkohësisht edhe për faktin se për këtë çështje ka njoftime. Gjithashtu edhe për rezervë.

Në librin “El Mekasib”, cituar prej shejkht Et Tusij, i njohur me epitelin “*Shejkhu taifeh*”, thuhet se transmetimi që flet për ndalimin e martesës së burrit me nënën e gruas, edhe nëse burri nuk ka kryer marrëdhënie intime me gruan e vet, është në përputhje të plotë me Librin e Allahut, kurse transmetimi që

tregon se martesë me nënën e gruas nuk është e ndaluar, kur burri nuk ka kryer marrëdhënie me gruan e tij, është në kundërshtim me Librin e Allahut. Rregulli që është në pajtim të plotë me fjalën e të gjithë fukahave, duhet të parashtrihet për kundërshtim, thënë ndryshe merret në përputhje me rregullin krahas kundërshtimit. Më pas, autori i librit “El Mekasib” thotë: “Si është e mundur, kur medh’hebi mbështet ndalimin në mënyrë absolute?”

4- Është e ndaluar rreptësisht martesë me vajzën e gruas, për shkak se burri ka kryer marrëdhënie intime me gruan dhe nuk është e ndaluar martesë me vajzën e gruas për shkak të kontratës së martesës, sepse me fjalën e përbashkët të fukahave, kur burri e divorcon gruan para se të kryejë marrëdhënie intime me të, lejohet që ai të bëjë kontratë martesë me vajzën e kësaj gruaje, ashtu siç është fjala e Allahut të Lartësuar: “...vajzat e grave tuaja që janë nën kujdesin tuaj me nënat e të cilave keni kryer marrëdhënie intime...”

Ajeti i nderuar ka përmendur kujdestarinë në shtëpinë tuaj, për të shpjeguar atë që ndodh në shumicën e rasteve. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) tregon se Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) thoshte: “Janë haram për ju vajzat e grave tuaja, me të cilat keni kryer ose jo marrëdhënie intime, sepse nënat janë të barabarta, pavarësisht nëse burri ka kryer ose jo marrëdhënie intime me ato.” Prandaj fukahatë e kanë bërë haram martesën me vajzën e gruas.

c) Ndalimi i bashkimit

Është e ndaluar martesë me dy motra, qoftë kur janë motra vetëm prej babai, qoftë kur janë motra vetëm prej nënës, qoftë kur

janë motra prej babai e prej nënës, ashtu siç është fjala e Allahut të Lartësuar: “...të bashkoni dy motra...”

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Me librin e Allahut, me Sunetin e Profetit dhe me fjalën e përbashkët të fukahave.”, nëse motra vdes, ose burri e divorcon dhe, nëse divorci është i kthyeshëm, burri ka të drejtë të lidhë kontratë martese me motrën e gruas që ai divorcoi, pasi ajo të përfundojë kohën e pritjes ligjore. Nëse divorci është i pakthyeshëm, kontrata e martesës me motrën e kësaj gruaje, lejohet të lidhet edhe para përfundimit të kohës së pritjes së motrës së divorcuar, sepse gruaja me divorc të kthyeshëm vazhdon të jetë në pozitën e gruas. Pikërisht për këtë fakt, mbetet detyrim edhe shpenzimi për atë, ashtu siç mbetet e lejuar edhe rikthimi te ajo.

Shumica e fukahave janë shprehur se, në mënyrë absolute, lejohet që halla e tezja të martohen me burrin që ka vajzën e të vëllait të saj ose me burrin që ka vajzën e motrës së saj, por nuk lejohet që vajza e vëllait të martohet me burrin që ka hallën, ose vajza e motrës të martohet me burrin që ka tezen, përveçse me lejen e hallës ose me lejen e tezës, domethënë se, kur burri, së pari, është martuar me vajzën e vëllait ose me vajzën e motrës, ai ka të drejtë të martohet me hallën e gruas së tij, ose me tezen e gruas, qoftë edhe kur gruaja që është mbesë për hallën e për tezen nuk i jep leje burrit.

Por kur burri, më parë, është martuar me hallën ose me tezen, burrit nuk i lejohet që të lidhë kontratë martese me vajzën e vëllait të gruas, ose me vajzën e motrës së gruas, përveçse kur i jep leje vetë halla ose vetë tezja të marrë edhe mbesën e tyre.

Fukahatë e kanë nxjerrë këtë rregull prej ajetit 23 të sures “En Nisa”, në të cilin Allahu i Lartësuar cakton numrin e grave të ndaluara dhe me fjalën e Tij të nderuar lejon të tjerat: “...me përjashtim të këtyre, keni leje të martoheni me të tjerat...”

Fjala “me përjashtim të këtyre” përfshin hallën e gruas, si dhe tezen e gruas. Sikur bashkimi hallë-mbesë dhe teze-mbesë të ishte i ndaluar, patjetër që teksti i Kuranit për ndalimin do të ishte i prerë, ashtu siç është i prerë për bashkimin e dy motrave.

Për sa i përket kushtit të lejes prej hallës, ose prej tezes, për këtë tregon transmetimi i ardhur prej Imam Bakirit, babait të Xhafer Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Ti nuk martohesh me vajzën e vëllait as me vajzën e motrës, kur ke për grua hallën ose tezen, përveçse kur halla ose teza të jep leje të martohesh edhe me mbesën e tyre, por ti lejohesh të martohesh pa lejen e gruas me hallën ose me tezen e gruas, domethënë mund të marrësh edhe hallën e gruas, ose tezen e gruas, pa lejen e gruas, e cila është ose vajza e vëllait, ose vajza e motrës së gruas që ke.”

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Këtë unë e gjej pa asnjë kundërshtim që e atakon, madje prej librit “Et Tedhkireh” mësojmë se kjo çështje gëzon fjalën e përbashkët të fukahave dhe pas origjinës është argumenti për lejimin, pasi lejimi përfshihet në fjalën e ajetit të nderuar: “...me përjashtim të këtyre, keni lejë të martoheni me të tjerat...”

d) Kurvërimi

Në lidhje me kurvërimin do të trajtojmë disa çështje:

1- Burrit nuk i lejohet të martohet me vajzën e tij të ardhur prej kurvërimit të tij, as me vajzën e djalit të tij të ardhur prej kurvërimit të tij, as me vajzën e vajzës së tij të ardhur prej kurvërimit, as me vajzën e vëllait e me vajzën e motrës së tij, sepse ajo, nëse është e ardhur prej kurvërimit, në të vërtetë, është prej të njëjtit ujë nga ai cili kanë lindur edhe ato, prandaj qoftë nga pikëpamja gjuhësore, qoftë nga pikëpamja e traditës, ajo është vajza e tij. Veç kësaj, dispozitat ndjekin emërtimet, por me argument ka dalë jashtë trashëgimia dhe detyrimi për ushqimin dhe mbeten të tjerat për shpërndarjen e haramit mbi pozitiven.

2- Nuk ka efekt për kurvërimin incidentet e të papriturat pas aktit të martesës, për shembull, burri kurvëron me nënën e gruas, ose me vajzën e gruas së tij, ose babai kurvëron me nusen e djalit të tij, ose djali kurvëron me gruan e babait të tij. Në të gjitha këto gjendje, gruaja me të cilën u kurvërua nuk është haram për burrin e saj ligjor, sipas rregullit “Harami nuk bën haram hallallin, pasi harami kurrë nuk e bën haram hallallin”, ashtu siç ka ardhur prej Ehli Bejtit (*Paqja e Allahut qoftë mbi ta!*), duke shtuar edhe tekstet e veçanta, prej të cilave kemi transmetimin që tregon, kur burri është martuar me një grua dhe ka kryer marrëdhënie intime me atë, më pas djali i këtij burri kurvëron me gruan e babait të tij. Ky kurvërim nuk sjell asnjë dëm mbi kontratën e martesës, sepse harami nuk e prish hallallin. Rasti tjetër, kur burri ka një grua dhe më pas ai mëkaton me nënën e gruas, ose me vajzën e gruas, gruaja nuk është haram për të, sepse harami nuk e prish atë që është hallall.

3- Kurvërimi para lidhjes së kontratës së martesës e bën të detyrueshme prishjen e krushqisë, për shembull, ai që kurvëron

me një grua, me këtë grua nuk lejohet të lidhin kontratë martese as babai e as djali i tij.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Me fjalën e përbashkët të shumicës së fukahave, kjo është thënia më e përhapur.”

Kemi edhe fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Kur një burrë kurvëron me një grua, vajza e asaj gruaje kurrë nuk është hallall për të.”, domethënë që atij nuk i lejohet të lidhë kontratë martese me atë grua, sepse babai i tij kurvëroi me të.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që ka kurvëruar me një grua, nëse ajo është hallall për djalin e tij? Ai është përgjigjur: “Jo.”

Kjo ishte për ndalimin e prerë të asaj gruaje për babain e për djalin e kurvarit, kurse në raport me vetë kurvarin, nëse lejohet që ai të lidhë kontratë martese me gruan me të cilën kurvëroi dhe më pas të martohet me atë, fukahatë kanë mendime të ndryshme, me faktin se lavirja ishte e martuar, ose ishte në kohën e pritjes ligjore për shkak të divorcit të kthyeshëm. Kjo kategori grash është e ndaluar përgjithmonë, domethënë që kurvarit nuk i lejohet të bëjë kontratë martese me gruan me të cilën kurvëroi, e cila në kohën e kurvërimit ishte duke kaluar kohën e pritjes ligjore për shkak divorci ose për shkak të vdekjes së burrit. Nëse gruaje në kohën e kurvërimit është e lirë nga këto që u thanë, ose është në kohën e pritjes për shkak divorci të pakthyeshëm, kjo grua nuk është e ndaluar të martohet me burrin me të cilin kurvëroi.

Në librin “Esh Sheràiru” thuhet se, kur burri kurvëron me një grua të martuar, ose me një grua që është në kohën e pritjes ligjore për shkak divorci të kthyeshëm, me fjalën e fukahave më të dëgjuar, për burrin me të cilin ajo kurvëroi, është e ndaluar përgjithmonë, domethënë se ajo kurrë nuk mund të martohet me të.

Autori i librit “El Xheuahir”, në komentimin e kësaj fraze ka thënë: “Madje në këtë unë nuk gjej asnjë kundërshtim, ashtu siç ka ardhur prej një grupi fukahash.”

Në librin “El Gun’jeh” dhe prej El Hil’lij dhe Krenarisë së studiuesve (fakhrul muhak’kijn), thuhet se kjo çështje gëzon fjalën e përbashkët të fukahave. Gjithashtu, për këtë çështje ka një transmetim të gradës “Dobët” (Daijf), sepse ai transmetim është marrë prej librave të fik’hut, ku vargu i përcjellësve ka shkuar deri te imam Rizai (*Paqja qoftë mbi të!*), por kërkohet maturi. Më tej, autori i librit “El Xheuahir” vazhdon: “Mbështetësit e kësaj thënieje janë bazuar në fjalën e përbashkët të fukahave, pa bërë asnjë dallim në fjalën e përbashkët të fukahave mes atij që ka dijeni dhe atij që nuk ka dijeni. Gjithashtu, ata nuk bëjnë asnjë dallim, nëse kurvari e di ose jo që ajo ka burrë; nuk bëjnë dallim mes martesës së përhershme e martesës së ndërprerë.”

Gjithashtu, autori i librit “El Xheuahir” ka thanë: “Kur burri kurvëron me një grua që nuk ka ndalues, ai nuk e ka të ndaluar të martohet me atë grua, edhe nëse ajo nuk ka bërë pendesën (teube). Kjo fjalë është në përputhje me mendimin e fukahave më të dëgjuar dhe ka një përhapje shumë të madhe, madje në librin “El Khilaf”, thuhet se kjo thënie gëzon fjalën e përbashkët të fukahave për shkak se transmetimet dhe rregullat

janë përgjithësuese, siç është rregulli “Harami nuk e bën haram hallallin”, si dhe transmetimi specifik i përmendur në “Sahijhun” e El Hil'lij, prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) që thotë: “Çdo burrë që kurvëron me një grua dhe më pas ai mendon që me atë grua të bëjë martesë hallall, kjo është e lejueshme, edhe pse fillimi i kësaj martese ishte kurvërim, kurse fundi është kurorëzim.”

E ngjashme me këtë martesë është rasti kur burri merr haram frutat e hurmës dhe pastaj e ble pemën, kështu që frutat tani janë hallall.

Këtë transmetim fukahatë e kanë kushtëzuar në kuptimin që gruaja pa ndalesa, nuk është as grua e martuar e as grua që kalon kohën e pritjes ligjore për shkak të divorcit të kthyesëm. Por për kushtëzimin nuk ka argument tjetër përveç fjalës së përbashkët të fukahave, ashtu siç ka thënë edhe autori i librit “El Xheuahir”.

Është prej punëve të mira të theksojmë me këtë rast se Ehli Bejti (*Paqja e Allahut qoftë mbi ta!*) e ka lejuar martesën me një grua të njohur për prostitucion, me shpresë se ajo do të bëjë jetën e grave të ndershme dhe do të heqë dorë prej kurvërimit.

Imam Bakiri, babai i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë, të cilin e ka mahnitur një grua dhe, kur burri pyet për atë grua, gratë e njoftojnë se ajo është prostitutë. Si duhet të veprojë? Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “S’ka problem që ai të martohet me të dhe ta bëjë atë grua të ruajtur.”

Kontrata e martesës për gruan që është në kohën e pritjes ligjore

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët me dëshminë e autorit të librit “El Xheuahir” dhe me autorin e librit “El Hadaik” se, kur burri lidh kontratë martese për një grua që është në kohën e pritjes ligjore për shkak të vdekjes së burrit, ose për shkak divorci të pakthyeshëm, ose për shkak të divorcit të kthyeshëm, ose për shkak dyshimi, kontrata e martesës prishet dhe, në mënyrë absolute, ajo kontratë martese nuk ka asnjë efekt. Kjo është e barabartë, nëse ai ka dijeni ose jo për dispozitën dhe për subjektin, ose ka dijeni vetëm për njërin dhe s’ka për tjetrin. Dijeni për subjektin është kur burri e di që gruaja është në kohën e pritjes ligjore dhe dijeni për dispozitën është kur burri e di që e ka haram të lidhë kontratë martese me atë grua.

Këtu del një pyetje: Nëse lidhja e kontratës së martesës e bën të detyrueshme ose jo ndalimin kategorik të martesës me atë grua, në kuptimin që kur përfundon koha e pritjes ligjore, për burrin nuk lejohet të lidhë kontratë martese me atë grua, për rrjedhojë, a mund të martohet një tjetër me atë grua?

Përgjigjja kërkon sqarimet vijuese:

1- Ai ka bërë kontratë martese dhe ka kryer edhe marrëdhënie intime me atë grua. Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se ajo grua është e ndaluar përgjithmonë për atë burrë. Kjo është e barabartë qoftë kur burri ka dijeni për dispozitën dhe për subjektin, qoftë kur ka dijeni vetëm për dispozitën, ose vetëm për subjektin.

2- Burri e di që ajo është në kohën e pritjes ligjore, gjithashtu e di që ajo grua për atë është kategorikisht e ndaluar, megjithëkëtë ai bën kontratë martese me atë grua. Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se ajo grua për këtë burrë është e ndaluar përgjithmonë.

Nga brendia e pyetjes, detyrimisht lind një nënpyetje: Nëse kurvërimi është kryer, kur gruaja ishte në kohën e pritjes ligjore, për shkak të vdekjes së burrit, ose për shkak të divorcit të pakthyesëm, siç u tha më sipër, në këtë rast, ndalimi i kësaj gruaje nuk bëhet detyrim. Pyetja është: Si e bën detyrim kontrata e martesës ndalimin e përhershëm, pa kryer marrëdhënie intime? A mund të jetë më i madh efekti i fjalës se sa efekti i veprimit?

Përgjigjja është: Argumenti ndarës në këtë çështje është teksti që do të përmendim në numrin 3 dhe s'ka asnjë argument tjetër përveç tij.

3- Burri lidh kontratë martese me atë grua, por nuk kryen marrëdhënie intime, por ama ka bërë kontratën e martesës, duke mos pasur dijeni që ajo është në kohën e pritjes ligjore; ose ai nuk ka dijeni që ai e ka të ndaluar rreptësisht të bëjë kontratë martese për atë grua. Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se ajo nuk është e ndaluar përgjithmonë për atë, por ai ka detyrë të presë përfundimin e kohës së pritjes ligjore që të rifillojë bërjen e kontratës së martesës dhe të martohet me atë grua. Autori i librit "El Mesalik" ka thënë: "Në lidhje me këtë çështje, ka shumë transmetime."

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Në këtë unë nuk gjej kundërshtim në asgjë, madje me fjalën e përbashkët të fukahave,

kjo thënie është argument pas transmetimeve specifike dhe të detajuara. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Burri që martohet me një grua në kohën e pritjes ligjore dhe kryen me atë marrëdhënie intime, ajo grua kurrë nuk është e lejuar për atë burrë.”

Gjithashtu, ai ka thënë: “Kur burri martohet me gruan në kohën kur ajo është duke kryer pritjen ligjore dhe kryen me atë grua marrëdhënie intime, ajo grua nuk është e ndaluar për atë përgjithmonë. Kjo është e barabartë, qoftë kur ai e di, qoftë kur nuk e di që gruaja ishte në kohën e pritjes ligjore. Por nëse nuk ka kryer marrëdhënie intime, ajo grua është e ndaluar për atë burrë, nëse ai nuk kishte dijeni që ajo ishte në kohën e pritjes ligjore. Por ajo është e ndaluar, nëse ai kishte dijeni për gjendjen e saj.”, domethënë që pasja dijeni është e veçantë për njërin dhe nuk është për tjetrin. Pra, nëse burri ka dijeni për gjendjen e gruas, e ka të ndaluar martesën me atë grua. Gjithashtu, ajo është ndaluar edhe për burrin që nuk kishte dijeni, por ai ka kryer marrëdhënie intime me atë grua.

Kontrata e martesës me gruan e martuar

Dispozita e kontratës së martesës me gruan e martuar është e njëjta dispozitë me kontratën e martesës me gruan që është në kohën e pritjes ligjore, në të gjitha gjendjet, sepse janë të barabarta në kuptim e në shtesë, që është marrëdhënia martesore. Prandaj ndalimi i martesës me gruan e martuar, në radhë të parë, vërtetohet nga këndvështrimi i kuptimit të pranimit, ashtu siç ka thënë autori i librit “El Mesalik”.

Përveç fjalës së këtij autori, duhet të shtohet edhe fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Gruaja e martuar që marton vetveten, ndahet dhe të dy kurrë nuk kthehen te njëri-tjetri.”

Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një grua të cilës i erdhi lajmi për vdekjen e burrit dhe ajo u martua. Por më pas burri i kësaj gruaje vjen. Si duhet të veprojë kjo grua? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Ajo kalon vetëm një kohë pritje ligjore për të dy burrat, tre muaj. Burri i fundit s’ka të drejtë përgjithmonë të martohet me atë grua.”

Numri i grave

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se burri ka të drejtë të mbajë nën kurorë katër gra, me kusht që mos të ketë frikë se bie në imoralitet dhe mban drejtësi mes grave, ashtu siç thuhet qartë në ajetin e nderuar të Kuranit Famëlartë. Drejtësia e kërkuar këtu është pjesëtimi i ditëve ndërmjet grave. Për këtë çështje do të flitet në vendin e vet.

Gjithashtu, burri ka detyrim të mbajë barazi në shpenzimin për të gjitha gratë e veta, si dhe në trajtimin e tyre, kurse drejtësia e barazia në dashurinë ndaj grave, nuk kërkohet, sepse është obligim që nuk mund të mbahet.

Bazë për numrin e grave është fjala e Allahut të Lartësuar:

“...فَانكِحُوا مَا طَابَ لَكُمْ مِنَ النِّسَاءِ مَثْنَى وَثُلَاثَ وَرُبَاعَ ۚ فَإِنْ حِفْظُهُمْ إِلَّا تَعْدِلُوا فَوَاحِدَةً...”

“...atëherë martohuni me gratë që ju pëlqejnë, me dy, tri e me katër dhe, nëse kini frikë se nuk do të mbani drejtësi (mes grave), atëherë vetëm një...” (*Sure En Nisa*”, ajeti 3)

Lidhësja “dhe” në vijim të ajetit ka të bëjë me përzgjedhjen dhe jo me martesën me më shumë se katër gra, ndryshe do të ishte e lejuar martesa edhe me 18 gra. Martesa me më shumë se katër gra, është martesë pa vlerë. Kufizimi i martesës deri në katër gra është prej domosdoshmërive të fesë.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Nuk lejohet të bashkohen më shumë se katër gra.”

Gjithashtu, ai ka thënë: “Burri nuk e bashkon ujin e tij në pesë.”

Kur njëra prej grave del prej martesës, për shkak të vdekjes, ose për shkak divorci të pakthyesëm, burri lejohet të martohet me një grua tjetër, por atij nuk i lejohet të martohet me gruan e pestë, kur gruaja e katërt është në kohën e pritjes ligjore për shkak divorci të kthyesëm, sepse gruaja e divorcuar me divorc të kthyesëm është në dispozitën e gruas, nga pikëpamja e detyrimit që ka burri të shpenzojë për të, sepse lejohet që ai të rikthehet te ajo grua.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur gruaja e divorcuar pastrohet dhe nuk ka divorc të kthyesëm, burri ka të drejtë të martohet me motrën e asaj gruaje.”

Fukahatë më të dëgjuar, në lidhje me martesën e pestë, nuk kanë bërë dallim ndërmjet motrës së gruas së divorcuar dhe të një gruaje tjetër, sepse shkak për lejimin e kurorëzimit me secilën

prej atyre të dyjave është shkëputja e gruas së divorcuar prej lidhjes martesore dhe bërja e saj e huaj për ish-burrin, ose si e huaj për atë. Këtë çështje e mbështet fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Burri nuk e bashkon ujin e tij në pesë.” Kjo do të thotë se gruaja e divorcuar me divorc të pakthyesëm, nuk lejohet të martohet me atë që e divorcoi.

Akuzimi i gruas shurdhmemece

Memecëria është sëmundje e gjuhës, e cila e pengon njeriun të flasë, kurse shurdhëria është sëmundje që shkakton humbjen e shqisës së dëgjimit. Një burrë e ka gruan shurdhmemece, domethënë, gruaja e tij as flet e as dëgjon, megjithëkëtë burri e akuzon këtë grua për kurvëri. Në lidhje me këtë çështje do të jepen hollësitë e mëposhtme:

1- Burri e akuzon atë për kurvëri, pa pretenduar se ka dëshmitarë, ose që ka argument. Kjo grua nuk është haram për këtë burrë, por burri do të ndëshkohet me dënimin që parashikon ligji i fesë për atakimin me fjalë, të nderit të gruas, domethënë ai dënohet me tetëdhjetë rrahje me kamxhik publikisht, me kusht që atakimi i gruas në nder prej tij të vërtetohet te gjykatësi.

2- Burri pretendon se ka dëshmitarë dhe sjell argumente për akuzën që i ka bërë asaj. Edhe kjo grua nuk është haram për burrin dhe akuza bie pas zbatimit të dënimit sipas ligjit, madje mbi këtë grua është detyrim të zbatohet ekzekutim me gjuajtje me gur (rexhm), për shkak se ajo është grua me burrë, por zbatimi i dënimit do të bëhet, vetëm pasi argumenti të vërtetohet te gjykatësi.

3- Burri pretendon dëshmitarët, por argumenti që ai sjell nuk vërtetohet te gjykatësi. Kjo grua është e ndaluar përgjithmonë për burrin, edhe pa bërë mallkimin e ndërsjellë. Gjithashtu, burrit nuk i hiqet zbatimi i dënimit që parashikon ligji për shkak se ajo u bë e ndaluar për burrin.

Dëshmori i dytë, në librin “Sherhu Lum’ah”, ka thënë: “Nuk bie zbatimi i dënimit për burrin me bërjen e asaj të ndaluar për burrin, por mblidhet fjala e dëshmitarëve dhe argumenti që duhet të vërtetohet te gjykatësi, ndryshe ajo është e ndaluar për atë burrë mes tij e mes Allahut, kurse zbatimi i dënimit mbetet në besën e burrit, ashtu siç e tregon edhe transmetimi i ardhur prej Ebu Besijrit, transmetim që është bazë në gjykim.”

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Gruaja është e ndaluar për atë burrë, edhe kur mes atyre të dyve nuk ka mallkim të ndërsjellë. Këtë unë e gjej pa asnjë kundërshtim. Madje kjo thënie gëzon fjalën e përbashkët të fukahave, duke shtuar edhe transmetimin e ardhur në “Sahijhun” e Ebu Besijrit, ose vërtetuesin e këtij transmetimi.”

Atakimi me fjalë, i nderit të gruas shurdhmemece, në të vërtetë, e bën detyrim ndarjen mes atyre të dyve me dy kushte: *Kushti i parë*: Burri pretendon se ka dëshmitarë. *Kushti i dytë*: Te gjykatësi nuk vërtetohet argumenti që sjell burri kundër saj për kurvëri. Nëse burri nuk pretendon dëshmitarët, ajo grua nuk është e ndaluar për të dhe, nëse ai pretendon dëshmitarët, por argumenti nuk vërtetohet, në të vërtetë, ata të dy nuk ndahen, por ai e ka detyrim mes e tij e mes Allahut që absolutisht të mos i afrohet asaj gruaje.

Mallkimi i ndërsjellë

Kur burri atakon me fjalë nderin e gruas së tij, jo shurdhmemece, madje e akuzon për kurvëri, ose e mohon fëmijën që ajo lind në shtratin e tij, ndërsa gruaja e përgënjeshton, por burri nuk ka argument për akuzën që bën, ai lejohet të bëjë mallkimin e ndërsjellë. Në lidhje me mënyrën mallkimit të ndërsjellë dhe kushtet e mallkimit të ndërsjellë, me lejen e Allahut, do të flitet në kapitujt “edh dhiahàr”- “Burri i thotë gruas: “Të kam si nënën time!””, “el ijàë”-“Paraqitjes” dhe “el liàn”-“Mallkimi i ndërsjellë” të kësaj pjese.

Kur plotësohet mallkimi i ndërsjellë, gruaja për atë burrë është e ndaluar përgjithmonë.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) i tha një çifti që mallkuan njëri-tjetrin: “Pas mallkimit të ndërsjellë që bëtë, ju të dy kurrë nuk mund të bashkoheni me kurorë.”

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Kjo thënie gëzon fjalën e përbashkët të fukahave, por kushtet e mallkimit të ndërsjellë, siç u tha më sipër, do të trajtohen në kapitullin përkatës.”

Sa herë thuhet fjala “Të kam divorcuar!”?

Kur burri i thotë gruas së tij tri herë “Të kam divorcuar!”, mes atyre të dyve ka dy kthime dhe ajo grua është e ndaluar për atë burrë. Pra, ai nuk e ka më hallall që ajo të jetë gruaja e tij, derisa gruaja të martohet me një burrë tjetër. Pasi burri i ka thënë gruas për herë të tretë “Je e divorcuar!”, gruaja e ka detyrim të

kalojë kohën e pritjes ligjore dhe, pasi të mbarojë koha e pritjes, për shkak të këtij divorci, ajo ka të drejtë të bëjë martesë ligjore të përhershme dhe burri i dytë duhet të kryejë marrëdhënie intime me këtë grua. Nëse gruaja ndahet prej burrit të dytë, për shkak të vdekjes së burrit, ose për shkak se edhe ky burrë mund ta divorcojë, në këtë gjendje, gruaja, pasi, të përfundojë kohën e pritjes ligjore, lejohet për burrin e parë dhe ai lidh kontratë martesë me të për herë të dytë. Nëse përsëri ai e divorcin, duke i thënë tri herë “Të kam divorcuar!”, gruaja përsëri bëhet e ndaluar për këtë burrë dhe pas kalimit të kohës së pritjes ligjore, ajo ka të drejtë të martohet me një burrë tjetër. Nëse edhe ky burrë e divorcon, ose vdes, ajo përsëri lejohet të lidhet me martesë me burrin e parë dhe ajo do të bëhet e ndaluar për atë burrë sa herë që ai thotë asaj tri herë “Të kam divorcuar!” dhe po aq herë pas kalimit të kohës së pritjes ligjore, ajo lejohet të martohet me një burrë tjetër. Kjo shpjegohet qartë në fjalën e Allahut të Lartësuar:

“الطَّلَاقُ مَرَّتَانٍ فَإِمْسَاكَ^١ أَوْ تَسْرِيحٍ بِإِحْسَانٍ

“Divorci është dy herë (me kthim), ose jetë të njerëzishme, ose shkurorëzim me mirëkuptim...” (Sure “El Bekare”, ajeti 229)

“فَإِنْ طَلَّقَهَا فَلَا تَحِلُّ لَهُ مِنْ^٢ بَعْدُ حَتَّى تَنْكِحَ زَوْجًا غَيْرَهُ

“Në qoftë se burri i thotë gruas tri herë “Je e divorcuar!”, pas kësaj fjale ajo nuk është më e lejuar për atë burrë, derisa ajo të martohet me një burrë tjetër...” (Sure “El Bekareh”, ajti 230)

Imam Rizai, nipi i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Allahu i Gjithëpushtetshëm, në të vërtetë, për divorcin ka lejuar

vetëm dy herë: **“Divorci është dy herë (me kthim), ose jetë të njerëzishme, ose shkurorezim me mirëkuptim...”**, domethënë në të tretën herë, që burri i thotë gruas: “Je e divorcuar!”, ajo grua nuk është më e lejuar për burrin e saj, derisa ajo të martohet me një burrë tjetër. Vetëkuptohet që kushti për martesën me një burrë tjetër është vënë me qëllim që njerëzit të mos e marrin divorcin si veprim të thjeshtë dhe pa rëndësi.”

Bazuar mbi rregullin e mësipërm, divorci i shqiptuar tri herë, është prej shkaqeve që e bën gruan përkohësisht të ndaluar për burrin dhe jo përgjithmonë, që do të thotë se gruaja bëhet e ndaluar përkohësisht për burrin e saj vetëm pas herës së tretë që ai i thotë: “Je e divorcuar!”. Pas kësaj here, ajo grua, pasi të kalojë edhe kohën e pritjes ligjore, është e lejuar për një burrë tjetër që ka dëshirë të martohet me atë grua dhe të kryejë edhe marrëdhënie intime me të. Pastaj gruaja mund të ndahet prej këtij burri të dytë për shkak se ai vdes, ose ai e divorcon. Fukahatë e imamive kanë veçuar vetëm një formë të vetme dhe kanë thënë se ajo është bërë e ndaluar përgjithmonë për burrin e parë, nëse burri, gjatë kohës së pritjes ligjore, i ka thënë asaj nëntë herë: “Je e divorcuar!”

Te fukahatë e imamive, divorc në kohën e pritjes (*talâkul id'deti*) do të thotë që burri e divorcon gruan dhe pastaj kthehet dhe kryen marrëdhënie intime me të, pastaj e divorcon përsëri në një periudhë pastrimi të saj, pastaj kthehet te ajo dhe kryen marrëdhënie intime me të, pastaj e divorcon në një periudhë tjetër pastrimi të saj. Tanimë ajo grua nuk është më e lejuar për atë burrë, veçse pasi të jetë martuar me një tjetër dhe të jetë ndarë prej të dytit dhe të bëjë me burrin e parë kontratë martese të dytë, pasi ka kryer edhe kohën e pritjes ligjore, pas ndarjes prej burrit me të cilin u martua. Pastaj ai e divorcin, duke i thënë tri herë: “Je e

divorcuar!” dhe vazhdon kështu, derisa plotësohet nëntë herë, që ai i thotë asaj: “Je e divorcuar!”, atëherë kjo grua për atë burrë bëhet e ndaluar përgjithmonë. Nëse divorci nuk është në kohën e pritjes ligjore, ose ai, për shembull, kthehet te ajo dhe pastaj e divorcon para se të kryejë me të marrëdhënie intime, ose martohet me atë me kontratë martese, pas përfundimit të pritjes ligjore, ajo grua nuk është e ndaluar për atë burrë, edhe sikur ai ta divorcojë atë njëqind herë.

Në librin “El Lum’ah” dhe në komentin e këtij libri, thuhet: “Divorci në kohën e pritjes ligjore është kur burri e divorcon gruan sipas të gjitha kushteve dhe pastaj, gjatë kohës së pritjes ligjore, ai kthehet te ajo dhe kryen me të edhe marrëdhënie intime, pastaj e divorcon në një periudhë tjetër pastrimi, domethënë që divorci ka ndodhur në kohën e pritjes ligjore, nga pikëpamja e kthimit në kohën e pritjes ligjore.

Në këtë gjendje, gruaja e divorcuar bëhet përgjithmonë e ndaluar për atë burrë në divorcin e nëntë, nëse ajo është grua e lirë (nuk është skllave). Divorci në kohën e pritjes ligjore është prej kategorive të divorcit të vlefshëm, por, pavarësisht nga kthimi që ai bën, nuk kryen marrëdhënie intime me gruan, ose kthehet te ajo pas kalimit të kohës së pritjes me një kontratë martese të re dhe kryen marrëdhënie intime me të. Nëse e divorcuara është grua e lirë, ajo është e ndaluar në çdo divorc që i thuhet asaj tri herë: “Je e divorcuar!”. Nëse gruaja është robëreshë, ajo bëhet e ndaluar në çdo divorc që asaj i thuhet dy herë: “Je e divorcuar!”.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Kjo thënie gëzon fjalën e përbashkët të fukahave.” Pastaj ai përmend transmetimet e ardhura prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*).

Me lejen e Allahut do të rikthehemi në këtë çështje në kapitullin “Divorci”.

Me fe të ndryshme

Fukahatë kanë një fjalë të përbashkët me dëshminë e autorit të librit “El Xhevahir” dhe me autorë të tjerë se për myslimanin e për myslimanen nuk lejohet martesë me atë individ të kombit të vet që nuk ka libër qiellor. Këta individë janë adhuruesit e idhujve, adhuruesit e zjarrit, adhuruesit e diellit, adhuruesit e të gjithë yjeve, adhuruesit e portreteve që ata preferojnë dhe padyshim ka më shumë përparësi ndalimi i martesës me atë që nuk beson në asgjë.

Gjithashtu, për myslimanin nuk lejohet që ai të martohet me një zjarradhuresë (*mexhûse*), patjetër që akoma më shumë nuk lejohet që një myslimane të martohet me një zjarradhurues. Megjithëse thuhet që edhe adhuruesit e zjarrit kanë një lloj libri të dyshimtë, domethënë se edhe ata kanë pasur libër, por ata e tjetërsuan librin e tyre dhe kështu libri u largua prej tyre.

Imam Bakiri, baba i Imam Xhafer Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), është pyetur për një mysliman që martohet me një adhuruese zjarri. A është e vlefshme martesë e tij? Ai është përgjigjur: “Jo, por s’ka problem, nëse myslimani ka një robëreshë zjarradhuruese.”

Autori i librit “El Xhevahir” ka thënë: “Zjarradhuruesit, në të vërtetë, janë atashuar në grupin e çifutëve e të kristianëve, në dispozitën e xhizjes (taksa që i paguan jomysliman shtetit islam) dhe në dispozitën e llojeve të shumës për shlyerjen e vrasjeve, për

shkak se, përveç Teuratit dhe Inxhilit (Ungjillit), ne nuk i marrim në konsideratë këto lloje librash, për të cilat thuhet se në kuptim janë cituar prej profetëve, por jo në kuptimin e fjalëve të librave të zbritura prej Zotit të Madhërishëm, ose ata janë libra këshilla, por nuk janë dispozita.

Ka të ngjarë që pikërisht për këtë, ithtarët e librave të mëparshëm kanë disa dispozita të veçanta, që nuk i kanë ata që s'kanë libër qiellorë.

Në radhë të parë, kjo përforcohet, nëse shikojmë ndalimin kategorik të martesës me një zjarradhuruese, me përjashtim të rastit kur zjarradhuruesja është robëreshë."

A i lejohet myslimanit të martohet me një grua prej ithtarëve të librave të mëparshëm, çifute, ose kristiane?

Në lidhje me këtë çështje, fukahatë kanë disa thënie. Disa fukaha e kanë ndaluar martesën e myslimanëve me gra prej ithtarëve të librave të mëparshëm në më shumë se gjashtë gjendje.

Fukaha të tjerë e kanë ndaluar në mënyrë të prerë martesën me to, disa të tjerë nuk e lejojnë martesën me to, me martesë të përhershme dhe e kanë lejuar në martesën e ndërprerë, si dhe kur ato janë robëresha. Të tjerë e kanë lejuar martesën me gratë prej ithtarëve të librave të mëparshëm, në raste kur myslimani është i detyruar të martohet me ato për shkak se nuk ka gra myslimane. Të tjerë e kanë lejuar martesën me to pa asnjë kusht, por e kanë quajtur martesë të papëlqyeshme (në shkallën keràhet). Për këtë thënien e fundit janë shprehur një grup fukahash të dëgjuar, ndër të cilët autori i librit "El Xhevahir", autori i librit "El Mesalik",

sej'jid Ebul Hasen El Asfehànij në librin "Uesijletu Nexhàt". Edhe ne jemi bashkuar me këtë mendim, bazuar në argumentet vijuese:

Argumenti i parë: Argumentet që tregojnë lejimin e martesës me to, në mënyrë të përgjithshme. Ka dalë jashtë këtij lejimi martesë e myslimanit me idhujtaren dhe martesë e myslimanës me idhujtarin e me ithtarin e librave të mëparshëm (çifut e kristian), kurse të tjerët, përveç këtyre që u thanë, kanë mbetur në kuptimin e të përfshirëve në argumentet përgjithësuese dhe të pakushtëzuara.

Argumenti i dytë: Fjala e Allahut të Lartësuar:

"الْيَوْمَ أُحِلَّ لَكُمُ الطَّيِّبَاتُ ۖ وَطَعَامُ الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ حِلٌّ لَكُمْ وَطَعَامُكُمْ حِلٌّ لَهُمْ ۖ وَالْمُحْصَنَاتُ مِنَ الْمُؤْمِنَاتِ وَالْمُحْصَنَاتُ مِنَ الَّذِينَ أُوتُوا الْكِتَابَ"

"Sot u lejuan për ju ushqimet e mira dhe ushqimet e ithtarëve të librave të mëparshëm, edhe ushqimet tuaja janë të lejuara për ata, si dhe gratë e ndershme të atyre që u është dhënë libri para jush..." (Sure "El Maide", ajeti 5)

Ajeti i nderuar e lejon fare qartë martesën me gratë e ndershme prej ithtarëve të librave të mëparshëm, qoftë me martesë të përhershme, qoftë me martesë të ndërprerë, qoftë edhe kur ato janë robëresha.

Fjala "gra të ndershme" do të thotë gra që nuk bëjnë vepra të turpshme, kurse fjala e Allahut të Plotpushtetshëm:

"وَلَا تَنْكِحُوا الْمُشْرِكَاتِ حَتَّى يُؤْمَنَّ"

“Dhe mos u martoni me idhujtaret, derisa ato të besojnë...”
(Sure “El Bekare”, ajeti 221), shpreh qartë se ajeti i nderuar është specifik për idhujtaret, të cilat nuk janë ithtare të librave të mëparshëm.

Fjala e Allahut të Lartësuar:

“وَلَا تُنْسِكُوا بِعَصَمِ الْكُوفَرِ”

“...mos i mbani idhujtaret nën kurorë...” (Sure “El Mumtehineh”, ajeti 10), nuk flet qartë për martesën, pasi vetë fjala “mbajtje nën kurorë” tregon martesë, por tregon edhe jo martesë. Veç kësaj, autori i librit “El-Mesalik” ka thënë: “Në të vërtetë, ajeti i nderuar nuk flet qartë për vullnetin për martesë dhe as për atë që është më përgjithësuese se martesa.”

Argumenti i tretë: Transmetimet e shumta të ardhura prej Ehli Bejtit (Paqja e Allahut qoftë mbi ta!) janë mbështetëse për këtë çështje. Autori i librit “El Uesail” dhe autori i librit “El Xheuahir” i kanë cilësuar transmetime të zgjatura, domethënë që ato kanë arritur një kufi nga pikëpamja e shumicës, aq sa i janë afruar gradës së *mustefidhatu*.

Prej këtyre transmetimeve përmendim transmetimin që tregon: Dikush e ka pyetur Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë besimtar që është martuar me një çifute, ose me një kristiane. A ka vepruar drejt?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Po sikur ai të marrë edhe një myslimane, ç’do të bëjë me çifuten e me kristianen?”

Pyetësi tha: “Për ato ai ka të drejtën e dëshirës.”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Nëse ai e bën martesën me çifuten ose me kristianen, le ta ndalojë atë, që të mos pijë verë e të mos hajë mish derri, por dije se me këtë martesë ai ka demonstruar mangësi në fenë e tij.”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk e ndaloi pyetësin të mos martohet me ithtaren e librave të mëparshëm, në të kundërt e lejoi të martohet me të: “Le të ndalojë atë që të mos pijë verë.”

Ky është shpjegimi që na tregon transmetimi, kurse nga pikëpamja e mbështetjes së transmetimit, autori i librit “El Mesalik” ka thënë: “Ky transmetim është shumë i qartë nga pikëpamja e mbështetësve, sepse rruga e përcjelljes së transmetimit është plotësisht e drejtë, madje në këtë transmetim tregohet se martesë e përmendur nuk është e pëlqyeshme.

Nisur nga këto shpjegime, bëhet e mundur mbartja e transmetimeve që flasin për ndalimin e martesës me gratë çifute e kristiane, në transmetimet që e konsiderojnë këtë martesë veprim jo të preferuar sipas rrugës së bashkimit mes dy transmetimeve. Më pas ai thotë: “Fukahatë kanë përfunduar në atë shumë kundërshtime e argumente, sa nuk sjell asnjë dobi marrja me këto zgjatje.”

Në përgjithësi, prej Ehli Bejtit (*Paqja e Allahut qoftë mbi ta!*) kanë ardhur transmetime që e ndalojnë martesën me ithtaret e librave të mëparshëm, por kanë ardhur edhe transmetime që e lejojnë martesën me to. Prej këtyre transmetimeve është edhe transmetimi në të cilin Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Me këtë martesë ai ka demonstruar mangësi në fenë e tij.”

Me këtë fjalë, ai bën bashkimin mes transmetimeve, duke mbartur transmetimet ndaluese në transmetimet që e shikojnë

veprim të papëlqyer, madje edhe veprim të neveritshëm. Gjithashtu, ai mbart transmetimet lejuese në transmetimet që vetëm thjesht nuk e konsiderojnë veprim të ndaluar. Rezultati është: Martesa me ithtaren e librave të mëparshëm, është *kerahet* (veprim jo i pëlqyer) dhe nuk është haram (veprim i ndaluar kategorikisht). Ky bashkim mes transmetimeve është ligjor, sepse argumenti për këtë bashkim është nxjerrë prej vetë ligjit të fesë.

Autori i librit “El Xheuahir”, pasi e ka tjerë fjalën gjatë e gjerë, në lidhje me kundërshtimin e ndaluesve dhe atyre që japin shpjegime të hollësishme, ka thënë: “Nga e gjitha kjo për ty bëhet e qartë dobësia e hollësive mes martesës së përhershme e mes martesave të tjera, por akoma më e dobët se kjo është specifikimi i martesës me ithtaren e librave të mëparshëm, vetëm kur ato janë robëresha. Po kështu janë edhe hollësitë mes lejimit e të tjerave, por ky bashkim transmetimesh, nga sa kam dëgjuar prej Librit e prej Sunetit, është në kundërshtim me transmetimet përgjithësuese.

Vlen të theksohet se nuk ka dallim në martesën me një ithtare të librave të mëparshëm, qoftë ajo shtetase e shtetit islam, qoftë kur ajo është në një vend jo mysliman.

Është interesante fjala e disave që e ndalojnë martesën me ithtaret e librave të mëparshëm, kur thonë: “Çifutja dhe e krishtera përpiqet të bëjë që fëmija i saj të përqafojë fenë e saj, por, cila është lidhja e kësaj fjale me vlefshmërinë e me pavlefshmërinë e kontratës së martesës? Ndryshe do të ishte ndaluar rreptësisht edhe martesa me myslimanen, krahas frikës prej asaj për fenë e për besimin e fëmijës.”

Braktisja e Islamit

Kush është në fenë islame dhe më pas përqafton një fe tjetër, me këtë njeri është e ndaluar në mënyrë absolute martesë, burrë ose grua qoftë ai, qoftë kur ky renegat ka mysliman vetëm njërin prej dy prindërve, ose të dy prindërit, qoftë kur të dy prindërit e tij nuk janë prej myslimanëve, por ai vetë kishte përqaftuar Islamin dhe më pas e braktisi, domethënë u bë renegat (*murted*).

Rengatizmi, braktisja e Islamit, në të dy rastet që u shpjeguan, domethënë qoftë kur renegati është nga prind myslimanë, qoftë kur rrjedh prej jomyslimanëve, por vetë ka përqaftuar Islamin dhe më pas e ka braktisur Islamin, braktisja e Islamit e ndalon martesën me renegatin ose renegaten.

Autori i librit “El Mesalik” ka thënë: “Rengatizmi është njëri prej llojeve të mohimit që e ndalon martesën me renegatin.”

Autori i librit “El Xheuahir” ka cituar prej Dëshmorit të parë, i cili në librin “Ed Durus”, ka thënë: “Në mënyrë absolute, nuk është e vlefshme martesë me renegatin, ose renegaten.”

Bazuar nga sa u tha më lart, kur të dy bashkëshortët janë myslimanë dhe më pas njëri prej tyre braktis Islamin, kurse bashkëshorti tjetër mbetet në fenë islame, menjëherë jepet gjykimi sipas sqarimit vijues:

1- Njëri prej dy bashkëshortëve e braktis fenë islame para se të kryejnë marrëdhënie intime. Në lidhje me këtë çështje, fukahatë janë bashkuar me dëshminë e autorit të librit “El-XhevAhir, i cili ka thënë: “Martesë prishet që në çastin e braktisjes së Islamit, qoftë renegat burri, ose gruaja. Kjo është e barabartë,

qoftë kur renegati është prej prindërve myslimanë, qoftë kur renegati është prej prindërve jomyslimanë, por që vetë kishte përqafuar fenë islame, sepse braktisja e fesë islame e ndalon martesën me braktisësin, ose me braktisësen e fesë islame, prandaj martesa prishet, edhe kur të dy bashkëshortët e braktisin Islamin së bashku.

Nëse burri braktis fenë islame dhe gruaja mbetet në fenë e vet islame, burri ka detyrim t'i paguajë gruas gjysmën e shumës së kurorës, sepse prishja erdhi nga ana e burrit. Kjo është e barabartë me rastin kur burri e divorcon gruan para se të kryejë marrëdhënie intime me të. Në qoftë se gruaja braktis fenë islame dhe burri mbetet në fenë e vet islame, ose ata që të dy e braktisin fenë islame, në këtë rast, gruaja nuk ka asnjë detyrim, sepse braktisja e fesë islame, nga ana e tyre, është prej shkaqeve të prishjes së martesës.

2- Burri prej prindi mysliman braktis fenë islame, pasi ka kryer marrëdhënie intime me gruan, martesa patjetër prishet në çast, sepse ai do të ekzekutohet, edhe nëse bën teube. Për rrjedhojë, pasuria që ai le, pjesëtohet dhe gruaja e tij do të kalojë kohën e pritjes ligjore që ka detyrim të kalojë gruaja në rastin kur i vdes burri.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kush braktis fenë islame, mohon dhe përgënjeshton të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) vrasja e këtij renegati i lejohet atij që i dëgjon prej tij mohimin e përgënjeshttrimin. Gruaja e tij është e divorcuar me divorc të pakthyesëm, që nga dita në të cilën ai braktisi fenë islame. Gjithashtu, gruaja e tij ka detyrim të kalojë kohën e pritjes ligjore

që kalon gruaja së cilësi vdes burri, pasuria e këtij renegati pjesëtohet mes trashëgimtarëve të renegatit dhe Imami (pushteti) ka detyrim të ekzekutojë renegatin pa i kërkuar shkakun.”

Ky renegat i paguan të plotë gruas shumë e kurorës, për shkak të pohimit të tij se ka kryer marrëdhënie intime me të.

3- Gruaja braktis fenë islame dhe nuk ka dallim, nëse është prej prindi mysliman, ose është prej prindërve jomyslimanë, por që vetë kishte pranuar fenë islame dhe tani e braktisi fenë islame, ose burri prej prindërve jomyslimanë ka përqaftuar fenë islame dhe më pas e braktis fenë islame, pasi ka kryer marrëdhënie intime me gruan. Në këtë rast, pritjet të përfundojë koha e pritjes ligjore dhe, nëse burri heq dorë nga braktisja e Islamit dhe kthehet në fenë islame, gjatë kohës që gruaja është në kohën e pritjes ligjore, në këtë gjendje, martesë mbetet siç ishte, ndryshe martesë prishet. Në të gjitha rastet, burri ka detyrim t’i paguajë të plotë gruas shumë e kurorës, për shkak se ka pohuar që ka kryer marrëdhënie intime me të.

Njëri prej dy bashkëshortëve përqafton Islamin

Të dy bashkëshortët nuk janë myslimanë dhe më vonë njëri prej tyre përqafton Islamin. Në lidhje me këtë gjendje, le të shikojmë hollësitë e vijuese:

1- Gruaja është çifute, ose kristiane, kurse burri nuk është mysliman, mund të jetë prej ithtarëve të librave të mëparshëm ose pagan, por më pas ky burrë përqafton Islamin, kurse gruaja qëndron në fenë e saj, çifute ose kristiane. Në lidhje me këtë

gjendje, fukahatë janë bashkuar me dëshminë e autorëve të librave “El Xheuahir”, “El Mesalik” dhe “El Hadaik”, që martesë mes tyre mbetet në gjendjen që është. Kjo është e barabartë, qoftë kur burri ka kryer marrëdhënie intime me gruan, qoftë kur nuk ka kryer marrëdhënie intime me të. Në këtë kontekst, edhe ata fukahë që në fillim kanë thënë se myslimanit nuk i lejohet të lidhë kontratë martesë me grua prej ithtarëve të librave të mëparshëm, janë shprehur për qëndrimin e martesës, sepse dispozita e fillimit, është si dispozita e qëndrimit dhe e vazhdimit.

2- Burri është prej ithtarëve të librave të mëparshëm, por edhe gruaja nuk është myslimane, ajo mund të jetë prej ithtarëve të librave të mëparshëm, ose pagane, por më vonë gruaja përqafon Islamin, kurse burri nuk e përqafon Islamin. Në këtë gjendje, shikohet: Nëse burri akoma nuk ka kryer marrëdhënie intime me gruan, martesë mes tyre priset në çast. Gjithashtu, në këtë gjendje, gruaja s’ka detyrim të kalojë kohën e pritjes ligjore, sepse ithtarit të librave të mëparshëm, bazuar në domosdoshmëritë e fesë e të medh’hebit, nuk i lejohet të martohet me një myslimane, akoma më shumë nuk lejohet martesë e myslimanës me një pagan, por gruaja, në këtë rast, nuk merr asgjë prej shumës së kurorës, për shkak se burri nuk ka kryer marrëdhënie intime me të, si dhe për faktin se prishja e martesës erdhi nga ana e gruas dhe jo nga ana e burrit. Gjithashtu, kjo grua nuk do të kalojë kohën e pritjes ligjore, për shkak se burri nuk ka kryer me të marrëdhënie intime.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur gruaja përqafon fenë islame dhe burri i saj nuk është në fenë islame, bëhet ndarja mes atyre të dyve.” Në një transmetim tjetër të shkallës “Sahijh”, sipas dëshmisë së autorit të librit “El Xheuahir”, thuhet: “Ndërpritet lidhja bashkëshortore prej këtij burri,

domethënë që ai burrë nuk mund të kryejë më marrëdhënie intime me atë grua, por as gruaja nuk do ta marrë shumën e kurorës e as nuk ka detyrim të kryejë kohën e pritjes ligjore për shkak të ndarjes prej këtij burri.” Tekstet që janë në kundërshtim me këtë transmetim tregojnë se transmetimi është i lënë dhe askush nuk ka punuar me këtë transmetim, ashtu siç ka thënë autori i librit “El Xheuahir”.

Autori i librit “El Hadaik” ka thënë: “Detyrimet për të cilat tregon transmetimi, si: ndarja, mosdhënia e shumës së kurorës, apo heqja e detyrimit prej gruas për të kaluar kohën e pritjes ligjore, të gjitha këto janë të njohura prej fukahave të medh’hebit.

Nëse gruaja përqafton fenë islame, pasi burri ka kryer marrëdhënie intime me të, martesë nuk prishet në çast, por pritet derisa gruaja të përfundojë kohën e pritjes ligjore. Nëse burri përqafton fenë islame, qoftë edhe në çastin e fundit të kohës së pritjes ligjore, ajo është gruaja e tij, ndryshe ajo është grua e divorcuar me divorc të plotë. Në këtë gjendje, burri ka detyrim t’i paguajë gruas shumën e kurorës, për shkak të pohimit të tij se ka kryer marrëdhënie intime me të.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Ky gjykim është në përputhje me fjalën e shumicës së fukahave, madje kjo është fjala më e përhapur mes tyre, sepse Allahu nuk ka bërë që mohuesit të jenë mbi besimtarët, duke shtuar këtu edhe tekstet e veçanta që flasin për këtë çështje.”

Dëshmori i dytë, në librin “Sherhu Lum’ah”, ka thënë: “Kjo është fjala me e përhapur në mesin e fukahave dhe me këtë fjalë ata japin fetvanë. Prej shejkhut kemi fjalën që thotë se martesë nuk

prishet me kalimin e kohës së pritjes ligjore, kur burri është jomysliman, që i përmbahet kushteve të jomyslimanit, që jeton nën mbrojtjen e shtetit islam, por ky jomysliman, në asnjë mënyrë, nuk duhet të kryejë me atë grua marrëdhënie intime, madje as të qëndrojë në vetmi të plotë me të, as ta çojë atë në ndonjë vend jomysliman, përderisa burri vazhdon të qëndrojë në kushtet e jomyslimanit që jeton nën mbrojtjen e shtetit islam, duke shtuar edhe transmetime të tjera të shkallës “Dajf”-“Dobët”, ose transmetime që kundërshtojnë transmetimet që janë në gradë më të fuqishme.”

3- Të dy bashkëshortët nuk janë prej ithtarëve të librave të mëparshëm, por janë adhurues idhujsh, ose prej atyre që kanë armiqësi ndaj Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe pjesëtarëve të tjerë të Ehli Bejtit (*Paqja e Allahut qoftë mbi ta!*), ose janë prej mohuesve të tjerë të ngjashëm me të gjithë mohuesit. Kur të dy bashkëshortët përqafojnë së bashku fenë islame, martesë mbetet. Kjo është e barabartë, qoftë kur përqaqimi i fesë islame ka ndodhur para se të kryejnë marrëdhënie intime, qoftë kur përqaqimi i fesë islame ndodh pas kryerjes së marrëdhënieve intime, për shkak se nuk ka argument që e bën të detyrueshëm prishjen e martesës. Kur Islamin e pranon vetëm njëri prej bashkëshortëve, atëherë shikohet: nëse kjo ndodh para se ata të kryejnë marrëdhënie intime, kontrata e martesës zgjidhet në çast, sepse, në këtë rast, për gruan nuk ka kohë pritje ligjore. Gjithashtu, martesë zgjidhet në çast dhe në rastin kur gruaja pranon Islamin, sepse për gruan myslimane është e ndaluar të jetë grua e jomyslimanit, por, nëse burri është ai që pranoi Islamin, në të vërtetë, për të lejohet martesë me një grua prej ithtarëve të librave të mëparshëm, por jo me gra të tjera.

Në qoftë se Islamin e përqafojnë vetëm, ajo nuk merr asgjë prej shumës së kurorës, sepse prishja e martesës erdhi nga ana e gruas. Nëse Islamin e pranon burri, ai ka detyrim t'i japë gruas gjysmën e shumës së kurorës, për shkak se prishja e martesës erdhi nga ana e burrit.

Kur Islamin e përqafojnë njëri prej bashkëshortëve, pasi kanë kryer marrëdhënie intime, prishja e martesës ndodh pas plotësimit të kohës së pritjes ligjore. Nëse Islamin e përqafojnë burri, ose gruaja para përfundimit të kohës së pritjes ligjore, martesa mbetet dhe nuk ka ndarje mes tyre, por burri ka detyrim t'i paguajë gruas shumën e kurorës, për shkak të pozitës që gëzon kryerja e marrëdhënieve intime. Autori i librit "El-Xhevahir" ka thënë: "Pa asnjë kundërshtim e pa asnjë komplikim, me tekst e me fetvanë e fukahave."

Autori i librit "El Mesalik" ka thënë: "Kjo është prej çështjeve për të cilat nuk ka kundërshtim rreth saj."

Në librin "El Uesail", transmetohet prej Mensur, bin Hazimit, i cili tregon: "Pyeta Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë, gruaja e të cilit është adhuruese zjarri, ose adhuruese idhujsh, por nuk është prej ithtarëve të librave të mëparshëm, ndërkaq burri, ose gruaja përqafojnë fenë islame. Si duhet të veprohet në këtë rast?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: "Në këtë rast pritet kalimi i kohës së pritjes ligjore nga ana e gruas, nëse ai ose ajo pranon fenë islame, para se gruaja të përfundojë kohën e pritjes ligjore, të dy mbeten në martesën e tyre të parë. Nëse burri

nuk e pranon fenë islame, para përfundimit të kohës së pritjes ligjore, ajo grua për të është ndarë përfundimisht.”

Martestat e jomyslimanëve

Të gjitha martesat e jomyslimanëve mes tyre janë të vlefshme, me kusht që të kenë ndodhur sipas mënyrës që ata e besojnë fenë e tyre. Ne myslimanët sistemojmë mbi martesat e tyre të gjitha efektet e vlefshmërisë, pa bërë asnjë dallim mes këtyre jomyslimanëve, qoftë kur janë prej ithtarëve të librave të mëparshëm, qoftë kur janë prej jomyslimanëve të tjerë, qoftë kur janë prej tyre që lejojnë martesën me të afërmit e tyre.

Prej Ehli Bejtit (*Paqja e Allahut qoftë mbi ta!*) është vërtetuar transmetimi: “Kush zbaton fenë e një kombi, ai duhet të zbatojë dispozitat e e tyre...” Ky është parimi që zbatohet tani dhe me të cilin punohet në Liban nëpër zyrat e gjendjes civile, ku çdo grup fetar ka gjykatat e veta për këto çështje.

Kur të dy bashkëshortët, ose vetëm njëri prej tyre pranon fenë islame, mbi atë që përqafoi Islamin ne zbatojmë dispozitat e Islamit, duke ecur në rrugën e zakoneve e të traditës në gjithçka që përputhet me ligjin e fesë islame, njëkohësisht kemi bërë pa vlerë gjithçka tjetër që është në kundërshtim me ligjin e fesë islame.

Autori i librit “El Xheuahir”, në kapitullin “Martesa”, në çështjen e parë, në qëllimin e tretë, ka thënë: “Ne gjykojmë për vlefshmërinë e asaj që ata kanë në duart e veta, si martesa, etj, në kuptimin që sistemojmë ndikimet e veprimit të tyre, edhe nëse ai veprim te ne është veprim i prishur, madje pas pranimit të Islamit

pohohen veprimet e tyre.”, domethënë që ne pohojmë për atë që përqafton Islamin punët që ai ka bërë në të kaluarën, edhe nëse punët e tij janë në kundërshtim me ligjin e fesë islame, kurse për punët që ai bën, pas përqafimit të fesë islame, ne pohojmë vetëm punët që ai bën në përputhje me ligjin e fesë islame dhe bëjmë pa vlerë të gjitha punët e tij që janë në kundërshtim me ligjin e fesë islame.

Ihrami

Burri që ka veshur Ihramin për Haxh ose për Umre, qoftë për obligim farz, qoftë për obligim mustehab, nuk lejohet, në asnjë mënyrë, të martojë veten, ose të martojë një burrë ose një grua tjetër, qoftë kur është i prokuruar për ta lidhur këtë martesë, qoftë kur marton veten e tij, qoftë kur është kujdestar. Nëse akti i martesës ndodh në kohën që ai është në Ihram, ai akt është pa vlerë.

Kjo është e barabartë, qoftë kur ai ka dijeni, qoftë kur nuk ka dijeni që lidhja e martesës gjatë kohës që ai është në Ihram, është veprim i ndaluar rreptësisht për të. Kjo ishte për sa i përket kontratës së martesës, kurse për sa i përket ndalimit të martesës, shikohet: Nëse bërësi i kontratës së martesës nuk ka dijeni që bërja e kontratës së martesës prej tij është veprim i ndaluar rreptësisht, gruaja për të cilën është bërë kontrata e martesës, është e ndaluar përkohësisht për burrin me të cilin ai lidhi kontratën e martesës dhe, kur të dy të dalin prej Ihramit, ose del prej Ihramit vetëm burri, ndërsa gruaja vazhdon të jetë në Ihram, për atë burrë lejohet

të rifillojë kontratën e martesës me atë¹ grua. Nëse burri në Ihram ka dijeni që e ka të ndaluar rreptësisht të bëjë kontratë martese, çifti që u lidh me kontratë martese, ndahet dhe ajo grua është përgjithmonë e ndaluar për atë burrë.

Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) ka thënë: “Kur burri është në Ihram, nuk bën kontratë martese as për vete e as për të tjerët dhe as nuk fejon njeri, as nuk bëhet dëshmitar në kontratën e martesës dhe, nëse ai bën kontratë martese, kontrata e martesës, e bërë prej tij, është e pavlefshme.”

Dëshmori i dytë, në librin “Sherhu Lum’ah” ka thënë: “Kjo është thënia më e përhapur. Gruaja, në mënyrë absolute, nuk bëhet e ndaluar nëse me të kryhet marrëdhënie intime gjatë kohës së Ihramit. Kjo është e barabartë, qoftë kur burri ka dijeni se ky është veprim haram, qoftë kur ai nuk ka dijeni për këtë.

Më sipër këtë çështje e kemi trajtuar në pjesën e dytë, në kapitullin “Lëniet për shkak të Ihramit”, në paragrafin “Martesa”.

¹ “En Nasibij” është personi që tregon urrejtje e armiqësi ndaj njërit prej individëve të Ehli Bejtit (Paqja e Allahut qoftë mbi ta!) dhe ndaj të afërmeve të të Dërguarit më të madh (Paqja e Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!). Ky person te imametë është mohues, edhe nëse ai shqipton dy dëshmitë, pasi në të vërtetë, siç vërtetohet, ai kundërshton domosdoshmërinë e fesë, domethënë ai kundërshton Kuran Kerimin, ashtu siç tregohet në fjalën e Allahut të Lartësuar: **“...thuaj: unë nuk kërkoj prej jush ndonjë shpërblim për thirrjen time, përveç dashurisë për hir të farefisnisë...”** (Sure “Esh Shura”, ajeti 23). “El mugàlij” është personi që i atribuon disa cilësi hyjnore njërit prej individëve të Ehli Bejtit, ose edhe individëve të tjerë. Edhe ky person është mohues, pavarësisht se i shqipton të dy dëshmitë.

Përshtatshmëria

Përshtatshmëria mes dy bashkëshortëve të imamijtë është Islami, madje në këtë çështje janë së bashku të gjitha medh'hebet e grupet islame, pa asnjë dallim mes tyre. Autori i librit "El Xheuahir", në kapitullin "Martesa", në paragrafin "Çështja e parë prej gjendjeve të robit", tekstualisht thotë: "Te martesa, Islami është në qendër të subjektit dhe në të gjitha grupet islame nuk është vërtetuar as "nasibij" e as "gàlij"¹ e as shfaqje të tjera të ngjashme. Të gjitha grupet janë në unitet për martesën me njëri-tjetrin, si dhe për trashëgiminë, përfshirë të gjitha dispozitat e tjera, si dhe dënimet fizike (*hudud*)."

Autori i librit "El Xheuahir" ka cituar prej Ehli Bejtit (*Paqja e Allahut qoftë mbi ta!*) transmetime të shumta që flasin për këtë çështje, të cilat ai i ka cilësuar transmetime të ardhura kohë pas kohe, prej të cilave do të përmendim transmetimet vijuese:

Imam Ali bin Hysejn, gjyshi i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), kur disa të tjerë i mohuan atij të drejtën për t'u martuar me disa njerëz, ose që ai të martojë të tjerët, tha: "Allahu ka ngritur me Islamin çdo të gjë ulët e të neveritshme. Ai ka plotësuar të gjitha mangësitë. Ai ka nderuar të njollosurin. Nuk ka njollosje për myslimanin, pasi njollosja është prej njollave të kohës së injorancës para Islamit."

Imam Muhamed Bakiri, babai i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: "Islami është ajo që shfaqet sheshit me fjalë ose me punë. Islamin e kanë përqaftur bashkësitë e njerëzve prej të gjitha grupeve. Me Islamin janë falur gjaqet. Duke u bazuar te Islami bëhet pjesëtimi i trashëgimisë, me Islamin lejohet kurorëzimi. Me Islamin, të gjithë janë së bashku e bëjnë faljen e

namazit, japin zekatin, agjërojnë e kryerjnë Haxhin. Me Islamin, të gjithë kanë dalë prej mohimit (kufrit)."

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: "Islami është dëshmia se nuk ka zot tjetër përveç Allahut, si dhe vërtetimi i të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) me Islamin ndalohet gjakderdhja dhe duke u bazuar te Islami bëhen martesat."

Kjo ishte në raport me grupet e me medh'hebet islame, kurse në raport me klasat e racizmin, autori i librit "Esh Sheraiu", autori i librit "El Xheuahir" dhe të tjerë autorë përveç këtyre të dyve, prej fukahave të imamive, kanë thënë: "Te ne lejohet martesa e skllavit me gruan e lirë, martesa e joarabit me gruan arabe, martesa e atij që nuk është prej fisit Hashimi me një grua të fisit Hashimi, ose kundërta. Gjithashtu, edhe ata që punojnë në profesione të ulëta, si fshesar e portier, apo në të tjera punë të kësaj kategorie, lejohen të martohen me gra fetare të mira, me gra dijetare e pasanike."

Autori i librit "El Xheuahir" ka cituar prej një grupi fukahash të mëdhenj, ndër të cilët prej shejkh Et Tùsij, shejkh Mufijdi, Benu Zuhreh dhe prej poliedrikut El Hil'lij, se prej kushteve të kapacitetit dhe të vlefshmërisë së martesës është që burri të ketë fuqi të përballojë shpenzimet. Mirëpo shumica e fukahave, bazuar në fjalën e Allahut të Lartësuar:

"إِنْ يَكُونُوا فُقَرَاءَ يُعْنِهِمُ اللَّهُ مِنْ فَضْلِهِ"

"...nëse jeni të varfër, Allahu ju pasuron me mirësitë e Tij..."
(Sure "En Nur", ajeti 32), e kanë kundërshtuar këtë thënie.

Martesa me shkëmbim

Martesë me ndërrim kemi atëherë kur njëri prej dy kujdestarëve i thotë kujdestarit tjetër: Të jap për grua vajzën time, ose motrën time, me kusht që edhe ti të më japësh mua për grua motrën tënde, ose vajzën tënde.” Ai tjetri pranon që, çdo njëra prej grave që u shkëmbyen, të jetë edhe shumë e kurorës, domethënë nuk do t’i paguajnë njëri-tjetrit shumën e kurorës.

Kjo lloj martese njëhej në kohën e injorancës para Islamit, por Islami e ndaloi kategorikisht martesën me ndërrim dhe për këtë të gjitha medh’hebet islame kanë një fjalë të përbashkët, të bazuar në fjalën e të Dërguarit më të madh (Paqja e Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!): *“Në Islam s’ka martesë me shkëmbim.”*

Ekspozimi i fejesës

Nuk lejohet të flitet lart e poshtë për gruan e martuar se për të është bërë kontratë martese. Gjithashtu, nuk lejohet të ekspozohet fejesa as për gruan që kalon kohën e pritjes për shkak të një divorci të kthyeshëm, sepse gruaja, në kohën e divorcit të kthyeshëm, vazhdon të jetë në dispozitën e bashkëshortes. Kurse për gruan që kalon periudhën e pritjes ligjore për shkak të një divorci të pakthyeshëm, lejohet ekspozimi i fejesës së saj prej burrit që e ka divorcuar dhe prej të tjerëve, me kusht që kontrata e martesës të bëhet vetëm pas përfundimit të kohës së pritjes ligjore.

Ekspozuesi që shpall fejesën e gruas së divorcuar nuk është burri që e divorcoi, domethënë ai burrë që e nuk ka të ndaluar të

kthehet te ajo grua. Për këtë bazohemi te fjala e Allahut të Lartësuar:

”وَلَا جُنَاحَ عَلَيْكُمْ فِيمَا عَرَّضْتُمْ بِهِ مِنْ خُطْبَةِ النَّسَاءِ أَوْ أَكُنْتُمْ فِي أَنْفُسِكُمْ عَلِيمَ اللَّهِ أَنَّكُمْ سَأَذْكُرُنَّهُنَّ وَلَكِنْ لَا تُؤَاعِدُوهُنَّ سِرًّا إِلَّا أَنْ تَقُولُوا قَوْلًا مَعْرُوفًا“

“Nuk bëni mëkat në parashtrimin e dëshirës suaj ndaj grave për fejesë në mënyrë të tërthortë, ose e mbani atë të fshejtkr në veten tuaj. Allahu e di se ju do t’u përmendi atyre këtë dëshirë, por mos u premtoni atyre (martesë) në fshehtësi, por u thoni vetëm fjalë të lejuara...” (Sure “El Bekare”, ajeti 235)

* * *

USHQIMI I FËMIJËS ME GJI

Në kapitullin e mësipërm trajtuam në tërësi shkaqet që e ndalojnë martesën dhe përmendëm: përkatësinë familjare, kurvërimin, krushqinë, kontratën e martesës, kur gruaja është në kohën e pritjes ligjore, kontratën e martesës me gruan e martuar, numrin e grave, atakimin me fjalë i nderit të gruas shurdhmemece, mallkimin e ndërsjellë, numrin e divorcit, ndryshimin në fe, braktisjen e fesë islame, veshjen e Ihramit për Haxh e Umre. Për të gjitha këto shkaqe kemi venë nga një paragraf të veçantë.

Gjithashtu, prej shkaqeve që ndalojnë martesën është edhe ushqimi i fëmijës me gji. Duke vënë në konsideratë rëndësinë e këtij ndaluesi, si dhe kushtet e degët e shumta që ka ky ndalues, ishte e domosdoshme që të vinim një kapitull të veçantë. Bazë për këtë ndalues është fjala e Allahut të Lartësuar:

“وَأُمَّهَاتُكُمُ اللَّائِي أَرْضَعْنَكُمْ وَأَخَوَاتُكُم مِّنَ الرِّضَاعَةِ”

“... gratë që ju kanë dhënë gji (nënë qumështi) dhe motrat prej gjirit (motër qumështi)...” (Sure “En Nisa”, ajeti 22)

Gjithashtu, bazë për këtë ndalues janë edhe hadithet e ardhura prej të Dërguarit të Allahut (*Paqja e Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), si dhe transmetimet e ardhura prej Ehli Bejtit (*Paqja e Allahut qoftë mbi ta!*): “Prej ushqimit me gji janë të ndaluara ato që janë të ndaluara prej përkatësisë familjare.”

Ky hadith i nderuar do të thotë se me gratë që ti e ke të ndaluar të martohesh për shkak të përkatësisë familjare, po ashtu për ty janë të ndaluara edhe gratë për shkak të ushqimit me gji.”

Kushtet

Ushqimi me gji ka ndikim për ndalimin e martesës, por shtrirja e këtij ndalimi bëhet vepruese vetëm nëse plotësohen kushtet vijuese:

1- Qumështi prej të cilit pi fëmija, duhet jetë qumësht prej një gruaje të martuar me burrë ligjor. Fukahatë kanë mendime të ndryshme, kur qumështi i gruas është për shkak të ndonjë marrëdhënie intime të dyshimtë dhe shtrohet pyetja: A shtrihet ndalimi plotësisht, ashtu siç shtrihet te martesa?

Fukahatë më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorëve të librave “El Hadaik” dhe “El Xheuahir”, të cilët janë shprehur për bashkimin e dyshimit me martesën ligjore, në pikëpamjen e ndalimit të martesës.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Në përputhje me fjalën e shumicës së fukahave, martesa e dyshimtë është si kontrata e vlefshme, madje në këtë nuk gjejmë ndonjë kundërshtim të vërtetuar.”

Autori i librit “El Hadaik” ka thënë: “Thënia që ka më shumë përhapje flet për bashkimin e qumështit që është për shkak të një martesë të dyshimtë me qumështin që është për shkak të një martesë të vlefshme, sepse edhe martesë e dyshimtë e bën të detyrueshme përkatësinë familjare, ashtu siç e bën martesë e vlefshme, prandaj edhe qumështi ndjek përkatësinë familjare.”

Kjo është thënia më e drejtë. Kush ndjek burimet e ligjit të fesë dhe fjalët e fukahave, gjen se kurorëzimi i vlefshëm është një emër me kuptim të përgjithshëm, që përfshin martesën dhe marrëdhëniet intime të dyshimta, ashtu si gjithëpërfshirëse është fjala e Allahut të Lartësuar: “... Gratë që ju kanë dhënë gjë (nënë qumështi)...”.

Çdo grua që i jep gjë fëmijës, qoftë ajo grua ligjore, qoftë grua me të cilën është kryer marrëdhënie intime e dyshimtë, ose edhe lavire, ose grua e pamartuar, por lavirja dhe gruaja e pamartuar kanë dalë prej këtij rregulli me argument, për rrjedhojë kanë mbetur gruaja e martuar dhe gruaja me të cilën është kryer marrëdhënie intime e dyshimtë.

Sido që të jetë, fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët, me përjashtim të ndonjërit që ka thënë ndonjë fjalë pa argument, se nuk ka asnjë efekt qumështi që del prej gruas pa kurorë, e virgjër ose jo qoftë ajo grua, as qumështi që del prej lavires për shkak të kurvërimit, sepse nuk ka ndalim prej ujit të kurvarit.

Gjithashtu, nuk ka asnjë ndikim prej qumështit që del pa qenë gruaja shtatzënë, ose pa lindur, edhe nëse ajo grua është e martuar me martesë ligjore. Për këtë çështje, tregon fjala që tha Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) kur u pyet për një grua së cilës i

rrjedh qumështi pa lindur fëmijë dhe me këtë qumësht ajo i jep gjë dy foshnjave, njëri mashkull e foshnja tjetër femër. Shtrohet pyetja: A janë të ndaluar për njëri-tjetrin këta fëmijë, ashtu siç janë të ndaluar, nëse ushqehen me gjë nga një grua e martuar që ka fëmijë vetë për gjiri? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Jo, nuk janë të ndaluar.”

Gjithashtu, fukahatë kanë kundërshtime mes tyre, kur gruaja ka qumësht para lindjes, nëse ndalimi shtrihet edhe për shkak të këtij lloj qumështi. Në lidhje me këtë çështje, fukahatë kanë dy thënie. Thënia më e saktë është se qumështi i gruas shtatzënë nuk ka ndikim për ndalimin, për shkak se, në këtë rast, shtrirja e ndalimit është në kundërshtim me origjinën dhe ndikimi i ndalimit reduktohet vetëm në rastin konkret, domethënë pas lindjes së fëmijës.

Kështu ka thënë autori i librit “El Xheuahir” dhe për këtë thënie ai ka cituar fjalën e përbashkët të fukahave prej librit të shejkht “El Khilaf”, prej librit “El Gun’jeh” të Ibn Zuhra dhe prej librit Es Seràir” të ibn Idrijsit.

Gjithashtu, për këtë thënie tregon edhe fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Gjiri që i ka dhënë gruaja jote, prej qumështit të fëmijës tënd, fëmijës së një gruaje tjetër.”

Fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) “qumështit të fëmijës tënd”, vërteton se është fjala për qumështin pas lindjes dhe jo për qumështin para lindjes.

Nuk është kusht që gruaja që i jep gjë një fëmijë tjetër, të jetë nën kurorën e burrit me të cilin ajo ka fëmijën, sepse burri, mbase e ka divorcur gruan, ose burri ka vdekur, duke e lënë gruan

shtatzënë, ose kur burri e ka divorcuar, ajo ishte me fëmijë për gjiri dhe më pas kjo grua i ka dhënë gjë një fëmijë tjetër. Në këtë rast, ndalimi vërtetohet për shkak se janë plotësuar të gjitha kushtet e ushqimit me gjë, madje edhe pasi gruaja martohet dhe burri i dytë kryen marrëdhënie intime me të.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Në mënyrë të prerë dhe me fjalën e përbashkët të fukahave, në shtrirjen e ndalimit nuk merret në konsideratë mbetja e gruas në kurorën e burrit prej të cilit ajo ka qumështin, pasi burri mund edhe ta divorcojë gruan, kur ajo ka mbetur shtatzënë prej tij dhe më pas ajo lind, ose ai e divorcon gruan pas lindjes së fëmijës gjatë kohës që ajo ka fëmijën e vet në gjë, ose burri vdes gjatë kohës që ajo ka fëmijën në gjë. Gjatë kësaj kohe ajo ushqen me gjë një fëmijë tjetër.

Ndalimi për shkak të ushqimit me gjë shtrihet pa asnjë diskutim, plotësisht sikur gruaja të ishte nën kurorën e burrit me të cilin ajo ka fëmijën. Kjo çështje gëzon fjalën e përbashkët të fukahave. Nuk ka dallim, nëse ajo i jep gjë fëmijës, kur është duke kaluar kohën e pritjes ligjore (id’det), ose i jep gjë fëmijës pas kësaj kohe.

Gjithashtu, nuk ka dallim as kur qumështi është i vazhdueshëm, ose ndërpritet dhe pastaj rikthehet, ose gruaja martohet përsëri dhe burri i dytë kryen marrëdhënie me këtë grua, nuk ka mbetur ose jo shtatzënë prej burrit të dytë, kur qumështi është në gjendjen e tij normale, domethënë që ajo nuk ka shtim të qumështit. Në të vërtetë, ky qumësht është për shkak të fëmijës që ajo ka me burrin e parë dhe për këtë s’ka asnjë kundërshtim në mesin e fukahave.”

2- Kushti i dytë ndalues kërkon që fëmija duhet të thithë qumështin drejtpërdrejtë prej gjirit të gruas. Sikur qumështi të derdhet në fytin e fëmijës, ose fëmija e thith qumështin jo drejtpërdrejt, ndalimi nuk vërtetohet.

Autori i librit “Esh Sheràiu” dhe autori i librit “El Xheuahir” kanë thënë: “Fjala që ka më shumë përhapje, thotë që fëmija duhet ta thithë qumështin prej sisës, sepse velëm kështu realizohet ushqimi i fëmijës me qumështin e gjirit. Sikur qumështi të derdhet në fytin e fëmijës, ose qumështi të futet në barkun e fëmijës me shiringë, ose me ndonjë mënyrë tjetër, ndalimi nuk shtrihet, për shkak se nuk vërtetohet ushqimi i drejtpërdrejtë prej gjirit. Për këtë çështje njofton edhe transmetimi i përcjellë prej Zurareh, prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili ka thënë: “Ndalimi për shkak të ushqimit me qumështin e gjirit, ndodh nga qumështi që fëmija pi prej një sise të vetme.”

Pa asnjë kundërshtim në mesin e fukahave tanë, ndalimi nuk shtrihet as kur qumështi bëhet djathë dhe fëmija ha prej këtij djathi, ose kur qumështi përzihet me ndonjë lëng tjetër, si për shembull, kur në gojën e fëmijës hidhet një lëng me të cilin fëmija ushqehet dhe ky lëng përzihet aq shumë me qumështin, sa qumështi e humbet natyrën e tij.

Nëse qumështi nuk del prej emrit të tij qumësht, për shkak të përzierjes, ky qumësht hyn në dispozitën e qumështit që e bën ndalimin të detyrueshëm.”

3- Fukahatë janë bashkuar me dëshminë e autorëve të librave “El Xheuahir”, “El Hadaik” dhe “El Mesalik”, të cilët kanë thënë se, që të shtrihet ndalimi, është kusht që fëmija të pijë një

numër racionesh të caktuara dhe të plota, para se të mbushë moshën dy vjeç. Pasi fëmija mbush dy vjeç, ose më shumë, ushqimi i tij me qumësht gjiri s'ka asnjë efekt si ndalues, madje dhe sikur të supozohet se ai qumësht ka mbetur ushqimi i vetëm dhe numrin e kërkuar të racioneve i ka plotësuar, pasi ka mbushur dy vjeç pa asnjë ndarje në kohë, ose fëmija ka pirë qumësht gjiri disa muaj, pasi ka mbushur dy vjeç, përsëri ndalimi për shkak të këtij qumështi, në këtë kohë, nuk ka shtrirje. Në lidhje me këtë çështje, Allahu i Lartësuar thotë:

“وَالْوَالِدَاتُ يُرْضِعْنَ أَوْلَادَهُنَّ حَوْلَيْنِ كَامِلَيْنِ لِمَنْ أَرَادَ أَنْ يُنَمِّمَ الرِّضَاعَةَ”

“Për atë që dëshiron të plotësojë ushqimin e fëmijës me gji, nënat i japin gji fëmijëve të tyre dy vjet të plota...” (Sure “El Bekare”, ajeti 233)

Gjithashtu, është edhe hadithi i nderuar: “S’ka ushqim me gji pas moshës së ndarjes prej gjirit (ablaktacion).”, si dhe transmetimi i ardhur prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Ushqimi me gji i fëmijës është para se fëmija të mbushë dy vjeç.”

Fukahatë kanë kundërshtime mes tyre në lidhje me moshën e fëmijës së gruas që ajo ka në gji dhe për shkak të të cilit ajo është me qumësht. Shtrohet pyetja: A është kusht apo nuk është kusht që edhe fëmija i gruas të jetë dy vjeç, plotësisht ashtu si fëmija që pi gjirin e kësaj gruaje?

Autori i librit “Esh Sheraiu” dhe autori i librit “El Mesalik” kanë thënë: “Kjo nuk është kusht dhe nuk është detyrim të tregohet kujdes për dy vitet e fëmijës së gruas që ushqen fëmijë tjetër me gjirin e saj.”

Ne jemi me mendimin e autorit të librit “El Xheuahir”, që edhe fëmija i gruas të mos jetë më shumë se dy vjeç, madje është detyrim të tregohet kujdes për moshën dy vjeç të fëmijës së gruas gjidhënëse, sepse, kur fëmija i saj mbush dy vjeç dhe gruaja pas dy vjetëve të fëmijës së saj i jep gji një fëmije tjetër, vërtetohet se ajo e ka ushqyer me gji, pasi ka kaluar mosha e ushqimit me gji, domethënë pas dhënies gji të fëmijës së saj. Por me fjalën e përbashkët të fukahave, dihet se nuk ka ushqim me gji, pasi fëmija i saj mbush moshën në të cilën ajo e ushqen fëmijën e saj me gji.

Kur arrihet numri i pirjeve të kërkuara dhe ne dyshojmë, nëse kjo ka qenë para apo pasi fëmija ka mbushur dy vjeç, në këtë gjendje, ndalimi nuk mund të shtrihet për efekt të ushqimit me gji, për shkak se kushti është dyshim në të kushtëzuarin. Për rrjedhojë, në bazë mbetet lejimi dhe mosndalimi.

4- Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët me dëshmitë e autorëve të librave “El Xheuahir”, “El Mesalik”, “El Hadaik” dhe të autorëve të tjerë se me ushqimin e fëmijës me gji, si të vijë mbarë, nuk shtihet ndalimi, pasi ndalimi është me rregull të veçantë dhe shpjegimi e kufizimi për ushqimin e fëmijës me gji bëhet me tri kushte.

Kushti i parë: Ndikimi që jep ushqimi me gji në trupin e fëmijës, që konsiston në shtimin e mishit e në forcimin e kockës.

Kushti i dytë: Fëmija të marrë pesëmbëdhjetë racione qumësht pa ndarje në kohë vetëm prej një gruaje, domethënë herë të pijë prej një gruaje dhe herë prej një gruaje tjetër. Pikërisht ky është edhe kuptimi fjalës të fukahave: “Patjetër të ketë vijueshmëri ndërmjet ushqimeve me gji”.

Kushti i tretë: Kufizimi në kohë: Fëmija pi prej gjirit të një gruaje një ditë e një natë, pra, fëmija ushqehet me gjirin e asaj gruaje gjatë njëzet e katër orëve.

Për kushtin e parë tregon fjala e përbashkët e fukahave, e cila, sipas shprehjes së autorit të librit “El Xheuahir”, e cila është është mjaft e njohur. Gjithashtu, tregon edhe hadithi që gjendet në librat tanë, i ardhur prej të Dërguarit të Allahut (*Paqja e Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), i cili ka thënë: “Ushqimi me gji është qumështi që shton mishin e forcon kockën.”

Gjithashtu, për këtë tregon fjala që ka cituar autori i librit “El Xhevahir” prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Ndalimi prej ushqimit me gji ndodh vetëm nëse qumështi i gjirit shton mishin e fëmijës dhe forcon kockën e tij.”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur nëse bëhet ndaluese ushqimi me gji me një gëlltitje, me dy gëlltitje dhe me tre gëlltitje. Ai është përgjigjur: “Jo, me përjashtim të asaj sasie qumështi që sjell shtimin e mishit e forcimin e kockës.”

Për kushtin e dytë e të tretë tregon fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Ndalimi prej ushqimit me gji nuk ndodh, përveçse kur fëmija pi qumësht gjiri një natë e një ditë, ose merr pesëmbëdhjetë racione qumësht prej gjirit.”

Imam Bakiri, babai i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Ushqimi me gji nuk e bën të ndaluar (martesën), nëse fëmija nuk ka pirë gji një ditë e një natë, ose nuk ka marrë pesëmbëdhjetë racione qumështi pa ndarje në kohë prej të njëjtës grua, që e ka qumështin prej fëmijës së burrit të saj dhe nuk është ushqyer me gji një herë prej një gruaje dhe herë tjetër prej një

gruaje tjetër. Sikur një fëmijë djalë dhe fëmijë vajzë të ketë pirë prej gjirit të një gruaje vetëm dhjetë racione qumësht, kjo sasi qumështi nuk bëhet ndaluese për martesën e këtij djali me këtë vajzë.”

Është domosdoshmëri që ushqimi i fëmijës me gji të jetë një natë e një ditë prej të njëjtës grua dhe gjatë kësaj kohe të mos ketë ushqim tjetër, ose të pijë gji prej ndonjë gruaje tjetër. Gjithashtu, duhet patjetër që racioni i qumështit që merr fëmija, të jetë i mjaftueshëm, sa të ngopë fëmijën dhe gruaa duhet i japë gji kësaj fëmije sa herë të ketë nevojë fëmija.

Pyetje: Fjala e tekstit “të mos ketë ushqim tjetër”, nuk përputhet me fjalën e autorit të librit “El Mesalik”: “Sikur mes racioneve të qumështit të gjirit të ketë një ndarje me ndonjë ushqim, ose me ndonjë pije, në asnjë mënyrë kjo nuk sjell ndonjë dëm në vijueshmërinë e marrjes së racioneve të qumështit prej gjirit, gjithashtu, nuk sjell asnjë dëm kur fëmija e pi qumështin jo drejtpërdrejt prej gjirit, por sjell dëm dhe e ndërpret vijueshmërinë e marrjes së qumështit të gjirit, kur fëmija pi prej gjirit të një gruaje tjetër.”

Fjala e mësipërme nuk përputhet as me fjalën e autorit të librit “El Xheuahir”, i cili ka thënë: “Nuk sjell dëm ndarja me ushqim, ose me të ngjashëm, por dëmi vjen me praninë e qumështit të një gruaje tjetër në gojën e fëmijës. Këtë unë e gjej pa asnjë kundërshtim.”

Autorëve të librave “El Mesalik” dhe “El Xheuahir” i përgjigjemi: “Ata e kanë lëshuar këtë fjalë pa kërkuar argument, ose pa cituar ndonjë argument, ose pa pasur ndonjë argument

logjik, kurse argumenti ynë është: Ngrënia e gjellës e ndalon shtrirjen e ndalimit, sepse ngrënia e gjellës ka ndikim në shtimin e mishit e në forcimin e kockës dhe, se krahas ngrënies së gjellës, nuk mund të mbështet shtimi i mishit e forcimi i kockës vetëm prej pirjes së gjirit, ashtu siç është kërkesa ligjore.

Kjo është në raport me shtimin e mishit dhe me forcimin e kockës, kurse në raport me numrin e racioneve të qumështit të marrë prej gjirit dhe pirjen e gjirit një natë e një ditë, ngrënia e gjellës është ndarës i jashtëm.” Fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Nuk ndan mes tyre racion gjiri tjetër”, nuk tregon lejimin e ndarjes me ngrënie gjelle. Në të kundërt, tregon se marrja e racioneve të qumështit prej gjirit dëmtohet me marrjen e një racioni qumështi prej gjirit të një gruaje tjetër, por nuk sjell dëm mbi vijueshmërinë ndarja me ngrënien e gjellës. Për rrjedhojë, nuk ndalohet martesë, sepse secili nga racionet, prej gjirit të një gruaje tjetër, ose ngrënia e gjellës, është ndarës i vijueshmërisë së ushqimit të fëmijës me gjirin e të njëjtës grua, duke shtuar se edhe qumështi i marrë prej gjirit të një gruaje tjetër, si dhe ngrënia e gjellës, kanë ndikim në daljen e mishit e në formimin e kockës.

Veç kësaj që u tha, theksimi vetëm në anën e jashtme të fjalës, bie në kundërshtim me atë që kanë thënë studiuesit largpamës e mendjendritur. Kanë ardhur transmetime të parregullta dhe të lëna, që flasin për ushqimin e fëmijës me gji. Këto transmetime i kanë përmendur disa fukaha, të cilëve u është përgjigjur autori i librit “El Xheuahir” me këto fjalë: “Sikur të ishte e lejuar për juristin e ligjit të fesë (fakijh) të përsërisë çdo gjë që ai gjen, ose që ai të tregohej i ngurtë në çdo gjë që vjen, ky jurist as nuk ka sjellë ndonjë freski në fushën e fik’hut, as nuk ka vënë

ndonjë kolonë në fe, prandaj i lutemi Allahut të Lartësuar të na ndriçojë diturinë e të na pastrojë ndërgjegjen.”¹

Shumë fukaha kanë thënë: “Çdo njëri nga të tri kushtet, domethënë shtimi i mishit, forcimi i kockës dhe marrja e pesëmbëdhjetë racioneve qumësht prej gjirit, si dhe dita e nata, është bazë më vete, kur gruaja i jep gjë fëmijës një ditë e një natë, pa i plotësuar pesëmbëdhjetë racione dhe nuk kemi as shtim të mishit e as forcim të kockave, ose nga sasia e qumështit që ka pirë fëmija ai shton mish e i forcohen kockat pa e plotësuar numrin e racioneve dhe para përfundimit të 24 orëve. Të gjitha këto janë të mjaftueshme për vërtetimin e dispozitës.

Ajo që ne e mendojmë bazë është shtimi i mishit dhe forcimi i kockës, gjithashtu edhe numri i marrjes së racioneve e koha një natë e një ditë, janë dy shenja ligjore që vërtetojnë shtimin e mishit e forcimin e kockave. Gjithashtu, argumenti ynë gjendet në “Sahijhun” e Ali bin Rethabit, argument të cilin e ka përmendur edhe autori i librit “El Xheuahir” dhe autori i librit “El Uesail”.

Prej këtij argumenti mësojmë se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur në lidhje me ndalimin për shkak të ushqimit të fëmijës me gjë. Ai është përgjigjur: “Sasia që sjell shtimin e mishit dhe forcimin e kockës.”

Pyetësi e pyeti përsëri: “Dhjetë racione qumësht gjiri, a janë shkak për ndalimin?” Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Jo, sepse kjo sasi

¹ Shih pjesën e pestë të librit “El Xhevahir”, në kapitullin “Martesa”, në paragrafin “Kushti i dytë i përhapjes së ndalimit për shkak të gjidhënies”, në thënien e autorit “Një ditë e një natë”.

nuk ndikon as në shtimin e mishit e as në e në forcimin e kockave.”

Fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), që dhjetë racione qumësht gjiri as nuk shtojnë mishin e as nuk forcojnë kockat, është fare e qartë në lidhje me faktin e shtimit të mishit e të forcimit të kockave. Sido që të jetë, përfundimi është i njëjtë, sepse, kur ne dimë mirë njërin prej tre faktorëve, vërtetohet dispozita dhe, kur ne dyshojmë vetëm në njërin prej tre faktorëve, atëherë i referohemi vlerësimit të dy faktorëve të tjerë. Kur ne dyshojmë në të tre faktorët, atëherë s’ka ndalim, sepse baza është jo, derisa të vërtetohet njëri prej faktorëve.

5- Kushti i pestë është jeta e mëndeshës, në të gjitha racionet e gjidhënies. Sikur të supozohet se mëndesha vdes para dhënies së racionit të fundit dhe fëmija vazhdon të jetë në gjirin e gruas e të pijë prej gjirit të saj, edhe pasi ajo kishte vdekur, në këtë gjendje, nuk vërtetohet ndalimi, sepse pas vdekjes për këtë grua nuk vërtetohet emri mëndeshë.

Një pyetje: Mëndeshës në gjumë dhe mëndeshës që i ka rënë të fikët, a mund të aneksohen në dispozitën e të vdekurës?

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Jo, sepse është i mjaftueshëm fakti i vijimit të jetës, pa vënë në konsideratë qëllimin.”

6- Qumështi të jetë prej një burri të vetëm, domethënë prej burrit të mëndeshës. Për këtë kusht tregon kuptimi që mësuam prej transmetimit të mësipërm, ose pirja e pesëmbëdhjetë racioneve qumësht prej të njëjtës grua dhe prej qumështit vetëm të

një burri.” Bazuar mbi këtë kusht, dalin dispozita të shumta, prej të cilave kemi:

a) Gruaja i jep gjithë fëmijës vetëm një pjesë të sasisë së caktuar, si për shembull, i jep tetë racione qumësht prej qumështit të një burri prej të cilit ajo ndahet dhe martohet me një burrë tjetër. Më pas ajo lind me burrin e dytë dhe qëllon që ajo të plotësojë racionet e qumështit që nuk i kishte dhënë fëmijës dhe i jep fëmijës edhe shtatë racione, kështu që plotësohet numri pesëmbëdhjetë, ndërkaq fëmija vazhdon të ushqehet me ushqim ose me qumështin e një gruaje tjetër. Në këtë gjendje, ndalimi nuk shtrihet mes fëmijës e mëndeshës, as mes burrit të saj të parë e të dytë, domethënë që kjo grua nuk është nënë qumështi për atë fëmijë dhe as burri i saj nuk është babë qumështi për atë fëmijë, sepse ai është ushqyer me gjirin e gruas së atij burri.

b) Gruaja i jep gjithë një fëmijë mashkull numrin e caktuar të racioneve prej qumështit që ajo ka prej një burri dhe më pas ai e divorcon gruan, e cila martohet me një burrë tjetër dhe ushqen me gjithë një fëmijë femër me numrin e plotë të racioneve prej qumështit të burrit të dytë. Në këtë gjendje, nuk vërtetohet ndalimi mes fëmijës vajzë e fëmijës djalë që u ushqyen me gjirin e të njëjtës grua, sepse mëndesha nuk e ka qumështin prej të njëjtit burrë, si dhe për shkak se është e pamundur që qumështi prej dy burrave të unifikohet.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Sikur, për shembull, gruaja i ka dhënë gjithë dy fëmijëve prej qumështit të dy burrave, qumësht që këta dy fëmijë kanë pirë prej gjirit të kësaj gruaje, nuk është shkak për ndalim mes atyre dy fëmijëve. Këtë thënie e kanë mbështetur aq fuqishëm fukahatë më të dëgjuar, sa është bërë në

gradën e thënies që gëzon fjalën e përbashkët të të gjithë fukahave.”

Me këtë shpjegim bëhet e qartë se vëllazëria prej nënës në ushqimin me gji nuk është e mjaftueshme për shtrirjen e ndalimit.

c) Kur gruaja i jep gji një fëmije mashkull dhe një fëmije femër prej qumështit të të njëjtit burrë, ndalimi vërtetohet mes këtyre dy fëmijëve. Kjo është e barabartë, qoftë kur ushqimi me gji është në të njëjtën kohë, qoftë kur është në dy kohë të ndryshme. Gjithashtu, është e barabartë, qoftë kur është me qumështin e të njëjtit fëmijë të gruas, qoftë kur është prej qumështit të dy fëmijëve të saj.

Sikur të supozojmë se gruaja i ka dhënë gji njëqind fëmijëve prej qumështit të të njëjtit burrë, ata fëmijë janë të ndaluar për njëri-tjetrin, për shkak se ata janë vëllezër e motra prej qumësht prej të njëjtit babë e prej të njëjtës nënë.

d) Fukahatë janë bashkuar me dëshminë e autorit të librit “El-Xhevahir”, i cili ka thënë: “Kur burri ka më shumë se një grua dhe njëra prej grave të tij i jep gji një fëmije mashkull të gjitha racionet e kërkuara, ndërsa gruaja tjetër e po këtij burri i jep gji një fëmije femër, në këtë gjendje, vërtetohet ndalimi mes atij fëmije mashkull dhe asaj fëmije femër dhe që të dy janë bërë vëlla e motër prej babe, prej qumështi.

Me këtë shpjegim bëhet e qartë se vetëm vëllazëria prej babait prej qumështi, është e mjaftueshme për të vërtetuar ndalimin mes dy fëmijëve që u ushqyen me gjirin e grave të të njëjtit burrë, kurse vëllazëria vetëm prej nënës prej qumësht nuk është e mjaftueshme për të vërtetuar ndalimin. Për këtë tregon

transmetimi i ardhur në librin El Halebij'jut, ku thuhet se ai ka pyetur Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*) për një djalë të rritur, që ka pirë gjë prej një gruaje, nëse lejohet të martohet me motrën e nënës për qumësht.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Në qoftë se të dyja gratë kanë pirë gjë prej të njëjtës grua dhe prej qumështit të të njëjtit burrë, ajo është e ndaluar për të, por, nëse të dyja gratë kanë pirë gjë prej të njëjtës grua prej qumështit të dy burrave, nuk ka problem.”

Me këtë shpjegim veçohet rregulli që prej qumështit është e ndaluar edhe ajo që është e ndaluar prej përkatësisë familjare. Përfshihet prej këtij rregulli motra prej qumështit nga nëna, sepse është e ndaluar vetëm motra për shkak të përkatësisë familjare dhe nuk është e ndaluar motra për shkak të qumështit.

Rezultati

Kur janë të gjitha kushtet që u thanë më sipër, fëmija që ushqehet me gjë, është në pozitën e birit natyral për mëndeshën dhe për burrin e saj prej të cilit ajo ka qumështin. Dispozita e këtij fëmije, në shtrirjen e ndalimit ndaj atyre të dyve, është dispozita e fëmijës jo me përkatësi familjare, për rrjedhojë edhe origjina e atyre të dyve, baballarët e gjyshërit, nënat e gjyshit, bëhet origjinë për fëmijën. Edhe degët e atyre të dyve, domethënë fëmijët e atyre të dyve bëhen vëllezër për të, pa asnjë dallim, nëse është i pari, apo është degë për shkak të përkatësisë familjare, ose për shkak të ushqimit me gjë.

Fëmijët e fëmijës të shqyer me gji dhe fëmijët e fëmijëve të tij, për mëndeshën dhe për burrin e saj prej të cilit ajo ka qumështin janë fëmijë, kurse prindërit e fëmijës së ushqyer me gjirin e mëndeshës, si dhe vëllezërit e tij, në raport me mëndeshën e me burrin e saj janë të huaj. Akoma më shumë, prindërit e tij janë të huaj për origjinat e për degët e atyre të dyve, domethënë për vëllezërit e për motrat e atyre të dyve.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Çështja e ndalimit për shkak të ushqimit me gji është e njëjtë si çështja e ndalimit për shkak të përkatësisë familjare.”

Ti thua: “E ndaluar, motër e ndaluar për shkak të përkatësisë familjare, motër e ndaluar për shkak të ushqimit me gji.” Kështu është e ndaluar edhe e bija, nusja e djalit dhe gruaja e babait. Po kështu është e ndaluar edhe martesë me dy motra njëherësh.

Ja një shembull: Ibrahimit i ka dhënë gji Atika, e cila është e martuar me Halilin, kështu që Ibrahim, për shkak të ushqimit me gji, bëhet djalë për Atikën e për burrin e saj, Halilin. Gjithashtu, nëna e Atikës është gjyshe prej nëne për Ibrahimin. Edhe babai i mëndeshës është gjysh prej nëne për Ibrahimin, motrat mëndeshës janë teze për Ibrahimin. Nëna e Halilit është gjyshe prej babe për Ibrahimin. Babai i Halilit është gjysh prej babe për Ibrahimin, vëllezërit e Halilit janë xhaxhallarë për Ibrahimin, motrat e Halilit janë halla për Ibrahimin. Fëmijët e Halilit, i cili është babë qumështi për Ibrahimin, janë vëllezërit e Ibrahimit. Edhe fëmijët e fëmijëve të Halilit janë vëllezër për Ibrahimin. Kjo është e barabartë, qoftë kur ata kanë nënë Atikën, qoftë kur kanë nënë një grua tjetër të Halilit, sepse vëllazëria edhe vetëm prej

babe e shtrin ndalimin. Fëmijët e gruas tjetër të Halilit (jo fëmijët e Atikës), siç u tha, janë vëllezër për Ibrahimin, por nuk janë vëllezër për Ibrahimin fëmijët e kësaj gruaje që nuk i ka me Halilin, sepse në vëllazërinë prej nëne, për shkak të ushqimit me gji, siç u tha më sipër, ndalimi nuk vërtetohet.

Kur Ibrahim i rritet dhe vijnë fëmijët e tij, fëmijët e Ibrahimit dhe fëmijët e fëmijëve të Ibrahimit, bëhen fëmijë për Atikën e për Halilin, kurse prindërit natyralë të Ibrahimit dhe vëllezërit e tij, janë në pozitën e të huajve për Atikën e për burrin e saj, Halilin. Është e vërtetë se ka tekst që tregon se babai natyral i fëmijës që ushqehet me gji nuk vë kurorë me fëmijët e babait për qumësht të djalit të tij.

Këtë çështje do ta shikojmë gjatë trajtimit me nënçështjet vijuese, duke u bazuar mbi kushtet që ne përmendëm më sipër.

Babai e motra prej qumështi

A i lejohet burrit të mëndeshës, i cili është edhe baba prej qumështi i fëmijës, të cilit i ka dhënë gji gruaja e tij, pra, është burri prej të cilit ajo është me qumësht për gjiri, të martohet me motrën natyrale të djalit për të cilin ai është baba prej qumështi?

Përgjigje: Për atë lejohet të martohet me motrën e tij. Gjithashtu, i lejohet të martohet edhe me nënën e tij. Kështu janë shprehur fukahatë më të dëgjuar, të cilët janë bashkuar me dëshminë e autorit të librit “El Hadaik”, i cili ka thënë: “E ndaluar për burrin është vajza e tij natyrale, ose vajza e tij prej qumështi, ose vajza e gruas së tij me të cilën ai ka kryer marrëdhënie intime.

Supozohet që motra e fëmijës së ushqyer me gji prej gruas së këtij burri nuk është bijë natyrale për burrin e mëndeshës, kur gruaja e tij, në mënyrë absolute, nuk i ka dhënë gji asaj. Pra, ajo nuk është bijë prej qumështi për burrin e gruas që i ka dhënë gji vëllait të kësaj vajze, nuk është as vajza e gruas së tij, për rrjedhojë, vetëm fakti që ajo është motra e djalit të tij prej qumështi, nuk e bën atë vajzë bijë për gruan e tij. Gjithashtu, nëna e asaj vajze është e huaj për burrin e gruas që i ka dhënë gji djalit të saj.”

Autori i librit “El-Xhevahir” ka thënë: “S’ka problem që babai prej qumështi të martohet me motrën natyrale të fëmijës së tij prej qumështi, madje edhe nëse ajo është motra e djalit të tij, për shkak se ajo për atë nuk është bijë prej qumështit. Sipas traditës, nuk është as vajza e gruas së tij, sepse e ndaluar për shkak të përkatësisë familjare është bija natyrale dhe vajza e gruas që është nën kujdestarinë e burrit të nënës së saj.”

Për sa i përket martesës me nënën natyrale të fëmijës prej qumështi, burri ka të drejtë të martohet me nënën e djalit të vet natyral dhe ka më shumë të drejtë të martohet me nënën e djalit prej qumështi.

Babai i fëmijës të ushqyer me gji dhe nëna e mëndeshës

A i lejohet babait të fëmijës të ushqyer me gji të martohet me nënën e mëndeshës që i ka dhënë gji djalit të tij?

Përgjigje: I lejohet, sepse nëna e saj nuk është nëna e gruas së tij, madje lejohet, edhe nëse është nëna e djalit të tij prej qumështi, sepse fakti që mëndesha është nënë prej qumështit për

djalin e tij, nuk e bën atë grua të babait të fëmijës që ushqehet me gji, derisa për nënën e tij të vërtetohet emri nënë e gruas. Thënë ndryshe, krushqia realizohet vetëm me dy punë, kontratë martesë dhe afërsi, por afërsia këtu ekziston mes vajzës e nënës së saj para kontratës, kurse krushqia bëhet ekzistuese vetëm pas kontratës së martesës me vajzën dhe vetëm kur kontrata bëhet ekzistuese, atëherë ekziston edhe krushqia mes bërësit të aktit (burrit) dhe asaj për të cilën u bë akti (vajza).

Për sa i përket fëmijës së ushqyer me gji, ai është në pozitën e të afërmit për shkak të përkatësisë familjare, por nuk ka pozitën e kontratës së martesës, për më tepër kontrata e martesës nuk i sjell atij asgjë.

Për këtë çështje, autori i librit “El Xheuahir” thotë: “Nuk duhet të kesh dyshim që ushqimi me gji bën të mundur afërsinë, në kuptimin që, kur gruaja e huaj ushqen me gji fëmijën tënd, ajo bëhet në pozitën e gruas tënde. Për rrjedhojë, nëna e saj është e ndaluar për ty, sepse është nëna e gruas.

Një grup fukahash janë shprehur se qëllimi me shtrirjen e ndalimit është i njëjtë me shtrirjen e ndalimit për shkak të përkatësisë familjare, që do të thotë se patjetër duhet të ekzistojë shkaku për afërsinë, që është kurorëzimi, sepse në ushqimin e fëmijës me gji ekziston një shkrirje. Kjo çështje, për një grup prej fukahave të mëdhenj, është shumë e komplikuar, madje është komplikuar aq shumë, sa ata, si grup, nga pakujdesia për të mësuar gjendjen e vërtetë, kanë shpallur të ndaluar edhe atë që ka lejuar Allahu i Lartësuar.”

Babai i fëmijës që ushqehet me gji dhe fëmijët e burrit të mëndeshës

A lejohet që babai natyral i fëmijës që ushqehet me gji të martohet me vajzën e burrit të mëndeshës, qoftë ajo vajzë tij natyrale, qoftë vajzë e tij për qumësht?

Një grup fukahash janë shprehur për lejimin, duke u bazuar në rregullin “Ndalohet për shkak të ushqimit me gji ato që ndalohen për shkak të përkatësisë familjare”. Në pyetjen tonë, vajza është vajza e burrit të mëndeshës dhe motër prej qumështi e fëmijës që ushqeui mëndesha me gjirin e saj. Por për babain e fëmijës ajo nuk është as vajzë e tij dhe as vajzë e gruas së tij, por dihet se e ndaluar është vajza dhe vajza e gruas, por jo motra prej qumështi e djalit.

Shumë studiues, ndër të cilët autori i librit “El Xheuahir”, Dëshmori i dytë dhe se’j’id Ebul Hasan El Asfehàni, janë shprehur për moslejimin, për shkak se ka tekst dhe atyre që janë shprehur për lejimin. Autori i librit “El Xheuahir” i është përgjigjur: “Ai është hulumtim kundrejt tekstit.”

Dëshmori i dytë, në librin “Sherhu Lum’ah”, ka thënë: “Shpjegimi i atyre që janë shprehur për mosndalimin, është gjë e mirë, sikur fjalën e tyre të mos e kundërshtojnë tekstet e sakta, për rrjedhojë është më mirë të shprehemi për ndalimin.”

Prej teksteve që u theksuan më sipër, kemi transmetimin që tregon: Dikush e ka pyetur Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*) për një mëndeshë që i ka dhënë gji fëmijës së tij. “A më lejohet mua të martohem me vajzën e burrit të mëndeshës?” Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) i tha atij: “Bëre shumë mirë që më pyete, pasi

njerëzve u jepet mundësia të thonë se për burrin është e ndaluar të marrë grua prej anës së burrit të mëndeshës. Ky ndalim është vetëm kur mëndesha e ka qumështin prej burrit më të cilin ajo i jep gjë fëmijës së tij dhe jo prej ndonjë burri tjetër.”

Pastaj pyetësi i tha: “Vajza nuk është e bija e mëndeshës që i dha gjë fëmijës tim, por ajo është e bija e një gruaje tjetër.” Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Edhe sikur të ishin dhjetë të ndara, për ty të gjitha janë të ndaluara, sepse ato janë në pozitën e vajzave tuaja.”

Në pikëpamjen e ndalimit për babain e fëmijës të ushqyer me gjë, fukahatë nuk kanë bërë dallim që fëmijët e burrit të mëndeshës të jenë fëmijë të tij natyralë, ose fëmijë prej qumështi.

Babait të fëmijës së ushqyer me gjë i lejohet të martohet me të bijën e mëndeshës prej qumështi dhe nuk është e bija e burrit të saj, sepse kjo vajzë nuk është e ndaluar as për fëmijën e ushqyer me gjë. Prandaj akoma më shumë, ajo nuk është e ndaluar për babain e tij. Gjithashtu, babait të fëmijës të ushqyer me gjë nuk i lejohet të martohet me vajzën natyrale të mëndeshës, por që nuk e ka me burrin prej të cilit ka qumështin që ushqeu fëmijën. Për këtë çështje Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur, nëse ky burrë e ka të lejuar të martohet me të bijën e kësaj mëndeshe. Dhe ai është përgjigjur: “Jo, për atë ajo është e ndaluar.”

Këtë transmetim fukahatë e kanë mbartur vetëm për vajzën nga përkatësia familjare dhe jo për vajzën prej qumështi. Në lidhje me sa theksuam, autori i librit “El-Xhevahir” ka thënë: “Ana e specifikimit të fëmijës së mëndeshës, nga përkatësia familjare, përveç burrit që nuk e ka ndaluar fëmijën e saj prej qumështi mbi

fëmijën e tij që është burimi për ndalimin, sepse vihet në konsideratë bashkimi i burrit në kundërshtim me burrin prej të cilit ajo ka qumështin, fëmijët e të cilit, të gjithë fëmijët e tij, janë të ndaluar për fëmijën e ushqyer me gji, qofshin fëmijë natyralë, qofshin fëmijë prej qumështi.

Ndalimi i gruas

Prej paragrafit të mësipërm u bënë të qarta dy çështje. Çështja e parë: Babait të fëmijës së ushqyer me gji nuk i lejohet martesë me fëmijët e burrit të mëndeshës, as me fëmijët e tij natyralë e as me fëmijët e tij prej qumështi.

Çështja e dytë: Babait të fëmijës së ushqyer me gji nuk i lejohet martesë me fëmijët e mëndeshës, as me fëmijët e saj natyralë e as me fëmijët e saj prej qumështi. Mbështetur mbi këto dy çështje, rezulton se, kur ti ke një fëmijë prej gruas tënde, por kësaj fëmije i ka dhënë gji nëna e gruas tënde, e cila është edhe gjyshe për fëmijën tënd, në këtë gjendje, gruaja jote bëhet e ndaluar për ty për shkak të këtij ushqimi me gji të fëmijës tënd. Kjo është e barabartë, qoftë kur burri i mëndeshës, e cila është nëna e gruas tënde, është babai i gruas tënde, ose është një burrë tjetër i huaj për gruan tënde. Nëse ai burrë është babai i gruas tënde, gruaja juaj është vajza e këtij burri, qoftë vajza e tij natyrale, qoftë vajza e tij prej qumështi. Nëse ai është i huaj, atëherë gruaja juaj është bija e tij prej qumështi.

Por çështja e parë thotë se babait të fëmijës së ushqyer me gji, që në këtë rast je ti, nuk i lejohet të martohet me bijat natyrale,

ose me bijat prej qumështit të burrit të mëndeshës, prej të cilit ajo ka qumështin.

Por, edhe kërkesa e çështjes së dytë është moslejimi për babain e fëmijës së ushqyer me gji të martohet me bijat natyrale të mëndeshës, atëherë për ndalimin e gruas tënde për ty, bashkohet edhe një ndalim më shumë se ndalimi për shkak të përkatësisë familjare.

Martesa me motrën e vëllait

Zejdi ka një motër prej qumështi, që quhet, le ta zëmë Hind. Gjithashtu, ka edhe një vëlla natyral të quajtur Khalid. A i lejohet Khalidit të martohet me Hindin, duke ditur se Hindi është motra prej qumështi e vëllait të tij, Zejdit?

Përgjigje: Lejohet, sepse e ndaluar për të bërë kontratë martese është vetëm motra e vërtetë dhe jo motra e vëllait, siç është ajo.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që është martuar me motrën e vëllait të vet. A është martesë e vlefshme?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Nuk do të dëshiroja të martohesha me motrën e vëllait tim, prej qumështi.”

Fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “nuk do të dëshiroja”, tregon qartë për shkallën kerahet të ndalimit. Në këtë linjë mendimi është edhe autori i librit “El Xheuahir”.

Autori i librit “El Mesalik” ka thënë: “Nëse dikush ka një vëlla prej babai dhe një motër prej nëne, për vëllain e tij prej babai lejohet të martohet me motrën e tij prej nëne, sepse mes tyre nuk ka përkatësi familjare, pasi, në të vërtetë, motra e vëllait prej nënës së tij është e ndaluar, kur ndalimi vjen nga ana e babait ose nga ana e nënës. Në rastin tonë nuk është kështu, sepse nuk ka përkatësi familjare mes vëllezërve me përkatësi familjare të atij që është ushqyer me gji e mes vëllezërve të tij prej qumështi.”

Ushqimi me gji pas martesës

Kur ushqimi me gji bëhet sipas kushteve të lartpërmendura, është prishës i martesës, plotësisht sikur ushqimi me gji të bëhej para martesës. Kush ka një grua të vogël, së cilës i jep gji vajza e tij, ose nëna e tij, ose motra e tij, ose vajza e vëllait të tij, ose gruaja e vëllait të tij, e vogla e ushqyer me gji prej këtyre që u thanë, është e ndaluar për atë, sepse, në këtë gjendje, ajo bëhet për atë ose bijë, ose motër, ose bija e vëllait, ose bija e motrës. Nëse ai ka dy gra, një të vogël dhe tjetrën të madhe dhe e madhja e ushqen me gji të voglën, gruaja e madhe bëhet e ndaluar për atë, sepse tani ajo u bë nënë e gruas së tij. Gjithashtu, për atë është e ndaluar edhe gruaja e vogël, sepse ajo u bë vajzë e gruas me të cilën ai ka kryer marrëdhënie intime, për shkak të ushqimit me gji prej gruas së madhe.

Djali i xhaxhait bëhet xhaxha

Burri marton djalin e tij të mitur me vajzën e mitur të vëllait të tij dhe gjyshja e këtyre të dyve ushqen me gjë njërin prej dy bashkëshortëve të mitur. Martesa mes dy të miturve prishet, sepse gjyshja, nëse është gjyshe prej babait, djali që piu gjirin e gjyshes bëhet xhaxha për gruan e tij, për shkak se për babain e saj ai u bë vëlla qumështi, kur më parë për të miturën ai ishte djalë i xhaxhait të saj. Nëse gjyshja i ka dhënë gjë vajzës, atëherë ajo bëhet hallë për burrin e saj, sepse tani ajo bëhet vëlla qumështi prej babait e tij prej nënës së tij. Nëse gjyshja është gjyshe nga ana e nënës dhe, sikur të dy të martuarit e mitur të ishin djalë tezeje e vajzë tezeje, ose do të ishin djalë xhaxhai e vajzë xhaxhai, nëse i ushqyeri me gjë prej gjyshes nga ana nënës është i mituri, ai bëhet dajë për gruan e tij. Nëse gjyshja nga nëna ka ushqyer me gjë të miturën, ajo bëhet teze për burrin e saj, sepse tani ajo është motër prej qumështi për nënën e burrit të saj. Të gjithë këta e kanë të ndaluar martesën për shkak të përkatësisë familjare. Për rrjedhojë e kanë të ndaluar edhe për shkak të ushqimit me gjë.

Dëshmia për ushqimin e fëmijës me gjë

Në kapitullin “Dëshmitë”, nënkaptulli “Kategoritë e të drejtave dhe të ngjarjeve”, në paragrafin “Çështje për të cilat burrat e kanë vështirë të kenë dijeni”, kemi folur për dëshminë e grave. Një grup fukahash kanë thënë se ushqimi i fëmijës me gjë vërtetohet me dëshminë e grave, kur gratë janë së bashku me burrat, si dhe kur janë të veçuara prej burrave.

Në këtë paragraf do të shikojmë se dëshmia, në lidhje me ushqimin e fëmijës me gji, nuk pranohet kur është dëshmi në tërësi, si për shembull, dëshmitari thotë se filanja i ka dhënë gji filanes dhe me kaq mjafton. Jo, patjetër kërkohet qartësim dhe sqarim, si për shembull, ai thotë: “Dëshmoj se filanja ka pirë pesëmbëdhjetë racione qumështi të njëpasnjëshme e të plota para se fëmija i mëndeshës të mbushte dy vjeç prej gjirit të filanes, e cila e kishte qumështin prej një martese të vlefshme.”

Ky sqarim kërkohet si domosdoshmëri për të bërë kujdesin më të madh që dëshmuesi, në dëshminë e tij, të mbështetet në atë që ai beson se me të vërtetë ajo që ai di e bën të detyrueshme ndalimin, pasi te gjykatësi ai nuk konsiderohet i ndaluar.

Dyshimi i dijetarëve të fesë në vlefshmërinë e gjidhënies

Gjatë punës që shkruaj ciklin e plotë të fik’hut të Imam Xhafer Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), kam vënë re se çështja e gjidhënies, në mënyrë absolute, është çështja me e komplikuar dhe më e hollësishme e çështjeve të fik’hut, sidomos njohja e dispozitave që dalin prej rregullit “Ndalohet për shkak të gjidhënies ajo që ndalohet për shkak të përkatësisë familjare”, specifikimi i këtyre dispozitave prej dispozitave të tjera, si dhe zbatimi i këtyre dispozitave në vendin përkatës.

Disa fukaha e kanë përgjithësuar ajetin e Kur’anit deri në atë shkallë sa gjidhënia është bërë te ata në pozitën e kontratës së martesës në vërtetimin e partneritetit dhe nënën prej qumështi për babain e fëmijës që ajo i ka dhënë gji, e kanë vënë në pozitën e nënës nga përkatësia familjare. Gjithashtu, motrën e vëllait e

kanë vënë në pozitën e motrës. Një tjetër fekih, këtë rregull e ka të veçantë vetëm në përkatësinë familjare, por i përgjithëson këto dispozita në të gjitha burimet, pa asnjë përjashtim. Një fekih i tretë veçon dhe nxjerr jashtë rregullit të lartpërmendur përkatësinë familjare të vërtetuar prej marrëdhënieve intime të dyshimta dhe në mënyrë të prerë nuk e merr këtë në konsideratë për shkak të gjidhënies.

Një i katërt, e konsideron kurvërimin si martesën ligjore nga ana e vërtetimit të ndalimit prej gjidhënies.

Një i pestë, mjaftohet me vërtetimin e ndalimit me gjidhënien e fëmijës në atë sasi sa agjëruesi çel agjërimin. Ndërsa një i gjashtë, thotë se patjetër duhet të ushqehet me gji dy vjet të plota, duke shtuar këtu edhe kontradikta të tjera, të cituara prej autorit të librit “El Xheuahir”, të autorit të librit “El Mesalik” dhe të autorëve të tjerë përveç këtyre të dyve.

Autori i librit “El Xheuahir” i mohon të gjitha këto dhe, duke folur rreth kushtit të dytë prej kushteve të ndalimit për shkak të gjidhënies, ka thënë: “Disa fukahave kanë dhënë fetva në atë që është e mundur të jetë në kundërshtim me domosdoshmëritë e fesë.”

Kurse për çështjen e parë pas kushtit të katërt, ka thënë: “Në dyshim kanë rënë një grup i madh prej fukahave të mëdhenj dhe çështja te ata paraqitet aq e komplikuar, sa ata kanë bërë të ndaluar një tërësi punësh të cilat Allahu i ka lejuar.”

Në lidhje me çështjen e dytë, ka thënë: “Qëndrova mbi disa kumtesa që trajtojnë këtë çështje dhe te ato kam parë punë shumë të çuditshme dhe gjëra të huaja, sa edhe për atë që aftësinë më të

vogël të shikimit në këto çështje të shprehet në mënyrë të prerë se ato dalin jashtë medh'hebit, ose edhe jashtë fesë."

Në lidhje me çështjen e tretë, ai ka thënë: "Ai që vështrohet në kumtesën e sejjid Ed Dàmàd, do të çuditet, kur të shikojë sa larg shkojnë dyshimet te dijetarët e fesë, madje të njëjtën gjë e përmban edhe kumtesa e gjyshit tim (gjyshi i autorit të librit "El Xheuahir"), El Ahned Mulla "Ebul Hasan Esh Sherijf", edhe pse në mes dy kumtesave ka një kontrast shumë të madh, sepse ajo që ka përmendur Es'sejjid Edamad¹ në kumtesën e tij, është diçka që nuk duhet t'i atribuohet as te studiuesit e vegjël, pa folur për dijetarët."

Nderim të veçantë për atë që ka thënë: "Rënia në dyshim është më e mirë se hedhja e vetes në shkatërrim, por ai që bie në dyshime, ka rënë në punë të ndaluara."

Vetëm Allahu i Gjithëpushtetshëm është Udhëzuesi në rrugën e drejtë.

* * *

¹ Sejjid Ed Dàmàd është Muham'med Bàkir El Esteràbàdij, vdekur në vitin 1040H. El Kummij, në librin "El Kenà uel Elkàb" e ka cilësuar atë "studiues i hollë, dijetar i urtë, kritik i thellë me karakter ndezës, qafat elegante janë stolisur me kolanet e poezisë së tij dhe me perlat e prozës së tij." Më pas, ai ka citur prej autorit të librit "Es'selàfeh", i cili, në lidhje me të, ka thënë: "Koha me një të ngjashëm me atë është shterpë dhe virtytet e tij nuk i nxë një zemër e mbyllur." Ebul Hasan Esh Sherijf është shejkh Muham'med Tàhir bin Ma'tùk El Fetùnij El Àmilij En Nebàtij, autor i librit "Dijàul Àlemijn", njëri prej gjyshërve të autorit të librit "El Xheuahir", vdekur në vitin 1138H.

KUJDESTARIA

Kujdestaria është pushteti i plotë ligjor që ka kujdestari për martesën e personit që ai ka në kujdestari për shkak të ndonjë të mete që ai ka. Është ky pushtet që i jep të drejtë kujdestarit, të kthejë të drejtën që i takon personit me të metë. Në lidhje me kujdestarinë do të trajtojmë disa çështje:

Vajza ka arritur pjekurinë seksuale dhe di të orientohet drejt

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se kujdestari ka të drejtë ta martojë të miturin, të miturën, të çmendurin, të çmendurën, mendjelehtin dhe mendjelehtën. Gjithashtu, fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se personi që ka arritur pjekurinë seksuale dhe është në gjendje të orientohet drejt, është i pavarur në martesën e tij dhe askush nuk mund të jetë kujdestar për të. Por dijetarët kanë mendime të ndryshme në lidhje me vajzën që ka arritur pjekurinë seksuale dhe di të orientohet drejt, nëse është e vlefshme martesa e saj pa kujdestar, nëse ajo është e pavarur të bëjë zgjedhjen që dëshiron, apo i takon kujdestarit ta martojë atë

dhe ajo, në punën e martesës së saj, nuk ka asgjë në dorë, apo kujdestari dhe vajza bashkëpunojnë në zgjedhje, domethënë se ajo nuk mund të veprojë në martesën e vetes pa kujdestarin, por as kujdestari nuk mund të veprojë i pavarur për martesën e saj pa vajzën, apo ka dallim mes jo beqares dhe beqares¹¹, ose mes martesës së përhershme dhe martesës së ndërprerë.

Në lidhje me këto çështje, fukahatë kanë pesë thënie. Thënia më e përhapur mes tyre është dëshmia e autorit të librit “El Xheuahir” dhe e shejkht El Ensarij, në librin “Mulhakatul Mekàsib”, të cilët kanë thënë: “Në mënyrë absolute, askush nuk ka pushtet mbi vajzën që ka arritur pjekurinë seksuale dhe di të orientohet drejt, për rrjedhojë ajo martohet me cilin të dëshirojë pa asnjë kusht.”

Në lidhje me këtë çështje, autori i librit “El Xheuahir” tekstualisht ka thënë: “Thënia më e përhapur në çështjen tonë objekt studimi, sipas citimeve dhe sipas përfundimit të arritur prej studimeve, domethënë që përveç tij e kanë cituar edhe të tjerë, por që edhe ai vetë është njohur me këto studime personalisht, bazuar në ato që kanë thënë fukahatë e mëparshëm dhe të mëvonshëm, rezulton rrëzimi i kujdestarisë për këtë vajzë.

Madje prej Sherijf El Murtezà, në librin “El Intisàr uen’nàsirij’jàt”, thuhet se kjo thënie gëzon fjalën e përbashkët të fukahave.

Kjo është thënia më e drejtë dhe për të cilën ne nuk kemi asnjë dyshim. Tani le të shikojmë argumentet:

¹ Autori i librit “El Xheuahir” dhe autori i librit “El Mesalik” kanë thënë: “S’ka asnjë kundërshtim për rrëzimin e kujdestarisë për jo beqaren, përveç transmetimit të cituar prej ibn Ebu Ukajlit, por ai është transmetim jo i rregullt.

Argumenti i parë: Kujdestaria është e kundërta e origjinës. Në të vërtetë, çdo njeri që ka arritur pjekurinë seksuale dhe që di të orientohej drejt, qoftë mashkull, qoftë femër, ka të drejtë dhe gëzon pavarësi të veprojë në të gjitha punët e tij dhe askush nuk ka të drejtë ta kundërshtojë atë në asgjë, përderisa me veprimin e tij ai nuk kundërshton ndonjë të drejtë private ose publike.

Është e detyrueshme që vajza të veprojë vetëm në punët e saj private dhe jo në punët e të tjerave. Gjithashtu, vajza gëzon të gjitha kapacitetet e plota për të vepruar në të gjitha drejtimet. Kjo është origjinë dhe për vërtetësinë e për vlefshmërinë e kësaj origjine, të gjithë myslimanët ndajnë një fjalë të përbashkët, madje edhe njerëzit e mëdhenj, akoma më shumë edhe të gjitha fetet e të gjitha ligjet qiellore e civile. Për rrjedhojë, me argument taksativ nuk lejohet të dilet prej kësaj origjine, sepse ne besojmë fort, në mënyrë absolute, në vlefshmërinë e kësaj origjine. Nëse ne duam ta kundërshtojmë këtë origjinë dhe të dalim prej saj në ndonjë burim prej burimeve, patjetër duhet të besojmë fort e në mënyrë të prerë në ekzistencën e këtij shkaku që e bëri të detyrueshëm kundërshtimin e kësaj origjine dhe daljen jashtë prej asaj, sepse ajo që dihet me siguri, nuk mund të priset as me dyshime e as me hamendje.

Bazuar mbi sa u tha, ai që e mohon kujdestarinë për vajzën e kompletuar, nuk kërkon vërtetim e argument për mohimin e tij, pasi, në të vërtetë, barra e vërtetimit të kujdestarisë është një punë që qëndron në parimin e sjelljes së argumentit prej atij që pretendon, si parim për çdo gjykim, bazuar në argumente të veçanta ose përgjithësuese.

Argumenti i dytë: Martesa e vajzës së kompletuar, sipas traditës përputhet, me emrin kontratë martese. Kjo gjë përfshihet në ajetin e nderuar të Kuranit Famëlartë: “أَوْفُوا بِالْعُقُودِ” - “...mbani besën për kontratat.” (Sure “El Maide”, ajeti 1), sepse dispozitat ndjekim emrat. Përveç kësaj, këtë e përforcon edhe fjala e përbashkët e fukahave, me dëshminë e autorit të librit “El Xheuahir” dhe shejkh El Ensàrij, të cilët kanë thënë: “Sikur vajza të shprehë dëshirën e saj për martesë me një mysliman, kontrata për martesën e saj është e vlefshme edhe pa miratimin e kujdestarit.”

Argumenti i tretë: Për këtë argument kemi fjalën e Allahut të Lartësuar:

“فَأَنكِحُوا مَا طَابَ لَكُمْ مِنَ النِّسَاءِ”

“...atëherë martohuni me gratë që ju pëlqejnë...” (Sure En Nisa”, ajeti 3) Gjithashtu, kemi edhe transmetimet përgjithësuese e të pakushtëzuara. Të gjitha këto tregojnë qartë lejimin e martesës e vlefshmërinë e saj, pa qenë e nevojshme të referohemi te kujdestari apo te këshillimi me të. Megjithëkëtë, prej këtij rregulli kanë dalë jashtë martesa e të çmendurës, e të miturës dhe e mendjelehtës, kur të tjerat mbeten në dispozitën përgjithësuese.

Argumenti i katërt: Prej Ehli Bejtit (Paqja e Allahut qoftë mbi ta!) kanë ardhur transmetime të shumta, që flasin qartë për lirinë që gëzon vajza për martesën e saj, kur ajo ka arritur pjekurinë seksuale dhe di të orientohet drejt. Në këtë gjendje, fukahatë kanë lënë në dorën e saj të zgjedhë burrin që ajo do.

Prej këtyre transmetimeve kemi fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “S’ka problem për martesën e vajzës beqare, kur ajo është e kënaqur, edhe pa lejen e babait të saj.”

Ky transmetim tregon qartë për pavarësinë e vajzës beqare që të martohet me kë të dëshirojë. Vetëkuptohet që këtë të drejtë akoma më shumë e gëzon jo beqarja. Shejkh El Ensarij, në librin “Mulhakatul Mekasib”, ka thënë: “Ky transmetim nuk pranon kushte.”

E njëjta qartësi shihet edhe në transmetimin e përcjellë prej El Halebij’jit, prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), kur ai e ka pyetur atë në lidhje me martesën e ndërprerë me vajzën beqare, ai është përgjigjur: “S’ka problem.”

Shejkh El Ensarij ka thënë se njoftimet në lidhje me lejimin e martesës së ndërprerë pa kujdestar, tregojnë se lejimi ka akoma më shumë përparësi në martesën e përhershme dhe është shprehur: “Medh’hebi i fukahave imamij ka vërtetuar se nuk ka asnjë thënie për dallimin mes martesës së ndërprerë dhe martesës së përhershme.” Bazuar mbi këtë fjalë, përderisa është e vlefshme martesë e ndërprerë pa kujdestar, vetëkuptohet që është e vlefshme, pa kujdestar edhe martesë e përhershme.

Imam Bakiri, babai i Imam Xhafer Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur gruaja është zotëruese e punës së saj, ajo shet e ble, i jep pasurinë e saj kujt të dojë ajo, është fjala për gruan normale, jo për gruan mendjelehtë, si e tillë, ajo e ka të lejuar të martohet me cilin të dojë, pa kujdestar, sepse, nëse nuk do të ishte kështu, martesë e saj do të ishte e vlefshme vetëm me urdhër të kujdestarit të saj.”

Ky transmetim e mohon qartë kujdestarinë për gruan e kompletuar. Në termin “grua e kompletuar” përfshihet beqarja dhe jo beqarja, përfshihet martesë e përhershme dhe martesë e ndërprerë.

Ti mund të thuash se prej Ehli Bejtit (*Paqja e Allahut qoftë mbi ta!*) kanë ardhur transmetime të cilat, nga ana e jashtme e fjalëve, tregojnë se babai gëzon të drejtën e kujdestarisë për martesën e vajzës beqare. Madje disa transmetime i njohin babait të drejtën e kujdestarisë, edhe në martesën e përhershme. Të tjera transmetime flasin për bashkëpunim mes babait e vajzës, në atë mënyrë që as babai nuk mund të veprojë i pavarur pa vajzën dhe as vajza nuk mund të veprojë e pavarur pa babain.

Përgjigjen e kësaj çështjeje, po e japim në disa drejtime:

E para: Me dëshminë e autorit të librit “El Xhevahir”, këto transmetime janë me mbështetës të gradës “Daijf”-“Dobët”. Në lidhje për këto transmetime, ai ka thënë: “Të gjitha këto transmetime, ose shumica e këtyre transmetimeve, kanë mangësi në mbështetje, për rrjedhojë, ato nuk mund të vihen në kategorinë transmetimeve të drejta.”

Bazuar mbi këtë sentencë, këto transmetime nuk mund të shërbejnë për oponencë. Autori i librit “El Mesalik” i ka diskutuar këto transmetime nga pikëpamja e mbështetjes dhe nga pikëpamja e argumentit, madje mbi këto transmetime ai është zgjatur më shumë se autori i librit “El Xhevahir”, por në asgjë nuk i ka marrë ato si mbështetje.

E dyta: Nëse vëmë në konsideratë vlefshmërinë e këtyre transmetimeve, ne i mbartim ato bazuar në rregullin e shoqërimit

dhe themi se është më mirë të kërkohet këshilla e kujdestarit, edhe pse martesë e gruas është e vlefshme edhe pa mendimin e kujdestarit. Bazuar mbi këtë rregull, ne i mbartim të gjitha transmetimet, madje edhe ato transmetime që flasin për mohimin e kujdestarisë. Argumenti ynë për këtë bashkim, mes transmetimeve, është bazuar mbi transmetimin e përcjellë prej Ibn Abasit, i cili tregon se një femër erdhi te Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe ajo i tha: “*Babai më ka martuar me djalën e njërit prej vëllezërve të tij, por unë nuk e dua këtë martesë.*”

Ai iu përgjigj: “*Konsiderojë të vlefshme atë që ka bërë babai yt.*”

Ajo i tha: “*Nuk e dua atë që ka qullosur babai im.*”

Atëherë Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) i tha asaj: “*Vër kurorë me kë të duash.*”

Në të vërtetë, i Dërguari i Allahut Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) e urdhëroi atë, që ajo ta konsideronte të vlefshëm atë që kishte bërë babai i saj. Kur ajo e njoftoi se nuk e dëshironte atë martesë, atëherë Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) e la në dorën e saj të drejtën e zgjedhjes, çka tregon se urdhëroi për lejimin. Duhet të theksojmë se ky lejim është në gradën veprim i pëlqyer (*mustehab*) dhe jo në gradën veprim i detyrueshëm (*vàxhib*).

E treta: Bazuar në supozimin e pamundësisë për të bashkuar transmetimet dhe mbartjen e atyre transmetimeve, bazuar mbi rregullin e shoqërimit dhe të qëndrimit të kundërshtimit të ndërsjellë, transmetimet që tregojnë pavarësinë e beqares në martesën e saj, kanë përparësi ndaj transmetimeve që

vërtetojnë kujdestarinë, sepse transmetimet që lejojnë pavarësinë e beqares në martesën e saj, kanë përhapjen më të gjerë.

Shejkh El Ensarij ka thënë: “Transmetimet që tregojnë pavarësinë e vajzës beqare në martesën e saj, janë të mbështetura në sentencat e shumicës së fukahave, madje ato gëzojnë fjalën e përbashkët të fukahave.” Krahas kësaj, duhet vënë në dukje se kjo çështje është në përputhje me fjalët e këtij libri, fjalë të cilat vërtetojnë kujdestarinë dhe, ashtu siç ka thënë autori i librit “El Xheuahir”, është në kundërshtim me vetë atë.

Prej Ehli Bejtit (*Paqja e Allahut qoftë mbi ta!*) vërtetohet se, kur dy transmetime kundërshtojnë njëra-tjetrën, merret transmetimi që ka më shumë shtrirje. Kur dy transmetime janë të barabarta, apo të ngjashme nga pikëpamja e shtrirjes, merret transmetimi që është në përputhje me librin e Allahut dhe ballafaqohet me transmetimin e anës së kundërt.

E katërta: Bazuar mbi supozimin se të dy transmetimet janë të barabarta nga të gjitha anët, në këtë rast, ne i referohemi origjinës, që është moskujdestaria. Por kjo ndodh, kur ne shprehemi për rrëzimin e dy transmetimeve që kundërshtojnë njëra-tjetrën. Nëse shprehemi për të drejtën e zgjedhjes, atëherë ne marrim transmetimet që mohojnë kujdestarinë.

Këtë çështje e mbyllim me ato fjalë që e ka mbyllur edhe autori i librit “El Xheuahir”, i cili, pasi zhvlerëson argumentet e atyre që janë shprehur për vërtetimin e kujdestarisë, madje që këmbëngulin në vërtetimin e kujdestarisë, ka thënë: “Edhe për atë që ka shkallën më të ulët të përzierjes së diturisë me gjëra pa vlerë dhe që këtë përzierje e praktikon në shkrimet e në bisedat e tij,

nuk duhet të qëndrojë në këtë çështje dhe të shprehet se ajo duhet të kërkojë këshillën e kujdestarit të saj e të pranojë zgjedhjen që ai ka bërë për të, sepse ushtrimi i tiranisë mbi atë femër, është veprim i papranueshëm, ashtu siç është veprim i papranueshëm edhe për atë që ka dëshirë të vërë kurorë me atë femër, pa lejen e kujdestarit të saj. Në martesën e vajzës, duhet të respektohet edhe mendimi i nënës së saj, madje nga këndvështrimi i veprimit të preferuar, çështja e martesës së vajzës është mirë të konsultohet me vëllain e saj, kur ajo nuk e ka babain dhe nënën, sepse vëllai për motrën, nga pikëpamja e mëshirës, është në pozitën e dy prindërve të saj.”

I mituri dhe e mitura

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se babai dhe gjyshi, nga ana e babait, kanë të drejtë të martojnë të miturin e të miturën, por as babai e as gjyshi, nga ana e babait nuk kanë të drejtë të divorcojnë prej bashkëshortit të mitur.

Imam Bakiri, babai i Imam Xhafer Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një të mitur të martuar me një të mitur, nëse ata të dy trashëgojnë njëri-tjetrin dhe ai është përgjigjur: “Nëse ata të dy i kanë martuar prindërit e tyre, atëherë po.”

Më pas pyetësi i tha: “A lejohet që babai të divorcojë për të miturin?” Imami tha: “Jo.”

Fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Nëse ata të dy i kanë martuar të prindërit e tyre”, tregon kuptimin e kushtit se në martesën e të miturit dhe të miturës askush përveç babait nuk ka

kujdestari. Në fjalën “askush” përfshihet edhe gjykatësi i të porositurit. Bazuar mbi këtë rregull, fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët me dëshminë e autorit të librit “El Hadaik”, i cili ka thënë: “S’ka kujdestari për gjykatësin në martesën e të miturit dhe të miturës.”

Kështu janë shprehur edhe fukahatë më të dëgjuar, të bazuar në atë që thuhet në librin “El Xheuahir”: “S’ka kujdestari për të porositurin prej babait, as për të porositurin prej gjyshit, as atëherë kur ata të dy e kanë lënë këtë me shkrim dhe i kanë dhënë leje të porositurit që ai të jetë kujdestar në martesë, sepse kujdestaria është në pozitën e prindit dhe e drejta prindërore nuk mund të bjerë duke e hequr këtë të drejtë. Gjithashtu, nuk është e vlefshme që e drejta prindërore t’i kalohet një tjetri.

Me këtë shpjegim bëhet e qartë se në martesën e të miturit dhe të së miturës, të drejtën e kujdestarisë e ka vetëm babai e gjyshi nga ana e babait dhe askush tjetër përveç këtyre të dyve. Gjithashtu, në kujdestari, secili prej këtyre të dyve, është i pavarur prej tjetrit, domethënë se, kur gjyshi bën kontratën e martesës me një njeri dhe babai bën kontratën e martesës për një njeri tjetër, mbetet e vlefshme kontrata e parë dhe prishet kontrata që është bërë më pas.

Nëse të dyja kontratat kanë ndodhur në të njëjtën kohë, mbetet e vlefshme kontrata e bërë prej gjyshit dhe prishet kontrata e bërë prej babait.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur babai marton një vajzë për djalin e tij dhe kjo martesë është e lejuar për djalin e tij, ndërsa babai i vajzës ka dëshirë për një burrë, por edhe

gjyshi ka dëshirë që mbesës së tij t'i japë një burrë, në këtë rast, gjyshi ka përparësi të martojë mbesën e tij."

Pyetje: Kur babai ose gjyshi marton të miturën ose të miturin dhe më pas ata të dy arrijnë moshën e pjekurisë seksuale, a kanë të drejtë këta të dy të kundërshtojnë martesën, apo që të dy janë të detyruar të përmbahen në atë martesë në të gjitha gjendjet, madje edhe sikur martesë të jetë dëmtim i mirëfilltë?

Përgjigjja për këtë pyetje kërkon sqarimet vijuese:

1- Martesa është bërë në vendin e duhur dhe në martesë s'ka fare dëmtim, as nga ana e martesës e as nga ana e shumës së kurorës, si për shembull, shuma e kurorës është në sasinë që praktikohet në raste të ngjashme. Nëse çështja qëndron kështu siç u tha, është detyrim përmbajtja në martesën që ka bërë kujdestari dhe me fjalën e përbashkët të fukahave, nuk është e vlefshme që martesë të kundërshtohet pas arritjes së pjekurisë seksuale dhe moshës kur njeriu orientohet drejt. Për këtë çështje janë mbartur edhe transmetimet që tregojnë detyrimin e personit me të meta, që të përmbahet në kontratën e martesës që kujdestari ka bërë për të. Prej këtyre transmetimeve kemi rastin kur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një vajzë të mitur, të cilën e ka martuar i ati, nëse ajo mund të veprojë për martesën e saj, kur të arrijë moshën e pjekurisë seksuale. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: "Jo."

2- Personi nën kujdestari dëmtohet prej martesës që ka bërë kujdestari për të. Padyshim që personi me mangësi gëzon të

drejtën e kundërshtimit të martesës, kur ai arrin pjekurinë seksuale, sepse s'ka kujdestari krahas dëmtimit.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Kur në martesë ka elemente prishëse dhe dëmtuese, personi nën kujdestari, në mënyrë të prerë, ka të drejtë ta kundërshtojë këtë martesë, sepse për këtë martesë nuk mund të ketë kujdestari.

Në kapitullin “Ngurtësimi”, në paragrafin “Kushti i kujdestarit” kemi thënë se nuk zbatohet veprimi i kujdestarit me pasurinë e atij që është me të meta, kur ka dëmtim. Vetëkuptohet që krahas dëmtimit, ka përparësi të mos zbatohet veprimi i kujdestarit, kur ka të bëjë me vetë personin me të meta.

3- Në martesë të mos ketë as interes, as korrupsion e as perversitet, domethënë që kontrata e martesës është e vlefshme, prandaj personi me të meta është i detyruar t'i përmbahet kontratës së martesës, domethënë që ai s'ka të drejtë ta kundërshtojë atë kontratë martese, pasi të arrijë moshën e pjekurisë seksuale. Në këtë rast, punohet me tekstin që vërteton kujdestarinë e babait e të gjyshit, por ka dalë jashtë këtij transmetimi martesa që ka dëmtim dhe korrupsion e perversitet, kurse martesat e tjera veç kësaj që u tha, mbeten në dispozitën e argumenteve përgjithësuese.

4- Nëse në martesë nuk ka elemente korruptive, por korrupsioni dhe dëmtimi janë në shumën e kurorës, si për shembull, shumën e kurorës për të miturën është më pak se shumën në raste të ngjashme që praktikohet zakonisht, ose për të miturin kërkohet më shumë se sa praktikohet në raste të ngjashme, në këtë gjendje, a ka të drejtë personi me të meta të kundërshtojë

kontratën e martesës, pasi të arrijë pjekurinë seksuale dhe a ka ai të drejtë ta prishë këtë kontratë martese, apo martesa për atë është e përfunduar, apo ai ka të drejtë të kundërshtojë vetëm shumën e kurorës dhe të kërkojë që edhe për atë pikë referimi të jetë shuma e kurorës në raste të ngjashme?

Në lidhje me këto çështje fukahatë kanë dy thënie. Një grup fukahash, ndër të cilët edhe autorët e librave “El-Xhevahir”, “El-Urvetul-Vuthka” dhe “El-Mustemsek”, kanë thënë se personi nën kujdestari, pasi të arrijë moshën e pjekurisë seksuale, ka të drejtën e përzgjedhjes, domethënë: Nëse ai dëshiron, ose i përmbahet kontratës së martesës, ose e prish atë, sepse këtu nuk kemi të bëjmë me ndarje mes kontratës e shumës së kurorës.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Është e qartë se realiteti nga jashtë, është veprim i vetëm dhe i specifikuar, duke vënë në konsideratë se detyrimi i të miturës që të përmbahet në shumën e kurorës, së ngjashme në formë imponimi, gjithashtu është dëmtim.”

Konstatohet se autori i librit “El Xheuahir”, nuk ngurron të pohojë se, kur kujdestari e marton të miturën për një shumë kurore të ngjashme, krahas mosdëmtimit për të miturën në origjinën e martesës, ai këmbëngul për zbatimin e kontratës së martesës me të drejtën e të miturës që ajo t’i përmbahet asaj kontrate martese, qoftë edhe me imponim. Nëse detyrimi që të përmbahet në kontratën e martesës për shumën e caktuar të kurorës është dëmtim, patjetër që kjo kontratë martese nuk duhet të zbatohet prej kujdestarit, përveçse me miratimin e saj, madje duhet të mohohet kujdestaria që nga kreu, në të gjitha format e në

të gjitha gjendjet, sepse kujdestaria e detyron personin nën kujdestari të martohet me imponim, pa dëshirën e tij.”

I çmenduri

Kujdestarinë për martesën e të çmendurit dhe të së çmendurës e ka vetëm babai dhe gjyshi nga ana e babait, domethënë se, për të çmendurin e për të çendurën, gjykatësi nuk mund të jetë kujdestar kur ata kanë babain, ose gjyshin nga ana e babait. Kjo është e barabartë, qoftë kur çmendja ka ardhur që në moshë të vogël, qoftë kur çmendja ka ardhur pas arritjes së pjekurisë seksuale dhe pas moshës në të cilën i mituri ose e mitura di të orientohet drejt. Vlen të theksohet se gjykatësi është kujdestar për atë që nuk ka kujdestar, por zakonisht supozohet ekzistenca e kujdestarit. Gjithashtu, duhet të theksohet se kujdestaria e gjykatësit në martesë, ka vend për t’u shikuar, për shkak se detyra e tij reduktohet vetëm në shpjegimin e dispozitave dhe në ndarjen e konflikteve, për ruajtjen e pasurive publike, siç janë vakëfet e pasuria e personit që nuk është i pranishëm dhe e personit me të meta, edhe pse ai ka kujdestar të veçantë.

Kurse kujdestari për veten, ajo është vetëm për të ruajturin prej mëkatesh. Patjetër, sikur të supozohet se i çmenduri e ka nevojë tepër të ngutshme martesën, në atë mënyrë që ai nuk e sistemon jetën e tij pa martesë dhe ky i çmendur s’ka as baba e as gjysh nga ana e babait, në këtë gjendje, parë nga këndvështrimi i detyrës së gjykatësit për ruajtjen e moralit dhe rregullit, gjykatësit i lejohet ta marrë në dorë punën e martesës së këtij të çmenduri,

madje martesën e këtij të çmenduri i lejohet ta marrë në dorë edhe ai që drejton punët e besimtarëve, edhe pse ekziston gjykatësi.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Kujdestaria e gjykatësit vërtetohet për personin që ka arritur moshën e pjekurisë seksuale, i cili për shkak të çmendurisë, nuk di të orientohet drejt dhe, kur ai nuk ka kujdestar nga përkatësia familjare, ose çoroditja mendore, atij i përsëritet dhe vetëm martesa për atë është përmirësim. Këtë unë e gjej pa asnjë kundërshtim. Madje të gjithë fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët për martesën e këtij të çmenduri prej këtij kujdestari.”

Për sa i përket të porositurit prej babait e prej gjyshit, fukahatë më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit “El Hadaik” që ky i porositur ka të drejtë të martojë të çmendurin, kur ai e ka të nevojshme martesën. Në lidhje me këtë çështje, autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “I porosituri ka të drejtë të martojë të çmendurin që ka arritur moshën e pjekurisë seksuale, kur martesa për atë bëhet domosdoshmëri. Për këtë shkak, disa fukaha kanë mohuar kundërshtimin në lidhje me këtë çështje, sepse ana e jashtme e këtij problemi bën që ky lejim, me fjalën e përbashkët të fukahave të marrë përparësi.”

Dijetari poliedrik, El Hil'lij, në librin “Et Tedhkireh”, thotë: “Te disa prej dijetarëve tanë të fesë, kujdestaria e të porositurit vërtetohet vetëm në një formë të vetme, vetëm kur i mituri është i çmendur dhe martesa për atë është jo vetëm e nevojshme, por është domosdoshmëri.”

Mendjelehti

Martesa e mendjelehtit nuk kërkon që të veprohet në pasurinë e tij dhe nuk kërkon as shumën e kurorës e as që ai të shpenzojë, si për shembull, një grua e pasur është e gatshme t'i japë atij e të mos marrë prej tij. Nëse puna qëndron kështu, martesë e tij është e vlefshme edhe pa lejen e kujdestarit, por, nëse martesë e tij kërkon që të veprohet në pasurinë e tij, atëherë shikohet: Nëse ai nuk ka nevojë për martesë, në mënyrë të prerë, martesë e tij është e pavlefshme, qoftë edhe me lejen e kujdestarit.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “I ngurtësuar për shkak të shpërdorimit, një shpërdorues i tillë, nuk lejohet të martohet, nëse martesë për atë nuk është domosdoshmëri, kur me martesën do të ndodhë asgjësimi i pasurisë së tij. Unë këtë e gjej pa asnjë kundërshtim, sepse nuk ka asnjë komplikim që mund ta atakojë moslejimin e martesës së këtij shpërdoruesi, domethënë se, edhe nëse bëhet kontrata e martesës, ajo kontratë martesë është e prishur, qoftë edhe kur është bërë me lejen e kujdestarit, pasi leja që mund t'i jepet shpërdoruesit për martesë, është e pavlefshme. Vetëkuptohet që lejimi nuk ka asnjë ndikim në martesën e tij.”

Në qoftë se mendjelehti është i detyruar të martohet, martesë e tij është e vlefshme me lejen e kujdestarit, ndryshe, nuk është e vlefshme. Kjo është fjala e fukahave, krahas pohimit të tyre se për këtë çështje nuk ka tekst të veçantë, për rrjedhojë argumenti i tyre i vetëm mbetet fakti që mendjelehti është i ndaluar të kryejë veprime pasurore, por edhe martesë bën pjesë në tërësinë e veprimeve pasurore, sepse martesë kërkon shumën e kurorës dhe përballimin e shpenzimeve për gruan.

Nisur nga fakti që nuk ka tekst që e ndalon martesën e mendjelehtit, por ne e shikojmë se ai e ka të domosdoshme martesën, në këtë gjendje, mendjelehti është i pavarur në punën e martesës dhe mund të martohet edhe pa lejen e kujdestarit, me kusht që atij për kurorën të mos i kërkohet më tepër se shuma që praktikohet në raste të ngjashme. Vetëkuptohet që ky kusht është vënë me qëllim që të sprapset dëmi që atij mund t'i bëhet. Me fjalë të tjera: Kujdestari ka detyrë të marrë leje prej tij për martesë, kur ai ka nevojë për martesë. Nëse ai nuk prononcohet për lejen, kujdestaria e tij rrëzohet. Pikërisht kjo përforcon atë që përmendëm më sipër prej fjalës që kanë thënë autorët e librave “Esh Sheraiu” dhe “El Kauaidu”: “Kur mendjelehti është i detyruar, nga nevoja e madhe, të martohet dhe bën martesë para se të marrë leje prej kujdestarit, kontrata e martesës që ai bën është e vlefshme.”

Kujdestaria për mendjelehtin në martesën e tij dhe për punë të tjera i takon babait të tij dhe gjyshit të tij nga ana e babait, kur ai e arrin moshën e pjekurisë seksuale në gjendje mendjelehtësie. Por në qoftë se ai arrin moshën e pjekurisë seksuale në gjendje normale dhe di të orientohej drejt, por më pas ai demonstroi shenja mendjelehtësie, në këtë gjendje, kujdestaria për këtë mendjelehtë i takon sundimtarit ligjor.

Këtë çështje ne e kemi trajtuar në mënyrë të detajuar në kapitullin “Ngurtësimi”, në paragrafin “Mendjelehti”.

* * *

MARTESA E PËRKOHSHME

(el mut'atu)

Detyra e dijetarit të fesë

Herët dhe vonë, rreth martesës së përkohshme, kanë ardhur shumë fjalë, çka do të thotë se janë shtuar kundërshtimet e diskutimet në lidhje me dispozitën e martesës së përkohshme, nëse në ligjin e fesë islame martesa e ndërprerë është hallall apo ajo është haram. Shumë njerëz, duke mos pasur dijeni në lidhje me të vërtetën për martesën e përkohshme, e konsiderojnë atë njërën prej rrugëve të kurvërimit e të mëkatimit sheshit, madje shkojnë deri aty sa të besojnë se fëmija i lindur prej martesës së përkohshme të shi'at nuk ka pjesë prej trashëgimisë së babait të tij. Gjithashtu, ky fëmijë nuk ka asgjë të përbashkët me vëllezërit e tij prej martesës së përhershme. Ata besojnë se gruaja me martesë të përkohshme nuk kalon kohën e pritjes ligjore dhe ajo ka mundësi të kalojë prej një burri te një burrë tjetër, nëse ajo e dëshiron këtë kalim, sapo të përfundojë afati për të cilën ata kishin rënë në marrëveshje njëri-tjetrit. Për të gjitha këto, ata e kanë quajtur martesën e përkohshme veprim të keq, e mohojnë dhe janë të ashpër ndaj atyre që e lejojnë martesën e ndërprerë.

Detyra e dietarit të fesë është që ai të ketë një rol pozitiv në ndërgjegjësimin e njerëzve, sidomos në çështjet e fesë dhe t'i udhëzojë ata në të vërtetën, larg fanatizmit e grupazhit, dukuri të cilat i mohon jo vetëm mendja, por edhe feja. Për të gjitha këto mendova të bëj një ekspozim të martesës së përkohshme dhe të zbuloj të vërtetën rreth kësaj martese, ashtu siç është ajo te shi'at, pa shprehur ndonjë opinion timin, pa dhënë asnjë mendim personal dhe pa bërë asnjë krahasim.

Kuptimet e fjalës “el mut’atu”

Fjala arabe “el mut’atu”, e përdoruar për martesën e përkohshme, ka disa kuptime, prej të cilave edhe dobia që sjell kënaqësi, ashtu siç thuhet në fjalën e Allahut të Lartësuar:

“مَتَاعُ الْحَيَاةِ الدُّنْيَا”

“...kënaqësi të kësaj bote...” (Sure “Al Imran”, ajeti 14)

Ka edhe kuptimin e furnizimit që merr njeriu kur niset për udhëtim, ose pajimet e materialet që merr, kur shkon në luftë. Kjo gjë pasqyrohet në fjalën e Allahut të Lartësuar:

“مَتَاعاً لَكُمْ وَلِلْغِيَاةِ”

“...kënaqësi për ju e për udhëtarët...” (Sure “El Maide”, ajeti 96)

Ka edhe kuptimin e mundësisë për të përfituar për një farë kohe, ashtu siç jepet në fjalën e Allahut të Lartësuar:

“فَأَمْتَعُهُ قَلِيلًا”

“...(edhe mohuesit) do t’i mundësoj të përfitojë për pak kohë...”
(Sure “El Bekare”, ajeti 126)

Ka edhe kuptimin e dhënies, ashtu siç është fjala e Allahut të Lartësuar:

“مَتَاعًا بِالْمَعْرُوفِ”

“...dhënie të zakonshme...” (Sure “El Bekare”, ajeti 236)

Fukahatë kanë folur rreth fjalës “el mut’atu”, në kuptimin e dhënies. Këtë dhënie e kanë bërë detyrim për burrin që është martuar me një grua, por, që në kohën e bërjes së kontratës së martesës, nuk ka caktuar shumën e kurorës. Më pas, këtë detyrim fukahatë e kanë lakuar, kur burri e ndan gruan para se të kryejë marrëdhënie intime me të, ose e kanë bërë detyrim që burri t’i dhurojë gruas së ndarë diçka, në përshtatje me gjendjen e tij pasurore. Argumentin për këtë detyrim mbi burrin, fukahatë e kanë nxjerrë prej ajetit 236 të sures “El Bekare”:

“لَا جُنَاحَ عَلَيْكُمْ إِنْ طَلَقْتُمُ النِّسَاءَ مَا لَمْ تَمْسُوهُنَّ أَوْ تَفْرِضُوا لَهُنَّ فَرِيضَةً وَمَتَّعُوهُنَّ عَلَى الْمَوْسِعِ قَدَرُهُ وَعَلَى الْمُقْتَرِ قَدَرُهُ مَتَاعًا بِالْمَعْرُوفِ حَقًّا عَلَى الْمُحْسِنِينَ”

“Nuk është mëkat për ju, nëse i divorconi gratë, para se të kryeni marrëdhënie intime me to dhe para se t’u caktoni atyre shumën (shumën e kurorës) dhe u bëni atyre një dhënie të zakonshme, i pasuri sipas mundësisë së tij, edhe i varfëri sipas mundësisë së tij, Një dhënie e zakonshme është detyrim për bamirësit.”

Për fjalën “el mut’atu”, fukahatë kanë folur edhe në kuptimin e përfitimit nga disa ndalime të Ihramit, gjatë kohës së

Haxhit, të cilin ne i kemi trajtuar në mënyrë të detajuar në pjesën e dytë të librit “Fik’hu i Imam Xhafer Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*)”, në kapitullin “Shkurtimi i flokëve dhe rruajtja e kokës”.

Martesa e përkohshme

Fukahatë, gjithashtu, kanë folur në lidhje me fjalën “el mut’atu”, në kuptimin e martesës së përkohshme. Të gjithë fukahatë myslimanë, të Ehli Sunetit dhe të shi’ave kanë rënë në një fjalë të përbashkët se Islami e ka ligjëruar martesën e përkohshme. I Dërguari i Allahut (*Paqja e brkimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) e ka lejuar martesën e përkohshme. Argumentin për këtë është nxjerrë prej ajetit 24, të sures “En-Nisa”:

“فَمَا اسْتَمْتَعْتُمْ بِهِ مِنْهُنَّ فَآتُوهُنَّ أُجُورَهُنَّ فَرِيضَةً”

“...dhe për kënaqësitë që përjetuat prej tyre, u jepni atyre shumën e caktuar si detyrim mbi ju...”

Në “Sahijhun” e Buhariut, në vëllimin 9, në kapitullin “Martesa”, gjendet hadithi që tregon se i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) u ka thënë sahabëve të tij, në disa prej luftërave që ka zhvilluar: “Për ju është lejuar të përjetoni kënaqësinë e martesës së përkohshme, prandaj përjetoheni këtë kënaqësi. Çdo burrë e çdo grua që bie në marrëveshje të bashkëjetojnë tri ditë dhe, nëse duan, le të shtojnë edhe më shumë dhe, nëse të dy duan ta lënë, le ta lënë bashkëjetesën.”

Në “Sahijhun” e Muslimit, në vëllimin 2, në kapitullin “Martesa e përkohshme”, në faqen 623, botim i vitit 1348H, transmetohet hadithi i përcjellë prej Xhabir bin Abdullahut, i cili tregon: “Ne kemi bërë martesë të përkohshme në kohën e të Dërguarit të Allahut, në kohën e Ebu Bekrit dhe në kohën e Ymerit.”

Në të njëjtën faqe, transmetohet një hadith tjetër i përcjellë po prej Xhabirit, në të cilin ai thotë: “Më pas Ymeri na e ndaloi martesën e përkohshme.”

Të gjithë myslimanët, pasi ranë në një fjalë të përbashkët për ligjërimin e martesës së përkohshme dhe për lejimin e saj në kohën e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) patën kundërshtime mes tyre në lidhje me anulimin e martesës së përkohshme. Por a mund të bëhet ajo haram, pasi e kishte bërë hallall Allahu i Gjithëpushtetshëm? Ehli Suneti është shprehur se martesa e përkohshme është anuluar dhe është ndaluar, pasi ishte dhënë leje për të bërë martesë të përkohshme.

Ibn Haxher El Askalani, në librin “Fet’hul Bàrij”, që është komenti i “Sahijhut” të Buhariut, në vëllimin 11, në faqen 70, botim i vitit 1959, ka thënë: “Kanë ardhur disa hadithe të gradës “Sahijh” – “Të sakta” që flasin qartë për ndalimin e martesës së përkohshme, pasi ajo ishte lejuar.” Në pjesën e gjashtë të librit “El Mugnij”, të autorit Ibn Kudameh, në faqen 645, botimi i tretë, tekstualisht thuhet: “Shafiji ka thënë: ‘Nuk di ndonjë gjë të cilën Allahu e ka bërë hallall, pastaj e ka bërë atë haram, pastaj e bëri atë hallall, pastaj e bëri atë haram, përveç martesës së përkohshme.’

Shi'at kanë thënë se të gjithë myslimanët ndajnë një fjalë të përbashkët për lejimin e martesës së përkohshme dhe kanë mosmarrëveshje mes tyre në lidhje me anulimin e saj. Por ajo që vërtetohet me argumente të qarta, nuk mund të anulohet e të hiqet thjesht për shkak të dyshimit e të hamendjes, por patjetër që anulimi duhet të vërtetohet me argumente të qarta. Argumentin për mosanulimin e martesës së përkohshme, shi'at e kanë nxjerrë prej transmetimeve të shumta të ardhura prej Ehli Bejtit (*Paqja e Allahut qoftë mbi ta!*), transmetime të cilat i ka përmendur El Hurr El Amilij në librin "El Uesail". Prej këtyre transmetimeve kemi transmetimin që tregon se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur, nëse ka ndonjë gjë që e ka anuluar ajetin e martesës së përkohshme. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: "Sikur Ymeri të mos e kishte ndaluar martesën e përkohshme, do të kurvëronte vetëm ndonjë njeri i keq."

S'ka dyshim se, sikur anulimi të vërtetohej te Ehli Suneti, patjetër që ata do flisnin me tezën e shi'ave. Sikur anulimi i martesës së përkohshme të mos vërtetohej te shi'at, patjetër që shi'at do të flisnin me tezën e Ehli Sunetit. Ajeti që flet për martesën e përkohshme, nuk është i vetmi vend ku ka mosmarrëveshje, nga pikëpamja e anulimit ose e mosanulimit, pasi mes Ehli Suneti dhe shi'ave ka mosmarrëveshje edhe për çështje të tjera të kësaj natyre, ashtu siç kanë mosmarrëveshje fukahatë e Ehli Sunetit njëri me tjetrin. Gjithashtu, edhe fukahatë e shi'ave kanë mosmarrëveshje njëri me tjetrin në lidhje me anulimin e disa prej dispozitave dhe ajeteve.

Sido që të jetë, te shi'at, martesë e ndërprerë ka të përbashkëta me martesën e përhershmen disa gjëra dhe ka dallim prej saj në disa gjëra të tjera. Në vijim do të shikojmë një

përmbledhje të shkurtër të gjërave që ato kanë të përbashkëta dhe të gjërave ku ato dallojnë nga njëra-tjetra:

Barazia mes martesës së përhershme dhe martesës së ndërprerë

Fukahatë e medh'hebit xhaferij ndajnë një fjalë të vetme se martesë e përhershme dhe martesë e përkohshme kanë të përbashkët punët vijuese:

1- Në të dyja llojet e martesës, grua ja patjetër duhet të jetë e mençur, të ketë arritur pjekurinë seksuale, të dijë të orientohej drejt, të mos ketë asnjë ndalues, sepse martesë e përkohshme nuk lejohet as me gruan e martuar, as me gruan që është në kohën e pritjes ligjore për shkak divorci ose për shkak të vdekjes së burrit.

Gjithashtu, martesë e përkohshme nuk lejohet me gruan e martuar, as me gruan e ndaluar për shkak të përkatësisë familjare, ose për shkak të krushqisë, ose për shkak të ushqimit me qumësht gjiri. Në dispozitën e ndalimit përfshihen të gjitha kategoritë e grave të ndaluara, të cilat ne i trajtuam me imtësi në kapitullin "Gratë e ndaluara".

Për gruan lejohet që ajo të bëjë martesë të përkohshme vetëm me një mysliman, i cili s'ka asnjë ndalues.

2- Martesë e përkohshme nuk është e vlefshme me dhënie të ndërsjellë dhe vetëm me pranim, pasi patjetër duhet kontratë e shqiptuar me fjalë, që të tregojë qartë qëllimin për martesë, plotësisht si në martesën e përhershme, pasi edhe në martesën e përkohshme kontratë nuk ndodh me fjalët "E dhurova", "E

lejova", apo me fjalë të ngjashme, pasi fjala e kontratës reduktohet me fjalët specifike, si: "Vura kurorë", "U martova" dhe "Bëra martesë të ndërprerë".

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Formula e martesës së përkohshme është fjala që ka vënë ligjvënësi për ofertën, si: "Të vura kurorë", "U martova me ty dhe bëra me ty martesë të përkohshme."

Me çdo njërën prej këtyre fjalëve, oferta ka ndodhur dhe nuk mund të ndodhë me fjalë të tjera përveç këtyre fjalëve, si për shembull, me fjalët, pronësi, dhurim dhe qiramarrje. Gjithashtu, edhe pranimi ndodh vetëm me fjalë që tregojnë ndërtimin e kontratës, si: "Pranova" dhe "E miratoj".

3- Kontrata e martesës së përkohshme është si kontrata e martesës së përhershme, domethënë që të drejtën e divorcit e ka vetëm burri, i cili padyshim ka të drejtë të dhurojë kohën për të cilën është rënë dakord për gruan e tij, për atë që do të bëjë martesë të përkohshme me atë grua, si për shembull, burri ndan gruan e tij me martesë të përhershme.

4- Martesa e përkohshme e shtrin ndalimin, plotësisht si martesa e përhershme dhe burri që bën martesë të ndërprerë, e ka haram përgjithmonë të martohet me vajzën që gruaja, me martesë të përkohshme, e ka sjellë me vete. Gjithashtu, ai nuk mund të bashkojë dy motra me martesë të ndërprerë, plotësisht ashtu siç nuk mund të bashkojë dy motra me martesë të përhershme, kurse ushqimi me gji prej lavires, në mënyrë të prerë, nuk ka asnjë ndikim për të. Edhe gruaja me martesë të përkohshme është grua

ligjore dhe fjetja me të është e vlefshme, kurse lavirja ka vetëm ndalim.

5- Fëmija prej martesës së përkohshme është si fëmija prej martesës së përhershme, në të drejtën e tij për trashëgimi e shpenzim, si dhe në të gjitha të drejtat materiale dhe edukative.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për gruan me martesë të përkohshme, kur ajo mbetet shtatzënë. I kujt është fëmija? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Ai është fëmija i tij.”

6- Fëmija i atashohet burrit thjesht për shkak të kryerjeve të marrëdhënieve intime, madje edhe atëherë kur ai është sprapsur dhe ujin e tij e ka derdhur jashtë, sepse shtrati i gruas me martesë të ndërprerë është si shtrati i gruas me martesë të përhershme dhe fëmija, me fjalën e përbashkët të fukahave dhe me tekst, është i shtratit.

7- Shuma e kurorës në martesën e përkohshme është si suma e kurorës në martesën e përhershme, nga pikëpamja e vlerësimit pak ose shumë dhe suma e kurorës është e vlefshme sipas asaj që është bërë marrëveshja, qoftë me një, qoftë një milion, në përputhje të plotë me ajetin e nderuar:

“وَأَتَيْتُمْ إِخْدَاهُنَّ قِنطَارًا فَلَا تَأْخُذُوا مِنْهُ شَيْئًا”

“...dhe më parë i dhatë ndonjëres prej grave një shumë të madhe, prej asaj shume të mos i merrni asgjë...” (Sure “En Nisa”, ajeti 20)

8- Kur burri ndan gruan me martesë të përkohshme, para se të kryejë me të marrëdhënie intime, për atë grua vërtetohet e drejta të marrë vetëm gjysmën e shumës së caktuar të kurorës. Po kështu, ajo merr vetëm gjysmën e shumës së kurorës, kur burri i dhuron kohën e caktuar gruas me martesë të përkohshme, para se të kryejë marrëdhënie intime me të. Por nëse koha e caktuar ka përfunduar dhe burri nuk ka kryer me të marrëdhënie intime për një shkak prej shkaqeve, ajo ka të drejtë ta marrë të plotë shumën e kurorës. Por edhe është thënë, gjysmën e shumës.

9- Në raport me shumën e kurorës dhe me kohën e pritjes ligjore, nuk ka ndikim qëndrimi në vetmi të plotë, pa kryer marrëdhënie intime, qoftë në martesën e përhershme, qoftë në martesën e përkohshme.

10- Gruaja me martesë të përkohshme, me të cilën burri ka kryer marrëdhënie intime, ka detyrim të kalojë kohën e pritjes ligjore me përfundimin e afatit, por ajo s'ka detyrim të kalojë kohën e pritjes ligjore, nëse burri nuk ka kryer marrëdhënie intime me të, plotësisht pa asnjë ndryshim si me gruan me martesë të përhershme. Gjithashtu, qoftë gruaja me martesë të përhershme, qoftë gruaja me martesë të përkohshme, kanë detyrim të kalojnë kohën e plotë të pritjes ligjore në rastin e vdekjes së burrit. Kjo është e barabartë, qoftë kur burri ka kryer marrëdhënie intime me atë grua, qoftë kur nuk ka kryer.

11- Çdo kusht të lejuar në ligjin islam që e vë gruaja ose burri në tekstin e kontratës së martesës së përkohshme, është i zbatueshëm si kushti i vënë në martesën e përhershme, bazuar në hadithin “Besimtarët janë në kushtet e tyre”.

12- Burri e ka të ndaluar, në mënyrë të prerë, të kryejë marrëdhënie intime qoftë me gruan me martesë të përkohshme, qoftë me gruan me martesë të përhershme, kur gruaja është me menstruacione.

13- Kur burri bën kontratë martese për një grua dhe më pas bëhet e qartë prishja e kontratës, për ndonjë shkak që e bën të detyrueshëm ndalimin, kontrata e martesës priset dhe gruaja nuk merr asgjë prej shumës së kurorës, nëse burri nuk ka kryer marrëdhënie intime me atë grua. Nëse prishja e kontratës bëhet e qartë, pasi burri ka kryer marrëdhënie intime me gruan, në këtë gjendje, shikohet: Nëse gruaja ka dijeni për ndalimin, megjithëkëtë ajo afrohet dhe vetëmundëson kryerjen e marrëdhënieve intime, në një kohë që ajo është e ndaluar për atë burrë, në këtë gjendje, ajo nuk merr asgjë prej shumës së kurorës, sepse, në këtë rast, ajo ka kurvëruar. Kjo gjë thuhet qartë në hadithin: “Nuk ka shumë kurore për laviren”

Nëse gruaja nuk ka dijeni për ndalimin, ajo ka të drejtë të marrë shumën e kurorës, ashtu siç është dispozita edhe për gruan me martesë të përhershme.

14- Burrit që ka bërë martesë të përkohshme, nuk i lejohet të bëjë martesë të përkohshme me vajzën e motrës së gruas që ka me martesë të përkohshme, ose me vajzën e vëllait të saj, përveçse me lejen e saj, ashtu siç është dispozita edhe në martesën e përhershme.

Dallimi mes martesës së përhershme dhe martesës së ndërprerë

Martesa e përhershme dallohet prej martesës së përkohshme në punët e mëposhtme:

1- Në tekstin e kontratës së martesës së përkohshme patjetër duhet të përmendet afati i caktuar. Ky afat i caktuar nuk pranon as shtim e as pakësim, kurse në martesën e përhershme nuk është e vlefshme, në asnjë rast, të shënohet afati në tekstin e kontratës së martesës. Pikërisht kjo e vërtetë tregon të vërtetën e martesës së ndërprerë me vetë këtë martesë dhe analogjia e kësaj martese mund të bëhet me vetë këtë martesë.

Kur burri dhe gruaja kanë qëllim martesën e përkohshme dhe kanë harruar të përmendin afatin në kontratën e martesës, a ndodh kjo martesë si martesë e përhershme, apo ndodh si martesë e përkohshme, apo kontrata e martesës nuk është efektive, domethënë nuk ndodh as martesë e përhershme e as martesë e përkohshme?

Fukahatë më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit “El Mesalik”, i cili ka thënë se, në këtë gjendje, ndodh martesë e përhershme.

Madje autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Mendoj se kjo thënie gëzon fjalën e përbashkët të fukahave, për shkak se fjala ka kompetencë të përhershme, ashtu siç ka thënë Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*): “Kur përmendet afati, kemi të bëjmë me martesë të përkohshme dhe, nëse afati nuk përmendet, martesa e përhershme është e vërtetuar.”

Disa fukaha kanë thënë: “Jo, kemi të bëjmë me kontratë jo efektive dhe s’ka as martesë të përhershme e as martesë të përkohshme, sepse qëllimi që ishte, nuk ndodhi dhe ajo që ndodhi, nuk ishte qëllim.”

2- Në martesën e përkohshme shuma e kurorës është njëra prej kolonave të kontratës. Kur ajo nuk përmendet në tekstin e kontratës, martesë është prishur që nga kreu. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Martesë e ndërprerë ndodh vetëm me dy punë: afatin e caktuar dhe shumën e caktuar të kurorës, domethënë një afat të ditur dhe një shumë kurore që dihet.”

Në martesën e përhershme shuma e kurorës nuk është kolonë, domethënë se, edhe pa caktimin e shumës, kontrata e martesës është e vlefshme, që do të thotë se martesë e përhershme është e vlefshme si me shumën e kurorës, ashtu dhe pa shumën e kurorës. Ai që martohet me një grua dhe në tekstin e kontratës së martesës nuk i përmend asaj shumën e kurorës dhe ai burrë kryen marrëdhënie intime me këtë grua, në këtë gjendje, burri ka detyrim t’i japë gruas shumën e kurorës që zakonisht jepet në raste të ngjashme.

3- Kur gruaja me martesë të përhershme ndahet para se me të të kryhet marrëdhënie intime, kjo grua nuk ka detyrim të kalojë kohën e pritjes ligjore, gjithashtu edhe gruaja me martesë të përkohshme nuk ka detyrim të kalojë kohën e pritjes ligjore pas përfundimit të afatit, nëse me të nuk është kryer marrëdhënie intime. Por nëse gruaja me martesë të përhershme ndahet, pasi me të është kryer marrëdhënie intime dhe nuk është shtatzënë, koha e pritjes ligjore për këtë grua është që ajo të kalojë tri menstruacione, domethënë tri muaj. Nëse ajo është shtatzënë,

koha e pritjes ligjore e saj është lindja e fëmijës. Kurse për gruan me martesë të përkohshme, kur me të është kryer marrëdhënie intime, koha e pritjes ligjore së saj, pas përfundimit të afatit dhe nuk është shtatzënë, është dy menstruacione, ose dyzet e pesë ditë. Nëse ajo është shtatzënë, koha e pritjes ligjore të saj është lindja e fëmijës. Kjo ishte në analogji me divorcin e gruas me martesë të përhershme dhe me përfundimin e afatit të gruas me martesë të përkohshme.

Kurse në raport me kohën e pritjes ligjore, në rastin e vdekjes së burrit, në mënyrë të prerë, nuk ka dallim mes gruas me martesë të përhershme dhe gruas me martesë të përkohshme, kur nuk janë shtatzëna dhe burri nuk ka kryer marrëdhënie intime me to. Nëse burri ka kryer marrëdhënie intime, të dyja do të kalojnë kohën më të gjatë të pritjes ligjore, duke filluar me kohën pas lindjes, domethënë katër muaj e dhjetë ditë.

4- Fukahatë e medh'hebit xhaferij kanë kundërshtime mes tyre, në lidhje me trashëgiminë e ndërsjellë të burrit e të gruas në martesën e përkohshme. Një grup fukahash, prej të cilëve Dëshmori i parë, Muham' med bin Mek'kij (vdekur në vitin 786H) dhe Dëshmori i dytë, Zejnud'dijn El Àmilij El Xhubaij (vdekur në vitin 965H), janë shprehur se burri trashëgon prej gruas vetëm me kusht, sepse vetë natyra e kontratës së martesës nuk e kërkon trashëgiminë e ndërsjellë, por nuk kërkon as mosekzistencën e trashëgimisë. Kur arrihet kushti, është detyrim të punohet sipas kushtit, në përputhje me hadithin: "Besimtarët janë në kushtet e tyre", si dhe me fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): "Nëse ata të dy kanë vënë kusht trashëgiminë, kanë detyrim të qëndrojnë në kushtin e tyre."

5- Për gruan me martesë të përkohshme, burri s'ka detyrim të shpenzojë, kurse për gruan me martesë të përhershme, burri ka detyrim të shpenzojë, edhe sikur të jetë vënë kusht që për atë të mos bëhet shpenzim (gjatë kohës së pritjes ligjore të gruas).

6- Martesa e përkohshme me vajzë beqare është veprim i urryer, kurse martesa e përhershme me të është veprim i pëlqyer. Autori i librit "El Hadaik" ka shkruar: "Kur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për martesën e përkohshme, ka thënë: 'Puna e gruas me martesë të ndërprerë është shumë e rëndë, prandaj kijeni frikë Allahun për beqaret.'"

7- Fukahatë kanë thënë se gruaja me martesë të përhershme ka të drejtë që burri i saj të flejë në një shtrat pranë shtratit të saj një natë në çdo katër net me fytyrë të kthyer në drejtim të saj, edhe nëse dy trupat e tyre nuk puqen, pasi ka rëndësi që ai të mos numërohet burrë që ka braktisur gruan, por për burrin mbetet detyrim që ai të kryejë marrëdhënie intime me gruan një herë në çdo katër muaj.

Gjithashtu, gruaja me martesë të përhershme ka të drejtë të kërkojë prej burrit që të mos kalojë natën me të, ose të kërkojë prej tij që të mos kryejë marrëdhënie intime me të.

Kurse gruaja me martesë të përkohshme nuk i ka këto të drejta, sepse zgjedhja është në dorën e burrit. Gjithashtu, gruaja me martesë të përkohshme nuk ka të drejtë të kërkojë prej burrit që ai të kalojë natën me të ose, ai të kontaktojë me të.

8- Kur burri e ndan gruan me martesë të përhershme me divorc të kthyeshëm, pasi ka kryer marrëdhënie intime me të, burri ka të drejtë të kthehet te ajo para se ajo të përfundojë kohën e

pritjes ligjore. Nëse divorci është me pasurinë e gruas, ose ajo është neveritur prej tij dhe jep aq sa ka mundësi, ajo ka të drejtë të kthejë prej kësaj dhënieje, derisa është brenda kohës së pritjes ligjore.

Për sa i përket gruas me martesë të përkohshme, ajo distancohet prej tij, sapo të mbarojë kohën e pritjes ligjore ose dhurimin e saj dhe, as burri e as gruaja s'kanë të drejtën e kthimit gjatë kohës që gruaja kalon kohën e pritjes ligjore. Vetëkuptohet që akoma më shumë nuk e kanë të drejtën e kthimit pas përfundimit të kohës së pritjes ligjore. Natyrisht që burrit i lejohet të përtërijë kontratën e martesës me këtë grua, me martesë të përhershme, ose me martesë të përkohshme gjatë kohës që gruaja vazhdon të jetë në kohën e pritjes ligjore, kurse të tjerëve u lejohet martesë me këtë grua, me martesë të përhershme, ose me martesë të përkohshme, vetëm pasi ajo të përfundojë kohën e pritjes ligjore.

9- Kur burri kryen marrëdhënie intime me gruan me martesë të përhershme, mbi të vërtetohet detyrimi të paguajë të plotë shumën e kurorës, por, nëse gruaja më pas e refuzon burrin, ngaqë është kryeneçe dhe nuk respekton burrin e saj, deri në atë shkallë sa burri s'ka mundësi të kryejë marrëdhënie intime me të, për këtë grua nuk pakësohet asgjë prej shumës së kurorës, por bie detyrimi i burrit që të shpenzojë për këtë grua, (gjatë kohës së pritjes ligjore pas divorcit), sepse shpenzimi bëhet kundrejt respektit e bindjes.

Kur burri kryen marrëdhënie intime me gruan me martesë të përkohshme dhe pastaj gruaja, pa ndonjë justifikim e pa ndonjë ndalim logjik, e refuzon burrin, burri ka të drejtë të mbajë prej

shumës së saj të kurorës, në përpjesëtim me kohën që ajo e ka refuzuar.

Autori i librit “El Xhevahir” ka thënë: “Sikur gruaja të refuzojë burrin gjatë një pjese të afatit, burri ka të drejtë të mbajë prej shumës së kurorës së saj në përpjesëtim me kohën e refuzimit. Nëse është gjysma e kohës, ai mban gjysmën e shumës së kurorës, nëse është një e treta, ai mban një të tretën e shumës. Këtë unë e gjej pa asnjë kundërshtim, madje edhe pa asnjë komplikim.”

Prej këtyre transmetimeve kemi transmetimin e përcjellë prej Handhalehit, i cili ka thënë: Pyeta Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*). Jam martuar me një grua për një muaj, me një shumë të caktuar dhe ajo më afrohet një pjesë të muajit dhe nuk e mban besën të më afrohet për një pjesë të ditëve të tjera. Si duhet të veprojmë? Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*) m’u përgjigj: “Mbaj prej shumës së kurorës sasinë e ditëve që ajo është ndaluar për ty, me përjashtim të ditëve të periudhës së menstruacioneve, sepse ato ditë i takojnë asaj.”

10- Burrit i lejohet të bëjë martesë të përkohshme me më shumë se katër gra, por burrit nuk i lejohet të bëjë martesë të përhershme me më shumë se katër gra.

El Hurr’rr El Àmilij, në librin “Uesàilu Sh’shij’ah”, ka përmendur transmetime të ardhura prej Ehi Bejtut që tregojnë për këtë lejim, por pranë atyre transmetimeve ai ka përmendur transmetime të tjera që tregojnë moslejimin e martesës së përkohshme me më shumë se katër gra, ashtu siç është dispozita për martesën e përhershme.

Prej këtyre transmetimeve kemi transmetimin e përcjellë prej Am'màr Es'sàbàtij, prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili është pyetur në lidhje me gruan me martesë të përkohshme dhe ai është përgjigjur: "Ajo është njëra prej katër grave."

Gjithashtu, kemi edhe transmetimin e përcjellë prej Zerares, prej Imam Bakirit, babait të Imam Xhafer Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili është pyetur, nëse gruaja me martesë të përkohshme është si robëreshat, me të cilat burri martohet me sa të dëshirojë? Ai është përgjigjur: "Jo, ajo është njëra prej katër grave."

Në tërësi, çdo gjë që vërtetohet për gruan me martesë të përhershme, vërtetohet edhe për gruan me martesë të ndërprerë, me përjashtim të atyre gjërave që kanë dalë jashtë kësaj dispozite me argument. Argumenti tregon dallimet që ne përmendëm më sipër dhe mbeten ndikimet e dispozitat e bazuara në dispozitën përgjithësuese. Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Origjina është partneriteti i gruas me martesë të përhershme me gruan me martesë të përkohshme në dispozitat, subjekti të cilave është kurora dhe martesë, por gruaja me martesë të ndërprerë ka dallim vetëm në ato gjëra që kanë dalë jashtë me argument."

Në librin "El Lum'ah" dhe në komentuesin e këtij libri, tekstualisht thuhet: "Dispozita e gruas me martesë të përkohshme është si dispozita e gruas me martesë të përhershme, në të gjitha dispozitat që u thanë më sipër, si vënia e kushtit, kujdestaria dhe ndalimi, përveç punëve të janë përjashtuar prej kësaj dispozite."

Nisur nga këto që u thanë, shumë fukaha kanë thënë: "E vërteta e martesës së përkohshme dhe e martesës së përhershme është një."

Gjithashtu, vetë fjala “martesë” lë të kuptohet se kemi të bëjmë me dy subjekte, njëra është martesë e përhershme dhe tjetra është martesë e ndërprerë, plotësisht siç është vetë njeriu në përgjithësi, mashkull e femër.

Martesa e përkohshme me grua të përmbajtur

Është mirë që fjalën rreth martesës së përkohshme ta mbyllim me njoftimet që kanë ardhur prej Ehli Bejtit (*Paqja e Allahut qoftë mbi ta!*), nga të cilat mësojmë se, kur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për martesën e përkohshme, është përgjigjur: “Ajo është hallall, por martohuni vetëm me një grua të përmbajtur, ashtu siç thotë Allahu i Lartësuar në fjalën e Tij:

“وَالَّذِينَ هُمْ لِأُزُوجِهِمْ حَافِظُونَ” - “Dhe ata që e ruajnë nderin e tyre.” (sure “El Muminun”, ajeti 5)

Në një transmetim tjetër, ai ka thënë: “Allahu, i Gjithëpushtetshëm urdhëron:

“لَا يَنْكِحُ إِلَّا زَانِيَةً أَوْ مُشْرِكَةً وَالزَّانِيَةُ وَالْمُشْرِكَةُ إِذَا زَانٍ أَوْ مُشْرِكٌ ۚ وَحَرَّمَ ذَلِكَ عَلَى الْمُؤْمِنِينَ”

“Kurvari mund të martohet vetëm me një lavire, ose me një idhujtare; edhe lavirja mund të martohet vetëm me një kurvar ose me një idhujtar dhe kjo është e ndaluar për besimtarët.” (Sure “En Nur”, ajeti 3)

Duke pasur mbështetje këtë ajet, shejkh Es’saduk ka thënë: “Kush bën martesë të përkohshme me një lavire, ai është kurvar.”

Po kështu thuhet edhe në librin “El Hadaik”.

Në librin “Uesàilu Sh’shi’ah”, në vëllimin 3, në faqen 73, botim i vitit 1324H, thuhet se Ali bin Jaktijni ka pyetur Imam Rizain, nipin e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) për martesën e përkohshme. Ai i tha atij: “Ku je ti dhe kjo që thua? Allahu nuk ka bërë që të mos kesh nevojë për këtë.”

Një tjetër e pyeti atë dhe ai tha: “Martesa e përkohshme është hallall dhe e lejuar pa asnjë kusht për atë që Allahu nuk i mundëson të bëjë martesë të rregullt. Por ai le të jetë i përmbajtur në martesën e përkohshme, nëse s’ka nevojë për këtë martesë, kur ka martesë të përhershme. Martesa e përkohshme është e lejuar për atë, vetëm nëse ai është larg gruas së tij.”

* * *

TË METAT

Të metat që zbulon njëri prej dy bashkëshortëve te tjetri janë dy llojesh. Lloji i parë e bën detyrim përzgjedhjen, domethënë, ose prishjen e martesës, ose vazhdimin e saj.

Lloji i dytë, në mënyrë absolute, e meta s'ka asnjë lloj ndikim mbi martesën, që do të thotë se është e barabartë, qoftë kur e meta ekziston, qoftë kur ajo nuk ekziston.

Kur e meta prej llojit të parë gjendet te burri, e drejta e përzgjedhjes vërtetohet për gruan dhe, kur e meta gjendet te gruaja, atëherë e drejta e përzgjedhjes vërtetohet për burrin. Ky rregull është veprues, kur asnjëri prej dy bashkëshortëve nuk ka dijeni për ekzistencën e të metës te bashkëshorti tjetër, para bërjes së kontratës së martesës.

Por nëse njëri prej dy bashkëshortëve ka dijeni dhe riskon me miratimin e tij dhe shpirtërisht është i kënaqur me të metën e partnerit, ai nuk e ka të drejtën e përzgjedhjes. Në vijim le të shikojmë hollësitë:

Çmenduria

Çmenduria është një e metë që shfaqet edhe te burri, edhe te gruaja. Çdo grua që martohet me një burrë dhe para bërjes së kontratës bëhet e qartë se ai është i çmendur, madje kjo gjendje te ai vazhdon edhe në kohën e bërjes së kontratës së martesës së tij me këtë grua, gruaja ka të drejtë ta refuzojë martesën.

Gjithashtu, gruaja ka të drejtë ta refuzojë e ta prishë martesën, edhe në rastin kur çmenduria e burrit ripërsëritet pas bërjes së kontratës së martesës, madje gruaja e ka këtë të drejtë, edhe nëse ai ka kryer marrëdhënie intime me të dhe ka disa fëmijë me të. Në të dyja gjendjet, nuk ka asnjë dallim, nëse çmenduria është e përhershme ose me periudha, domethënë që gjendja e çmendurisë atij i vjen me faza të ndërprera.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një grua, burri i së cilës është prekur në mendjen e tij pas martesës me të. Si duhet të veprojë kjo grua? Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Nëse ajo dëshiron, ka të drejtë ta lërë atë.”

Po kështu, çdo burrë që është martuar me një grua dhe para bërjes së kontratës së martesës bëhet e qartë se gruaja është e çmendur, burri ka të drejtë ta refuzojë martesën. Kjo është e barabartë, qoftë kur çmenduria është e përhershme, qoftë kur është me faza, sepse fakti vërteton se ajo është e çmendur.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kthehet ajo që i bëhet lëkura me pulla, e çmendura dhe lebrosha.”

Kur çmenduria te gruaja ripërtërihet pas bërjes së kontratës, burri nuk e ka të drejtën e përzgjedhjes, madje çdo e

metë që ndodh te gruaja, çmenduria ose ndonjë e metë tjetër, nuk e bën të detyrueshme prishjen e martesës. Kjo është e barabartë, qoftë kur e meta është shfaqur para kryerjes së marrëdhënieve intime, qoftë kur është shfaqur pas kryerjes së marrëdhënieve intime.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Kjo është thënia që ka përhapjen më të madhe, madje aq të madhe, sikur të gëzojë fjalën e përbashkët të fukahave, për shkak të shoqërimit të detyrimit, i cili është kërkesë e origjinës te kontrata e martesës, kurse dëmtimi, mund të rikuperohet vetëm duke e divorcuar gruan, domethënë që burri ka mundësi të shpëtojë prej dëmtimit, duke e divorcuar gruan të e cila u shfaq e meta. Shumica e teksteve vërtetojnë të drejtën e përzgjedhjes për burrin, sidomos kur gruaja i ka bërë lajka burrit dhe i ka fshejkhur atij të metën që ajo ka që para bërjes së kontratës së martesës.

Si përmbledhje, për gruan, prishja e martesës bëhet në rastin e çmendurisë së mëparshme dhe të çmendurisë së mëvonshme, kurse për burrin, prishja e martesës bëhet vetëm në rastin e çmendurisë së mëparshme, jo në rastin e çmendurisë së mëvonshme.

Kur prishja e martesës bëhet para kryerjes së marrëdhënieve intime, gruaja nuk ka as të drejtën e shumës së kurorës, as nuk kalon kohën e pritjes ligjore për shkak të divorcit. Nëse prishja e martesës bëhet pas kryerjes së marrëdhënieve intime, gruaja ka të drejtë të marrë shumën e kurorës dhe është e detyruar të kalojë kohën e pritjes ligjore. S’ka asnjë dallim, nëse prishësi i martesës është burri apo është gruaja. Është me vlerë të theksohet se, kur njëri prej dy bashkëshortëve bie dakord për të

metën, me fjalë e me veprim, pas rënies dakord, nuk e ka më të drejtën që ta prishë martesën për shkak të asaj të mete.

Tredhja

Tredhja ndodh me heqjen e dy testikujve, ose me shtypjen e dy testikujve. Autori i librit “El Mesalik” ka thënë: “Burrit të tredhur i tendoset penisi dhe mund të arrijë kënaqësi seksuale, por prej tij nuk del spermë.”

Nëse një grua martohet me një burrë të tredhur, pa e ditur gjendjen e tij dhe më pas për të bëhet e qartë kjo gjendje e burrit, gruaja ka të drejtën e përzgjedhjes për prishjen e martesës, ose për vazhdimin e saj. Kjo e drejtë e gruas, në kuadrin e shprehjes së autorit të librit “El Xhevahir”, është e vërtetuar me fjalën e përbashkët të fukahave dhe me tekste të shumta.

Prej këtyre teksteve kemi fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), kur është pyetur për një burrë të tredhur që i ka fshehur të vërtetën e gjendjes së tij një gruaje myslimane dhe është martuar me të. Si duhet të veprohet në këtë gjendje? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Bëhet ndarja mes atyre të dyve, nëse dëshiron gruaja, kjo gjendje atij i shkakton dhembje koke. Nëse gruaja bie dakord me gjendjen e burrit dhe qëndron me të dhe, pasi ka rënë dakord, ajo nuk ka më të drejtë të kundërshtojë burrin.”

Në një transmetim të dytë, ai ka thënë: “Gruaja ka të drejtën e shumës së kurorës, sapo burri të hyjë te ajo.”

Nëse burri nuk realizon hyrjen, gruaja nuk merr asgjë prej shumë s të kurorës. Ky rregull është veprues, kur treshja është bërë para bërjes së kontratës së martesës. Nëse treshja i ka ndodhur pas bërjes së kontratës, gruaja nuk e ka të drejtën e përzgjedhjes, por ka detyrim të bëjë durim. Kjo është e barabartë, qoftë kur burri ka mundur të hyjë te ajo, qoftë kur nuk ka mundur të hyjë.

Kështu janë shprehur shumica e fukahave. Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Në origjinë, tekstet janë specifike, kur treshja ka ndodhur para kontratës së martesës.”

Në paragrafin vijues, “Penisi i prerë”, do të shikojmë se, në rastin kur treshja ndodh pas kontratës, nuk ka përzgjedhje, por ajo bëhet e detyrueshme, vetëm nëse treshja ka ndodhur para kontratës.

Penisi i prerë

Kur penisi i burrit pritët deri në bazë dhe prej tij s’ka mbetur asgjë, gruaja ka të drejtën e përzgjedhjes, nëse prerja ka ndodhur para kontratës dhe ajo nuk kishte dijeni për këtë gjendje të burrit. Kur penisi i burrit pritët pjesërisht dhe prej tij mbetet aq sa burri mund të hyjë te gruaja dhe penisi i tij depërton te gruaja, qoftë edhe sa gjatësia e një mize jeshile, gruaja nuk ka të drejtën e përzgjedhjes.

Kur prerja e penisit ndodh pas kontratës, në lidhje me këtë gjendje, fukahatë kanë dy thënie: Vërtetimin e të drejtës së përzgjedhjes për gruan dhe mosvërtetimin e përzgjedhjes për

gruan. Sido që të jetë gjendja e tij, që i është ekspozuar prerjes së penisit, fukahatë kanë pohuar se për këtë gjendje nuk ka tekste specifike, prandaj fukahatë burrin me penis të prerë e kanë atashuar në burrin e tredhur.

Në lidhje me burrin me penis të prerë autori i librit “El Mesalik” ka thënë: “Penisi i prerë është një e metë shumë më e madhe se tredhja, sepse burri i tredhur, në tërësi, ka forcë të depërtojë te gruaja, madje thuhet se ai bëhet edhe më i fuqishëm se burri normal për shkak të mosdaljes së spermës prej tij.”

Fjala më e drejtë është: Kur tredhja dhe prerja e penisit ndodhin pas kontratës së martesës, për gruan vërtetohet e drejta e përzgjedhjes, plotësisht sikur tredhja dhe prerja e penisit të kishte ndodhur para bërjes së kontratës, ashtu siç ka ardhur në “Sahijhun” e Ebu Besijrit, i cili tregon: “Kam pyetur Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*) për një grua, burri i së cilës u sprovua rëndë, aq sa nuk ka më forcë të kryejë marrëdhënie intime. A të ndahet gruaja prej këtij burri?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Po, nëse do gruaja.”

Një transmetim i ngjashëm është përcjellë edhe prej Ebu Sabàh El Kenànij. Autori i librit “El Xheuahir” i ka cilësuar këto dy transmetime të gradës “Sahijh” dhe ka thënë se fjala e pyetësit “burri i së cilës u sprovua rëndë...”, tregon se kjo gjendje atij i ndodhi pas bërjes së kontratës së martesës, ose më e pakta, ajo fjalë përfshin edhe kuptimin se sprovua atij i ka ndodhur ose para bërjes së kontratës, ose pas bërjes së kontratës.

Impotencia

Impotencia është një sëmundje që e bën burrin të pafuqishëm për të kryer marrëdhënie intime. Në lidhje me këtë gjendje, fukahatë janë bashkuar me dëshminë e autorëve të librave “El Xhevahir” dhe El Hadaik”, të cilët janë shprehur se kjo sëmundje është një e metë që i mundëson gruas ta prishë martesën. Kjo është e barabartë, qoftë kur kjo gjendje e burrit ishte para kontratës, qoftë kur impotencia i ka ardhur atij pas kontratës dhe para se ai të kryejë marrëdhënie intime me atë grua.

Pyetje: Kur ndodh impotencia dhe përtërihet pas kryerjes së marrëdhënieve intime, qoftë edhe vetëm një herë, a e ka gruaja të drejtën e përzgjedhjes për prishjen e martesës?

Autori i librit “El Xhevahir” ka cituar prej Ibn Zehres dhe prej sheh Mufijdit se gruaja e ka të drejtën ta prishë martesën. Autori i librit “El-Mesalik”, tekstualisht ka thënë: “Mufijdi dhe një grup fukahash kanë shkuar deri aty sa të thonë se gruaja e ka të drejtën për të prishur martesën, për shkak të përbashkët të ardhur nga moskryerja e marrëdhënieve intime.

Gjithashtu, të drejtën e gruas për prishjen e martesës, në rastin e impotencës së burrit, e vërtetojnë transmetimet përgjithësuese, në të cilat nuk bëhet asnjë sqarim, nëse janë kryer ose nuk janë kryer marrëdhënie intime, ashtu siç thuhet qartë në transmetimin e ardhur në “Sahijhun” e Muham’med bin Muslimit, të përcjellë prej El Kenanijit, i cili tregon se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një grua, burri i së cilës është dëmtuar aq rëndë, sa ka humbur përgjithmonë aftësinë për të kryer marrëdhënie intime. A të ndahet gruaja prej tij? Ai tha:

“Po, nëse ajo do.” Ka edhe transmetime të shumta me mbështetës të gradës “Sahijh” që trajtojnë këtë çështje.

Te libri “El Mesalik” duket qartë animi në favor të kësaj fjale të Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), por fjala më e përhapur mbetet dëshmia e autorit të librit “El Xheuahir, që gruaja nuk e ka të drejtën e përzgjedhjes, sepse Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*), në lidhje me burrin impotent, ka thënë: “Kur ai e di se nuk mund të shkojë me gratë, ata të dy ndahen, domethënë bëhet ndarja mes tij e mes gruas së tij. Nëse ai bie me gruan e tij, qoftë edhe vetëm një herë, nuk bëhet ndarja mes tyre.”

Në një transmetim tjetër, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) thoshte: ‘Kur burri martohet me një grua dhe bie me të vetëm një herë të vetme dhe pastaj largohet prej saj, kjo grua nuk e ka të drejtën e përzgjedhjes, por ajo duhet të bëjë durim, ngaqë burri i saj po kalon një sprovë të rëndë.’”

Ky transmetim dhe transmetimet e tjera me kuptim të ngjashëm, janë të kushtëzuara me transmetimin e El Kenanijit.

Një pyetje tjetër: Burri s’kryen dot marrëdhënie intime me gruan e tij, por ai mund të kryejë me gra të tjera, duke ditur se ai nuk ka ndonjë ndalim nga ana e gruas. A vërtetohet për gruan e drejta e përzgjedhjes?

Autori i librit “El Xheuahir” dhe shumë fukaha janë shprehur se për këtë grua nuk ka përzgjedhje.

Ne mendojmë se ajo ka plotësisht të drejtë ta prishë martesën, sepse, kur burri i saj kryen marrëdhënie intime me gra

të tjera, ajo nuk ka detyrim të bëjë gusul për shkak të xhunubllëkut, gjithashtu as dëmi që i shkaktohet asaj nuk mund të hiqet, ngaqë prej burrit të saj përfiton një grua tjetër.

Këtu duhet të shtohet edhe fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), e ardhur në transmetimin e përcjellë prej Ibn Meskanit: “Nëse burri shkon te ajo, ndryshe gruaja ndahet prej tij.”, si dhe fjalën tjetër të Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) në transmetimin e përcjellë prej El Bakhterij’jit: “Nëse ai arrin te ajo, ndryshe bëhet ndarja ndërmjet tyre.”

Kuptohet qartë se fjala “arrin” është përdorur në kuptimin e pamundësisë për të kryer marrëdhëniet intime me gruan e vet, por nuk përjashton mundësinë që ai të kryejë marrëdhënie intime me gratë e tjera. Mendoj se për këtë rregull pretendon edhe sheh Mufijdi, kur thotë se, në këtë gjendje, gruaja ka të drejtën e përzgjedhjes.

Autori i librit “El Mesalik” ka thënë: “Duket qartë se prej Mufijdit vihet në konsideratë pafuqia e tij për të kryer marrëdhënie intime me atë dhe nuk merret në konsideratë fuqia e tij për të kryer marrëdhënie intime me gratë e tjera, sepse Mufijdi ka thënë se, sikur të arrijë te ajo qoftë edhe një herë të vetme, ai është zotërues i saj dhe, nëse ai nuk arrin te ajo një vit, atëherë gruaja ka të drejtën e përzgjedhjes.”

Ai që mediton mbi këto fjalë të Mufijdit dhe i krahason fjalët e tij me transmetimet e ardhura prej Ehli Bejtit (*Paqja e Allahut qoftë mbi ta!*) do të gjejë se sheh Mufijdi i ka shkëputur këto fjalë pikërisht prej vetë transmetimeve.

Kur gruaja ka dijeni për impotencën dhe është dakord me këtë gjendje, bie e drejta e saj e përzgjedhjes dhe asaj nuk i lejohet të heqë dorë nga gjendja që ajo vetë kishte miratuar.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Kur impotencia vërtetohet dhe ajo bën durim, duke pasur dijeni se, për shkak të impotencës, ajo e ka të drejtën e përzgjedhjes, nuk ka asnjë mendim ndryshe që gruaja nuk e ka të drejtën e përzgjedhjes, kur ajo e dëshiron atë burrë, sepse e drejta e përzgjedhjes është një e drejtë që rrëzohet, nëse gruaja dëshiron që kjo e drejtë e saj të rrëzohet, ashtu siç është edhe fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Kur gruaja vazhdon të bashkëjetojë me burrin e saj, pasi mëson se ai është impotent dhe është e kënaqur me gjendjen e tij, pas këtij miratimi, nga ana e saj, ajo nuk e gëzon më të drejtën e përzgjedhjes.”

Kur gruaja mëson për impotencën e burrit dhe nuk bën durim, por e ngre punën e saj te gjykatësi, gjykatësi, nga ana e tij, e shtyn gjykimin një vit të plotë, duke filluar që prej kohës kur gruaja e ngriti çështjen te gjykatësi. Gjykatësi e bën këtë shtyrje për shkak se burri mund të qetësohet gjatë stinëve të vitit, pavarësisht se ajo pretendon që gjatë kohës që ka jetuar me burrin, në asnjë rast nuk ka përjetuar kënaqësi prej atij burri. Nëse burri arrin të kryejë marrëdhënie intime me të, për gruan nuk ka më përzgjedhje, ndryshe, me fjalën e përbashkët te fukahave dhe me tekst, ajo ka të drejtë ta prishë martesën. Prej këtyre teksteve përmendim fjalën e Imam Bakirit, babait të Imam Xhafer Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Çështja e impotentit shtyhet një vit, duke filluar që prej ditës, kur gruaja e tij e ka ngritur këtë çështje në gjykatë. Nëse ai arrin te ajo, ndryshe bëhet ndarja mes atyre të dyve. Nëse gruaja është e kënaqur të qëndrojë me këtë burrë

impotent dhe më pas kërkon të drejtën e përzgjedhjes, kërkesa e saj refuzohet.”

Disa fukaha kanë thënë se sekreti në caktimin e afatit për shtyrjen e ndarjes një vit, qëndron në faktin që burri të kalojë të katër stinët, pasi është e pranueshme që ai të mos ketë fuqi të kryejë marrëdhënie intime me gruan gjatë verës për shkak të temperaturës së lartë dhe i kalon kjo gjendje gjatë dimrit, ose i ndodh e kundërta, s’ka fuqi për këtë punë gjatë dimrit për shkak të të ftohtit dhe i kthehet fuqia gjatë verës, ose e ka të pamundur për shkak të thatësirës së verës dhe i kthehet mundësia nga lagështira e pranverës, ose gjendja e lagështirës i zhduket gjatë vjeshtës.

Kur gruaja e prish martesën, atëherë kur asaj i lejohet të bëjë prishjen, ajo ka të drejtë të kërkojë vetëm gjysmën e shumës së kurorës dhe nuk ka detyrim të kalojë kohën e pritjes ligjore. Në dëshminë e tij, autori i librit “El Mesalik”, transmeton një njoftim të shkallës “Sahijh”, të vërtetuar sipas rregullit të përcjelljes së njoftimeve, prej Imam Bakirit, babait të imam Xhafer Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Nëse burri nuk arrin te ajo, bëhet ndarja mes tyre dhe asaj i jepet vetëm gjysma e shumës së kurorës. Gjithashtu, ajo nuk ka detyrim të kalojë kohën e pritjes ligjore.”

Gruaja ka të drejtë ta prishë martesën pa lejen e gjykatësit, por ajo kthehet te burri kur mbushet afati ligjor i shtyrjes së ndarjes, sepse kthimi i saj te burri, është prej detyrave të gjykatësit, kurse prishja e martesës, është e drejtë që i takon vetëm gruas dhe s’ka asnjë lidhje me të drejtat e përgjithshme, as nga afër e as nga larg, pra, kjo e drejtë është si të gjitha të drejtat në përzgjedhjet e tjera.

Rruga e vërtetimit të impotencës

Impotencia vërtetohet me pohimin e vetë burrit. Kur ai vetë nuk e pohon, atëherë pyetet gruaja, nëse ajo ka argument që ai ka pohuar impotencën. Gjithsesi, nuk pranohet argumenti prej saj për impotencën e burrit, sepse impotencia është prej gjendjeve të fshehta dhe, nëse ajo nuk ka argument që të vërtetojë se burri i ka pohuar asaj impotencën e tij, atëherë shikohet: Nëse gruaja është beqare, lihet ta shikojnë gratë me përvojë dhe veprohet sipas fjalës së grave. Nëse gruaja nuk është beqare, burri duhet të betohet, sepse, në këtë rast, ai është mohuesi i faktit, kurse ajo pretendon te ai ekzistencën e një të mete që i jep asaj të drejtën e përzgjedhjes. Si origjinë është që burri është plotësisht i formuar, fizikisht i shëndoshë dhe pa të meta trupore, derisa të vërtetohet e kundërta. Nëse burri betohet, pretendimi i gruas nuk pranohet, por, nëse burri ngurron të betohet, gjykohet se ai është impotent thjesht për faktin që ai ngurron të betohet, por nuk pranohet betimi i gruas me qëllim. Kjo bëhet me qëllim që gjykimi të bëhet pas refuzimit.

Në këtë gjendje, gjykatësi vendos të shtyjë gjykimin për një vit, sipas sqarimit që bëme më lart. Imam Bakiri, babai i imam Xhafer Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Kur burri martohet me një grua beqare, e cila ishte martuar me një tjetër, për të cilin ajo pretendon se burri nuk është afruar te ajo as kur janë gjendur në dhomën e gjumit, në këtë gjendje, merret në konsideratë fjala e burrit, i cili ka detyrim të betohet se ai ka kryer marrëdhënie intime me të.”

Në këtë gjendje, burri betohet, sepse gruaja është pretenduese. Nëse burri është martuar me atë grua dhe ajo është beqare, njëkohësisht pretendon se burri nuk ka arritur te ajo, këtë

gjendje e vërtetojnë gratë dhe burri le të marrë fjalën e asaj te e cila ka besim. Kur vërtetohet se ajo është beqare, Imami, gjykatësi, e shtyn ndarjen për një vit. Nëse gjatë kësaj kohe burri arrin te ajo, martesë vazhdon, ndryshe ata të dy ndahen. Në këtë rast, gruas i jepet gjysma e shumës së kurorës dhe gruaja nuk ka detyrim të kalojë kohën e pritjes ligjore.

Kur burri pohon pafuqinë e tij për të kryer marrëdhënie intime me gruan, në këtë gjendje, gjykatësi e shtyn ndarjen një vit, por pas përfundimit të afatit të shtyrjes, burri thotë: “Hyra te gruaja.”, kurse gruaja thotë: “Jo, nuk ka hyrë te unë.”, në këtë gjendje, merret në konsideratë fjala e burrit, apo fjala e gruas?

Autori i librit “El Xheuahir ka thënë: “Vendoset sipas fjalës së burrit, por burri ka detyrim të betohet, plotësisht si në rastin kur ai nuk e ka pohuar pafuqinë e tij që në fillim. Ky përfundim është nxjerrë me argumente shumë të hollësishme, madje janë aq të hollësishme, sa janë të paktë ata që mund të jenë të vëmendshëm ndaj këtyre argumenteve, pasi ai mund të anojë kah pretendimi i burrit se ai ka fuqi për të kryer marrëdhënie intime, megjithëse më parë kishte pohuar pafuqinë e tij për të kryer marrëdhënie intime.

Në këtë gjendje, nuk mund të mendohet se burri po pretendon një gjë të re, ose pohimi i tij është mohim pas pohimit, megjithëkëtë horizonti i autorit i librit “El Xheuahir” shtrihet përtej cakut të vështirimit të atyre që kuptojnë vetëm anën e jashtme të çështjes. Le të shikojmë se sa qartë është shprehur ky autor në lidhje me këtë çështje:

E para: Pohimi i tij për pafuqinë para përfundimit të afatit, nuk vërteton impotencën, sepse pafuqia, në kohën e pohimit, mund të jetë pafuqi e përkohshme, por mund të jetë edhe pafuqi e përhershme. Vetëkuptohet që ekzistenca e të përgjithshmes nuk vërteton ekzistencën e të veçantës dhe, kur ti thua: “Shkrova me laps.”, ky pohim i yti nuk vërteton se lapsi me të cilin shkrove ti është laps plumbi, ose është laps me bojë. Po kështu, pafuqia nuk tregon impotencën, ose ndonjë të metë tjetër, sepse pafuqia mund të jetë edhe për shkak të ndonjë të mete në krijim, por mund të jetë edhe për ndonjë shkak që s’ka të bëjë me krijimin. Gjithashtu, shoqërimi i pafuqisë nuk vërteton impotencën, përveçse duke u bazuar mbi origjinën e vërtetuar.¹

E dyta: Mohuesi është ai që hesht, kur gruaja ankohet prej tij dhe pretendues është ai që nuk hesht, kur gruaja ankohet. Padyshim se kur gruaja hesht për gjendjen e impotencës së burrit, patjetër që edhe burri do të heshtë për impotencën e tij. Por sikur burri të heshtë dhe gruaja nuk hesht, në këtë gjendje, gruaja është pretenduese dhe ka detyrim të sjellë argument, kurse burri është mohues dhe ka detyrim të betohet.

E treta: Më sipër pamë transmetimin e ardhur prej Imam Bakirit, babait të Imam Xhafer Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), në të

¹ Prej origjinave të gabuara të fukahatë e medh’hebit xhaferij është ajo që quhet origjina e vërtetuar, domethënë vërtetohet njëri prej ndikimeve të subjektit me argument logjik, por nuk vërtetohet me bazë ligjore, kurse shoqërimi është argument për analogji me sendin me të cilin bëhet shoqërimi vetëm me dispozita ligjore pa argumente logjike. Për shembull: dispozita shoqëruese se akoma është natë gjatë netëve të Ramazanit, lejon vetëm marrjen e ushqimit, por në asnjë rast nuk vërteton që ora nuk ka shkuar pesë, duke vënë në konsideratë se ora pesë është koha e ndalimit të marrjes së ushqimit e të ujit.

cilin thuhet: “Burri ka detyrim të betohet që ai ka kryer marrëdhënie intime me të, sepse ajo është pretenduese.”

Në këtë gjendje, Imami, gjykatësi, nuk bën ndarjen mes atyre të dyve për shkak se më parë ai ka pohuar pafuqinë e tij, ose për shkak të ndonjë të mete tjetër.

Lebrosa dhe gjymtyra e këputur

Të metat që u trajtuan më sipër, ishin tri. Gjithashtu, pamë se të metat që ishin specifike për burrin, ishin: tredhja, prerja e penisit dhe impotenca. E metë e përbashkët, si për burrin ashtu edhe për gruan, ishte çmenduria.

Gjithashtu, pamë se gruaja e çmendur kthehet sipas rrugëve që u trajtuan më sipër, kurse me sëmundjen lebrosës dhe të këputjes së ndonjë gjymtyre, gruaja kthehet, kur njëra nga këto dy të meta ajo i kishte para bërjes së kontratës së martesës dhe burri nuk kishte dijeni për të metën e gruas. Gjithashtu, pamë se gruaja nuk ka të drejtë ta prishë martesën, kur burri është prekur nga lebrosa, ose ka një gjymtyrë të këputur.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kthehet gruaja e prekur nga lebrosa, e çmendura dhe gruaja me gjymtyrë të këputur.”

Kur ai është pyetur për gruan çakërr (sulle), ai është përgjigjur: “Jo.”

Përsëri atë e pyetën: “Si mendon, nëse burri ka kryer marrëdhënie intime me të, si do të bëjë për shumën e saj të kurores?” Ai është

përgjigjur: “Ajo ka të drejtë ta marrë shumën e kurorës kundrejt kënaqësisë që ai përjetoi me të.”

Verbimi dhe çalimi

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se verbimi dhe çalimi te burri nuk përbëjnë të metë, domethënë se gruaja nuk ka të drejtë ta prishë martesën, kur burri ka njërën nga këto dy të meta, madje edhe nëse ajo nuk e ka ditur për këtë gjendje të burrit para bërjes së kontratës, me përjashtim të rastit kur burri i ka fshehur asaj gjendjen e tij dhe me pas ajo ka konstatuar se gjendja e tij është në kundërshtim me atë që ai ishte paraqitur.

Në lidhje me fshehjen e gjendjes së vërtetë (et tedlijs), do të flitet në kapitullin vijues. Fukahatë kanë mendime të ndryshme, nëse verbërimi e çalimi te gruaja përbëjnë ose jo të metë që burri mund ta refuzojë martesën me atë grua për shkak të asaj të mete.

Në lidhje me këtë çështje, fukahatë kanë dy thënie, të cilat i ka përmendur në mënyrë të shkoqitur autori i librit “El Hadaik”, në pjesën e gjashtë, në kapitullin “Të metat e gruas”. Autori i librit “El Xheuahir” dhe autori i librit “El Mesalik” e kanë zgjatur fjalën në lidhje me çalimin, duke sjellë shumë argumente, kurse autori i librit “El Hadaik” ka thënë: “Prej asaj që ka thënë shejkh i grupit në librin “El Mabsut” del qartë se verbërimi nuk është e metë, sepse ky autor numëron vetëm gjashtë të meta.”

Më pas autori i librit “El Hadaik” ka thënë: “Ndër kolegët tanë fukaha ka edhe prej atyre që e kanë numëruar verbërimin ndër të metat.”

Autori i librit “El Xhevahir” ka thënë: “Verbërimi e bën të detyrueshëm përzgjedhjen dhe këtë unë e gjej pa asnjë kundërshtim. Madje El Murteda dhe Ibn Zuhre kanë thënë se çështja e verbërimit, në lidhje me të drejtën e përzgjedhjes, gëzon fjalën e përbashkët të fukahave. Kjo fjalë është argument që i shtohet tekstit të gradës “Sahijh”.

Për sa i përket çalimit, shumica e fukahave kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit “El Mesalik” dhe të librit “El Hadaik” se çalimi te gruaja është një e metë që burrit i jep të drejtën ta prishë martesën.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që është martuar me një grua dhe, kur e sjellin gruan, ajo rezulton të jetë e verbër, ose lebrose, ose çalamane. A do të martohet ky burrë me këtë grua? Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Ajo i kthehet kujdestarit të saj.”

Babai i tij, Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Kthehet lebrosha, e verbra dhe çalamania.”

Kërci, mishi i tepërt, përzierja e dy kanaleve dhe ngjitja

Kërci është diçka si briri i dashit në brendësi të vaginës; mishi i tepërt është një copë mishi në vaginë, që nuk lë depërtimin e spërkatjes që i vjen nga përpara. Në disa transmetime të ardhura prej Ehli Bejtit, thuhet se kërci dhe mishi i tepërt janë e njëjta gjë. Përzierja e dy kanaleve, do të thotë që kanali i urinës përziehet me kanalin vaginal dhe ngjitja është bllokimi i kanalit, ku depërton

penisi në vaginë, në atë mënyrë që, në rastin e ngjitjes, nuk mundësohet kryerja e marrëdhënieve intime.

Këto katër të meta, janë specifike vetëm për gruan. Në të vërtetë, tekste kanë ardhur për kërcin, mishin e tepërt e për përzierjen e dy kanaleve dhe nuk ka tekst për ngjitjen, prandaj shumica e fukahave e kanë atashuar këtë të metë te kërci, sepse që të dy pengojnë kryerjen e marrëdhënieve intime.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Thënia më e përhapur është se edhe ngjitja është prej të metave.”

Dëshmori i dytë, në librin “El Lum’ah”, ka thënë: “Dhe në atë (ngjitjen) ka fuqi.”

Në mënyrë të përmbledhur, fukahatë kanë numëruar te gratë shtatë të meta, disa të tjerë kanë thënë tetë, një tjetër ka thënë gjashtë, kurse Dëshmori i parë, në librin “Err Rreudah”, ka numëruar nëntë, që janë: çmenduria, gjymtyra e këputur, lebrosa, verbimi, çalimi, kërci, mishi i tepërt, përzierja e dy kanaleve dhe ngjitja. Të gjitha këto të meta i kemi ekspozuar dhe kemi thënë se gruaja nuk kthehet për shkak të njërës prej këtyre të metave, kur e meta ka ardhur pas bërjes së kontratës së martesës dhe kemi thënë se kjo është e barabartë, qoftë kur burri ka kryer marrëdhënie intime me të, qoftë kur nuk ka kryer.

Gjithashtu, gruaja nuk kthehet, edhe kur njëra nga këto të meta ishte te gruaja para bërjes së kontratës së martesës, kur burri kishte dijeni për të metën, ose edhe nuk kishte dijeni, megjithëkëtë ai ishte i kënaqur me martesën e bërë, pasi u njoh me atë të metë dhe mori informacion rreth saj.

Kur burri nxjerr si shkak për prishjen e martesës një të metë që i lejon atij prishjen e martesës dhe nuk ka kryer marrëdhënie intime me gruan, asaj nuk i takon asgjë prej shumës së kurorës. Nëse burri e prish martesën, pasi ka kryer marrëdhënie intime me të, gruaja ka të drejtë ta marrë të plotë shumën e kurorës, nëse shuma e kurorës është përmendur në tekstin e kontratës dhe, nëse nuk është përmendur, ajo merr shumën e ngjashme të kurorës që jepet zakonisht, kur kontrata është bërë pa shënuar shumën e kurorës.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që është martuar me një grua, në të cilin ai gjen se ka kërce. Ai tha: “Kjo grua nuk mbetet me barrë dhe burri i saj e ka të pamundur të kryejë marrëdhënie intime me të, prandaj, në këtë gjendje, ai e kthen gruan në familjen e saj.” Pyetësi tha: “Po, nëse ai ka hyrë te ajo?”

Ai iu përgjigj: “Nëse burri kishte dijeni para se të hynte te ajo, do të thotë se ai e kishte miratuar të metën e saj, por, nëse mëson për të vetëm pasi kryen marrëdhënie intime me të, nëse dëshiron, ose e mban, ose e kthen në familjen e saj. Për këtë që ngjau mes tyre, ajo ka të drejtë ta marrë të plotë shumën e kurorës, kundrejt kënaqësisë që burri përjetoi me të.”

Menjëherë

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët me dëshminë e autorit të librit “El Xheuahir” se përzgjedhja për prishjen e martesës vërtetohet në çast, kur burri, ose gruaja ka dijeni për të metën, ose kur e di që ka të drejtën e përzgjedhjes, përzgjedhja bëhet detyrim të përdoret menjëherë, megjithëkëtë ai nuk

ndërmerr prishjen e martesës, por i përmbahet kontratës së martesës. Kur burri nuk ka dijeni për të metën, ose ka dijeni, por nuk e di që ai ka të drejtën e përzgjedhjes, ose ka dijeni për të drejtën e përzgjedhjes, por nuk e di që prishja duhet të bëhet menjëherë, në këto raste, ai është i justifikuar për vonesën, prandaj ai ndërmerr prishjen e martesës, sapo të mësojë për të metën.

Nuk merret në konsideratë leja e gjykatësit

Prishja e martesës s'ka nevojë për lejen e gjykatësit. Kjo është e barabartë, qoftë kur prishja bëhet nga ana e burrit, qoftë kur prishja bëhet nga ana e gruas, por patjetër që çështja i referohet gjykatësit që ai të caktojë afatin për impotentin, ashtu siç u theksua më sipër, sepse argumentet që flasin për lejimin e prishjes, janë të përgjithshme dhe nuk janë të kushtëzuara me lejen e gjykatësit.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Bazuar mbi këto, fukahatë kanë dhënë fetva në lidhje me këto çështje, pa asnjë komplikim e pa asnjë ngurrim.”

Argumentin e sjell pretenduesi i të metës

E meta që bën detyrim prishjen e martesës, mund të jetë e dukshme, si: çmenduria, verbimi e çalimi. Mund të jetë edhe e fshehtë, si: impotencia e ngjitja. Nëse e meta është e dukshme, nuk është e nevojshme të sillet argument, as të kërkohet betim. Kur e meta është e fshehtë dhe çifti ka kundërshtime në lidhje me ekzistencën e kësaj të mete, ai që pretendon të metën, është i detyruar të sjellë argumentin, sepse origjina është që personi është

pa të meta, derisa të vërtetohet e kundërta, kurse ai që e mohon të metën, është i detyruar të betohet.

Ndërmjet prishjes dhe divorcit

Prishja dallon nga divorci në veprimet vijuese:

1- Divorci nuk është i vlefshëm pa praninë e dy dëshmitarëve të drejtë, kurse prishja është e vlefshme pa dëshmitarë.

2- Gruaja e divorcuar, me të cilën është kryer marrëdhënie intime, është kusht që divorci të ndodhë, kur ajo nuk është me menstruacione, ose me lehoni dhe, gjatë kësaj kohe, burri të mos ketë kryer marrëdhënie intime me të. Këtë çështje, do ta shikojmë në kapitullin “Divorci”. Por kjo nuk është kusht për gruan që kthehet për shkak të së metës që ajo ka.

3- Prishja nuk llogaritet njëra ndër tri herët që burri i thotë gruas: “Je e ndarë!”. Dihet se pas këtyre tri herëve gruaja bëhet e ndaluar për divorcuesin, derisa ajo të martohet me një burrë tjetër dhe ky i fundit ta divorcojë, çka i jep asaj mundësi të rimartohet përsëri me burrin e parë.

4- E divorcuara, para se të kryhen marrëdhënie intime me të, ka të drejtë të marrë gjysmën e shumës së kurorës, kurse gruaja e kthyer në familjen e saj, me prishjen e martesës për shkak të së metës, kur me të nuk është kryer marrëdhënie intime, nuk ka të drejtë të marrë asgjë prej shumës së kurorës, me përjashtim të rastit kur prishja bëhet për shkak të impotencës.

* * *

FSHEHJA E TË METËS

(Et tedlijs)

Përzgjedhja për të metën dhe përzgjedhja për fshehjen e të metës

Të metat që ne përmendëm në kapitullin e mëparshëm, ishin të meta për të cilat ligjvënësi i ka vënë në bazë të tekstit dhe ishin të atij lloji që e bënë përzgjedhjen të detyrueshme në të gjitha gjendjet. Pamë që kjo ishte e barabartë, qoftë kur kishte fshehje të mete, qoftë kur nuk kishte fshehje të mete, domethënë kur, krahas së metës që bën detyrim përzgjedhjen, ka edhe fshehje të së metës dhe burri ka kryer marrëdhënie intime me gruan. Në këtë gjendje, burri i paguan gruas shumë e kurorës, për shkak se ai është fshehësi i të metës. Kjo është e barabartë, qoftë kur fshehës është gruaja¹, qoftë kur fshehës është kujdestari që e ka martuar atë, sepse i mashtruar ka të drejtë të kërkojë prej tjetrit.

¹ Kur pretenduese është gruaja, ajo nuk ka të drejtë të marrë asgjë prej shumës së kurorës, përveç asaj shume të paktë që përputhet me emërtimin financim simbolik, në kompensimin e kryerjes së marrëdhënieve intime. Kështu janë shprehur fukahatë më të dëgjuar, të cilët kanë shkruar me dëshminë e Dëshmorit të dytë në librin “El Lum’ah”.

Për sa u përket të metave të tjera, si për shembull, sëmundje të ndryshme, por as gjymtyrë e këputur e as lebrojë, apo personi ka një të keqe (që mund të jetë në fjalë, në punë e në pamje), përfshirë edhe të meta të tjera, për të cilat ligjvënësi nuk ka tekst, këto lloje të metash, në vetvete, nuk e bëjnë të detyrueshme përzgjedhjen në prishjen e martesës, megjithëse, në të vërtetë, edhe këto të meta e bëjnë të detyrueshme përzgjedhjen, kur ekzistenca e të metës është vënë kusht, ose kur e meta sjell dëmtim.

Sqarimin e kësaj çështjeje, do ta shikojmë në vijim.

Kuptimi i togfjalëshit “fshehje e të metës”

Fshehja e të metës është mashtrimi, me qëllim fshehjen e një të mete që ekziston kundrejt pretendimit se nuk ekziston asnjë e metë. Kur mashtruesi është burri, gruaja është e mashtruara dhe, kur mashtruese është gruaja, burri është i mashtruari.

Një shembull, në lidhje me fshehjen e të metës: Njëri nga dy partnerët është çakërr, ose është tuberkuloz dhe në kohën e bërjes së kontratës, ai ia fsheh këtë të metë partnerit tjetër. Pas bërjes së kontratës, e vërteta bëhet e qartë.

Pretendim për plotësim, kemi atëherë kur gruaja pretendon se është beqare dhe e re, ose kur burri pretendon se ka pozitë e është njeri i nderuar, por më pas pretendimi rezulton i rremë.

Pyetje: Kur në njërën palë është një e metë, jo prej të metave që bën detyrim përzgjedhjen dhe ai hesht për këtë të metë e nuk prononcohet për të metën e konstatuar as pozitivisht e as

negativisht, por as nuk hiqet si i shëndoshë e si person që nuk e ka atë sëmundje, duke supozuar se pala tjetër nuk ka dijeni rreth asaj të mete, ky mosproncim a numërohet si fshehje e të metës?

Përgjigje: Kur e meta është prej llojit që zakonisht nuk tolerohet dhe, që në shumicën e rasteve, askush nuk rrezikon të bëjë martesë me mbartësin e kësaj të mete, në këtë gjendje, kemi të bëjmë me fshehje të së metës.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Ajo që del qartë prej teksteve që trajtojnë këtë çështje, madje që ka edhe fjalën e qartë të një grupi fukahash, realizohet këtu me heshtjen për të metën, krahas dijenisë që ka për të metën, përveç njoftimeve që tregojnë se ai nuk është i shëndoshë.”

Pasi e tha këtë shprehje në fillim të fjalës së tij, në lidhje me fshehjen e të metës, me qëllim mashtrimi, në çështjen e dymbëdhjetë të çështjeve që ai trajton, tha: “Prej nesh patjetër që është përmendur më shumë se një herë forca e vërtetimit të përzgjedhjes në rastin e fshehjes së të metës, kur burri është paraqitur me cilësi të plotësuara para gruas me të cilën do të martohet, por që më pas rezulton e kundërta.”

Në e miratojmë plotësisht se heshtja për të metën, kur pala tjetër nuk ka akoma dijeni për atë të metë, është fshehje e mirëfilltë e asaj të mete, por ne nuk gjejmë argument ligjor që të themi se çdo fshehje e të metës e bën të detyrueshme prishjen e martesës, ose bën të detyrueshme rrëzimin e shumës së kurorës, ose rrëzimin e një pjese prej shumës së kurorës, sipas rregullit të përgjithshëm.

Bazuar mbi këtë rregull, rezulton se për fshehjen e të metës, në mënyrë të prerë, s'ka asnjë ndikim në analogji me shumën e kurorës, as në analogji me prishjen e martesës, me përjashtim të rasteve për të cilat e meta vërtetohet me argument, veçanërisht me argument me ajet të Kuranit Famëllartë, ose me ndonjë transmetim, ose kur argumenti është me fjalën e përbashkët të fukahave, siç është rregulli përgjithësues: "S'ka dëmtim..." Në vijim sqarimi:

Fshehja e të metës dhe lejimi i prishjes

Prishja e martesës, kur e meta fshihet, lejohet vetëm në tri gjendjet vijuese:

1- Kur cilësia e plotësimit, ose mungesa e të metës, është vënë kusht në tekstin e kontratës, si për shembull, burri thotë: "Martohem me ty, me kusht që të jesh e virgjër, ose me kusht që fizikisht të jesh e shëndetshme dhe pa sëmundje.", ose gruaja thotë: "Martohem me ty me kusht që ti të dish këtë gjë, ose të mos kesh sëmundje."

2- Kur plotësimi fizik e mungesa e të metave merren si cilësi dhe jo si kusht, për shembull, kur kujdestari i gruas thotë: "Të martoj me filanen, që është beqare dhe pa sëmundje."

3- Kur përmendet plotësimi dhe mungesa e të metave gjatë bisedës rreth martesës, më pas bëhet kontrata mbi bazën e kësaj bisede.

Kur realizohet njëra prej këtyre tri gjendjeve, i mashtuari ka të drejtën e përzgjedhjes, në qoftë se rezulton e kundërta, por jo

ngaqë atij i është fshejtkur e meta, por për shkak të mosrealizimit të kushtit për të cilin kishin rënë dakord të dyja palët. Kjo është e barabartë, qoftë kur kushti është shprehur qartë me fjalë, qoftë kur është i nënkuptueshëm nga përmbajtja e kontratës.

Në këtë gjendje, prishja është e menjëhershme. Ky rregull është veprues, kur e meta e fshejtkur mësohet më vonë. Por në rast se ai ka dijeni për të metën, megjithëkëtë hesht, pas kësaj dijenie e kësaj heshtjeje, nuk ka më prishje të martesës, me përjashtim të rastit kur ai nuk e di se ka të drejtën e prishjes, ose nuk ka dijeni që prishja duhet të bëhet menjëherë, sapo të mësojë për të metën.

Kur kontrata e martesës bëhet pa përmendur ndonjë gjë në tekstin e saj, ose kontrata bëhet në bazë të një gjëje të mëparshme dhe më pas në njërin prej dy partnerëve gjendet një e metë, a ka, apo nuk ka të drejtë partneri tjetër ta prishë martesën? Përgjigjja për këtë pyetje do të mësohet në vijim:

Burri është fshehësi i të metës

Kur një grua martohet me një burrë, e bindur se burri është pa të meta, por burri, me heshtjen e tij, i ka fshejtkur asaj të metën dhe nuk e ka treguar sheshit të metën që ka, por më pas bëhet e qartë se ai ka një të metë të madhe, si për shembull, gruaja beson se ai shikon, kurse në të vërtetë, ai është i verbër, ose ka të meta të tjera që janë në kundërshtim me dëshirat që e kanë shtyrë gruan të martohet me atë burrë, në këtë gjendje, a ka të drejtë gruaja ta prishë martesën?

Sipas fjalëve të shumë fukahave, kemi parë se gruas nuk i lejohet ta prishë martesën, përveçse kur burri është i çmendur, ose impotent, ose ka penisin të prerë, sipas shpjegimit që pamë në kapitullin e të metave. Gjithashtu, për gruan lejohet të prishë martesën, kur cilësia e plotësimit, ose mungesa e të metave është vënë kusht, ose është cilësuar në kontratën e martesës, ose kontrata e martesës është ndërtuar mbi njërën prej këtyre dy cilësive, ashtu siç e pamë në paragrafin e mësipërm.

Padyshim që prej shprehjes së librit “El Xheuahir”, në kapitullin “Martesa”, qëllimi i tretë “Fshehja e të metës”, del qartë se edhe fshehja e të metës është shkak për të drejtën e përzgjedhjes, ashtu siç thuhet në çështjen e dytë prej qëllimit të martesës: “Kur gruaja martohet me një burrë, me kusht që ai të jetë njeri i lirë, por ai rezulton që është skllav, në këtë gjendje, gruaja ka të drejtën e prishjes, bazuar në transmetimin e ardhur në “Sahijhun” e Muham’med bin Muslimit, ku tregohet se Imam Bakiri, babai i Imam Xhafer Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), është pyetur për një grua të lirë, e cila, në të vërtetë, është martuar me një skllav, duke e ditur se ai ishte njeri i lirë, por më pas ajo mësoi se ai ishte skllav. Çfarë duhet të bëjë kjo grua? A i lejohet ta prishë martesën? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Ajo është zotëruese e vetes, nëse do, vazhdon martesën me të dhe, nëse nuk do, nuk martohet me të.”

Këtë transmetim, autori i librit “El Xheuahir” e ka komentuar: “Ky transmetim tregon qartë për mospasjen dallim mes vënies e mosvënies kusht të lirisë në tekstin e kontratës, pasi është vërtetuar fshehja e të metës, mashtrimi e rreziku që mund të vijë nga fshehja e të metës.”

Në çështjen e dymbëdhjetë, ka thënë: “Për vërtetimin e përzgjedhjes, mënyra e fshehjes së të metës, i atashohet mënyrës së kushtit.”

Ajo që ne konstatojmë, rezulton se fshehja e të metës, thjesht si fshehje, nuk vërteton të drejtën e përzgjedhjes për gruan, por e drejta e përzgjedhjes për gruan vërtetohet, kur gjatë bërjes së aktit të martesës, përzgjedhja është vënë qartë si kusht, ose që nënkuptohet prej brendisë së tekstit të kontratës, ose kur kontrata është ndërtuar mbi cilësinë, ose kur në fshehjen e të metës ka dëmtim për gruan që zakonisht nuk tolerohet, siç është verbëria e sëmundjet infektive të burrit, sepse ajeti: **“mbani besën për kontratat”**, nuk aplikohet në kontratën që gjeneron dëmtim, sepse në Islam “s’ka dëmtim e as përgjigje të dëmtimit me dëmtim”, sidomos kur dihet se divorci është në dorën e burrit dhe nuk është në dorën e gruas.

Nëse dikush thotë se te martesa ka një aromë adhurimi, si përgjigje ne i themi atij se rregulli: “S’ka dëmtim...” përfshin marrëdhëniet dhe adhurimet, madje përfshin edhe namazin që është kolona e fesë.

Meriton të theksohet se, kur e meta i ndodh burrit pas kontratës, gruaja s’ka të drejtë ta prishë martesën, pasi e meta e burrit vërtetohet.

Gruaja fsheh të metën

Kur burrit i fshihet e meta e gruas, martesa nuk priset,¹ por shuma e kurorës i kthehet e plotë burrit që kishte bërë martesë

me atë grua. Kthimi i shumë bëshet, sepse, në këtë rast, ai është i mashtruar dhe sipas rregullit, mashtruesi i kthen të mashtruarit prej tij. Në qoftë se fshehtë e të metës është gruaja, ajo ka të drejtë të marrë prej shumë së kurorës aq sa mund të quhet financim.

Dëshmori i dytë, në librin “El Lum’ah”, ka thënë: “Burri i kthen shumë e kurorës të mashtruarit dhe, kur mashtruese është gruaja, asaj i jepet prej shumë së kurorës sa më pak që është e mundur. Fjala “sa më pak”, është fjala që ka përhapjen më të gjerë.”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë, të cilit një grua i ka lënë në dorë punën e saj, ose ajo është e afërme e atij, ose është fqinje me të. Por ky burrë nuk e njeh në brendësi punën e saj. Më pas gjen se ajo ka fshejkr një të metë që kishte. Si duhet të veprohet në këtë rast? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Asaj i merret shuma e kurorës dhe ai që e martoi, nuk ka asnjë detyrim.”

Imam Bakiri, babai i Imam Xhafer Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “Kush marton një grua, e cila ka një të metë, por ajo e fsheh të metën dhe nuk ia tregon burrit të saj, shuma e kurorës që ajo do të marrë, pas zbulimit të së metës te ajo, është në përpjesëtim me kënaqësinë që burri ka përjetuar prej saj. Shumën e kurorës e paguan ai që e martoi atë grua, sepse nuk e bëri të qartë të metën që ajo kishte.”

Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që e merr gruan te disa njerëz, mirëpo gruaja e tij është çakërre dhe ata nuk ia kishin thënë këtë burrit. A kthehet gruaja ne këtë rast? Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Gruaja

nuk kthehet, por gruaja kthehet kur ka sëmundjen e lebrosës, ose ka ndonjë gjymtyrë të këputur, ose është e çmendur, ose nëse gruaja i del prej mitrës një masë si toptë.”

Më pas pyetësi tha: “Ç’do të na thuash për këtë burrë, që ka kryer marrëdhënie intime me atë grua? Si do të veprojë ai me shumën e saj të kurorës?”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Ajo ka të drejtë të marrë prej shumës së kurorës sipas kënaqësisë që ai ka përjetuar prej saj, kurse kujdestari që e martoi atë grua, gjobitet me shumën që burri ka dhënë për atë grua.”

Këto transmetime dhe të tjera të ngjashme, tregojnë qartë se burri i kërkon fshehtësinë të së metës shumën e kurorës, por burri nuk ka të drejtë të prishë martesën.

Beqarja dhe e martuara

Kur martohet një vajzë dhe virgjëria është vënë kusht, ose është theksuar si cilësi në tekstin e kontratës së martesës, ose kontrata e martesës është bërë në bazë të virgjërisë dhe më pas rezulton se ajo nuk ishte e virgjër që para kontratës, në këtë gjendje, burri ka të drejtë ta prishë martesën, për shkak të vonimit të kushtit.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Shpresohet që për këtë çështje nuk ka mendime ndryshe.”

Gruaja nuk ka ndonjë gjë prej tri gjërave që u përmendëm dhe burri martohet me atë grua me besim të plotë se ajo është e

virgjër, sepse ajo nuk ka qenë e martuar më parë me ndonjë tjetër. Pas kontratës, burri pretendon se ajo nuk është e virgjër. Në qoftë se pretendimi i burrit vërtetohet me pohimin e vetë gruas, ose me pohimin e ndonjë tjetri, burri ka të drejtë ta prishë martesën.

Gjithashtu, ai ka të drejtë të pakësojë prej shumës së kurorës në përpjesëtim me diferencën e shumës së saj të kurorës si e virgjër dhe shumës së saj të kurorës si jo e virgjër. Në qoftë se diferenca mes dy shumave të saj rezulton gjysma, atëherë asaj i jepet gjysma e shumës nominale. Në qoftë se diferenca rezulton sa një e treta, asaj i jepen dy të tretat. Kështu janë shprehur shumë fukaha dhe teksti për këtë çështje ka ardhur prej Ehli Bejtit, ku thuhet: *“Pakësohet prej shumës së kurorës, pa ndërhyrë te diferenca.”*

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që është martuar me një femër beqare, por ai nuk e gjen të virgjër. A është detyrim që asaj t'i jepet e plotë shuma e kurorës, apo i jepet e pakësuar?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: *“Pakësohet.”*

Nëse burri s'ka mundësi të vërtetojë në kontratë se gruaja nuk është e virgjër, burri ka të drejtë të kërkojë që ajo të betohet se, në kohën e kontratës, ajo ishte e virgjër, sepse baza është që ajo të qëndrojë në krijimin e saj origjinal, derisa të vërtetohet e kundërta.

Çështje

1- Kush pretendon një të metë në partnerin e tij, ai ka detyrim të sjellë argument, kurse ai që e mohon të metën, ka

detyrim të betohet, sepse baza është mosekzistenca e të metës, derisa të vërtetohet e kundërta.

2- Kush pretendon një gjë shtesë në formulën e kontratës, ai ka detyrim të sjellë argumentin, kurse mohuesi ka detyrim të betohet, sepse baza është mosekzistenca as e kushtit dhe as e shtesës, derisa të vërtetohet e kundërta.

3- Çdo e metë për shkak të së cilës gjykohet pavlefshmëria e kontratës së martesës, gruaja ka të drejtë të marrë shumën e ngjashme të kurorës, kur burri ka kryer marrëdhënie intime me të, pra, ajo nuk merr shumën nominale, sepse pavlefshmëria e kontratës kërkon pavlefshmërinë e nominales, prandaj në këtë gjendje, për gruan vërtetohet shuma e ngjashme e kurorës, për shkak se ka vend për dyshim.

Për çdo të metë, që gjykohet vlefshmëria e kontratës, gruaja ka të drejtë të marrë shumën nominale të kurorës, kur me të është kryer marrëdhënie intime, edhe nëse pasohet me prishje, sepse prishja e heq kontratën në kohën e prishjes, por në origjinë nuk e prish atë.

* * *

SHUMA E KURORËS

(El mehru)

Shuma e kurorës në terminologjinë e ligjit islam emërtohet me fjalët e arabishtes “mehr”, “sadàk” dhe “ferijdah”, ashtu siç përmendet në ajetet e Kuranit Famëlartë. Në librat e fik’hut përdoret më shumë fjala “mehr”. Shuma e kurorës (mehri), në librat e fik’hut, trajtohet e ndarë në tri lloje: shuma e përcaktuar e kurorës, shuma e ngjashme e kurorës, shuma që jepet zakonisht në raste të ngjashme dhe shumë e kurorës që e cakton vetë njeri prej dy bashkëshortëve për shkak se është i autorizuar të caktojë shumën e kurorës.

Shuma e përcaktuar e kurorës

Shuma e përcaktuar e kurorës është shuma për të cilën kanë rënë dakord të dy bashkëshortët dhe që të dy e kanë saktësuar këtë shumë në tekstin e kontratës. Kjo shumë jepet nga ato pasuri që lejohet të ketë myslimani në pronësi. Me fjalën e përbashkët të fukahave, që janë bazuar në fjalën e Allahut të Lartësuar, nuk ka kufi për shumën më të lartë:

“وَإِنْ أَرَدْتُمْ اسْتِبْدَالَ زَوْجٍ مَّكَانَ زَوْجٍ وَآتَيْتُمْ إِحْدَاهُنَّ قِنْطَارًا فَلَا تَأْخُذُوا مِنْهُ شَيْئًا

“Në qoftë se dëshironi të merrni një grua në vend të një gruaje tjetër (asaj që divorcuat) të cilës i kishit dhënë një shumë të madhe, prej asaj shume mos merrni asgjë...” (Sure “En Nisa”, ajeti 20)

Gjithashtu, me fjalën e përbashkët të fukahave, nuk ka kufi as për shumën më të vogël, ashtu siç ka thënë Imam Bakiri, babai i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Shumë kurore është çdo send për të cilin njerëzit bien dakord mes tyre, pak ose shumë.” Është veprim i pëlqyer (mustehab) që shuma e kurorës të mos jetë më shumë se shuma e praktikës profetike, domethënë pesëqind dirhemë. Hadithe të shumta tregojnë se i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) u martua vetë dhe martoi vajzat e tij me këtë shumë kurore. Thuhet se shuma e kurorës vlerësohet në tridhjetë e pesë lira floriri osmane. Në të gjitha rastet, është veprim i pëlqyer në ligjin e fesë që shuma e kurorës të jetë e paktë.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) njofton se i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Gratë më të mira të umetit tim janë: ajo që është mëngjes në fytyrë dhe ajo me shumë kurore më të vogël.” Pastaj, për të shpjeguar kuptimin e këtij hadithi, tha: “Pesimizmi te gruaja është shuma e lartë e kurorës së saj.”

Kushtet e shumës së kurorës

Në shumën e kurorës është kusht:

1- Shuma e kurorës të jetë pasuri hallall dhe prej pasurive të njohura ligjërisht. Kur për shumën e kurorës së gruas caktohet verë, ose një derr, ose një kafshë e ngordhur, ose sende të tjera që nuk lejohen të jenë pasuri, kjo shumë kurore nuk ka asnjë vlerë, por kontrata e martesës është e vlefshme dhe për atë grua vërtetohet e drejta e shumës së ngjashme të kurorës, kur janë kryer marrëdhënie intime me të. Kjo është fjala më e përhapur në mesin e fukahave. Është edhe dëshmia e autorit të librit “El Xheuahir”.

Kërkesa për vlefshmërinë e kontratës ekziston, domethënë ekziston propozimi dhe pranimi, kurse ndaluesi për vlefshmërinë nuk ekziston. Përveç kësaj, pavlefshmëria e shumës së kurorës nuk kërkon prishjen e kontratës, domethënë që kontrata është e vlefshme krahas shumës së kurorës dhe nuk është e vlefshme pa shumën e kurorës. Në të vërtetë, kontrata është e vlefshme, edhe sikur të jetë vënë kusht të mos ketë fare shumë kurore.

2- Shuma e kurorës, në një mënyrë ose një tjetër, të dihet se si është, si për shembull, thuhet që për shumë kurore është kjo copë stofi, ose kjo parcelë toke, ose është para floriri, ose para argjendi, por nuk është kusht që të dihet me hollësi.

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ka martuar njërin prej shokëve të tij me një grua dhe si shumë kurore për këtë grua caktoi që burri t’i mësojë asaj ato pjesë prej Kur’anit Famëlartë që ai dinte më mirë, pa dhënë hollësi për pjesën që ai dinte më mirë.

Gjithashtu, kontrata e martesës është e vlefshme, edhe kur si shumë kurore caktohet një shtëpi, ose një kalë, pa përmendur cilësitë e atij kali që e dallojnë atë prej kuajve të tjerë, apo shtëpinë prej shtëpive të tjera, por thjesht i përcakton në atë gjendje që janë dhe ai i jep gruas një kalë ose një shtëpi nga mesi i kuajve të tij, ose i jep asaj njërën prej shtëpive që ka në pronësi.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që martohet me një grua dhe për shumë kurore vë një shërbëtor. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: “Një shërbëtor prej shërbëtorëve.”

Pyetësi tha: “Ai ka vënë një shtëpi për shumë kurore. Është e drejtë kjo shumë kurore?”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Njërën prej shtëpive nga shtëpitë që ai ka.”

Prej fukahave që kanë dhënë fetva të bazuar në këtë transmetim, është edhe sejjid El Hakijm, ashtu siç thuhet në disertacionin e tij “Minhaxhu Sàlihijn”.

Autori i librit “El Xheuahir”, në lidhje me çështjen e shumë s kurorës, tekstualisht ka thënë: “Është e vlefshme që për shumë kurore të vihet një send, ose diçka të ngjashme me sendin. Burri ka detyrim që të financojë sado pak.”

Ashtu siç është e vlefshme për porositësin, kur lë porosi për një tjetër, me fjalën: “Jepi sendin.”, për rrjedhojë, trashëgimtari ka detyrim t’i japë atij një send për të cilin përputhet fjala pasuri, pak ose shumë qoftë. Kjo dhënie e shënuar në kontratën e martesës,

nuk është si kompensimi që duhet të jepet patjetër, për të hequr mashtrimin, në rastin kur dihet e meta.

3- Shuma e kurorës është e vlefshme të jetë në para letër, ose metalike, ose rrobë, ose tokë, ose kafshë, ose një përfitim, ose çdo gjë tjetër që ka një vlerë.

Kur për gruan caktohet një shumë kurore e rrëmbyer, si për shembull, që të martohet me atë grua, burri ka vënë për shumë kurore një tokë, por rezulton se ajo tokë është pronë e babait të tij, ose e ndonjë tjetri, nëse pronari i tokës e lejon, gruaja merr atë që u caktua nominalisht për të, ndryshe për gruan vërtetohet kompensimi me një tokë të ngjashme me tokën e caktuar, ose i jepet vlera e asaj toke, sepse ajo që është caktuar si shumë kurore, lejohet të merret në pronësi, në kundërshtim me verën e me derrin që nuk lejohen të merren në pronësi.

Kur burri martohet me gruan me një shumë kurore të fshehtë dhe me një shume kurore tjetër të njohur, gruaja ka të drejtë të marrë të parën. Kjo është e barabartë, qoftë kur shuma e parë është më shumë ose më pak se e dyta.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Pa asnjë kundërshtim e pa asnjë komplikim. Vetëkuptohet që shuma e dytë është veprim i gabuar, për rrjedhojë nuk shërben për asgjë.”

Shuma e ngjashme e kurorës

Shuma e ngjashme e kurorës, merret në konsideratë në gjendjet vijuese:

1- Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët me dëshminë e autorit të librit “El Xheuahir” që shuma e kurorës nuk është prej kolonave të kontratës së martesës (pa të cilën nuk mund të lidhet). Gjithashtu, shuma e kurorës nuk është as kusht për vlefshmërinë e kontratës së martesës, pasi kontrata e martesës është e vlefshme, qoftë kur shuma e kurorës vihet në kontratë, qoftë edhe kur nuk vihet, madje kontrata e martesës është e vlefshme edhe me kushtim që të mos ketë shumë kurore, por burri, në të tilla gjendje, ka detyrim të japë një lloj kompensimi për gruan, pak ose shumë.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një grua që ia dhuron veten e saj një burri dhe ai vë kurorë me këtë grua, pa caktuar shumë kurore për të. A është e lejueshme kjo lloj martese? Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Në të vërtetë, kjo ishte e veçantë vetëm për Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), kurse për të tjerët martesa me këtë grua nuk është e vlefshme, derisa burri t’i japë gruas diçka, para se të kryejë marrëdhënie intime me të, pak ose shumë qoftë ajo që ai jep, qoftë edhe një rrobë, ose një dirhem.”

Kontrata e martesës quhet kontratë martese edhe pa e përmendur shumën e kurorës në kontratë. Quhet kontratë martese edhe pa e vënë kusht shumën e kurorës, quhet kontratë martese edhe me kompensimin që jep burri kundrejt kënaqësisë që përjetoi prej asaj gruaje, për të cilën, pas kryerjes së marrëdhënieve intime, vërtetohet e drejta për të marrë një shumë kurore të ngjashme. Por nëse burri e divorcon atë, para se të kryejë marrëdhënie intime, ajo nuk ka të drejtë të marrë shumë kurore, megjithëkëtë burri që e divorcoi atë grua, ka detyrim t’i japë asaj një dhuratë, sipas gjendjes së tij. Nëse është i pasur, dhuratë është si dhurata që jep i pasuri dhe, nëse është i varfër, dhurata e tij është si dhurata që jep

i varfëri, si për shembull, një unazë, një rrobë, një palë vathë, etj. Nëse ata të dy bien dakord për këtë dhuratë, veprohet sipas fjalës që janë marrë vesh, ndryshe dhuratën e cakton gjykatësi.

Argument për këtë caktim është fjala e Allahut të Lartësuar:

“لَا جُنَاحَ عَلَيْكُمْ إِنْ طَلَقْتُمُ النِّسَاءَ مَا لَمْ تَمْسُوهُنَّ أَوْ تَفْرِضُوا لَهُنَّ فَرِيضَةً وَمَتَّعُوهُنَّ عَلَى الْمَوْسِعِ قَدَرَهُ وَعَلَى الْمُقْتَرِ قَدَرُهُ مَتَاعًا بِالْمَعْرُوفِ حَقًّا عَلَى الْمُحْسِنِينَ”

“Nuk është mëkat për ju, nëse i divorconi gratë pa kryer marrëdhënie intime me to dhe, para se t’i divorconi, caktoni për ato një shumë, ose i pajisni ato, i pasuri sipas mundësisë së tij dhe i varfëri sipas mundësisë së tij; një pajisje e zakonshme është detyrim për punëmirët.” (Sure “El Bekare”, ajeti 236)

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Kur burri e divorcon gruan e tij, para se të kryejë marrëdhënie intime me të, asaj i takon vetëm gjysma e shumës së kurorës. Nëse për atë grua nuk është caktuar shumë kurore, atëherë asaj i jepet dhurata e zakonshme, i pasuri sipas gjendjes së tij dhe i varfëri sipas gjendjes së tij. Gjithashtu, kjo grua nuk ka detyrim të kalojë kohën e pritjes ligjore dhe ka të drejtë të martohet kur të dëshirojë, madje që në çastin kur burri e divorcoi.”

Kur vdes njëri prej bashkëshortëve, para se të kryejnë marrëdhënie intime dhe para se burri të caktojë dhuratën për të, kësaj gruaje nuk i takon as shuma e kurorës e as dhurata, por ajo ka të drejtën e trashëgimisë dhe ka detyrim të kalojë kohën e pritjes ligjore.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një grua që vdes para se burri të kryejë marrëdhënie intime me të. Sa i

takon asaj prej shumë së kurorës? Si qëndron puna e trashëgimisë së saj? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Në qoftë se për atë është caktuar shumë kurore, ajo merr gjysmën e shumë së kurorës dhe burri e trashëgon gruan. Në qoftë se për të nuk është caktuar shumë kurore, ajo nuk merr asgjë, por gruaja e trashëgon burrin dhe ka detyrim të kalojë kohën e pritjes ligjore.”

Kur burri është martuar me atë grua, sipas Librit të Allahut e Sunetit të Profetit të Allahut, por ai nuk ka caktuar për atë grua shumë e kurorës, ajo nuk ka të drejtë të marrë shumë e ngjashme të kurorës, por ajo ka të drejtë të marrë shumë e kurorës sipas rrugës së Sunetit. Kjo shumë, ashtu siç u tha më sipër është e barabartë me pesëqind dirhemë. Autori i librit “El Xhevahir” ka thënë: “Kjo çështje gëzon fjalën e përbashkët të fukahave.”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që është martuar me një grua, por për gruan nuk ka caktuar shumë e kurorës, ndërsa kontrata e martesës është bërë duke thënë: “Unë vë kurorë me ty, sipas Librit të Allahut dhe Sunetit të Profetit të Tij (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*). Ndërkaq burri vdes, ose ka qëllim që me të, të kryejë marrëdhënie intime. Sa i takon asaj gruaje prej shumë së kurorës? Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Shuma e kurorës jepet sipas Sunetit.”

Pyetësi e pyeti: “Burri i thotë asaj se do të marrë shumë e kurorës si gratë e rangut të saj.” Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Kjo është shuma e kurorës sipas Sunetit.”

2- Gjithashtu, për gruan vërtetohet shuma e ngjashme e kurorës, kur kontrata është bërë prej atij që nuk ka asnjë pasuri të ligjshme, por ka nga ato gjëra, të cilat në ligjin e fesë islame, nuk mund të merren në pronësi, si për shembull, ai ka verë, ose derra, siç u shpjegua më lart.

Kush bën kontratë martesë për një grua dhe kryen marrëdhënie intime me të, por më pas bëhet e qartë se kontrata është e prishur, për shkak se gruaja rezultoi të jetë motra e tij prej qumështi, ose për ndonjë shkak tjetër që e bën gruan të ndaluar për atë burrë, me fjalën e përbashkët të fukahave, kontrata prishet dhe në këtë gjendje shikohet: Në qoftë se në kontratën e martesës ai nuk ka caktuar për atë grua shumën e kurorës, gruaja ka të drejtë të marrë shumë kurore të ngjashme që jepet zakonisht, por, nëse shuma e kurorës është caktuar në kontratën e martesës dhe është më pak se shuma e ngjashme e kurorës që jepet zakonisht, gruaja ka të drejtë të marrë shumën e kurorës së caktuar në kontratë, sepse gruaja ishte e kënaqur më atë shumë. Gjithashtu, edhe kur shuma e kurorës është më e madhe se shuma e ngjashme që jepet zakonisht, gruaja ka të drejtë të marrë shumën e ngjashme, të cilën ajo e meriton për shkak të kryerjes së marrëdhënieve intime dhe jo për shkak të kontratës.

Kjo lloj marrëdhënie intime quhet marrëdhënie intime me dyshim, siç është kryerja e marrëdhënieve intime prej të dehurit, atij që është në gjumë dhe të çmendurit.¹ Në lidhje me

¹ Kur një i çmendur kap një grua me dhunë dhe ky i çmendur ka pasuri, gruaja ka të drejtë të kërkojë prej kujdestarit të të çmendurit shumën e ngjashme të kurorës, shumë të cilën kujdestari e paguan prej pasurisë së të çmendurit. Në këtë gjendje, gjykatësi ka detyrë ta detyrojë kujdestarin për këtë, por gruaja s'ka

marrëdhëniet intime me dyshim, do të flitet në kapitullin “Përkatësia familjare”.

3- Kush detyron me forcë një grua që ajo të kryejë marrëdhënie intime me të, ai ka detyrim t’i japë asaj shumë e ngjashme të kurorës. Nëse gruaja e miraton kërkesën e tij, burri s’ka asnjë detyrim ndaj asaj, sepse, në këtë gjendje, ajo ka kurvëruar me dashje.

Shuma e ngjashme e kurorës llogaritet në analogji me shumë e kurorës që marrin gratë e ngjashme me të.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që martohet me një grua dhe për atë ai nuk cakton shumë e kurorës, pastaj kryen marrëdhënie intime me atë. Si duhet të veprohet në këtë gjendje?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Ajo ka shumë e grave të ngjashme me atë.”

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Në shumë e ngjashme të kurorës merret në konsideratë gjendja e gruas: shkalla shoqërore, bukuria, mosha, virgjëria, gjendja pasurore, mendja, nderi, edukata dhe të tjera cilësi prej të cilave ndryshon fare qartë qëllimi dhe dëshira.”

Fukahatë më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit “El Xheuahir” dhe të autorit të librit “El Hadaik”, të cilët janë shprehur se gruaja ka të drejtë të marrë një shumë kurore të barabartë me shumë që marrin të ngjashmet me të, me kusht që

të drejtë të kërkojë prej kujdestarit, në qoftë se i çmenduri është i varfër, prandaj është detyrim që gruaja të presë, derisa ai të bëhet në gjendje të mirë.

kjo shumë të mos e tejkalojë shumën e kurorës sipas Sunetit, e cila, siç e pamë, ishte 500 dirhemë.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që është martuar me një grua dhe burri ka harruar të përmendë shumën e saj të kurorës, derisa kryen marrëdhënie intime me të. Sa është shumë e kurorës? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Suneti është pesëqind dirhemë.”

Këtë transmetim dhe transmetime të tjera të ngjashme që trajtojnë këtë çështje, fukahatë i kanë mbartur në rastin kur shumata e kurorës së të ngjashmeve me të është më shumë se shumata e kurorës sipas Sunetit dhe, duke bërë bashkimin mes transmetimit në fjalë dhe transmetimeve të tjera, rezulton se asaj i takon e njëjta shumë kurore që marrin gratë e ngjashmet me të.

Kur bashkëshortët bien dakord pas bërjes së kontratës për një shumë të caktuar dhe kjo shumë është e saktësuar në tekstin e kontratës si shumë kurore, për asnjërin prej atyre të dyve nuk lejohet të heqë dorë, sepse, sipas shprehjes së autorit të librit “Esh Sheraiu”, caktimi i shumës së kurorës prej vetë atyre të dyve në fillim, lejohet të përfundojë në po atë shumë.

Autorizimi për caktimin e shumës së kurorës

Autorizimin për caktimin e shumës së kurorës fukahatë e kanë ndarë në dy pjesë. E para: Autorizim vetëm për martesë, domethënë që kontrata e martesës bëhet pa e përmendur shumën e kurorës. Më sipër u shpjegua se gruaja ka të drejtën e shumës së kurorës, kur janë kryer marrëdhënie intime me të.

E dyta: Autorizim për shumën e kurorës, domethënë që, kur bëhet kontrata e martesës, autorizohet të caktojë shumën e kurorës ose burri, ose gruaja. Kjo është pjesa e tretë e studimit mbi shumën e kurorës.

Fukahatë janë bashkuar me autorin e librit “El-Hadaik” se autorizimi për të caktuar shumën e kurorës është veprim i lejuar. Në rastin kur shuma e kurorës nuk saktësohet në kontratën e martesës, gruaja është e detyruar të pranojë shumën që i jep burri, pak, ose shumë qoftë, për shkak se vetë gruaja, me vullnetin e me përzgjedhjen e saj, e kishte miratuar atë veprim, domethënë, të mos shkruhej shuma e kurorës në tekstin e kontratës. Në qoftë se caktimi i shumës së kurorës i lihet në dorë gruas, në këtë rast, gruaja ka detyrim të mos caktojë më tepër se shuma e kurorës së Sunetit, që ishte e barabartë me 500 dirhemë.

Imam Bakiri, babai i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), është pyetur për një burrë që është martuar me një grua, në dorën e së cilës është lënë caktimi i shumës së kurorës. Sa duhet të kërkojë kjo grua për shumën e kurorës?

Imam Bakiri është përgjigjur: “Me vendimin e saj, ajo nuk e tejkalon shumën e kurorës së grave të Muhamedit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), që është pesha e 500 dirhemëve argjend.”

Pyetësi tha: “Si mendon, nëse caktimi i shumës së kurorës do të ishte bërë prej burrit dhe gruaja të ishte e kënaqur me atë caktim?”

Imam Bakiri iu përgjigj: “Kur vendoset për një shumë, ajo është shuma e lejuar për atë grua, pak ose shumë qoftë.”

Pyetësi i drejtohet Imam Bakirit me një pyetje të dytë: “Si është e mundur, që ti nuk lejove vendimin e saj, kur vendimi nuk është në favor të burrit dhe tani lejon vendimin e burrit që nuk është në favorin e gruas?”

Imam Bakiri iu përgjigj: “Ai vendim ishte gjykimi i saj, por ajo s’ka të drejtë të tejkalojë atë që ka praktikuar i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), pasi me atë shumë ai është martuar me gratë e veta, prandaj unë e referova gjykimin e saj te Suneti, praktika profetike, si dhe për faktin se vendimi ishte thjesht gjykimi i saj, ndërkaq e lashë punën e caktimit të shumës së kurorës në dorën e burrit dhe ajo ishte dakord me caktimin që ai bëri, prandaj gruaja është e detyruar të pranojë shumën e kurorës që caktoi burri, e vogël ose e madhe qoftë shuma që ai caktoi.”

Kur burri e divorcin gruan para se të kryejë marrëdhënie intime me të dhe ngarkon një tjetër që të caktojë shumën e kurorës për këtë grua të divorcuar, burri duhet t’i shpjegojë të autorizuarit gjendjen reale, nëse nuk ia kishte shpjeguar më parë, me qëllim që ai, si i autorizuar, të ketë mundësi t’i japë të drejtën atij që i takon dhe ashtu siç i takon, domethënë ashtu siç e kemi shpjeguar më sipër: Kësaj gruaje i takon vetëm gjysma e shumës së kurorës.

Në qoftë se burri vdes para se të bëjë shpjegimin dhe ka kryer marrëdhënie intime me gruan, gruas i takon e plotë shuma e kurorës. Nëse burri vdes para se të kryejë marrëdhënie intime me gruan që divorcoi dhe ka bërë edhe shpjegimin për të autorizuarin, e drejta e shumës së kurorës për gruan bie, por ajo ka të drejtën e dhuratës. Imam Bakiri, babai i imam Xhafer Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), është pyetur për një burrë që është

martuar me një grua dhe burri ka autorizimin për caktuar vetë shumën e kurorës, ose është gruaja e autorizuar të caktojë shumën e kurorës, ndërkaq burri vdes, ose vdes gruaja, para se me atë grua burri të kryejë marrëdhënie intime. Çfarë i takon kësaj gruaje?

Ai iu përgjigj: “Gruas i takon dhurata dhe trashëgimia, por për atë s’ka shumë kurore.”

Përsheptimi në pagimin e shumës së kurorës dhe vonimi në pagimin e saj

Në pagimin e shumës së kurorës lejohet vonimi dhe përsheptimi, pagimi i gjithë shumës, ose i një pjese të saj. Afati për pagimin e shumës së kurorës mund të jetë i përcaktuar faktikisht, ose realisht, si për shembull, një vit ose më shumë, ose më pak se një vit. Por afati për pagimin e shumës së kurorës mund të jetë realisht dhe jo faktikisht, si për shembull, njëri prej dy afateve: vdekja ose divorci, pasi për të dyja gjendjet afati është i lejuar, sepse qoftë vdekja qoftë divorci mund të ndodhin realisht, por jo domosdoshmërisht, për shkak se çështja e shumës së kurorës mund trajtohet prej injorantëve, ashtu siç nuk trajtohet çmimi në shitjen, pasi për shumën e kurorës, në të vërtetë, nuk ka kompensim.

Në lidhje me këtë çështje, sej’jid El Hakijm, në pjesën e dytë të librit “Minhàxhu Sàlihij”, në kapitullin “Shuma e kurorës”, ka thënë: “Sikur afati për pagimin e shumës së kurorës të shtyhet, bëhet detyrim përcaktimi i kohës, qoftë në tërësi, si për shembull, ardhja e udhëtarit, lindja e të voglit, ose ndodhi të tjera.”

Ky autor, me fjalën “lejohej shtyrja e afatit për pagimin e shumës së kurorës deri në ardhjen e udhëtarit”, ka qëllim ardhjen e një udhëtarit të përcaktuar, ose një lindje të përcaktuar dhe jo udhëtar e lindje në përgjithësi.

Pyetje: Kur pagesa e shumës së kurorës shtyhet dhe nuk përcaktohet afati, si për shembull, sikur burri të thotë: “U martova me ty me dy mijë, një mijë me pagim të përshpejtuar dhe një mijë me pagim të vonuar.”, në këtë gjendje, kjo grua do të jetë e lejuar, vetëm nëse paguhet e gjithë shuma e kurorës, ose prishet vetëm shuma e kurorës së përcaktuar dhe pas kryerjes së marrëdhënieve intime për atë grua, vërtetohet shuma e ngjashme e kurorës, apo jemi në të njëjtën gjendje plotësisht sikur shuma e kurorës të mos jetë përmendur që në fillim?

Sej’jid El Hakijm, në librin “Minhàxhu Sàlihij”, ka thënë: “Është pa vlerë shuma e kurorës dhe është e vlefshme kontrata e martesës. Nëse me gruan, burri kryen marrëdhënie intime, gruaja merr shumën e ngjashme të kurorës.”

Konstatohet se, të gjithë fukahatë kanë rënë në një fjalë të përbashkët, ndër të cilët edhe sej’jid El Hakijm se kontrata e martesës nuk është prej kontratave marrje-dhënie dhe, për këtë shkak, shuma e kurorës mund të përballet prej injorantëve me ata çka është e pamundur të përballohet çmimi.

Pikërisht për këtë shkak, edhe autori i librit “El Xheuahir” ka lejuar që shuma e kurorës të ndodhë me fjalën “send”, ashtu siç e kemi trajtuar në paragrafin “Kushtet e shumës së kurorës”, në pikën e dytë të këtij kapitulli. Pas këtij shpjegimi, s’ka më vend të

flitet për pavlefshmëri të shumës së kurorës, por bëhet e detyrueshme të flitet vetëm për vlefshmërinë e shumës së kurorës.

Autori i nderuar e ka mbartur fjalën “afat” mbi fjalën “vonim për disa ditë”, në atë mënyrë që fjala “vonim” të ketë kuptimin e afatit. Bazuar mbi këtë rregull, gruas i lejohet të kërkojë shumën e kurorës prej vonuesit pas një dite ose pas dy ditëve, për rrjedhojë, rezultati do të ishte i barabartë me përshpejtimin e pagesës së shumës së kurorës. Veç kësaj, bazuar në fjalën e sejjid El Hakijm, gruas i lejohet të kërkojë shumën e ngjashme të kurorës, kur me të është konsumuar kryerja e marrëdhënieve intime, edhe sikur shuma e caktuar e kurorës, për të cilën ajo kishte rënë dakord, të jetë më e vogël se shuma e ngjashme e kurorës.

Personalisht mendoj se kjo nuk përputhet me asnjërën prej bazave të medh’hebit.

Vonimi i pagimit të shumës së kurorës së përshpejtuar dhe përshpejtimi i pagimit të shumës së kurorës së vonuar

Kur shuma e kurorës është e përcaktuar të jetë me pagim të përshpejtuar dhe më pas gruaja bie dakord që pagimi i shumës së kurorës të shtyhet deri në një afat kohor të caktuar, a bëhet detyrim qenia e saj dakord për këtë shtyrje, në atë mënyrë që asaj nuk i lejohet të heqë dorë dhe të kërkojë shumën e saj të kurorës para këtij afati?

Përgjigje: Kur miratimi për shtyrjen e afatit të pagimit të shumës së kurorës nuk është vënë kusht në një kontratë të

detyrueshme, gruas i lejohet të heqë dorë, sepse është plotësisht si premtimi fillestar, për të cilin mbajtja e besës është veprim i pëlqyer, por nuk është detyrim. Autori i librit “Miftahul Kerameh”, në vëllimin 5, në faqen 55, në kapitullin “Borxhi”, ka thënë: “Kur gjendja vonohet, shtyrja nuk është e detyrueshme”. Ashtu thuhet edhe në librat “El Mebsut” “El Khilaf”, “Es Serair”, “Esh Sheraiu”, “En Nafiu”, “Et Tedhkireh”, “Et Tebsireh”, “Et Tahrijr”, “El Irshad”, “Ed Durus”, “El Mejsejeh”, “El Mesalik” dhe “El Kifajeh”.

Në këtë të fundit renditet edhe fjala që ka përhapjen më të madhe në mesin e fukahave, të cilët janë shprehur se nuk ka kontratë për të cilën mbajtja e besës është detyrim, por kemi vetëm premtim dhe mbajtja e besës për premtimin është veprim i pëlqyer (mustehab). S’ka dallim, nëse premtimi është shumë kurore, apo ndonjë premtim tjetër.”

Një thënie e ngjashme me këtë gjendet edhe në librin “El Xheuahir”, në fundin e kapitullit “Shitblerja”.

Pyetja e dytë: Kur shuma e kurorës është e përcaktuar dhe me pagim të vonuar, por burri më pas bie dakord që të paguajë sa më shpejt, ky miratim, nga ana e burrit, a bëhet detyrim për të?

Përgjigje: Elalameh, në librin “El Kauaid”, në kapitullin “Borxhi”, ka thënë: “Sikur borxhmarrësi të rrëzojë afatin e shlyerjes së borxhit që ai ka detyrim të shlyejë, afati nuk rrëzohet, por as borxhdhënësi s’ka të drejtë të kërkojë prej tij shlyerjen menjëherë të borxhit.”

Me fjalën e përbashkët të fukahave, vërtetohet lejimi për shpejtim në shlyerjen e borxhit me afat shlyerje të vonuar, me kusht të rrëzimit të një pjese të borxhit.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që ka për të marrë borxh prej një tjetri, të cilit i thotë para se të vijë afati i shlyerjes: “Më kthe sa më shpejt gjysmën e borxhit që më ke dhe unë të fal gjysmën tjetër të borxhit.” A lejohet kjo apo jo? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Po.”

Për të dyja çështjet kemi folur në mënyrë të detajuar në pjesën e katërt, në kapitullin “Borxhi”, në paragrafin “Përsheptimi për shlyerjen e borxhit me rrëzimin e një pjese të borxhit”.

Babai i gruas dhe shuma e kurorës

Kur burri cakton një shumë për babain e gruas, këtë shumë a e merr në pronësi babai i gruas dhe a e ka hallall babai i gruas ta marrë këtë shumë? Përgjigjja për këtë pyetje kërkon shpjegimet e mëposhtme:

1- Burri cakton një shumë për paratë e kurorës dhe pastaj cakton edhe një shumë të dytë për babain e gruas, në atë mënyrë që shuma që ai caktoi për babain të mos jetë pjesë e shumës së kurorës së gruas. Nëse çështja qëndron kështu siç u shtrua, burri ka detyrim të paguajë vetëm shumën e kurorës dhe rrëzohet detyrimi i tij për të paguar shumën që ai caktoi për babain e gruas.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Pa asnjë kundërshtim, madje në librin “El Gun’jeh” thuhet se kjo ka fjalën e

përbashkët të fukahave, sepse bazë për këtë është transmetimi i ardhur në “Sahijhun” e El Uisha, prej Imam Rizait (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili ka thënë: ‘Sikur një burrë të martohet me një grua dhe për shumën e kurorës për këtë grua paguan njëzet mijë, ndërkaq ai vë edhe dhjetë mijë për babain e gruas, shuma që ai vuri për kurorën, është e vlefshme, kurse shuma që ai vuri për babain e gruas, është e parregullt.’”

2- Në tekstin e kontratës burri, nga ana e tij, vë kusht diçka edhe për babain e gruas, duke e konsideruar këtë dhënie për babain e gruas pjesë të shumës së kurorës. Fukahatë më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit “El Mesalik” se ky kusht është pa vlerë, sepse kushti, në të vërtetë, është i vlefshëm vetëm për personin për të cilin bëhet kontrata dhe nuk është i vlefshëm për asnjë person tjetër përveç tij.

3- Gruaja i vë kusht burrit që ai të shtojë diçka mbi shumën e kurorës së saj dhe këtë shtesë t’ia japë babait së saj. Burri, nga ana e tij, e miraton këtë kusht të gruas. Nëse çështja qëndron kështu siç u shtrua, duhet të zbatohet kushti, sipas rregullit: “Besimtarët janë në kushtet e tyre”, përderisa kushti as nuk bën hallall haramin e as nuk bën haram hallallin, sepse ky kusht nuk është në kundërshtim as me kërkesat e kontratës e as kundërshton Librin e Allahut e Sunetin profetik.

4- Burri merr përsipër të bëjë për babain e gruas, ose për ndonjë tjetër një punë hallall, si për shembull, të ndërmjetësojë mes të fejuarit e të fejuarës, me qëllim që të zhduken vështirësitë e pengesat. Ky veprim, ligjërisht, është i lejueshëm kur veprimi nuk përmendet në kontratën e martesës, ndryshe është si në rastin e parë.

Është punë e mirë që këtë paragraf ta mbyllim me transmetimin që tregon se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që marton vajzën e vet. A i lejohet këtij babai të hajë prej shumës së saj të kurorës? Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Jo, kjo shumë nuk është për babain e gruas.”

Refuzimi i gruas, derisa të marrë në dorë shumën e kurorës

A e merr gruaja në pronësi shumën e kurorës thjesht me bërjen e kontratës, apo marrja në pronësi e kësaj shumë prej saj është e kushtëzuar me kryerjen e marrëdhënie intime me të?

Fukahatë më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit “El Xheuahir” dhe të autorit të librit “El Hadaik” se gruaja e merr në pronësi shumën e kurorës, edhe nëse burri nuk kryen marrëdhënie intime me të, ashtu siç thotë Allahu i Lartësuar në fjalën e Tij:

“وَأَتُوا النِّسَاءَ صَدُقَاتِهِنَّ نِحْلَةً”

“Grave jepuni dhuratën e kurorës së tyre të mirë...” (Sure “En Nisa”, ajeti 4)

Ajeti i nderuar tregon qartë se Allahu i Lartësuar e ka bërë detyrim dhënien e shumës së kurorës për gratë, pa vënë kusht kryerjen e marrëdhënieve intime me to. Duke shtuar këtu se burri e ka në dorë të veprojë me gruan në lidhje me kryerjen e marrëdhënieve intime me të, edhe thjesht me bërjen e kontratës së martesës. Por Allahu i Lartësuar e ka bërë detyrim që edhe gruaja

të marrë në pronësi shumën e kurorës thjesht me bërjen e kontratës së martesës.

Pyetje: Është vërtetuar se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Shumën e kurorës nuk e bën detyrim asgjë tjetër përveç kryerjes së marrëdhënieve intime.” Si duhet ta kuptojmë këtë thënie?

Përgjigje: Kjo fjalë e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk e mohon marrjen në pronësi të shumës së kurorës para kryerjes së marrëdhënieve intime, sepse pronësia ekziston dhe pohohet vetëm pas kryerjes së marrëdhënieve intime.

Me një fjalë, marrjen në pronësi të shumës së kurorës e kemi dy llojesh: pronësi e lëkundur dhe pronësi e qëndrueshme. Në lidhje me këtë transmetim, autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Në transmetimin “shumën e kurorës nuk e bën detyrim asgjë tjetër përveç kryerjes së marrëdhënieve intime”, nuk është qëllim mohimi i mundësisë së vërtetimit të së drejtës për marrjen e plotë të shumës së kurorës, me rastin e qëndrimit në vetmi të plotë të burrit me gruan, sepse kjo është e huaj në këtë çështje, sepse vetë shumën e kurorës është tregues i vërtetimit të së drejtës për shumën e kurorës.

Për këtë çështje do të flitet më në hollësi në paragrafin “Qëndrimi në vetmi”.

Në lidhje me pronësinë mbi shumën e kurorës nga ana e gruas si pasojë e kontratës së martesës, renditen disa dispozita, prej të cilave është dispozita që flet për të drejtën e gruas për të vepruar me shumën e kurorës edhe para se ta marrë atë në dorë, madje gruaja ka të drejtë të veprojë me këtë shumë edhe pa lejen e

burrit, kur shuma e kurorës është objekt i jashtëm (jashtë shtëpisë).

Dispozitë tjetër është që edhe rritja që vjen prej shumës së kurorës, i takon gruas që nga data e bërjes së kontratës së martesës.

Dispozitë tjetër është se gruaja ka të drejtë ta bojkotojë burrin, derisa ta marrë të përsheptuar të gjithë shumën e kurorës. Pasi gruaja merr në dorë shumën e kurorës, nuk ka të drejtë të bojkotojë burrin. Nëse e bojkoton, atëherë ajo grua numërohet grua që nuk qëndron në pozicionin e vet, për rrjedhojë, për këtë grua rrëzohet detyrimi që burri të shpenzojë për të. Por burri ka detyrim të shpenzojë për gruan, kur ajo e bojkoton burrin para se të marrë në dorë shumën e kurorës, sepse ky bojkotim, në këtë rast, është ligjërisht i justifikuar, me kusht që ajo vetë të mos i ketë dhënë burrit mundësi asnjë herë që ai të kontaktojë me të. Në rast se ajo i ka dhënë burrit atë mundësi, para se të marrë në dorë shumën e kurorës, qoftë edhe një herë të vetme, ajo s'ka më të drejtë ta bojkotojë burrin e të protestojë se bojkotimi nga ana e saj vjen për shkak se nuk ka marrë shumën e kurorës.

Në lidhje me këtë çështje, autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Kjo është thënia që ka përhapje më të gjerë dhe është e ngjashme me bazat e medh’hebit e me rregullat e tij, sepse burri ka të drejtë të përjetojë kënaqësi me gruan, menjëherë pas bërjes së kontratës së martesës. Kjo është e barabartë, nëse i ka paguar ose jo asaj shumën e kurorës. Por me fjalën e përbashkët të fukahave, ka dalë jashtë prej këtij rregulli përjetimi i kënaqësisë para marrjes në dorë të shumës së kurorës, kurse çështjet e tjera, që kanë lidhje me shumën e kurorës, mbeten në origjinën e tyre, për shkak se e

drejta e gruas për marrjen e përshpejtuar të shumës së kurorës, është rrëzuar që nga çasti kur ajo ka dhënë miratimin e saj, për më tepër, s'ka argument që të lejojë kthimin e asaj të drejte për gruan."

Kur gruaja është e vogël në moshë, aq sa nuk mund të kryhen marrëdhënie intime me të, kurse burri është i madh, në këtë gjendje, kujdestari i gruas ka të drejtë të kërkojë shumën e kurorës dhe nuk është detyrim që të pritët, derisa gruaja të arrijë moshën e pjekurisë seksuale, sepse detyrimi është që gruaja merr në pronësi shumën e kurorës menjëherë pas bërjes së kontratës së martesës. Kur gruaja është e madhe, kurse burri është i vogël, për të njëjtin shkak gruaja ka të drejtë të kërkojë shumën e kurorës së saj prej kujdestarit të burrit, pasi ajo nuk është e detyruar të presë, derisa burri të arrijë moshën e pjekurisë seksuale.

Kur burri dhe gruaja janë që të dy kokëfortë dhe gruaja thotë: "Unë nuk bindem, derisa të marr në dorë shumën e kurorës.", ndërkaq edhe burri thotë: "Nuk ta jap shumën e kurorës, derisa të më bindesh.", në këtë gjendje, burri detyrohet t'i dorëzojë shumën e kurorës një njeriu besnik, kurse gruaja e ka detyrim t'i bindet burrit. Nëse ajo, me të vërtetë bindet, atëherë asaj i dorëzohet shuma e kurorës, për rrjedhojë burri e ka detyrim të shpenzojë për të. Nëse gruaja e bojkoton, asaj nuk i jepet shuma e kurorës. Gjithashtu, rrëzohet edhe detyrimi për burrin që të shpenzojë për atë grua. Në rast se burri nuk i dorëzon shumën e kurorës njeriut besnik, merret vendim që ai të shpenzojë për gruan, nëse ka një kërkesë të tillë nga ana e gruas, sepse kokëfortësia, në këtë rast, vjen prej burrit dhe nuk vjen prej gruas.

Pamundësia e burrit për paguar shumën e kurorës

Kur burri s'ka mundësi të paguajë shumën e kurorës, nuk rrëzohet e drejta e gruas që burri të shpenzojë për gruan e tij. Gjithashtu, nuk rrëzohet as e drejta e saj për të bojkotuar burrin, kur ai nuk ka kryer marrëdhënie intime me të, sepse pamundësia për të plotësuar një të drejtë, nuk e rrëzon të drejtën, por bën detyrim justifikimin dhe ngritjen e mëkatit për shkak të vonimit. Gjithashtu, bën detyrim që partneri të presë deri në përmirësimin e gjendjes ekonomike, domethënë se gruaja s'ka të drejtë ta prishë martesën për shkak të pamundësisë së burrit për të paguar shumën e kurorës, por as gjykatësi nuk ka të drejtë ta divorcojë këtë grua për shkak të pamundësisë së burrit për të paguar shumën e saj të kurorës.

Babai dhe shuma e kurorës së gruas së djalit

Babai nuk ka detyrim të paguajë shumën e kurorës për gruan e djalit të tij të rritur, përveçse kur babit i duhet të garantojë shumën e kurorës për gruan e djalit të vet. Kur babai marton djalin e tij të vogël dhe ky djalë ka trashëguar pasuri prej nënës së tij, ose ai vetë zotëron pasuri me njërin prej shkaqeve, shuma e kurorës për gruan e këtij djali merret prej pasurisë së tij dhe babai nuk ka asnjë detyrim. Në qoftë se djali i vogël, në kohën e bërjes së kontratës së martesës, s'ka pasuri, shuma e kurorës së gruas së këtij djali është detyrim mbi babain e djalit dhe djali s'ka asnjë detyrim, madje edhe sikur më pas ai të bëhet i pasur.

Prej teksteve që trajtojnë këtë çështje, kemi rastin kur Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) u pyet për një burrë që ka martuar

djalin e tij të vogël. Kush do ta paguajë shumën e kurorës? Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Nëse djali i tij ka pasuri, shumën e kurorës e paguan djali, por nëse djali s’ka pasuri, babai është garantues, domethënë, babai ose paguan, ose nuk paguan.”

Divorci para kryerjes së marrëdhënieve intime

Kur për gruan, në kontratën e martesës, përmendet shuma e kurorës dhe pastaj burri e divorcon atë grua, para se të kryejë marrëdhënie intime me të, shuma e kurorës për këtë grua përgjysmohet, por nëse kontrata është bërë pa e përmendur fare shumën e kurorës, me fjalën e përbashkët të fukahave dhe me tekst, në këtë gjendje gruaja nuk merr asgjë prej shumës së kurorës, përveç dhuratës.

Prej teksteve, në lidhje me këtë çështje kemi ajetin 236 të sures “El-Bekare”:

”لَا جُنَاحَ عَلَيْكُمْ إِنْ طَلَقْتُمُ النِّسَاءَ مَا لَمْ تَمْسُوهُنَّ أَوْ تَفْرِضُوا لَهُنَّ فَرِيضَةً وَمَتَّعُوهُنَّ عَلَى الْمَوْسِعِ قَدَرَهُ وَعَلَى الْمُقْتَرِ قَدَرُهُ مَتَاعًا بِالْمَعْرُوفِ حَقًّا عَلَى الْمُحْسِنِينَ. وَإِنْ طَلَقْتُمُوهُنَّ مِنْ قَبْلِ أَنْ تَمْسُوهُنَّ وَقَدْ فَرَضْتُمْ لَهُنَّ فَرِيضَةً فَوَضَعْنَهَا فَرِيضَةً فَوَضَعْنَهَا مَا فَرَضْتُمْ.”

“Nuk është mëkat për ju nëse i divorconi gratë pa kryer marrëdhënie intime me to dhe, para se t’i divorconi caktoni për to një shumë, ose i pajisni ato, i pasuri sipas mundësisë së tij dhe i varfëri sipas mundësisë së tij; një pajisje e zakonshme është detyrim për punëmirët. Dhe, nëse i divorconi gratë para se të kryeni marrëdhënie intime me to, por keni caktuar për ato

shumën e kurorës, atëherë duhet t'u jepni atyre gjysmën e shumës që kishit caktuar..." (Sure "El Bekare", ajetet 236 - 267)

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: "Kur burri divorcon gruan e tij, para se të kryejë marrëdhënie intime me të, në të vërtetë, gjendja e saj gruaje është bërë e qartë dhe ajo martohet që nga çasti që ai e divorcoi atë. Nëse burri kishte caktuar për atë grua shumën e kurorës, ajo ka të drejtë të marrë vetëm gjysmën e asaj shume. Nëse ai nuk kishte caktuar shumë kurore për të, atëherë ai le t'i bëjë asaj një dhuratë."

Bazuar mbi këtë shpjegim, kur burri nuk i ka paguar gruas asgjë prej shumës së kurorës që ai kishte caktuar për të dhe e divorcon këtë grua, para se të kryejë marrëdhënie intime me të, burri ka detyrim t'i paguajë asaj gjysmën e shumës së kurorës që kishte caktuar për gruan. Nëse burri e ka paguar të plotë shumën e kurorës, burrit i kthehet gjysma e asaj shume dhe, kur si shumë kurore caktohet një send dhe sendi vazhdon të jetë në gjendjen që ishte, ose është asgjësuar, apo është tjetërsuar, kur sendi vazhdon të jetë, burrit i jepet ose gjysma e sendit dhe, kur sendi është asgjësuar, ose është tjetërsuar, burrit i jepet gjysma e një sendi të ngjashëm, ose vlera e gjysmës së sendit.

Sikur shuma e kurorës të mos jetë përmendur në kontratën e martesës dhe të dy bashkëshortët kanë rënë dakord që në vend të shumës të jetë një send, por, pasi janë marrë vesh për këtë çështje, burri e divorcon gruan, para se të kryejë marrëdhënie intime me të, në këtë gjendje, gruas i takon gjysma e sendit për të cilin ata të dy kishin rënë dakord, sepse sendi në fjalë është plotësisht sikur shuma e kurorës të ishte caktuar në kontratë,

ashtu siç e pamë më sipër në paragrafin “Shuma e ngjashme e kurorës”.

Fukahatë më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit “El Xheuahir” se, kur gruaja e shkarkon burrin nga përgjegjësia për të paguar shumën e kurorës dhe më pas burri e divorcon këtë grua, ajo ka të drejtë të kërkojë prej tij gjysmën e shumës së kurorës.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që ka bërë me një grua martesë të përhershme, ose martesë të ndërprerë dhe më pas gruaja e vë shumën e kurorës në ndonjë vend? Si duhet të veprohet?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Kur gruaja e vë shumën e kurorës në ndonjë vend, do të thotë se atë shumë ajo e ka në dorën e saj dhe, nëse burri e divorcon këtë grua, para se të kryejë marrëdhënie intime me të, gruaja i kthen burrit gjysmën e shumës së kurorës.”

Vdekja para kryerjes së marrëdhënieve intime

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se, kur vdes njëri prej dy bashkëshortëve, para se të kryejnë marrëdhënie intime dhe para se burri të caktojë shumën e kurorës për gruan, kësaj gruaje nuk i takon ta marrë shumën e kurorës, por ajo ka të drejtën e trashëgimisë. Gjithashtu, ajo është e detyruar të kalojë kohën e pritjes ligjore, ashtu siç u shpjegua më sipër në paragrafin “Shuma e ngjashme e kurorës”.

Por dijetarët kanë mendime të ndryshme mes e tyre dhe kjo ndryshueshmëri mendimesh vjen për shkak të transmetimeve të ndryshme me të cilat ata kanë punuar. Në disa transmetime thuhet se, kur vdes njëri prej dy bashkëshortëve, pas kryerjes së marrëdhënieve intime dhe, pasi është caktuar shuma e kurorës, gruas i takon e plotë shuma e kurorës. Kjo është e barabartë, qoftë kur burri vdes para gruas, qoftë kur gruaja vdes para burrit.

Një tjetër ka thënë se gruas i takon vetëm gjysma e shumës së kurorës. Një i tretë ka bërë dallim kur gruaja vdes para burrit, në këtë gjendje, ai ka thënë se mbetet detyrim që gruas t'i jepet vetëm gjysma e shumës së kurorës dhe, në qoftë se burri vdes para gruas, për këtë grua bëhet detyrim që ajo të marrë të gjithë shumën e kurorës.

Por thënia me drejtë është: Gruaja nuk ka të drejtë të marrë më shumë se gjysmën e shumës së kurorës. Kjo është e barabartë, qoftë kur gruaja vdes para burrit, qoftë kur burri vdes para gruas. Të gjitha transmetimet që trajtojnë këtë çështje, janë të shkallës "Sahijh", të saktësuara për gradën e vërtetësisë sipas rregullave të përcjelljes së transmetimeve e të njoftimeve dhe janë konsideruar më shumë të saktësuara se transmetimet e tjera që trajtojnë të njëjtën çështje.

Disa fukaha kanë punuar me këto transmetime dhe këta janë një grup prej fukahave të mëdhenj, ndër të cilët sej'jid Ebul Hasan El Asfehanej në librin "El Uesijleh", shejkh Ahmed Kàshiful Gità në librin "Sefijnetu Nexhàt", shejkh Es Saduk në librin "El Mukan'neu". Prej këtij të fundit, ai ka cituar fjalë për fjalë: "Kjo është thënia mbi të cilën unë jam mbështetur dhe me të cilën unë kam dhënë feta."

Gjithashtu, prej këtij grupi fukahash të mëdhenj kemi edhe El Hurr'rr El Amilij, i cili, pasi ka përmendur të gjitha transmetimet që kanë ardhur në lidhje me këtë çështje dhe që ai i ka numëruar dhe ka thënë se janë 25 transmetime, fjalë për fjalë ka thënë: "Nuk është e panjohur fuqia e haditheve që tregojnë për të drejtën e gruas që të marrë gjysmës e shumës së kurorës.

Së pari: Duhet të theksohet se transmetimet që flasin për këtë çështje, janë të shumta, kurse transmetimet që e kundërshtojnë të drejtën e gruas për të marrë gjysmën e shumës së kurorës, janë të pakta.

Së dyti: Përcjellësit e transmetimeve që pohojnë të drejtën e gruas për të marrë gjysmën e shumës së kurorës, janë njerëzit më të ditur e më të besueshëm.

Së treti: Transmetimet e lartpërmendura kanë mbështetje më të fuqishme se transmetimet e dyta.

Së katërti: Transmetimet e para dallohen për fuqinë vërtetuese e për qartësi, kurse transmetimet që i kundërshtojnë transmetimet e para nuk e kanë mbështetjen e fuqishme dhe kanë shkallë mbështetje të dobët.

Gjithashtu, duhet të theksohet edhe pranimi nga ana e këtij autori për t'i komentuar këto transmetime dhe për t'i mbartur ato në gradën e veprimit të pëlqyer (mustehab), domethënë, transmetimet që pohojnë të drejtën e gruas për të marrë vetëm gjysmën e shumës së kurorës, tregojnë se gjysma e shumës së caktuar, ligjërisht është e saktësuar, çka mundëson që edhe për gjysmën e shumës së kurorës lejohet të thuhet shuma e saj e kurorës."

Këtë paragraf po e mbyllim me disa prej këtyre transmetimeve të qarta të shkallës “Sahijh”, që trajtojnë çështjen e të drejtës së gruas për të marrë gjysmën e shumës së kurorës.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për rastin kur gruaja ose burri vdes, para se burri të kryejë marrëdhënie intime me të? A i takon gruas shuma e kurorës dhe sa? Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Cilido që të vdesë, gruas i takon gjysma e shumës së kurorës që ai kishte caktuar për atë grua. Nëse për atë grua nuk është caktuar shumë kurore, asaj nuk i takon asgjë.”

Përcjellësi i këtij transmetimi është Zurareh bin Ajuni, kurse përmbajtja e transmetimit është fjala e Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*): “Cili prej atyre të dyve të vdesë”. Por, fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) nuk pranon komentim.

Në një transmetim të ngjashëm, të përcjellë me fjalët e përcjellësit Ibn Bekijr, prej Ubejd bin Zurares, thuhet: “Pyeta Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*) për një burrë që është martuar me një grua, por që nuk ka kryer marrëdhënie intime me të. Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) m’u përgjigj: “Nëse burri vdes para gruas, ose gruaja vdes para burrit, kësaj gruaje i takon gjysma e shumës së kurorës, por kjo grua ka detyrim të kalojë të plotë kohën e pritjes ligjore. Gjithashtu, kjo grua ka edhe të drejtën e trashëgimisë.”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka vënë shenjën e barazimit mes vdekjes dhe divorcit.

Zhvirgjërimi jo me rrugën e zakonshme

Kur burri e zhvirgjëron gruan e vet me gishtin e tij, ose me ndonjë mjet, ky zhvirgjërim, a është në dispozitën e kryerjes së marrëdhënieve intime në analogji me vërtetimin e të drejtës së gruas për shumën e kurorës dhe për detyrimin e saj që të kalojë kohën e pritjes ligjore, nëse burri pas këtij akti e divorcon atë?

Për sa i përket shumës së kurorës, për burrin mbetet detyrim që t'i paguajë gruas shumën e kurorës, ashtu siç shkruhet në librat e hadithit: Abdullah bin Sinani e ka pyetur Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*) për dënimin që ka burri që sulet mbi gruan dhe i rruan asaj kokën.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: “Ai rrihet dhe burgoset për represion. Nëse flokët mbijnë, atij i merret e njëjta shumë kurore që ai ka paguar për gratë e tij. Në rast se flokët nuk mbijnë, atij i merret shuma e plotë për shlyerjen e vrasjes me qëllim (ed dijetu).”

Ibn Sinani pyeti përsëri: “Përse duhet të paguajë ai të njëjtën shumë kurore që i ka paguar grave të tij, nëse flokët e asaj gruaje rimbijnë?” Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) iu përgjigj: “Flokët e gruas dhe virgjëria, që të dyja janë prej elementeve të bukuri së gruas. Nëse shkon njëra prej këtyre të dyjave, bëhet detyrim që ajo ta marrë të plotë shumën e kurorës.”

Fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Nëse shkon njëra prej këtyre të dyjave, bëhet detyrim që ajo ta marrë të plotë shumën e kurorës”, përfshin edhe prishjen e virgjërisë me gisht dhe me mjet.

Edhe babai i tij, Imam Bakiri (*Paqja qoftë mbi të!*), është pyetur për një burrë që është martuar me një skllave, por atij nuk i kishte ndodhur të kryejë marrëdhënie intime me ndonjë tjetër si me atë, ose ai është martuar me një grua, e cila vaginën e kishte të ngjitur, të cilën ai e divorcon menjëherë pas kryerjes së marrëdhënieve intime. Si duhet të veprohet?

Imam Bakiri është përgjigjur: “Këto dy gra i shikon një grua, te e cila ai ka besim. Në qoftë se gruaja ishte ashtu siç e gjeti ai, ajo ka të drejtë të marrë vetëm gjysmën e shumës së kurorës që burri kishte caktuar për të.”

Kjo do të thotë se, kur gruaja shkon te burri e virgjër dhe përsëri del prej tij e virgjër, ajo ka të drejtë të marrë vetëm gjysmën e shumës së kurorës dhe, nëse del e zhvirgjëruar, domethënë se burri e ka zhvirgjëruar atë me njërin prej shkaqeve, ajo e merr të plotë shumën e kurorës.

Për sa i përket detyrimit që ka kjo grua për të kaluar kohën e pritjes ligjore, për këtë çështje, në mënyrë të prerë, s’ka asnjë argument, sepse koha e pritjes bëhet detyrim për gruan vetëm për shkak të ujit të burrit, ose për shkak të kontaktit, por në rastin konkret, supozohet se nuk kemi as kontakt e as zbrazje uji.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Në të vërtetë, pritja ligjore është prej ujit.”

Kur ai u pyet: “Nëse burri ka hyrë te ajo, por s’ka zbritje uji, si duhet të veprohet?”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Nëse ai ka hyrë, bëhet detyrim gusuli, shuma e kurorës dhe koha ligjore e pritjes.”

Në një transmetim të dytë, ai ka thënë: “Kur takohen dy vendet e synetllëkut, bëhet detyrim shuma e kurorës, koha ligjore e pritjes dhe gusuli.”

Në një transmetim të tretë, ai ka thënë: “Kur ai e fut penisin në vaginën e gruas, bëhet detyrim gusuli, rrahja me kamxhik, ekzekutimi me gjuajtje me gur, si dhe detyrimi për të paguar shumën e kurorës.”

Qëndrimi në vetmi të plotë

Kur burri është në vetmi të plotë me gruan e tij, në atë mënyrë që atë asgjë nuk e pengon që të kryejë marrëdhënie intime më të, megjithëkëtë ai nuk kryen marrëdhënie intime, ky qëndrim në vetmi a ka ndonjë ndikim në raport me shumën e kurorës ose me kohën ligjore të pritjes?

Shumica e fukahave kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit “El Mesalik” se bazë merret hyrja faktikisht dhe realisht, kurse qëndrimi në vetmi, në mënyrë absolute, s’ka asnjë efekt, ashtu siç është përmendur në fjalën e Allahut të Lartësuar, që pamë më sipër:

“لَا جُنَاحَ عَلَيْكُمْ إِنْ طَلَقْتُمُ النِّسَاءَ مَا لَمْ تَمْسُوهُنَّ”

“Nuk është mëkat për ju nëse i divorconi gratë pa kryer marrëdhënie intime me ato...”

Komentuesit e Kuranit ndajnë një fjalë të përbashkët se fjala e Kuranit “lem tumes’suhun’ne” ka kuptimin e kryerjes së marrëdhënieve intime. Duke u bazuar mbi këtë, rezulton se qëndrimi në vetmi s’ka asnjë ndikim, edhe nëse ai e prek gruan, por nuk kryen marrëdhënie intime me të.

Në lidhje me këtë çështje, prej Ehli Bejtit (*Paqja e Allahut qoftë mbi ta!*) kanë ardhur transmetime të shumta.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që, pasi ka bërë martesën, ka mbyllur derën, ose ka ulur perden, në këtë mjedis të vetmuar ai e ka prekur dhe e ka puthur gruan. Pastaj e divorcon. A bëhet detyrim shuma e kurorës për këtë rast? Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Shumën e kurorës nuk e bën detyrim asgjë tjetër përveç hyrjes te gruaja.”

Në një transmetim të dytë, ai ka thënë: “Ai ka detyrim të paguajë vetëm gjysmën e shumës së kurorës.”

Transmetimet që tregojnë qartë se qëndrimi në vetmi e bën detyrim shumën e kurorës, i kanë mbartur në transmetimet që tregojnë kur qëndrimi në vetmi, është shoqëruar me kryerjen e marrëdhënieve intime, si dhe me transmetimet që tregojnë se thjesht qëndrimi në vetmi, nuk ka asnjë ndikim.

Konflikti

1- Kur të dy bashkëshortët kanë mosmarrëveshje, nëse i takon apo nuk i takon gruas e drejta për të marrë shumën e kurorës, në rastin kur burri thotë: “Ajo, që në bazë, nuk ka të drejtë ta marrë shumën e kurorës.”, ndërsa gruaja thotë: “Jo, ai ka

detyrim ta paguajë shumën e kurorës.”, në këtë gjendje, shikohet: Nëse burri akoma nuk ka kryer marrëdhënie intime me atë grua, merret në konsideratë fjala e burrit, por burri ka detyrim të betohet.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Pa asnjë kundërshtim, për shkak të mundësisë, që në tekstin e kontratës së martesës të mos jetë shënuar shuma e kurorës. Por unë e di se caktimi i shumës së kontratës në kontratë, nuk vihet në konsideratë për vlefshmërinë e kontratës.”

Domethënë është e lejueshme që kontrata të bëhet edhe pa e përmendur shumën e kurorës. Gjithashtu, është e lejueshme që kontrata e martesës të bëhet edhe kur në tekstin e saj përmendet shuma e kurorës. Duke vlerësuar rastin e parë, burri nuk rezulton të jetë përgjegjës për të paguar shumën e kurorës, ashtu siç u tha më sipër, kurse, duke vlerësuar të dytën, burri rezulton të jetë përgjegjës për të paguar shumën e kurorës. Në këtë gjendje, dyshimi i referohet dyshimit, nëse është kërkesë apo nuk është kërkesë, që në kontratën e martesës të caktohet shuma e kurorës, por në origjinë kemi mospërgjegjësinë.

Në rastin kur burri ka kryer marrëdhënie intime me gruan dhe ka depozituar një shumë që nuk është më tepër se shuma e ngjashme e kurorës, për gruan vendoset ta marrë këtë shumë dhe nuk parashikohet që kjo shumë mund të mohohet, sepse shuma e kurorës, në të gjitha rastet, është e vërtetuar për shkak të kryerjes së marrëdhënieve intime. Kjo është e barabartë, qoftë kur burri ka caktuar shumë kurore për gruan, qoftë kur nuk ka caktuar.

2- Kur të dy bashkëshortët kanë mosmarrëveshje në lidhje me hyrjen e burrit te gruaja dhe gruaja thotë se nuk ka hyrë, me qëllim që të vërtetojë për veten e saj të drejtën e bojkotimit të burrit, derisa të marrë në dorë shumën e kurorës të përshpejtuar. Ndërkaq burri thotë: “Kam hyrë.”, me qëllim që të vërtetojë se bojkotimi nga ana e gruas është pa justifikim ligjor; ose burri thotë: “Nuk kam hyrë.”, me qëllim që, për shkak të divorcit, prej tij të rrëzohet detyrimi për gjysmën e shumës, ndërsa gruaja thotë: “Ka hyrë.”, me qëllim që të vërtetojë të drejtën e saj për të marrë të plotë shumën e kurorës, si dhe shpenzimet përgjatë kohës së pritjes ligjore, në këtë gjendje, merret në konsideratë fjala e atij që mohon hyrjen e burrit te gruaja. Kjo është e barabartë, qoftë kur mohuesi është burri, qoftë kur mohuese është gruaja, pra veprohet në përputhje me rregullin: “Pretenduesi ka detyrim të sjellë argument dhe mohuesi ka të detyrim të betohet”, me përjashtim të rastit kur pretenduese është gruaja, ose burri pretendon hyrjen te gruaja dhe gruaja ishte e virgjër.

Në këtë gjendje, zbulimi i të vërtetës bëhet prej grave me përvojë, ose prej mjekut specialist. Fjala e grave, ose diagnostikimi i mjekut e ndërpret konfliktin. Në qoftë se diagnostikimi nga ana e mjeku rezulton që gruaja vazhdon të jetë e virgjër dhe prej fjalës së tij arrihet siguria e plotë, refuzohet pa betim fjala e atij që pretendon hyrjen e burrit në gruan.

3- Të dy bashkëshortët kanë mosmarrëveshje në lidhje me caktimin e shumës së kurorës në tekstin e kontratës. Njëri prej tyre thotë: “Kontrata është bërë së bashku me shumën e saktë të kurorës.” Tjetri thotë: “Jo, kontrata është bërë pa e përmendur shumën e kurorës.” Në këtë gjendje, ai që pretendon caktimin e

shumës së kurorës, duhet të sjellë argument, kurse ai që mohon, ka detyrim të betohet.

Kur gruaja pretendon caktimin e shumës së kurorës dhe burri e mohon, madje burri betohet se shuma e kurorës nuk është përmendur në tekstin e kontratës së martesës, duke ditur se gruaja është e pafuqishme të vërtetojë pretendimin e saj, kësaj gruaje i jepet shuma e ngjashme e kurorës që zakonisht jepet pas kryerjes së marrëdhënieve intime, me kusht që shuma e ngjashme të mos jetë më tepër nga sa pretendon ajo. Për shembull, sikur gruaja të thotë se kontrata e martesës është bërë me dhjetë dhe burri e mohon, në një kohë që shuma e ngjashme e kurorës është njëzetë, gruas i jepen vetëm dhjetë, sepse u veprua sipas pohimit të saj, për rrjedhojë, kjo grua nuk ka të drejtë të marrë më tepër. Në rastin kur shuma e ngjashme e kurorës është dhjetë dhe gruaja thotë se kontrata është bërë me njëzetë, asaj i jepen dhjetë.

4- Burri e gruaja bien dakord që shuma e kurorës është caktuar, por kanë mosmarrëveshje për sasinë dhe gruaja thotë dhjetë, kurse burri thotë pesë. Shumica e fukahave kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit “El Xheuahir” se merret në konsideratë fjala e atij që mohon shtesën, sepse, si origjinë, është mospasja shtesë, derisa të vërtetohet e kundërta.

Imam Bakiri, babai i Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), është pyetur për një burrë që është martuar me një grua dhe nuk ka kryer marrëdhënie intime me të. Ndërkaq gruaja pretendon se shuma e saj e kurorës është njëqind dinarë, por burri ka përmendur se shuma e saj e kurorës është pesëdhjetë. Gruaja nuk ka argument që të vërtetojë pretendimin e saj. Ky autor është

shprehur: “Merret në konsideratë fjala e burrit, krahas betimit të tij.”

5- Të dy bashkëshortët kanë mosmarrëveshje në lidhje me marrjen e shumës së kurorës. Gruaja thotë: “Nuk e kam marrë.” Burri thotë: “Jo, e ka marrë.” Në këtë gjendje, merret në konsideratë fjala e gruas, sepse origjina është mosmarrja, derisa të vërtetohet e kundërta, kurse burri ka detyrim të sjellë argument, sepse ai është pretendues.

Në lidhje me këtë çështje, nuk ka dallim nëse konflikti ka ndodhur para apo pas kryerjes së marrëdhënieve intime.

Pyetje: Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur në lidhje me këtë konflikt dhe ka thënë: “Kur ajo shkon te ai, hyn mes tij dhe pas kësaj ajo kërkon, për atë grua s’ka asgjë, sepse ajo shumë kurore është e tepërt për të. Në këtë gjendje, burri betohet në Allahun se për atë grua nuk ka shumë kurore, as pak e as shumë.”

Ky transmetim tregon jo tekstualisht se, në këtë rast, a merret në konsideratë fjala e burrit, kur ai ka kryer marrëdhënie intime me atë grua, në të njëjtën kohë lë të kuptohet se në konsideratë merret fjala e gruas, kur burri akoma nuk ka kryer marrëdhënie intime me të.

Përgjigje: Një grup fukahash, ndër të cilit edhe autori i librit “El Xheuahir”, kanë thënë: “Në kohët e mëparshme ishte zakon që gruaja nuk çohet në shtëpinë e burrit të saj pa marrë në dorë shumën e përshpejtuar të kurorës.”

Ky transmetim dhe transmetime të tjerë të ngjashme janë në pozitën e zakonit, kurse në ditët e sotme për këtë zakon s'ka asnjë ndikim prandaj del detyrim të punohet me origjinën, domethënë mosmarrja e shumës së kurorës, derisa të vërtetohet e kundërta.

6- Të dy bashkëshortët bien dakord, që gruaja ka marrë diçka prej burrit, por më pas, mes tyre, kanë lindur mosmarrëveshje dhe gruaja thotë se shuma që ajo ka marrë, ishte dhuratë, kurse burri thotë se paratë që ajo mori, ishin prej shumës së kurorës. Në këtë gjendje, merret në konsideratë fjala e burrit, derisa të vërtetohet e kundërta, sepse burri e di më mirë nijetin që kishte.

Kjo është kur nuk ka krahasues aktualë prej zakonit të traditës, që e bëjnë të detyrueshëm besueshmërinë, ose kur nuk kemi krahasues prej gjendjeve të veçanta të burrit, që tregojnë se ajo shumë ishte dhuratë, si për shembull, ishte diçka që hahej, ose një rrobë, ose "shenjë" siç e quajnë libanezët, kurse egjiptianët e quajnë "dhuratë e të fejuarit për të fejuarën" që mund të jetë një unazë, ose diçka e ngjashme që i fejuari i dhuron të fejuarës së tij.

Nëse çështja qëndron kështu siç u përshkrua, merret në konsideratë fjala e gruas dhe jo fjala e burrit.

Bazuar mbi sa u tha, sendi objekt konflikti merret në dispozitën e dhuratës dhe kjo dhuratë nuk lejohet të kërkohet, pasi është marrë në dorë dhe, pasi marrëdhëniet bashkëshortore janë ndërtuar, ashtu siç është shpjeguar në pjesën e katërt, në kapitullin "Dhurata", në paragrafin "A lejohet kontrata me dhuratë?".

Nëse burri e ka bërë dhuratën për gruan para bërjes së kontratës së martesës, ai ka të drejtë të kërkojë që ajo t'ia kthejë dhuratën, nëse ajo dhuratë vazhdon të jetë te ajo, nëse gruaja nuk ka vepruar me atë dhuratë, duke e shitur, ose duke ia dhuruar dikujt, ose duke e tjetërsuar në ndonjë formë tjetër, me kusht, që të mos jetë e atillë që ajo dhuratë nuk lejohet të kërkohet.

* * *

←—————→ **DY BASHKËSHORTËT DHE PAJISJET** ←—————→

←—————→ **E SHTËPISË** ←—————→

Dy vetë banojnë në të njëjtën banesë, ku detyrimisht ka disa pajisje e mjete të tjera, por më pas ata kanë mosmarrëveshje për ndonjë send prej këtyre pasjeve e mjeteve dhe, secili prej atyre të dyve pretendon se ai send i takon atij. Mosmarrëveshje të kësaj natyre mund të kenë edhe dy bashkëshortët për të gjitha pajisjet e për mjetet e tjera të shtëpisë, ose bashkëshortët kanë mosmarrëveshje për një pjesë të tyre.

Po japim një shembull për ta ilustruar: Një zdrukthëtar e një rrobaqepës rrinë në të njëjtin dyqan dhe më pas kanë mosmarrëveshje në lidhje me disa pajisje e mjete të dyqanit. Nëse puna qëndron kështu siç u shtrua, rezulton që problemi mes tyre është prej kapitullit “Pretendues e mohues”, domethënë se pretenduesi ka detyrim të sjellë argument, kurse mohuesi ka detyrim të betohet; ose problemi mes dy vetëve që kanë konflikt, trajtohet sipas kapitullit “Të dy ortakët janë pretendues”, domethënë se çdonjëri prej tyre është edhe pretendues, edhe mohues, për rrjedhojë, secili ka detyrim të sjellë argument dhe të

betohet, ashtu siç veprohet mes dy pretenduesve. Si duhet të veprohet në këto raste?

Përgjigje: Kur i referohemi rregullave që kanë gjetur miratim, do të gjejmë se mohues është njëri prej atyre të dyve: ose është ai fjala e të cilit përputhet me origjinën, ose është ai që e ka sendin në dorë, kurse pretenduesi është e kundërta e të dyve, domethënë ai nuk është as ai që e ka sendin në dorë dhe as fjala e të cilit përputhet me origjinën. Për sa i përket traditës dhe zakonit, mbi ato nuk mund të mbështetesh për asgjë, përveçse kur sillet një argument i veçantë, i cili duhet të merret në konsideratë dhe me ekzistencën e këtij argumenti të veçantë, puna reduktohet duke u bazuar në origjinën e atij argumenti, sepse dispozitat ligjore nuk merren as prej traditës e as prej zakoneve të njerëzve.¹

Natyrisht që traditës e zakoneve i referohemi për të njohur objektin nga ana e jashtme, me të cilin ka lidhje dispozita ligjore, si për shembull, shpallja e verës haram është marrë prej tekstit të Ligjvënësit, kurse për specifikimin e verës, nga ana e jashtme dhe dallimin e saj prej lëngjeve të tjerë, i referohemi traditës dhe njerëzve me përvojë. Bazuar mbi këtë specifikim, ana e jashtme mund të jetë me pretenduesin dhe jo me mohuesin, por siç mund të jetë me mohuesin dhe jo me pretenduesin.

Padyshim që për këtë s'ka bazë këtu, prandaj mund të jetë në përputhje me njërën palë dhe të mos jetë në përputhje me palën tjetër, në atë mënyrë që, kur origjina është më njërin, ai është

¹ Ndodh që dispozita ligjore të përftohet prej traditës së njerëzve, pasi edhe në kohën e Imamit të ruajtur prej mëkateve dhe me opinionin e tij, nuk është dëgjuar që ai ta ketë ndaluar këtë. Me një fjalë, tradita nuk është argument, përveçse me lejimin nga ana e Ligjvënësit, qoftë kur lejimi shprehet në përmbajtje, qoftë kur lejimi është shprehur qartë.

mohues, kurse ai që e kundërshton origjinën, është pretendues. Kur ne themi se origjina është që kjo pajise të mos jetë pronë e burrit, fjala jonë është në kundërshtim me origjinën që të mos jetë pronë për gruan, pra, nuk është në favor të njëres origjinë dhe në dëm të origjinës tjetër, pa bërë asnjë dallim mes asaj që i shërben vetëm njërit prej atyre të dyve dhe mes asaj që sendi i shërben të dyve, pasi ne kemi thënë: “Ana e jashtme nuk shërben për t’u mbështetur në atë.” Kështu qëndron edhe analogjia në lidhje me zdrukthëtarin e rrobaqepësin.

Sikur ne të shprehemi ashtu siç ka thënë njëri prej fukahave se ai send që u shërben vetëm grave, ai send i takon gruas dhe, sendi që u shërben vetëm burrave, ai send i takon burrit, sendi që u shërben të dyve, duke gjykuar nga ana e jashtme e sendit, që të dy janë të barabartë. Sikur të shprehemi kështu siç u tha më lart, do të duhej të themi ashtu siç u shtrua.

Kur një burrë ka konflikt me një grua të huaj (për atë burrë) për ndonjë send, të cilin asnjëri nuk e ka në dorë, gjithashtu, ata të dy nuk banojnë në të njëjtën banesë, në atë mënyrë që, kur sendi objekt grindje është i atillë që i shërben vetëm grave, në këtë gjendje, gruaja është mohuese dhe burri është pretendues. Nëse sendi objekt grindje u shërben të dyve, për shembull, grinden për një sharrë, ose njëri prej atyre të dyve është zdrukthëtar dhe tjetri rrobaqepës dhe asnjë nuk e ka në dorë atë objekt, gjithashtu, ata nuk rrinë në të njëjtin mjedis, në këtë gjendje, zdrukthëtari është mohues dhe tjetri është pretendues, megjithëse për këtë çështje nuk është shprehur askush përveç imamive.¹

¹ Në pjesën e katërt të librit “El Furûk” –“Dallimet”, në “Dallimi 232” thuhet: “Sikur të kenë konflikt një gjykatës dhe një ushtar për një shigjetë, në këtë

Atëherë s'ka mbetur gjë tjetër përveçse të themi se, kur një send prej pajisjeve të shtëpisë është gjithmonë, ose më të shumtën e kohës në dorën e njërit prej dy bashkëshortëve, ai që e ka sendin në dorë është mohues, kurse tjetri është pretendues. Kur ata të dy kanë konflikt për bizhuteri ose për rroba që i vesh vetëm gruaja dhe ajo i ka përdoruar ato, veprohet sipas fjalës së gruas, krahas betimit të saj, për shkak se ai send i shërben vetëm grave.

Kur të dy bashkëshortët grinden për një çallmë, ose për armë që i ka përdorur e i përdor burri, veprohet sipas fjalës së burrit, krahas betimit të tij, për shkak se ato janë në dorën e tij dhe për faktin se ato i shërbejnë vetëm burrit.¹

Nisur nga ky shtrim i çështjes, ne themi: Kur mosmarrëveshja mes atyre të dyve ndodh për bizhu, të cilën gjithmonë e përdor gruaja dhe e kanë të dy, vetëkuptohet që në këtë bizhu të dy janë të barabartë, madje edhe nëse ky objekt do të gjendej në arkën e burrit, i cili mban edhe çelësat e kësaj arke, domethënë që këtë arkë e përdor vetëm ai dhe askush tjetër, domethënë objekti është në dorën e burrit. Në këtë gjendje, merret në konsideratë fjala e burrit dhe jo fjala e gruas. Gjithashtu, kur një armë gjendet në arkën personale të gruas, merret në konsideratë fjala e gruas, për faktin se ajo e ka sendin në dorën e saj. Në këtë

gjendje, gjykatësi është pretendues, por edhe ushtari është pretendues kundër atij. Më pas çështjen e ka komplikuar ai që ka thënë: "Sikur të pretendojë Ebu Bekri kundër njeriut më mëkatar, do të duhet që Ebu Bekri të ishte mohues."

¹ Bazuar nga sa u tha, ne i mbartin hadithet që i ndajnë sendet në sende për gratë e në sende për burrat, madje kjo ndihet edhe në librin "Muvethik Junes", ku thuhet: "Sendet që janë të veçanta për gratë, i takojnë gruas, sendet që janë të përbashkëta si për burrat, ashtu edhe për gratë, i takojnë atij që e ka në zotërim." Fjala e Imamit "...ai që merr në zotërim...", tregon qartë pasjen e sendit në dorë.

gjendje, jemi para faktit, kur sendi është në dorën e atij që nuk i shërben.

Për sa i përket sendit që nuk është as në dorën e njërit e as në dorën e tjetrit si send personal, si për shembull, një radio, të cilën e dëgjojnë të dy, ose një orë muri, prej së cilës përfitojnë të dy, apo tryeza e ngrënies, ku ata të dy marrin ushqimin, të gjitha këto pajisje dhe të tjera të ngjashme, në këto sende, të dy janë të barabartë.

Më sipër u njohëm me çështjen e zdrukthëtarit e të rrobaqepësit që rrinin në të njëjtin dyqan dhe për zdrukthëtarin gjykohet se i takon sharra, kurse rrobaqepësit i takon gjilpëra, për faktin se çdo njëri prej atyre të dyve ka në dorë mjetin përkatës të profesionit. Në këtë gjendje, dobia që vjen prej atij sendi, si dhe specialiteti i sendit s'kanë asnjë ndikim. Sikur të supozohet se në punishte është një sharrë, të cilën nuk e ka në dorë përgjithmonë, ose në shumicën e rasteve njëri prej atyre të dyve dhe e ka tjetri, në rast konflikti mes tyre, që të dy janë të barabartë në atë sharrë.

Nëse këtë çështje e trajtojmë sipas traditës, mësojmë se, kur dy vetë që rrinë në të njëjtin dyqan, kanë mosmarrëveshje për ndonjërin prej sendeve të dyqanit, në qoftë se atë send e përdor njëri dhe nuk e përdor tjetri, sendi i takon atij që e ka në dorë dhe jo ai tjetrit që e përdor, por patjetër krahas betimit të tij.

Duke ditur se që të dy janë pretendues dhe, nëse njëri prej atyre të dyve sjell argument dhe nuk sjell tjetri, sendi i takon atij që sjell argumentin.

Në qoftë se të dy sjellin argumente, në këtë gjendje, sendi ndahet mes atyre të dyve. Në qoftë se sendi nuk është i atyre të dyve, ose nuk është i njërit prej atyre të dyve, që të dy betohen dhe e ndajnë sendin mes tyre. Në qoftë se betohet vetëm njëri prej

atyre të dyve, kurse tjetri nuk pranon të betohet, në këtë gjendje, sendi i takon atij që u betua.

Për mua, para studimeve që kisha kryer dhe pas kërkimeve që kisha bërë, besoja në hollësitë e rregullit: “Mes sendit që shërben dhe sendit që nuk shërben”, pavarësisht se në dorën e kujt është sendi, por më pas u ktheva te rregulli i pasjes së sendit në dorë, pavarësisht nëse sendi i shërben ose nuk i shërben atij që e ka në dorë.

Ndjekësit e medh’hebit hanbelij, si dhe shumica e ndjekësve të medh’hebit imamij kanë thënë se sendet që u shërbejnë burrave, si çallmat, këmishët, rrobat e trasha të sipërme, kësulata e armët, këto sende i takojnë burrit, patjetër krahas betimit të tij. Kurse sendet që u shërbejnë grave, si: bizhuteritë, fustanet, apo veshje të brendshme grash, këto sende i takojnë gruas, patjetër krahas betimit të saj. Në lidhje me sendet që u shërbejnë të dyve, si shtrojat dhe enët, këto pajisje u takojnë të dyve.

Ndjekësit e medh’hebit hanefi kanë thënë se, për sa i përket sendit që është në dorën e njërit prej atyre të dyve, ai send i takon atij që e ka në dorë, patjetër krahas betimit të tij, kurse sendet që janë të përbashkëta, i takojnë vetëm burrit, patjetër krahas betimit të tij.

Ndjekësit e medh’hebit malikij kanë thënë se sendi që u shërben vetëm grave, ai send i takon gruas, sendi që u shërben burrave dhe grave, ai send i takon burrit, për faktin se dora e burrit është më e fuqishme se dora e gruas (libri “El Mugnij”, kapitulli “Gjykimet”).

* * *

PËRKASTËSIA FAMILJARE

(gjenealogjia)

Fëmija i atashohet burrit për shkak të martesës, ose për shkak të një marrëdhënie intime të dyshimtë, krahas kujdesit për kushtet e mëposhtme:

Marrëdhëniet intime, shtrati dhe rregulli i mundësisë

Kontrata e martesës i heq ndalimet e pengesat që ishin mes burrit e gruas para kontratës dhe mundëson lejimin e kryerjes së marrëdhënieve intime mes atyre të dyve. Gjithashtu, kontrata e martesës lejon për ata të dy pasojat që vijnë prej marrëdhënieve intime. Por kontrata e martesës, thjesht si kontratë, nuk është shkak i plotë për t'i atashuar fëmijën burrit, pasi burri, patjetër duhet të kryejë marrëdhënie intime me gruan. Qëllimi i përdorimit të fjalës “shtrati” në hadithin: “Fëmija është i shtratit dhe kurvari është për gurin” (ekzekutohet me gjuajtje me gur), është qëllimi që burri e gruaja të kryejnë marrëdhënie të plota intime, ose thënë ndryshe, ky hadith komenton fjalën e Allahut të Lartësuar:

“هَٰؤُلَاءِ لَيَأْسُ لَكُمْ وَأَنْتُمْ لَيَأْسُ هَٰؤُلَاءِ”

“...ato janë mbulojë për ju (ruajnë nderin) dhe ju jeni mbulojë për ato...” (Sures “El Bekare”, ajeti 187)

Bazuar mbi këtë shpjegim, fëmija nuk i atashohet burrit, thjesht ngaqë ai është burri dhe me kaq mjafton. Jo, që burrit t’i atashohet fëmija, ai patjetër duhet të konsumojë realisht dhe të plota marrëdhënie intime me gruan e tij.

Kontaktimi dhe kryerja e marrëdhënieve intime, s’kanë nevojë as për shpjegim e as për koment, por a e bën të detyrueshëm çdo kontaktim atashimin e fëmijës burrit, apo fëmija i atashohet atij vetëm krahas një kontaktimi të veçantë? Përgjigjen për këtë pyetje do ta marrim në sqarimet vijuese:

Së pari: Burri, patjetër duhet të fusë penisin dhe të derdhë spermën në brendësi të vaginës. Në këtë gjendje, nuk ka asnjë dyshim që fëmija i atashohet burrit.

Së dyti: Nuk arrihet hyrja, por uji i burrit derdhet mbi vaginë. Me këtë derdhje fëmija i atashohet burrit, njëlloj sikur të kishte derdhur ujin e tij brenda në vaginë, për faktin se uji mund të kalojë në brendësi, pa e ndier fare këtë fakt asnjëri prej dy bashkëshortëve.

Fukahatë kanë rënë në pajtim mbi një rregull të përgjithshëm, të cilin e kanë emërtuar “Rregulli i mundësisë së atashimit” që është: “Çdo veprim që mundëson atashimin e fëmijës burrit, është detyrë që me atë të atashohet edhe me ligjin e fesë.”

Kur gjykatësi ka dijeni për këtë mundësi, ai merr vendim pa qenë nevoja të kërkohej vërtetim, sepse argumenti mbështetës i këtij rregulli është hadithi: “Fëmija është i shtratit”. Hadithi tregon se çdo fëmijë është i shtratit, derisa të vërtetohet e kundërta.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Një burrë erdhi te Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe i tha: ‘Kjo është gruaja ime dhe është shtatzënë. Është vajzë tepër e re, është e virgjër dhe tani na rezulton shtatzënë në muajin e nëntë. Për këtë unë di vetëm të mirën. Unë vetë jam plak i moshuar dhe nuk e kam prekur. Por ja që kjo është në këtë gjendje.’

Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) i tha atij: “Po të kujtoj Allahun, a e ke derdhur ujin ndonjëherë mbi vaginën e saj?” Plaku tha: “Po. Atëherë Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: “Fëmijën e saj unë ta atashoj ty.”

Padyshim që, në radhë të parë, për atashimin e fëmijës burrit, qëndron fakti se burri e ka futur penisin në vaginën e gruas, edhe pse më pastaj e ka derdhur ujin jashtë vaginës. Në lidhje me këtë gjendje, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Erdhi një burrë te i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe i tha: ‘Jam sprapsur prej një robëreshë që kam, por ajo na vjen me një fëmijë.’ I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) i tha: “Mbështetja sipër mundëson që ty të shpëtojë.” Kështu i atashoi atij fëmijën.

Së treti: E fut të gjithë, ose një pjesë të penisit, në atë mënyrë që takohen dy vendet e synetllëkut, por nuk derdh spermë. Edhe në këtë gjendje, fëmija i atashohet burrit, sepse

kuptimi i shtratit, ashtu siç thamë më sipër, do të thotë kryerja e marrëdhënieve intime dhe supozohet që burri kryen marrëdhënie intime me gruan.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Lindja është e mundur prej burrit me hyrjen e tij, edhe nëse nuk ka derdhje sperme, sepse ndodh që të vihet në lëvizje vezorja e gruas dhe ajo të ketë lidhje me spermatozoidin e burrit në vendin e vet, ose edhe pa këtë veprim, për shkak të ndonjë urtësie, për të cilën ka dijeni vetëm i Madhërishmi, Fuqiploti. Pikërisht për këto shkaqe është thënë që fëmija është i shtratit dhe, siç u shpjegua më sipër, me fjalën “shtrat” kuptohet kryerja realisht e marrëdhënieve intime burrë-grua.”

Në tërësi, thjesht bërja e kontratës së martesës nuk e bën të detyrueshme atashimin e fëmijës, nëse krahas kontratës mungon njëri prej dy veprimeve nga ana e burrit: ose hyrje e penisit në vaginën e gruas, edhe kur nuk ka derdhje të spermës, ose derdhje e spermës jashtë mbi vaginë edhe pa hyrje. Kur realizohet njëri prej këtyre dy veprimeve, nuk mund të mohohet që fëmija t’i atashohet burrit, me përjashtim të rastit të mallkimit të ndërsjellë, për të cilën, me lejen e Allahut, do të flasin në pjesën e gjashtë të këtij libri.

Koha më e paktë e shtatzënisë

Kushti i dytë për atashimin e fëmijës burrit është që të kalojnë gjashtë muaj që nga koha e kryerjes së marrëdhënieve intime, ose që nga koha kur ai ka derdhur ujin e tij mbi vaginën e

gruas. Me fjalën e përbashkët të fukahave dhe me tekst, gjashtë muaj është koha më e paktë e shtatzënisë.

Prej teksteve kemi fjalën e Allahut të Lartësuar, në ajetin 15, të sures “El-Ahkaf”, ku tekstualisht thuhet se shtatzënia dhe ushqimi me gji i fëmijës zgjat tridhjetë muaj:

“وَحَمْلُهُ وَفَصَالُهُ ثَلَاثُونَ شَهْرًا”

“...shtatzënia e gjdhënia e fëmijës zgjat tridhjetë muaj...”

Gjithashtu, është edhe ajeti 14 i sures “Lukman”, ku tekstualisht thuhet se gjdhënia është dy vjet të plota:

“وَفَصَالُهُ فِي عَامَيْنِ”

“...ndarja e tij (fëmijës) prej gjirit është dy vjet...”

Siç shihet, argumenti është i përbërë prej dy ajeteve dhe, nëse bëjmë zbritjen e dy vjetëve, prej tridhjetë muajve, na mbeten nëntë muaj. Me fjalën e përbashkët të fukahave, nëntë muaj është koha më e paktë e shtatzënisë, fakt që e ka pohuar dhe e mbështet edhe mjekësia moderne.

Prej Ehli Bejt (Paqja e Allahut qoftë mbi ta!) vërtetohet se koha më e vogël e shtatzënisë është gjashtë muaj dhe koha me e gjatë e shtatzënisë është një vit.

Koha më e gjatë e shtatzënisë

Kushti i tretë për atashimin e fëmijës, është që koha e shtatzënisë të mos jetë më e gjatë se sa koha më e gjatë e saj, madje

fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se koha e shtatzënisë nuk është më shumë se një vit, qoftë edhe një orë më shumë. Bazuar mbi këtë rregull, kur burri e divorcon gruan, ose burri vdes dhe gruaja lind pas një viti, qoftë edhe një orë më shumë se një vit, ai fëmijë nuk i atashohet burrit.

Fukahatë kanë kundërshtime mes tyre, në lidhje me caktimin e kohëzgjatjes së shtatzënisë. Fukahatë më të dëgjuar kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit “El Xheuahir, i cili është shprehur se shtatzënia zgjat nëntë muaj.

Fukaha të tjerë kanë thënë se shtatzënia zgjat dhjetë muaj, kurse Sherijf El Murtezà, Ebu S’alàh dhe Dëshmori i dytë kanë preferuar të thonë se shtatzënia zgjat një vit të plotë. Për këtë fjalë ata mbartin transmetimet që tregojnë se shtatzënia, në të shumtën e herëve, zgjat nëntë muaj. Dëshmori i dytë, në librin “El Mesalik”, ka thënë: “Ibn Hakijm ka transmetuar prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), se ai është pyetur në lidhje me gruan e divorcuar prej burrit të saj dhe gruaja thotë: “Jam shtatzënë, madje ajo qëndron shtatzënë një vit.”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) tha: “Nëse ajo lind qoftë edhe vetëm një orë më shumë se një vit, ajo grua nuk besohet në pretendimin e saj.”

Më pas, Dëshmori i dytë ka thënë: “Kjo është fjala më afër së vërtetës së plotë, pasi nuk ka ardhur argument që mund të merret në konsideratë që të vërtetojë se koha më e gjatë e shtatzënisë është më pak se një vit. Veç kësaj, edhe shoqërimi i dispozitës së kësaj fjale me dispozitën e shtratit, është dispozita

më e drejtë, edhe pse në shumicën e rasteve ka kundërshtime, por në kohën tonë kanë ndodhur raste që e vërtetojnë këtë që thamë.

Fëmija prej marrëdhënieve intime të dyshimta

Marrëdhënie intime të dyshimta kemi kur burri kontakton me një grua e cila është e ndaluar për të, por ai nuk ka dijeni për këtë ndalim. Dyshimi është dy kategori: dyshim në kontratë, krahas kryerjes së marrëdhënieve intime dhe dyshim në kryerjen e marrëdhënieve intime, pa bërë kontratën e martesës.

Dyshim në kontratën e martesës kemi kur bëhet kontrata për martesën e një burri me një grua dhe më pas rezulton se ajo kontratë është e prishur, për shkak të ndonjërit prej shkaqeve që e bëjnë prishjen të detyrueshme.

Dyshim në kryerjen e marrëdhënieve intime pa kontratën e martesës, kemi kur burri kontakton me një grua pa pasur mes atyre të dyve një kontratë martese të vlefshme dhe jo kontratë të prishur. Veç kësaj burri, beson se ajo grua është e lejuar për të, por më pas bëhet e qartë e kundërta. Në këtë kategori hyjnë kryerja e marrëdhënieve intime prej të çmendurit, të dehurit dhe prej atij që është në gjumë me një grua të huaj për të.

Fëmija prej marrëdhënieve të dyshimta intime është plotësisht ligjor dhe mes tij e mes fëmijës që lind prej një martese të vlefshme, s'ka asnjë dallim. Kjo është e barabartë, qoftë kur dyshimi është dyshim në kontratë, qoftë kur është dyshim në veprim, prandaj kur dyshuesi e largon prej vetes fëmijën, largimi që ai bën, nuk merret në konsideratë dhe ai detyrohet ta pranojë

fëmijën, kur vërtetohen tri kushtet e mësipërme, që ishin: ose hyrja te gruaja, ose derdhja e spermës mbi vaginën e gruas dhe shtatzënia vazhdon më e pakta gjashtë muaj, por as shtyrja e kohës së shtatzënisë më shumë se koha me gjatë e saj.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që martohet me një grua që është duke kaluar kohën e pritjes ligjore. Si duhet të veprohet në këtë rast? Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Bëhet ndarja mes atyre të dyve dhe gruaja kalon vetëm një kohë pritje për të dy burrat. Nëse gruaja lind fëmijën për gjashtë muaj, ose për më shumë, domethënë duke llogaritur kohën që nga koha e kryerjes së marrëdhënieve intime me burrin e dytë, fëmija është i burrit të dytë. Nëse gruaja lind në më pak se gjashtë muaj, fëmija është i burrit të parë.”

Autori i librit “Esh Sheràiu” dhe “El Xheuahir” ka thanë: “Sikur një grua të martohet, duke kujtuar se s’ka pengesa që e ndalojnë të martohet, ose ajo kujton se i ka vdekur burri, ose kujton se burri e ka divorcuar, por më pas bëhet e qartë se burri as nuk ka vdekur e as nuk e ka divorcuar, kjo grua, në mënyrë të prerë, i kthehet burrit të parë, vetëm pasi të kalojë kohën e pritjes ligjore për shkak të martesës me burrin e dytë, i cili e ka bërë detyrim që martesa e tij të jetë e dyshimtë. Në këtë gjendje, fëmija i atashohet burrit të dytë, krahas arritjes së kushteve që e bëjnë të detyrueshëm atashimin e fëmijës.”

Dyshimi mund të jetë ose prej burrit, ose prej gruas, si për shembull, asnjëri prej atyre të dyve nuk ka dijeni dhe askush nuk i ka tërhequr vëmendjen se janë të ndaluar për njëri-tjetrin.

Dyshimi mund të jetë edhe vetëm prej burrit, ashtu siç mund të jetë edhe vetëm prej gruas, për shembull, gruaja ka dijeni që është e martuar dhe e ka burrin, ndërkaq ajo mashtron një burrë. Dyshimi mund të jetë edhe vetëm prej gruas, si për shembull, burri e di që ajo është vajza e gruas së tij, me të cilën ai ka kryer marrëdhënie intime, ose gruaja është e motra e tij prej qumështi, apo ai ka dijeni për shkaqe të tjera që e bëjnë gruan të ndaluar për atë burrë, megjithëkëtë ai e mashtron atë. Gjithashtu, dyshimi mund të jetë prej të dyja palëve. Në këtë rast, fëmija i atashohet të dyve, por, kur dyshimi është vetëm prej njëres anë, fëmija i takon anës së dyshuar.

Kush i afrohet një gruaje të ndaluar për të dhe ai pretendon se nuk kishte dijeni për këtë ndalim, pranohet fjala e burrit, pa sjellë argument dhe pa betim. Po kështu, pranohet fjala e gruas, pa sjellë argument dhe pa betim, kur gruaja pretendon dyshimin, sepse zbatimi i ligjit për veprime që dënohem me ekzekutim, ligji nuk zbatohet kur veprimi i dënueshëm është kryer me dyshime dhe, kur është e mundur të thuhet që fëmija është i lindur prej marrëdhënieve të dyshimta, qoftë edhe atëherë kur mundësia e dyshimit është edhe një për qind, nuk lejohet të gjykohet e të thuhet se ai është fëmijë i lindur prej kurvërimit. Kjo çështje është prej burimeve “Kur argumenti i dobët mposht argumentin e fuqishëm dhe e pakta mposht të shumtën”.

Fëmija i gjetur në rrugë

Fëmija i gjetur në rrugë s’ka asgjë të përbashkët me përkatësinë familjare, sepse për këtë fëmijë mungojnë tri kushtet

që duhet të ekzistojnë patjetër, kushte që e bëjnë të detyrueshëm atashimin e fëmijës. Në këtë paragraf po e theksojmë çështjen e fëmijës së gjetur në rrugë, vetëm për të sqaruar çështjen dhe në ndjekje të renditjes së çështjeve nga ana e fukahave. E njëjta gjendje është edhe për fëmijën e birësuar.

Fëmijë i gjetur në rrugë është kur njeriu gjen një fëmijë, i cili s'ka mundësi të sjellë asnjë dobi për veten e tij, gjithashtu ai fëmijë s'ka mundësi të largojë ndonjë dëm prej vetes së tij, kështu që gjetësi përkujdeset për këtë fëmijë, siç përkujdeset për njerëzit e tjerë të familjes që ai ka në ngarkim. Të gjitha medh'hebet islame (shkollat juridike islame) ndajnë një fjalë të përbashkët se nuk ka trashëgimi mes fëmijës së gjetur në rrugë dhe gjetësit, pasi përkujdesja e këtij të fundit, për këtë fëmijë është thjesht një punë bamirësie dhe bashkëpunim për punë të mirë e për devotshmëri. Shembulli i këtij fëmije të gjetur në rrugë është si shembulli i atij njeriu i cili i dhuron një tjetri një shumë të madhe pasurie, me qëllim afrimin të Allahu. Me dhurimin e tij, ai e bën të varfrin të pasur, nga të përulur e bën të nderuar, por kjo bamirësi nuk është shkak për trashëgimi. Kështu qëndron edhe puna e fëmijës së gjetur në rrugë.

Birësimi

Birësim do të thotë: Njeriu ka qëllim të konsiderojë si birin e tij një fëmijë që i dihet përkatësia familjare, por me birësimin ai e bën atë fëmijë të jetë prej familjes së tij. Ligji i fesë islame nuk e merr birësimin në konsideratë si shkak për trashëgimi, sepse birësimi nuk e ndryshon realitetin nga e vërteta e tij, pasi më parë

përkatësia familjare e atij fëmije ishte e vërtetuar dhe e njohur. Përkatësia familjare nuk pranon prishjen dhe nuk rrëzohet me rrëzues.

Në lidhje me këtë çështje, shprehen qartë ajetet 4-5 të sures “El Ahzab”:

”وَمَا جَعَلَ أَدْعِيَاءَكُمْ أَبْنَاءَكُمْ ۚ ذَلِكُمْ قَوْلُكُمْ بِأَفْوَاهِكُمْ ۖ وَاللَّهُ يَقُولُ الْحَقَّ وَهُوَ يَهْدِي السَّبِيلَ. اُدْعُوهُمْ لِأَبَائِهِمْ هُوَ أَقْسَطُ عِنْدَ اللَّهِ

“...as fëmijët tuaj të birësuar nuk i konsideron si bij të vërtetë. Këto janë vetëm fjalë që dalin prej gojës suaj, kurse Allahu thotë të vërtetën dhe udhëzon në rrugë të drejtë. Thërritini të birësuarit sipas etërve të tyre! Kjo është më e drejtë në sytë e Allahut...”

Komentuesit e Kuranit, si shkak të zbritjes së këtyre ajeteve, kanë përmendur një ndodhi të këndshme. Në kohën e injorancës, para Islamit, u mor rob lufte Zejd bin Haritheh, të cilin e bleu i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*). Pas shpalljes së Islamit, babai i Zejdit erdhi në Mekë dhe i kërkoi të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) që t’i shiste djalin e tij Zejdin, ose t’i jepte Zejdit lirinë.

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) i tha: “Ai është i lirë, prandaj le të shkojë ku të dojë.”

Mirëpo Zejdi kundërshtoi të ndahej prej të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*).

Nga kjo fjalë e Zejdit, Harithehi u zemërua shumë dhe thirri: “O kurejshë, dëshmoni se Zejdi nuk është biri im!”

Ndërkaq edhe i Dërguari i Allahut (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!) tha: “Dëshmoni që Zejdi është biri im!”¹

Dy burra kryejnë marrëdhënie intime me të njëjtën grua

Kur burri kurvëron me një grua të martuar dhe ajo mbetet shtatzënë, kjo shtatzëni mund të jetë edhe prej kurvarit dhe prej burrit. Në këtë gjendje, fëmija i atashohet burrit, edhe nëse fëmija është i dyshimtë, që është prej kurvarit.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për dy burra që kanë kryer marrëdhënie intime me të njëjtën grua, në kohën që ajo nuk ishte në periudhë pastrimi (pas menstruacioneve). Kujt i takon fëmija?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “I takon atij ku është fëmija.”

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ka thënë: “Fëmija është i shtratit dhe kurvari është për gurin (ekzekutohet me gjuajtje me gur).”

Gjithashtu, Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që është martuar me një grua jo të besueshme, e cila pretendon se është shtatzënë. Ç’duhet të bëjë ky burrë?

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Ai bën durim, ashtu siç ka thënë i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i*

¹ Libri “Mexhmeul bejân fîj tefsîjrîl Kurân”.

Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!): “Fëmija është i shtratit dhe kurvari është për gurin (ekzekutohet me gjuajtje me gur).”

Dikush kryen marrëdhënie intime me dyshim me një grua të martuar dhe ajo mbetet shtatzënë. Pra, ka mundësi që shtatzënia e saj të jetë ose prej burrit, ose prej atij që ishte me dyshim. Në këtë gjendje, çështja se kujt i atashohet fëmija zgjidhet me short dhe atij që i del emri, atij i atashohet fëmija.

Autori i librit *El Xheuahir*” ka thënë: “Sikur ai të kryejë marrëdhënie intime të dyshimtë, në atë mënyrë që lindja e fëmijës mund të jetë ose prej burrit, ose prej atij që ishte me dyshim, në këtë gjendje, hidhet short mes atyre të dyve dhe fëmija i atashohet atij që i bie shorti, sepse gruaja është shtrat për të dy, pa bërë dallim që të dy kontaktimet me atë grua kanë ndodhur apo nuk kanë ndodhur në të njëjtin pastrim të saj, krahas mundësisë për t’i atashuar fëmijën të dyve.

Është e qartë se, kur është mundësia që fëmija t’i atashohet njërit prej atyre të dyve dhe jo tjetrit, është detyrim që fëmija t’i atashohet atij që i takon, pa hedhur short, gjithashtu, fëmija mund të mos i atashohet asnjërit prej atyre të dyve, për shkak të pamundësisë që ai fëmijë të jetë lindur prej atyre të dyve dhe, kjo është fare qartë.”

Kur burri e divorcon gruan e tij dhe me atë grua kishte kryer marrëdhënie intime, ndërkaq gruaja ka plotësuar kohën e pritjes ligjore, pastaj kjo grua martohet, më pas gruaja lind fëmijën në më pak se gjashtë muaj, që është me burrin e dytë, por kanë kaluar gjashtë muaj ose edhe më shumë, që nga koha që burri i parë kishte kryer marrëdhënie intime me të, ose koha e afrimit të

burrit të parë te kjo grua nuk është më shumë se koha më e gjatë e shtatzënisë, në këtë gjendje, fëmija i takon burrit të parë. Nëse gruaja është me burrin e dytë më shumë se gjashtë muaj, fëmija i takon burrit të dytë.

Kur burri e divorcon gruan dhe gruaja martohet, pastaj ajo lind në më pak se gjashtë muaj që prej kohës që ka kryer marrëdhënie intime me burrin e dytë dhe lindja ka ndodhur në kohën më të gjatë të shtatzënisë, që prej kohës së afrimit me burrin e parë, fëmijës i mohohet atësia prej të dyve.

Për shembull: kanë kaluar tetë muaj pas divorcit dhe pas këtyre muajve gruaja është martuar me një burrë tjetër dhe qëndron me këtë të fundit pesë muaj, pastaj lind fëmijën. Ne kemi vënë në konsideratë se koha më e gjatë e shtatzënisë është një vit. Ky fëmijë nuk i atashohet burrit të parë, sepse ka kaluar më shumë se një vit, që nga koha që ai ishte afruar me këtë grua. Gjithashtu, fëmija nuk i atashohet as burrit të dytë, sepse nuk kanë kaluar gjashtë muaj që ai është afruar me këtë grua.

Dyshimi

Kur ne dimë që burri as nuk ka kryer marrëdhënie intime reale dhe as nuk e ka derdhur ujin e tij jashtë mbi vaginën e gruas, ose ai ka kryer marrëdhënie intime me atë grua dhe gruaja lind në më pak se gjashtë muaj, që nga data kur ai ka hyrë te ajo, apo gruaja lind për më shumë se koha më e gjatë e shtatzënisë, si për shembull, burri nuk është pranë gruas për një kohë më të gjatë se koha më e gjatë e shtatzënisë, kur ne i dimë këto, nuk lejohet që

këtij burri t'i atashohet fëmija. Por nëse burri e pohon se fëmija është i tij, atëherë veprohet sipas pohimit të burrit.

Kur ne dimë që burri ka hyrë te gruaja dhe kanë kaluar gjashtë muaj të shtatzënisë, por as nuk është tejkaluar koha me e gjatë e shtatzënisë, burri nuk e mohon dot atësinë e fëmijës, veçse me anë të mallkimit të ndërsjellë, madje edhe sikur të bien dakord ai dhe gruaja për të mohuar atësinë e atij fëmije.

Kur ne dimë se ai ka hyrë te gruaja dhe dyshojmë, nëse kanë kaluar gjashtë muaj që ajo është shtatzënë, ose dyshojmë që është tejkaluar koha më e gjatë e shtatzënisë, fëmija i atashohet burrit, edhe sikur ai të mohojë atësinë për atë fëmijë. Në këtë gjendje, në asnjë rast, nuk shikohet në mohimin që ai bën, sepse, në të shumtën e kohës, ai ka ndarë shtatin me gruan, duke vepruar në bazë të rregullit "Gjithçka që është e mundur të jetë prej tij, ai është fëmija i tij", ashtu siç njofton edhe hadithi: "Fëmija është i shtratit". Prej këtij rregulli ka dalë rasti, kur dihet në mënyrë të prerë se ai fëmijë nuk është i tij, atëherë mbetet ajo që dihet dhe për të dyshuarin zbatohet dispozita e shtratit.

Me këtë shpjegim bëhet e qartë për ne se ky rregull shërben për të ngritur subjektin e atij që thotë: Dyshimi për kushtin kërkon dyshimin për të kushtëzuarin.

Konflikti

1- Kur burri e heq fëmijën prej vetes me argumentin se ai nuk ka hyrë te ajo grua dhe gruaja thotë: "Jo, ai ka hyrë." dhe gruaja e thotë këtë fjalë me qëllim që t'i atashojë atij fëmijën, në

këtë gjendje, merret në konsideratë fjala e burrit, sepse origjina është moshyrja.

Pyetje: Rregulli i shtratit dhe mundësia e atashimit, a nuk janë ngritëse të subjektit të origjinës, ashtu siç u tha më sipër?

Përgjigje: Më sipër u shpjegua se shtrati ka kuptimin e kryerjes së marrëdhënieve intime dhe, kur ne dyshojmë, nëse burri ka kryer marrëdhënie intime me atë grua, ose nuk ka kryer, në të vërtetë, dyshojmë në vetë subjektin e rregullit. Është e kuptueshme që nuk lejohet të bazohemi nga fakti që sendi është i pakushtëzuar, ose është thënë në përgjithësi, me përjashtim të rastit kur vërtetohet ekzistenca e subjektit të atij sendi.¹¹

2- Burri e gruaja bien dakord që hyrja është kryer dhe kanë mosmarrëveshje për kohën e lindjes së fëmijës. Gruaja thotë se ka lindur fëmijën, pasi kaluan gjashtë muaj, ose e ka lindur para se të tejkalohet koha më e gjatë e shtatzënisë, ndërsa burri thotë se ajo lindi para se të mbushen gjashtë muaj, ose burri thotë se ajo lindi, pasi ishte tejkaluar koha me gjatë e shtatzënisë. Në këtë gjendje, merret në konsideratë fjala e gruas, sepse origjina është që fëmija të atashohet për shkak të kryerjes së marrëdhënieve intime, domethënë për shkak të shtratit, derisa të vërtetohet e kundërta.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Në të gjitha gjendjet, gruaja është mohuese, duke marrë në konsideratë se pretendimi i saj për origjinën, pa asnjë dallim, përputhet me pretendimin e burrit për më shumë se koha më e gjatë e

¹ Është e habitshme që autori i librit “El-Xhevahir” është kapur pa asnjë kusht me rregullin. Kur ne dyshojmë në lidhje me hyrjen, domethënë në lidhje me kryerjen e marrëdhënieve intime, mendojmë përciptas se kjo është kapje pas së përgjithshmes, ose është kapje pas të pakushtëzuarës në dyshimin e miratuar.

shtatzënisë, ose lindja ka ndodhur në më pak se koha më e vogël e shtatzënisë, kurse burri, në të gjitha gjendjet, është pretendues dhe mohon origjinën që ishte, fëmija i atashohet atij për shkak të kryerjes së marrëdhënieve intime.

Rrugët e vërtetimit të përkatësisë familjare (atësia)

Përkatësia familjare vërtetohet me pohim, për të cilin kemi folur me hollësi dhe gjerë e gjatë në kapitullin “Pohimi”, në paragrafin “Pohimi për përkatësinë familjare”.

Gjithashtu, përkatësia familjare vërtetohet me dëshminë e dy burrave të drejtë, por në përkatësinë familjare nuk pranohet dëshmia e grave, as kur janë vetëm gra e as kur gratë janë së bashku me burrat. Përkatësia familjare vërtetohet edhe më anë të lobimit, domethënë kur njeriu, në një grup njerëzish ku ai banon, e thotë me të madhe dhe shpesh se ai është biri i filanit, në atë mënyrë që, kur të pyetet për atë një person që ka dijeni për trungjet gjenealogjike të njerëzve, ai e vërteton fjalën e këtij njeriu.

Gjithashtu, përkatësia familjare vërtetohet edhe kur ai e ka regjistruar emrin e tij me këtë mbiemër, me këtë përkatësi familjare, ose me këtë emër ai është regjistruar në zyrat e hipotekave, të statistikave, të gjykatave, në fletoren e tregtarit, të kasapit, etj.

Ne i kemi parë argumentet e vërtetimit të përkatësisë familjare nga të gjitha anët. Veç kësaj kemi bërë një studim të plotë rreth kësaj çështjeje në librin “El Fusûlu esh Sher’ij’jeh”.

GJIDHËNIA DHE KUJDESI PËR FËMIJËN

Qumështi i nënës

Qumështi më i mirë që pi foshnja është qumështi i nënës së tij, për faktin se qumështi i nënës është ushqimi më i përshtatshëm dhe përmban elementet e domosdoshme. Është ushqimi më i tretshëm prej fëmijës. Veç kësaj, fëmija është ushqyer prej nënës edhe gjatë kohës kur ishte në barkun e saj.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Prijsi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ka thënë: “S’ka asnjë qumësht që pi fëmija me më shumë begati se qumështi i nënës së tij.”

Koha e gjidhënies

Ligji i fesë ka përcaktuar kohën gjatë së cilës fëmija është detyrë të ushqehet me qumështin e gjirit dhe e ka përcaktuar, dy vjet, por edhe ka lejuar që kjo kohë të reduktohet në njëzet e një muaj. Gjithashtu, ligji lejon që koha ligjore e gjidhënies të shtohet

me një muaj, ose edhe me dy muaj, ashtu si thotë Allahu i Lartësuar në fjalën e Tij:

”وَالْوَالِدَاتُ يُرْضِعْنَ أَوْلَادَهُنَّ حَوْلَيْنِ كَامِلَيْنِ لِمَنْ أَرَادَ أَنْ يُنَمِّمَ الرِّضَاعَةَ وَعَلَى الْمَوْلُودِ لَهُ رِزْقُهُنَّ وَكِسْوَتُهُنَّ بِالْمَعْرُوفِ لَا تُكَلَّفُ نَفْسٌ إِلَّا وُسْعَهَا لَا تُضَارَّ وَالِدَةٌ بِوَلَدِهَا وَلَا مَوْلُودٌ لَهُ بِوَلَدِهِ...”

“Nënat që duan të plotësojnë gjidhënien për fëmijët e tyre, i ushqejnë ata me qumësht gjiri dy vjet të plota. Baba i fëmijës ka detyrim ushqimin e veshmbathjen për ato (gratë). Askush nuk ngarkohet më tepër nga mundësia që ai ka; nuk lejohet të dëmtohet asnjë nënë me fëmijën e saj dhe asnjë babë me fëmijën e tij...” (Sure “El Bekare”, ajeti 233)

Kurse për lejimin e shkurtimit të kohës së gjidhënies njëzet e një muaj, tregon ajeti 15, i sures “El Ahkaf”:

”وَحَمْلُهُ وَفِصَالُهُ ثَلَاثُونَ شَهْرًا”

“...shtatzënia e gjidhënia e fëmijës zgjat tridhjetë muaj...”

Kur shtatzënia e saj vazhdon nëntë muaj, që është koha e zakonshme e shtatzënisë, për foshnjën mbetet të ushqehet me qumësht gjiri njëzet e një muaj.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Koha e gjidhënies është njëzet e një muaj dhe, nëse kjo kohë pakësohet, ky pakësim i kohës së gjidhënies, është padrejtësi që i bëhet foshnjës.”

Kurse argumentin për shtimin e kohës së gjidhënies një muaj dhe dy muaj, autori i librit “El Xheuahir” e ka nxjerrë prej një transmetimi, i cili, në fakt, nuk tregon qartë për lejimin. Por ai

është mjaftuar me këtë lejim, pa pasur tekst që të tregojë për shtimin e kohës së gjidhënies. Bazuar mbi këtë transmetim, lejohet që nëna të ushqejë me qumësht gjiri fëmijën e saj për vite me radhë, sidomos kur fëmija ka nevojë të ushqehet me qumësht gjiri, por nëna nuk ka të drejtë të marrë shpërblim për kohën shtesë të gjidhënies më shumë se dy vjet të plota.

Shpërblimi për gjidhënien

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët me dëshminë e autorëve të librave “El Xheuahir dhe “El Hadaik” se nëna nuk detyrohet të ushqejë me gjiri fëmijën e saj, ashtu siç është fjala e Allahut të Lartësuar:

“فَإِنْ أَرْضَعْنَ لَكُمْ فَاتُّوهُنَّ أُجُورَهُنَّ”

“...nëse ato i ushqejnë me gjiri fëmijët tuaj, u jepni atyre shpërblimin...” (Sure “Et Talak”, ajeti 6)

Për këtë çështje është edhe fjala e Imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!): “Gruaja nuk detyrohet të ushqejë me gjiri fëmijën e saj.”

Vetëkuptohet se, kur ushqimi i fëmijës me gjiri reduktohet vetëm me nënën, në atë mënyrë që fëmija dëmtohet, nëse fëmija nuk ushqehet me qumësht gjiri, në këtë gjendje, është detyrim për nënën ta ushqejë fëmijën me gjirin e saj.

Nëna ka të drejtë të kërkojë shpërblim për gjirin që i jep fëmijës së saj, ashtu siç urdhëron Allahu i Lartësuar në fjalën e Tij: **“...nëse ato i ushqejnë me gjiri fëmijët tuaj, t’u jepni atyre shpërblimin...”**

Në qoftë se fëmija ka pasuri, shpërblimi për nënën merret prej pasurisë së fëmijës, ndryshe paguan babai i fëmijës, kur është në gjendje të mirë, sado i lartë të jetë shpërblimi. Në qoftë se babai s'ka pasuri, atëherë nëna ka detyrë ta ushqejë me gji fëmijën e saj falas, sepse qumështi i gjirit për fëmijën është gjellë dhe bukë, prandaj dispozita e ushqimit të fëmijës me qumësht gjiri është plotësisht si dispozita e shpenzimit.

Hollësitë në lidhje me këtë çështje do të trajtohen në kapitullin "Shpenzimi".

Kur nëna, për gjidhënien, kërkon shpërblim më shumë se gratë e tjera, babai i fëmijës ka të drejtë t'ia marrë asaj fëmijën dhe ia lë në dorëzim një gruaje tjetër. Gjithashtu, babai e merr fëmijën prej nënës, kur gjen një grua që e ushqen me gji fëmijën e tij falas, pasi nëna nuk pranon t'i japë gji fëmijës së vet pa shpërblim. Por nëse nëna është e kënaqur me atë shpërblim me të cilin kënaqen edhe gratë e tjera, ose e ushqen fëmijën me gji për bamirësi, vetëkuptohet që nëna ka përparësi ta ushqejë me gji fëmijën e saj.

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: "Kur burri divorcon gruan dhe gruaja është shtatzënë, burri ka detyrim të shpenzojë për gruan, derisa ajo të lindë dhe, kur ajo të lindë, burri i jep asaj shpërblim për gjirin që ajo i jep fëmijës së tij. Nuk lejohet që burri të dëmtojë nënën e fëmijës, kur gjen një grua tjetër që e ushqen fëmijën me gji me shpërblim më të lirë se shpërblimi që kërkon nëna. Nëse nëna mbetet e kënaqur me shpërblim që kërkon gruaja tjetër, nëna ka më shumë të drejtë të ushqejë fëmijën e saj me gji, derisa të plotësohet koha e ndarjes së fëmijës prej gjirit."

Në të gjitha gjendjet, gjykatësi ka detyrim të kujdeset për interesin e fëmijës dhe për mosdëmtimin e nënës. Nëse gjykatësi vërteton, nuk vendos vetëm nga ana e jashtme e fakteve që herën e parë, për shkak se shumë prindër përpiqen të mashtrojnë duke përdorur për këtë qëllim gra të cilat gjoja do ta ushqejnë fëmijën me gji për bamirësi, domethënë kemi rastin kur burri ka qëllim të dëmtojë nënën me fëmijën e saj, mirëpo Allahu, i Plotpushtetshëm thotë: “nuk lejohet të dëmtohet asnjë nënë me fëmijën e saj.”

Kujdesi për fëmijën

Në tekstin arabisht, fjala arabe “hadaneh” ka kuptimin “shpendi ngroh vezët”, ose “shpendi i mbron të vegjlit nën fletët e veta”.

Këtu, me fjalën “hadaneh”-“kujdesi për fëmijën”, ka për qëllim të tregojë ruajtjen dhe rritjen e fëmijës, si dhe kujdesin për ruajtjen e interesave të fëmijës.

Dëshmori i dytë, në librin “El Mesalik”, ka thënë: “Kujdesi për fëmijën prej femrës është më i përshtatshëm se kujdesi për fëmijën prej burrit, sepse gruaja është më e mëshirshme. Veç kësaj, gruaja, nga vetë natyra e krijimit të saj, është e përgatitur të kujdeset për fëmijën.

Kush e ka detyrim të kujdeset për fëmijën?

Kujdesi për fëmijën është detyrë e nënës dhe e babait, derisa nuk ka ndodhur divorci. Nëse burri e divorcon gruan, nëna

ka më shumë të drejtë të kujdeset për fëmijën mashkull, derisa ai të arrijë moshën dy vjeç.

Gjithashtu, nëna ka më shumë të drejtë të kujdeset për fëmijën femër, derisa ajo të arrijë moshën shtatë vjeç. Kjo është fjala që ka përhapje më të gjerë në mesin e fukahave, të cilët kanë shkuar me dëshminë e autorit të librit “El Xheuahir”. Për këtë sqarim, nuk ka argument të qartë në tekste.

Autori i librit “El Mesalik” ka thënë: “Fukahatë kanë mendime të ndryshme se cili prej dy prindërve ka më shumë të drejtë të kujdeset për fëmijën. Këto mendime ndryshe të fukahave vijnë për shkak se edhe transmetimet, me të cilat ata kanë punuar, janë të ndryshme. Në disa transmetime tregohet se, në mënyrë absolute, nëna e pamartuar ka më shumë të drejtë të kujdeset për fëmijën e saj.

Në disa transmetime të tjera tregohet se nëna ka më shumë të drejtë të kujdeset për fëmijën e saj, derisa fëmija të arrijë moshën shtatë vjeç. Në një transmetim tjetër thuhet nëntë vjeç. Në disa transmetime të tjera tregohet se babai ka më shumë të drejtë të kujdeset për fëmijën. Gjithashtu, jo të gjitha transmetimet flasin për dallimin në kohëzgjatjen e kujdesit për fëmijën mashkull e për fëmijën femër.

Në lidhje me këtë çështje, transmetimet nuk janë të gradës “Sahijh”-“Të saktë”, por këto transmetime janë ose të gradës “Daijf”, ose të gradës “Mursel”, ose të gradës “Meukùf”.¹

¹ Transmetimi i gradës “Mursel” është kur transmetimi i atashohet Imamit të ruajtur prej mëkateve, pa përmendur farë përcjellësit, ose përmenden vetëm disa prej përcjellësve të atij transmetimi. Gjithashtu, transmetimi është i gradës

Sqarimi që bëjnë fukahatë më të dëgjuar, në lidhje me hollësitë e dallimit për kohën e kujdesit për fëmijën mashkull dhe për fëmijën femër, është sipas bindjes që kanë formuar fukahatë nga bashkimi mes dy teksteve, njërin prej të cilëve e transmeton Ej'jüb bin Nùh, në të cilin tregohet se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) ka thënë: “Gruaja ka më shumë të drejtë të kujdeset për fëmijën e saj, derisa fëmija të arrijë moshën shtatë vjeç.”

Transmetimin e dytë e ka transmetuar Daud bin Husen, prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Derisa fëmija vazhdon të ushqehet me qumësht gjiri, ai është nën kujdesin e të dy prindërve, në mënyrë të barabartë. Pasi kalon moshë e ushqimit me gj, babai ka më shumë të drejtë se nëna të kujdeset për këtë fëmijë. Në rastin kur babai vdes, nëna ka më shumë të drejtë të kujdeset për fëmijën, më shumë se të afërmit e fëmijës nga ana e babait.”

Konstatohet se ky bashkim mes dy transmetimeve është arbitrar, sepse për bashkimin mes dy transmetimeve s’ka argument as prej ligjit e as prej traditës.

Në radhë të dytë, konstatohet se fjala “fëmijë”, në të dy transmetimet, përfshin fëmijën mashkull dhe fëmijën femër.

Në radhë të tretë, konstatohet se kemi edhe një transmetim tjetër, ku thuhet se gruaja ka më shumë të drejtë të kujdeset për fëmijën e saj, derisa nuk është martuar.

“Meukùf”, kur transmetimi nuk i atashohet Imamit të ruajtur prej mëkateve, por qëndron në ndonjërin prej përcjellësve.

Gjithashtu, kemi edhe një transmetim të katërt, ku thuhet se gruaja ka më shumë të drejtë të kujdeset për fëmijën, derisa ai të arrijë moshën nëntë vjeç.

Puna e fukahave më të dëgjuar s'ka asnjë ndikim në bashkimin mes teksteve, kur bashkimi nuk ka bazë prej ligjit ose prej traditës, madje edhe atëherë kur ne themi se puna e tyre anon më shumë nga ana e njërit prej dy teksteve që kundërshtojnë njëri-tjetrin.

Nuk është larg logjikës që nëna të jetë më e veçantë në kujdesin për fëmijën, derisa fëmija, qoftë mashkull, qoftë femër, të arrijë moshën dy vjeç. Pasi fëmija mbush dy vjeç, puna e kujdesit për fëmijën lihet në hulumtimin e në këndvështrimin e gjykatësit. Është gjykatësi ai që vendos ta lërë fëmijën nën kujdesin e nënës, ose nën kujdesin e babait, pasi fëmija arrin moshën dy vjeç. Kuptohet se gjykatësi, me vendimin që merr, ka parasysh interesin e fëmijës për punët e fesë dhe për punët e kësaj bote. Ne themi se kjo është vetëm nga ana teorike, kurse nga ana praktike, ne jemi me shumicën që thotë se nëna ka më shumë të drejtë të kujdeset për fëmijën mashkull, derisa ai të arrijë moshën dy vjeç dhe nëna ka më shumë të drejtë të kujdeset për fëmijën femër, derisa ajo të arrijë moshën shtatë vjeç, me kusht që nëna nuk të mos jetë martuar. Nëse nëna martohet para kësaj kohe, e drejta e saj që të kujdeset për fëmijën rrëzohet.

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët se, kur fëmija arrin moshën e pjekurisë seksuale, ka të drejtë të shkojë me njërin prej dy prindërve të tij që ai dëshiron të shkojë.

Kushtet

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Në kujdesin për fëmijën është kusht që gruaja të jetë e lirë (të mos jetë robëreshë), të jetë myslimane, të jetë e mençur dhe e pamartuar. Për këto katër kushte s’ka asnjë kundërshtim në mesin e fukahave.”

Kushti që gruaja të jetë myslimane, është vënë kur fëmija është në dispozitën për të qenë mysliman, sepse jomyslimani s’ka rrugë të kujdeset për myslimanin. Kushti që gruaja të jetë e mençme, është vënë se e çmendura ka vetë nevojë që të kujdeset dikush tjetër për të.

Kushti që gruaja të mos jetë e martuar, është bazuar në fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Gruaja ka më shumë të drejtë të kujdeset për fëmijën, derisa ajo nuk është martuar.”

Gjithashtu, është kusht që gruaja të mos vuajë nga sëmundje infektive, të mos jetë lavire me damkë dhe as e atillë që lë pas dore kujdesin për fëmijën dhe neglizhon ruajtjen e interesave të fëmijës. Të gjitha këto kushte janë venë me qëllim që të ruhet shëndeti dhe morali i fëmijës.

Udhëtimi me fëmijën

Gruaja e divorcuar s’ka të drejtë të udhëtojë me fëmijën në një vend të largët, pa miratimin e babait të fëmijës. Gjithashtu, babai s’ka të drejtë t’ia marrë fëmijën nënës, por babai udhëton me fëmijën, kur gruaja e ka fëmijën nën kujdesin e saj, sepse babait i takon e drejta e kujdestarisë për fëmijën e tij, prandaj është detyrim që fëmija të mos largohet prej babait të tij, por edhe nëna

ka të drejtën të kujdeset për fëmijën. Për rrjedhojë, është detyrim që fëmija të mos i merret nënës. Në këtë gjendje, është e pamundur ruajtja e dy të drejtave njëherësh, përveçse duke vepruar sipas asaj që u tha më sipër.

Shpërblimi për kujdesin ndaj fëmijës

A ka të drejtë nëna të marrë shpërblim për kujdesin ndaj fëmijës, përveç shpërblimit që merr për ushqimin e tij me gji?

Autori i librit “El Mesalik”, anon kah mohimi i marrjes së shpërblimit për kujdesin ndaj fëmijës, kurse autori i librit “El Xheuahir” anon kah vërtetimi i kësaj të drejte. Është fakt se në ligjin e fesë nuk ka tekst që e bën detyrim dhënien e shpërblimit, kur gruaja kujdeset për fëmijën e saj.

Gjithashtu, edhe zakoni nuk njeh rast, kur nëna ka marrë shpërblim për shkak se kujdeset për fëmijën e vet. Kujdesi për fëmijën nuk ka asnjë lidhje me shpenzimet që bën burri kur divorcon gruan, pasi s’ka tekst që të tregojë se babai e ka detyrim t’i japë gruas shpërblim, ngaqë ajo kujdeset për fëmijën, ashtu siç e ka detyrim t’i japë asaj shpërblim për ushqimin e fëmijës me qumështin e gjirit.

Në të vërtetë, kujdesi për fëmijën nuk është punë që i takon babait, prandaj e drejta është në anën e autorit të librit “El Mesalik” që thotë se nuk është detyrim dhënia e shpërblimit për kujdesin ndaj fëmijës, veçanërisht kur kujdesi për fëmijën është detyrim që duhet ta bëjë nëna.

Kur fëmija humb të dy prindërit

Kujdesi për fëmijën i takon nënës, pastaj i takon babait, ashtu siç u tha më sipër. Kur nëna vdes, para se të mbarojë koha gjatë së cilës gruaja e ka fëmijën nën kujdesin e saj, kujdesin për këtë fëmijë, në radhë të parë, i takon babait të fëmijës, madje edhe para gjyshes së fëmijës nga nëna (nëna e nënës së fëmijës).

Kur vdes babai, ose babai çmendet, pasi kujdesi për fëmijën i ka kaluar atij dhe nëna vazhdon të jetojë, të drejtën e kujdesit për këtë fëmijë, në radhë të parë, e ka nëna, e cila ka më shumë të drejtë të kujdeset për fëmijën më shumë se të afërmit e fëmijës nga babai, përfshirë gjyshin e fëmijës nga babai, madje nëna ka më shumë të drejtë të kujdeset për fëmijën e saj, edhe sikur të jetë martuar me një burrë, i cili s'ka asnjë lloj afërsie me babain e fëmijës.

Kur fëmija humb të dy prindërit, kujdesi për fëmijën i kalon gjyshit të fëmijës nga babai. Kur fëmija humb të dy prindërit dhe fëmija s'ka kujdestar, e drejta e kujdesit për këtë fëmijë u takon të afërmeve të fëmijës nga ana e babait të tij, sipas radhës që ata kanë në trashëgimi, domethënë që më i afërmi e pengon atë që është më i largët. Në rastin kur si renditje janë të barabartë, si për shembull, gjyshja nga nëna dhe gjyshja nga babai, ose halla e teza, domethënë se kur ata janë shumë, atëherë hidhet short mes tyre. Atij që i del emri prej shortit, ka më shumë të drejtë të kujdeset për fëmijën, derisa edhe ky të vdesë, ose të heqë dorë prej të drejtës së tij, domethënë të drejtës për t'u kujdesur për fëmijën.

Kujdesi për fëmijën rrëzohet me rrëzim

A është kujdesi për fëmijën një e drejtë të cilën lejohet ta rrëzojë ai që e ka këtë drejtë, apo kujdesi për fëmijën është një dispozitë që rrëzohet vetëm me rrëzim?

Përgjigje: Fjala e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Gruaja ka më shumë të drejtë të kujdeset për fëmijën, derisa ai të mbushë shtatë vjeç, nëse gruaja do”, tregon qartë se kujdesi për fëmijën është një e drejtë dhe nuk është dispozitë.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Komenti për dëshirën e gruas dhe shprehja se gruaja ka më shumë të drejtë, tregojnë qartë se kujdesi për fëmijën është si ushqimi i fëmijës me gji, domethënë që nuk është detyrim për gruan, prandaj gruaja ka të drejtë ta rrëzojë të drejtën e saj.”

Më pas ky autor ka cituar prej autorit të librit “Err Rrijad”: “S’ka asnjë dyshim që kujdesi për fëmijën është një e drejtë.”, domethënë që lejohet rrëzimi i kësaj të drejte.

* * *

SHPENZIMI

Shpenzimi për gruan

Me fjalën e përbashkët të fukahave dhe me tekst, burri ka detyrim të shpenzojë për gruan e tij, edhe sikur gruaja të jetë e pasur. Prej teksteve kemi fjalën e Allahut të Lartësuar:

“وَعَلَى الْمَوْلُودِ لَهُ رِزْقُهُنَّ وَكِسْوَتُهُنَّ”

“...Babai i fëmijës ka detyrim ushqimin e veshmbathjen për ato (gratë).” (Sure “El Bekare”, ajeti 233)

Në tekstin e ajetit të nderuar fjala “baba” ka ardhur me termin “el-meulûdi”, kurse “gratë” janë përmendur me përemrin vetor “hun’ne”, numër shumës, gjinia femërore, veta e tretë.

Gjithashtu, prej teksteve, kemi fjalën tjetër të Allahut të Lartësuar:

“الرِّجَالُ قَوَّامُونَ عَلَى النِّسَاءِ بِمَا فَضَّلَ اللَّهُ بَعْضَهُمْ عَلَى بَعْضٍ وَبِمَا أَنْفَقُوا مِنْ أَمْوَالِهِمْ”

“Burrat mbajnë përgjegjësi për gratë me atë që Allahu disa i ka graduar mbi disa me atë ata kanë shpenzuar prej pasurisë së tyre...” (Sure “En Nisa”, ajeti 34)

Prej teksteve kemi edhe fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “E drejta që ka gruaja prej burrit të saj, është që ajo të ngopë barkun e saj, të mbulojë lëkurën e saj dhe, në qoftë se ajo nuk e di (që e gëzon këtë të drejtë), Allahu i faltë mëkatet.”

Urrejtja dhe bindja

Fukahatë ndajnë një mendim të përbashkët se burri ka detyrim të shpenzojë për gruan me martesë të përhershme, kurse për gruan me martesë të ndërprerë nuk ka detyrim të shpenzojë. Por fukahatë kanë mendime të ndryshme, nëse shpenzimi bëhet detyrim vetëm për shkak të kontratës së martesës, apo shpenzimi bëhet detyrim me kontratën krahas bindjes.

Dallimi mes dy thënieve bëhet i dukshëm, kur shikojmë gjendjen mes bashkëshortëve në rastet e mëposhtme:

a) Të dy bashkëshortët kanë mosmarrëveshje në lidhje me bindjen. Gruaja thotë: “Unë kurrë nuk jam larguar prej teje, unë jam e bindur, prandaj kam të drejtë të shpenzosh për mua.”

Burri thotë: “Ti më urren, prandaj nuk e meriton shpenzimin.”

Në këtë rast, veprohet sipas thënies së parë, domethënë që shpenzimi bëhet detyrim për shkak të kontratës së martesës. Në këtë gjendje, burri është pretenduesi, prandaj ai ka detyrim të sjellë argumentin, kurse gruaja është mohuese, prandaj ajo ka detyrim të betohet.

Nëse do të gjykojmë sipas thënies së dytë, domethënë detyruese për shpenzimin është kontrata e martesës krahas

bindjes, mirëpo thënia e dytë është e kundërta e ajetit të Kuranit, për rrjedhojë, në këtë gjendje, burri është mohuesi, kurse gruaja është pretenduese.

Sipas shprehjes së fukahave, bazuar mbi thënien e parë, kontrata kërkon të bëhet shpenzimi, kurse urrejta, nga ana e gruas, është ndalues për shpenzimin. Por origjina është që të mos ketë ndalues, derisa të vërtetohet e kundërta. Bazuar mbi thënien e dytë, bindja është kusht që shpenzimi të bëhet detyrim, por origjina është mosekzistenca e kushtit, derisa të vërtetohet e kundërta.

b) Burri ka bërë kontratën e martesës me atë grua, por gruaja qëndron në familjen e saj për një kohë. Në këtë gjendje, bazuar mbi thënien e parë, shpenzimi për këtë grua bëhet detyrim gjatë kohës që ajo është pranë familjes së vet, për shkak të pozitës së kontratës së martesës, për të cilën ne thamë se ajo kërkon bërjen e shpenzimit për gruan. Bazuar mbi thënien e dytë, gruaja nuk e gëzon të drejtën e shpenzimit.

Në të gjitha gjendjet, shumica e fukahave kanë shkuar me dëshminë e autorëve të librave “Esh’sheràiu” dhe “El-Hadaik”, të cilët janë shprehur se thjesht kontrata e martesës nuk e bën detyrim shpenzimin, pasi krahas kontratës, patjetër duhet të vërtetohet edhe bindja nga ana e gruas.

Autori i librit “El Hadaik” ka thënë: “Nuk kam parë ndonjë që të deklarojë se thjesht kontrata e bën detyrim shpenzimin.”

Fjala më e drejtë është se thjesht bërja e kontratës, ose mospasja kontratë martese, nuk e bën detyrim shpenzimin, kurse transmetimet që flasin për bindjen e gruas ndaj burrit, në të

vërtetë, kanë ardhur për të shpjeguar të drejtën e burrit që gruaja t'i bindet atij, por s'ka argument që të tregojë as nga afër e as nga larg që bindja është kusht ose jo për shpenzimin.

Gjithashtu, këto transmetime tregojnë se shpenzimi është detyrim, ose ato transmetime kanë ardhur për të shpjeguar origjinën e detyrimit, nga pikëpamja e mendimit, pavarësisht nga bindja e urrejtja.

Tanimë ne e dimë se gruaja që i bindet burrit, meriton që për atë të shpenzohet, ashtu siç dimë se gruaja që urren burrin e saj, nuk meriton të shpenzohet asgjë për të. Kur ne dyshojmë, nëse gruaja i bindet burrit, apo ajo e urren burrin, për këtë s'ka as argument e as origjinë që të vërtetojë njërin prej dy gjendjeve të asaj gruaje, për rrjedhojë, origjina mbetet mosdetyrimi për shpenzim, derisa të vërtetohet e kundërta. Bazuar mbi këtë shpjegim, kur gruaja kërkon që për atë të shpenzohet, ajo e ka detyrim të sjellë argumente, që është grua e bindur ndaj burrit. Kur gruaja e ka të pamundur të vërtetojë kërkesën e saj me argumente, betohet burri dhe nuk pranohet pretendimi i gruas.

Vetëkuptohet se, kur ne dimë gjendjen e mëparshme të gruas se ajo me të vërtetë është grua që i bindet burrit, atëherë ne bëjmë shoqërimin e ekzistencës së bindjes dhe gjykojmë se ajo meriton shpenzimin, derisa të vërtetohet e kundërta. Kur ne dimë që ajo e urren burrin e saj, bëjmë shoqërimin e dispozitës së gruas që urren burrin, derisa të vërtetohet e kundërta, duke ditur edhe thjesht dyshimin që ajo e urren burrin, është i mjaftueshëm për të rrëzuar detyrimin për shpenzim.

Gruaja e vogël në moshë

Nuk ka shpenzim për gruan e vogël në moshë, që nuk përballon shtratin, edhe nëse burri është i madh në moshë, sepse siç u tha më sipër, thjesht bërja e kontratës së martesës, nuk e bën detyrim shpenzimin. Sipas shprehjes së autorit të librit “El Xheuahir, për shkak të moshës së vogël, ajo nuk e di ç’do të thotë dhe si është bindja e ndjekja e burrit.

Burri i vogël në moshë

Fukahatë kanë kundërshtime mes tyre, nëse është detyrim shpenzimi për gruan, kur ajo është e madhe në moshë dhe e përballon shtratin, kurse burri është aq i vogël në moshë, sa nuk di rreth procesit të seksit.

Është thënë se shpenzimi për këtë grua është detyrim, për shkak se ndalimi vjen prej burrit dhe jo prej gruas. Një grup fukahash, ndër të cilët edhe shejkh Et Tûsij dhe autori i librit “El Xhevahir” kanë thënë se nuk është detyrim dhe kjo është fjala më e drejtë, derisa pamundësia natyrale vjen nga ana e burrit. Veç kësaj, i vogli në moshë nuk është i obliguar me detyrimet e ligjit të fesë, kurse për obligimin e kujdestarit të këtij të vogli, që të paguajë shpenzimin për gruan e të voglit, s’ka argument që të detyrojë kujdestarin të shpenzojë në vend të të voglit, megjithëse, në lidhje me mosdetyrimin për shpenzim, nuk ka as dyshimin më të vogël, pasi origjina është mosshpenzim.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Sikur i pamunduri të shërohet me anë të gruas, përsëri është thënë: ‘Ka dyshim në

përgjithësimin e argumenteve, sepse ato janë urdhra e obligime për të mëdhenjtë dhe jo për të vegjlit, prandaj shpenzimi prej kujdestarit, në origjinë, paguhet, ashtu siç pohohet në librat “Keshfu Lithàm”, Err Rrijàd” dhe “Nihàjetul Muràd”.

Gruaja e sëmure

Sëmundja dhe menstruacionet ndalojnë shtratin, por shpenzimin për gruan nuk rrëzohet për shkak të këtyre dy ndaluesve. Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Pa asnjë kundërshtim, për shkak të pozitës që gëzon justifikimi ligjor ose logjik.”

Kur gruaja udhëton me lejen e burrit, shpenzimi nuk rrëzohet, sepse lejimi, nga ana e burrit, është rrëzim i të drejtës së tij dhe rrëzimi ka ardhur prej vetë burrit, prandaj mbetet e drejta e gruas ashtu siç ishte. Kjo është e barabartë, qoftë kur udhëtimi i gruas është për interesin e burrit, qoftë kur ajo udhëton për interesin e saj, qoftë udhëtim farz, ose udhëtim mustehab. Kur gruaja udhëton pa lejen e burrit, atëherë shikohet: Në qoftë se udhëtimi ndërmerret për të kryer ndonjë detyrim farz, si për shembull, gruaja udhëton për të kryer Haxhin, e drejta e shpenzimit për këtë grua nuk rrëzohet, sepse s’ka bindje ndaj të krijuarit duke kundërshtuar urdhrin e Krijuesit. Nëse udhëtimi nuk bëhet për të plotësuar ndonjë detyrim farz, për atë grua s’ka shpenzim.

Shpenzimi për gruan për kohën e pritjes ligjore

Në tërësi, a ka shpenzim për gruan që kalon kohën e pritjes ligjore, apo për këtë grua nuk ka shpenzim, apo për këtë çështje ka sqarim për shkaqe që bëjnë të detyrueshme që gruaja të kalojë kohën e pritjes ligjore? Përgjigje: Në lidhje me këtë çështje, sqarimi është si vijon:

1- Gruaja kalon kohën e pritjes ligjore për shkak të një divorci të kthyeshëm. Për këtë grua vërtetohet shpenzimi, qoftë shtatzënë, ose jo, sepse, me fjalën e përbashkët të fukahave dhe me tekst, gruaja me divorc të kthyeshëm është në dispozitën e gruas me divorc të pakthyeshëm. Prej teksteve, kemi fjalën e Imam Bakirit, babait të Imam Xhafer Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Burri s’ka detyrim të shpenzojë për gruan e divorcuar tri herë, por shpenzimi është për atë grua të cilën burrit mund të kthehet.”

2- Gruaja kalon kohën e pritjes ligjore për shkak të një divorci përfundimtar. Për këtë grua vërtetohet e drejta e shpenzimit, kur ajo është shtatzënë, pasi, me fjalën e përbashkët të fukahave dhe me tekst, s’ka shpenzim pa shtatzëni. Prej teksteve kemi fjalën e Allahut të Lartësuar:

“وَإِنْ كُنَّ أُولَاتٍ حَمْلٍ فَأَنْفِقُوا عَلَيْهِنَّ حَتَّى يَضَعْنَ حَمْلَهُنَّ”

“...nëse ato janë shtatzëna, shpenzoni për ato derisa të lindin fëmijën...” (Sure “Et Talak”, ajeti 6)

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një burrë që divorcon gruan e tij dhe ajo është shtatzënë. Deri kur ka

detyrim burri të shpenzojë për këtë grua? Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Afati i asaj gruaje është derisa të lindë fëmijën dhe burri ka detyrim të shpenzojë për atë grua, derisa ajo ta lindë fëmijën.”

Në ajetin e Kur'anit dhe në transmetimin, divorci i përmendur nuk është specifikuar se është divorc i kthyeshëm, apo është divorc i pakthyeshëm, prandaj fjala divorc i përmbledh të dy llojet e divorcit së bashku.

Fukahatë kanë kundërshtime mes tyre, nëse shpenzimi është detyrim të bëhet për gruan shtatzënë, apo për fëmijën që ajo ka në bark? Bazuar mbi këtë kundërshtim, del degëzimi: sikur shpenzimi të jetë për gruan shtatzënë, është detyrim shlyerja e atij shpenzimi, plotësisht siç është detyrim shlyerja e borxhit. Kur shpenzimi është për barrën në barkun e nënës, nuk është detyrim të shpenzohet për atë që pritet të vijë së afërmi, ashtu siç do të shikojmë më poshtë.

Thënia më e drejtë është se shpenzimi është për gruan shtatzënë dhe jo për fëmijën që ajo ka në bark, sepse fjala e Allahut të Lartësuar “shpenzoni për ato”, si dhe fjala e Imamit: “ai ka detyrim të shpenzojë për atë”, flasin qartë se shpenzimi bëhet për gruan shtatzënë dhe jo për fëmijën që ajo ka në bark.

Veç kësaj, nga pikëpamja e traditës, shtatzënia është subjekt për shpenzim, për rrjedhojë s’ka kundërshtim për këtë subjekt. Disa fukahaja janë munduar që shpenzimin ta hedhin mbi fëmijën që ajo ka në bark, duke u bazuar në fjalën: “Shpenzimi për fëmijën në barkun e nënës, realizohet me shpenzimin që bëhet për nënën e tij.”

Këtë thënie e ka komentuar autori i librit “El Xheuahir” me fjalën e tij: “Siç e shikon, kjo thënie është prej thënieve që të bëjnë të qeshësh.”

3- Gruaja kalon kohën e pritjes ligjore për shkak të vdekjes së burrit. Për këtë grua s’ka shpenzim, qoftë shtatzënë ose jo. Autori i librit “El Mesalik” ka thënë: “Mosshpenzimi për këtë grua ka ardhur në këtë transmetim me mbështetës që merren në konsideratë dhe, bazuar mbi mosshpenzimin, kanë punuar fukahatë e mëvonshëm, pasi kjo është thënia më e fuqishme.”

Autori i librit “El Xhevahir” ka thënë: “S’ka vend të thuhet kjo fjalë.”

Prej këtyre transmetimeve të gradës “Sahijh”, kemi transmetimin e përcjellë prej Zerares, prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*). Zurara tregon: “E pyeta Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*) për një grua që i ka vdekur burri, nëse është detyrë të shpenzohet për të.” Ai (*Paqja qoftë mbi të!*) m’u përgjigj: “Jo.”

Në një transmetim të dytë, të gradës “Sahijh”, tregohet se Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është pyetur për një grua shtatzënë, së cilës i ka vdekur burri dhe ajo është duke kaluar kohën e pritjes ligjore. Ka shpenzim për këtë grua? Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Jo.”

Gruaja nëpunëse

Referohu në pjesën e katërt të këtij libri, në kapitullin “Qiradhënia”, në paragrafin “Gruaja nëpunëse”.

Çështje

1- Për gruan ithtare të librave të mëparshëm (çifute e kristiane), shpenzimi është detyrim, plotësisht siç është detyrim për gruan myslimane. Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Pa asnjë kundërshtim e pa asnjë komplikim.”

2- Kur gruaja del jashtë shtëpisë së burrit pa lejen e tij, ose gruaja nuk pranon të banojë në një shtëpi të cilën ajo e konsideron të papërshtatshme, me fjalën e përbashkët të fukahave, kjo grua numërohet si grua që urren burrin.

3- Gruaja i bindet burrit të saj në shtrat dhe banon me burrin aty ku dëshiron burri, por gruaja i flet burrit me fjalë të ashpra, i qëndron fytyrëngrysur dhe e kundërshton në shumë punë që ai bën. Nëse çështja qëndron kështu dhe këtë sjellje ajo e ka në karakter, thënë ndryshe, është gatuar, është brumosur e tillë, madje ajo kështu sillet edhe me nënën e me babain e saj, në këtë gjendje, kjo grua konsiderohet urryese për burrin. Nëse ajo nuk është e tillë si karakter, pasi me të tjerët ajo ka sjellje korrekte, përveç burrit të saj, padyshim që kjo grua numërohet si grua që e urren burrin e saj, për rrjedhojë nuk meriton që burri të shpenzojë për këtë grua.

4- Kur gruaja refuzon të ndjekë burrin e saj, derisa ajo të marrë në dorë shumën e saj të kurorës, në këtë gjendje, shikohet, në qoftë se ajo i është dhënë burrit, qoftë edhe një herë të vetme, pas kësaj ajo s’ka më të drejtë ta refuzojë burrin. Nëse e refuzon, numërohet si grua që e urren burrin, por, nëse ajo, në mënyrë absolute, nuk i është dhënë burrit, për shkak se nuk ka marrë

shumën e saj të kurorës, kjo grua nuk numërohet si grua që urren burrin, prandaj ajo ka të drejtë që burri të shpenzojë për të.

5- Kur gruaja e refuzon burrin e saj për shkak të shpenzimit, ose për shkak të shumës së kurorës, nëse burri nuk është në gjendje të mirë, për rrjedhojë s'ka mundësi të mbajë fjalën e dhënë, shpenzimi për këtë grua rrëzohet, sepse, në këtë gjendje ajo, duke refuzuar burrin, i bën padrejtësi burrit. Nëse burri është në gjendje të mirë dhe e shtyn dhënien, në këtë gjendje, ai që bën padrejtësi, është burri, prandaj mbetet shpenzimi për gruan.

6- Kur gruaja divorcohet në gjendjen e saj si grua që urren burrin, ajo nuk e meriton shpenzimin. Gjithashtu, kur gruaja është duke kaluar kohën e pritjes ligjore për shkak të një divorci të kthyesëm dhe gjatë kësaj kohe ajo tregon urrejtje ndaj burrit, shpenzimi për këtë grua rrëzohet. Nëse ajo i rikthehet bindjes, asaj i kthehet e drejta e shpenzimit, plotësisht siç shpenzohet për gruan e padivorcuar.

Zakoni dhe shpenzimi për gruan

Në lidhje me caktimin e masës së shpenzimit për gruan, s'ka ndonjë bazë ligjore, prandaj ligji i fesë caktimin e shpenzimit për gruan e ka referuar me zakonin, domethënë ajo çka njerëzit e konsiderojnë të quhet e domosdoshme të shpenzohet për gruan, atë shpenzim do të ketë edhe për të. Kur shikojmë se në disa transmetime ka ardhur ndonjë lloj përcaktimi në lidhje me masën e shpenzimit për gruan, në të vërtetë, qëllimi më këtë përcaktim është që të shpjegohet detyrimi që kanë njerëzit, sepse Ligjvënësi,

në shumë raste, nuk flet për një çështje, duke pasur parasysh vetëm njërin individ të shoqërisë.

Gjithashtu, Ligjvënësi nuk përcakton as me cilësinë e tij ligjore, siç është fjala e tij: “Ditën e Bajramit le të hanë ushqimet më të mira”. Në zakonin e njerëzve shpenzimi për gruan përfshin: ushqimin, veshmbathjen, banesën,, shërbyeset e pajisjet, që është zakon t’i kenë gratë e rangut të saj.

Në lidhje me shpenzimin për gruan, patjetër duhet të marrim në konsideratë gjendjen materiale të burrit, plotësisht ashtu siç deklaroi qartë Kurani Famëlartë:

“لِيُنْفِقَ ذُو سَعَةٍ مِّن سَعَتِهِ ۖ وَمَن قُدِرَ عَلَيْهِ رِزْقُهُ فَلْيُنْفِقْ مِمَّا آتَاهُ اللَّهُ ۚ لَا يُكَلِّفُ اللَّهُ نَفْسًا إِلَّا مَا آتَاهَا ۚ سَيَجْعَلُ اللَّهُ بَعْدَ عُسْرٍ يُسْرًا”

“I pasuri le të shpenzojë sipas mundësisë që ka dhe ai që është ngushtë nga gjendja, le të shpenzojë prej asaj që i ka dhënë Allahu; asnjërin nuk e ngarkon Allahu me më shumë nga sa i ka dhënë; Allahu bën që pas gjendjes së vështirë, të vijë gjendja e mirë.” (Sure Et Talàk”, ajeti 7)

Gjithashtu, Allahu i Lartësuar thotë:

“أَسْكِنُوهُنَّ مِمَّا فِي بَيْتِكُمْ مِّنْ حَيْثُ سَكَنْتُمْ ۚ وَمَن جُرْحَتْكَ فَرِيقَتَيْنِ مِّنْهُنَّ فَاصْلَاهُ ۚ

“Sipas mundësisë që keni, i veni ato (gratë e divorcuara) të banojnë aty ku banoni vetë...” (Sure “Et Talàk”, ajeti 6)

Gruaja ka të drejtën e plotë të jetojë me burrin e saj në shtëpi më vete, pa qenë së bashku me të asnjëri prej të afërmeve të

burrit, me përjashtim të shemrës, ashtu siç është fjala e Allahut të Lartësuar:

“أَسْكِنُوهُنَّ مِنْ حَيْثُ سَكَنْتُمْ مِنْ وُجْدِكُمْ وَلَا تُضَارُوهُنَّ لِيُضَيِّقُوا عَلَيْهِنَّ”

“...ato (gratë) veni të banojnë aty ku banoni vetë dhe mos i dëmtoni ato duke i shtrënguar...” (Sure “Et Talàk”, ajeti 6)

Pagesa për mjekim

Më sipër thamë që pikë referimi, në lidhje me caktimin e shpenzimit për gruan, është zakoni i vendit dhe, sipas zakonit, çdo gjë për të cilën ka nevojë gruaja, ajo gjë në këndvështrimin e zakonit, bën pjesë në shpenzimin për gruan. Vetëkuptohet që nevoja për ilaçe e për mjekim është më e madhe se nevoja për ushqim, veshmbathje, banesë, shërbyes, ose “për të kuqe e për të bardhë”, domethënë, derisa këto që u thanë bëjnë pjesë në shpenzimin për gruan, padyshim që shpenzimi për mjekim ka përparësi.

Shpenzimi për kohën e lehonisë

Shpenzimi për kohën e lehonisë është detyrim për burrin, kur këtë shpenzim e dikton nevoja.

Garancia për shpenzimin e gruas

A ka të drejtë gruaja t'i kërkojë burrit një garantues, që të garantojë shpenzimin për atë në të ardhmen, kur ajo ka vendosur të udhëtojë, e pashoqëruar prej burrit dhe burri nuk i ka lënë asaj asnjë send?

Shumica e fukahave kanë thënë se gruaja nuk e ka këtë të drejtë, sepse shpenzimi për gruan nuk vërtetohet, kur gruaja është larg burrit, për shkak se kërkohet garantim për një send që nuk është detyrim, por kjo gjë nuk lejohet.

Ne mendojmë se gruaja ka të drejtë të kërkojë garanci, sepse shkak për garancinë është i realizueshëm, pasi ekziston shkak që e bën detyrim shpenzimin për gruan dhe ky shkak është martesë, krahas mosurrejtjes nga ana e gruas për burrin e saj.

Veç kësaj, s'ka argument për të mos e lejuar garantimin e saj, edhe pse garantimi nuk është detyrim.

Sej'jid El Jezdij, në librin "El Urvetul Vuthkà", në kapitullin "Garantimi", në "Çështja 38", ka thënë: "S'ka ndonjë ndalues që të ndalojë garantimin e asaj që nuk është detyrim, pasi është vërtetuar domosdoshmëria. Gjithashtu, s'ka argument as me tekst e as me fjalën e përbashkët të fukahave për pavlefshmërinë e garantimit. Madje në shumë burime, fukahatë kanë gjykuar për vlefshmërinë e garantimit."

Kurse në "Çështja 35", autori i lartpërmendur ka thënë: "Nuk përjashtohet vlefshmëria e garantimit të shpenzimit në të

ardhmen për gruan, sepse është e mjaftueshme ekzistenca e asaj që e bën të detyrueshme, domethënë martesë.”

Sej’jid El Hakijm, në librin “Minhàxhu sSàlihijn”, në vëllimin 2, në kapitullin “Dorështrenguari në shpenzime”, ka thënë: “Është fare i qartë rrëzimi i shpenzimit në të gjitha kohët e ardhshme. Padyshim se, kur lejohet rrëzimi i shpenzimit, lejohet të kërkohet edhe garantimi.”

Shejkh Amed Kàshiful Gitài, në librin “Sefijnetu Nexhàt, në kapitullin “Garantimi”, ka thënë: “Fjala për vlefshmërinë nuk përjashtohet, nëse ky përjashtim nuk ka fjalën e përbashkët të fukahave, prandaj shpenzimi për gruan në të ardhmen, garantohet ashtu siç garantohet për të kaluarën e për të tashmen.”

Kur çështja arrin të referohet në fjalën e përbashkët të fukahave, duke ditur se çdo fjalë e përbashkët e fukahave është vënë pas kohës së imamëve të pastër, ajo fjalë e përbashkët mund të atakohet. Kur ne hamendësojmë që argumenti mbështetës për këtë fjalë të përbashkët këtu është besimi i atyre që thonë se shpenzimi për të ardhmen nuk lejohet të garantohet, sepse është garantim për një send që nuk është detyrim, pra, kur ne hamendësojmë kështu, me fjalën e përbashkët të fukahave, bie nxjerrja e argumentit, sepse ai është argument vetëm kur bëhet e qartë plotësisht se ai është mendimi i Imamit të ruajtur prej mëkateve. Vetëkuptohet që hamendja është në kundërshtim me atë që dihet qartë.

Kemi folur në mënyrë të detajuar për garantimin e asaj që nuk është detyrim, në lidhje me shpenzimin për gruan në të

ardhmen, në pjesën e katërt të këtij libri, në kapitullin “Garantimi”, në paragrafin “E drejta e garantuar”.

Prishja, dhurata, pajtimi

Ashtu siç lejohet garantimi e rrëzimi i shpenzimit për të ardhmen, po ashtu lejohet edhe pajtimi në lidhje me shpenzimin me një shumë të caktuar, për të cilën kanë rënë në marrëveshje të dyja palët, por lejohet edhe rrëzimi i shpenzimit me një herë të vetme. Gruaja e merr në pronësi shpenzimin, vetëm kur e merr në dorë shumën e caktuar, sipas transmetimit të përcjellë prej Shihab bin Abd Rab’beh, prej Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili, në këtë transmetim, duke folur në lidhje me shpenzimet për të afërmit, ka thënë: “I pari i familjes le të caktojë ushqimin për secilin prej individëve të familjes së tij. Nëse ai do, i jep të hajë, nëse do, ia dhuron, ose nëse ai do, ia jep si sadaka.”

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Transmetimi i shkallës “Sahijh” i përcjellë prej Shihabit tregon se marrja në pronësi e shpenzimit para mundësisë, është i ngjashëm me gusulin e ditës së xhuma, të bërë ditën e enjte, ose është i ngjashëm me dhënien e sadakasë së Fitrit para hyrjes së hënës.”

Autori i librit “El Hadaik” ka thënë: “Gruaja e ka të drejtën e shpenzimit në formën e marrjes së shumës në pronësi dhe jo në formën e përfitimit, sepse përfitimi prej shpenzimit plotësohet vetëm atëherë kur vetë shpenzimi është asgjësuar si shumë.”

Bazuar mbi këtë që u tha, kur burri paguan për gruan e tij shumën e shpenzimit për ditët që do të vijjnë dhe më pas ajo

shumë humb ose prishet në dorën e gruas, burri nuk ka detyrim të paguajë për herë të dytë. Kjo është e barabartë, qoftë kur humbja e prishja ka ardhur prej ndonjë force madhore, qoftë kur humbja e prishja ka ardhur prej shkujdesjes e abuzimit me atë shumë.

Autori i librit “El Mesalik” ka thënë: “Edhe sikur shpenzimi të jetë marrë në formë zotërimi, qoftë edhe kur asaj i është vjedhur shuma e shpenzimit, ose shpenzimi është asgjësuar, burri s’ka detyrim të japë shumën e shpenzimit edhe një herë tjetër, madje edhe nëse humbja e prishja ka ardhur për shkak të shkujdesjes së gruas.”

Pyetje: Kur burri i jep në dorë gruas shumën e shpenzimit për një kohë të caktuar dhe më pas ai e divorcon gruan, ose ajo e refuzon burrin para përfundimit të kësaj kohe të caktuar, a i kthehet burrit shuma që i dha gruas për shpenzim?

Përgjigje: Patjetër që shuma i kthehet burrit dhe ky kthim nuk bie në kundërshtim me marrjen në pronësi të shumës së shpenzimit, sepse subjekti për këtë shpenzim është martesë e bindja nga ana e gruas. Kur njëri prej këtyre dy elementeve bie, bie edhe subjekti, për rrjedhojë shuma e shpenzimit i kalon një tjetri dhe nuk mbetet te ajo, plotësisht ashtu siç e ka në pronësi njeriu pasurinë e vet, derisa është gjallë dhe kur ai vdes, pasuria i kalon një tjetri, ose të tjerëve.

Në tërësi, shkaqet e kalimit të pasurisë prej një personi në një person tjetër, janë të shumta dhe nuk mund të përmbliidhen vetëm në rastet që kanë përmendur fukahatë, përderisa për këtë çështje nuk ka ardhur ndonjë ajet i Kuranit ose ndonjë transmetim. Ne shprehemi kështu, ngaqë dimë se nuk kemi

nevojë të kemi ndonjë direktivë të veçantë për këtë çështje, derisa për çështjen në fjalë ekziston teksti, i cili është jo vetëm parametër për dispozitat, por është edhe burimi nga janë nxjerrë dispozitat.

Shlyerja e shpenzimit për gruan

Me fjalën e përbashkët të fukahave, shpenzimi për gruan shlyhet ashtu siç shlyhet borxhi. Kur burri ka për të marrë prej gruas së tij borxhin që ajo i ka marrë burrit të saj, për burrin lejohet të mbajë borxhin që i ka dhënë gruas prej shpenzimit që ai bën për gruan e tij, prej shpenzimeve që ka bërë dhe prej shpenzimeve që do të bëjë për gruan në të ardhmen, me kusht që gruaja të jetë e pasur.

Nëse gruaja është e varfër, burrit nuk i lejohet që borxhin që i detyrohet gruaja, ta mbajë prej shumës që ai ka detyrim të shpenzojë për gruan, sepse shlyerja e borxhit bëhet detyrim kur borxhmarrësi është në gjendje të mirë dhe jo kur ai është në vështirësi.

E divorcuara pretendon se është shtatzënë

Më sipër u shpjegua se gruaja e divorcuar ka të drejtën e shpenzimit, kur ajo është shtatzënë dhe nuk e ka këtë drejtë nëse nuk është shtatzënë. Nëse dihet që gruaja është shtatzënë, burri që e ka divorcuar, ka detyrim t'i dorëzojë asaj shumën e shpenzimit, por burri nuk ka dijeni që ajo është shtatzënë dhe kemi vetëm pretendimin e gruas. Në këtë gjendje, a duhet të merret si e vërtetë fjala e gruas apo jo?

Përgjigje: Fjala e gruas merret si e vërtetë, sipas fjalës së Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): “Allahu ka lënë në dorën e grave tri gjëra (të besohen kur pohojnë): menstruacionet, kohën e tyre të pastrimit dhe shtatzëninë.”

Bazuar mbi këtë transmetim, kur shtatzania bëhet e qartë, atëherë veprohet ashtu siç u tha më sipër, ndryshe burri që e ka divorcuar atë grua, ka të drejtë të kërkojë prej gruas që ajo t'i kthejë shumën që i ka paguar asaj për shpenzimet, bazuar në hadithin: “Dora marrëse ka detyrim të shlyejë ato që ka marrë, derisa të plotësohet shlyerja”, si dhe në hadithin tjetër: “Kush prish pasurinë e tjetrit, prishësi është garantues për pasurinë e prishur”.

Konflikti

1- Të dy bashkëshortët kanë mosmarrëveshje në lidhje me shpenzimin dhe burri pohon se gruaja e ka marrë shpenzimin që i takon, kurse gruaja thotë se ai kurrë s'ka shpenzuar. Burri thotë se ka shpenzuar. Në këtë gjendje, shikohet, në qoftë se gruaja banon me burrin në të njëjtën shtëpi, merret në konsideratë fjala e burrit. Nëse bashkëshortët banojnë secili më vete, merret në konsideratë fjala e gruas.

2- Kur burri pohon se ai nuk ka shpenzuar për gruan me pretendimin se ajo e refuzon atë, por nuk dihet gjendja e mëparshme e gruas, nëse ajo ishte e bindur ndaj burrit, apo e refuzonte burrin, në këtë gjendje, mbetet detyrim të vërtetohet që ajo është grua që i bindet burrit. Për të vërtetuar se ajo është grua e bindur ndaj burrit të saj, mjafton fakti që gruaja banon në atë

shtëpi ku e ka vënë burri të banojë, ose gruaja ka kërkuar prej burrit që ai të përgatisë për të një banesë të mirë dhe ai nuk e ka përgatitur banesën në përputhje me kërkesën e gruas, pa përmendur të tjera fakte që bëjnë të qartë se burri ka ndjekur fjalën e gruas. Në këtë gjendje, nuk pranohet dëshmia e grave, qoftë kur gratë dëshmojnë veç e veç, qoftë kur dëshmojnë së bashku.

3- Gruaja largohet prej shtëpisë së burrit, duke sjellë si argument se ai e ka përzënë, ose ai i ka dhënë leje që ajo të dalë jashtë shtëpisë, kurse burri e hedh poshtë fjalën e gruas. Në këtë gjendje, gruaja ka detyrim të sjellë argumente dhe burri ka detyrim të betohet.

4- Pas bërjes së kontratës së martesës, gruaja qëndron për një kohë në shtëpinë e babait të saj dhe më pas ajo i kërkon burrit shpenzimin për këtë kohë. Në këtë gjendje, për këtë grua vërtetohet e drejta e shpenzimit, nëse burri ka kryer marrëdhënie intime me të, ose kur ajo ka treguar qartë se do jetë e bindur e do ta ndjekë burrin atëherë kur burri t'i paguajë asaj shumë e përshpejtuar të kurorës.

5- Dy bashkëshortët janë në një fjalë se ai e ka divorcuar gruan dhe se ajo ka lindur fëmijën, por gruaja thotë: "Më parë unë kam lindur fëmijën dhe pastaj ai më divorcoi, kështu që unë jam duke kaluar kohën e pritjes ligjore, për rrjedhojë ai ka detyrim të shpenzojë për mua gjatë kohës së pritjes.", kurse burri thotë: "Jo, më parë e kam divorcuar dhe pastaj ajo lindi fëmijën, kështu që tani ajo nuk po kalon kohën e pritjes ligjore, për rrjedhojë nuk ka të drejtë ta marrë shpenzimin." Në këtë gjendje, cili prej dy bashkëshortëve është pretenduesi dhe cili është mohuesi?

Gruaja mund t'i thotë burrit: "Më parë më divorcove dhe pastaj unë linda fëmijën, për rrjedhojë nuk ke të drejtë të kërlesh gjë prej meje, sepse unë nuk po kaloj kokën e pritjes ligjore."

Mirëpo burri thotë: "Jo, më parë ti linde fëmijën dhe pastaj unë të kam divorcuar, prandaj unë kam të drejtë të kërkoj prej teje."

Në këtë gjendje, cili është pretenduesi dhe cili është mohuesi?

Në lidhje me këtë çështje, fukahatë kanë shumë thënie. Thënia më e vërtetë është: Merret në konsideratë fjala e gruas, krahas betimit të saj në të dyja gjendjet, kurse burri ka detyrim të sjellë argumentin, për shkak se puna e kalimit të kohës së pritjes ligjore është në dorën e gruas, qoftë kur mohohet, qoftë kur vërtetohet, ashtu siç e pamë më sipër në fjalën e Imam Sadikut (*Paqja qoftë mbi të!*): "Allahu ka lënë në dorën e grave tri gjëra (të besohen kur pohojnë): menstruacionet, kohën e tyre të pastrimit dhe shtatzëninë."

Në një transmetim të dytë është shtuar edhe fjala: "...edhe koha e pritjes ligjore."

Sej'jid El Jezdij, në librin *Mulhakàtul Urveh*", ka thënë: "Për këtë çështje ka tri thënie. Thënia më e fuqishme është thënia që pohon përparësinë për fjalën e gruas, për shkak se puna e kalimit të kohës së pritjes ligjore është në dorën e saj."

Bazuar mbi këtë shpjegim, kur burri pretendon se divorci ka ndodhur para se ajo të lindë fëmijën dhe gruaja e ka përfunduar kohën e pritjes ligjore, mirëpo burri e ka të pamundur të sjellë argument, në këtë gjendje, gruaja betohet dhe vendoset që

ajo të marrë shumën e shpenzimit. Nuk lejohet që burri të kërkojë prej gruas thjesht për shkak të pohimit të tij, ashtu siç nuk i lejohet gruas që vetëm me pohimin e saj të martohet, pa plotësuar kohën e pritjes ligjore.

Shpenzimi për të afërmit

Prindërit kanë detyrim të shpenzojnë për fëmijët e tyre, meshkuj e femra. Gjithashtu, është detyrim për fëmijët të shpenzojnë për prindërit e tyre, meshkuj e femra, sado larg të shkojnë, por nuk është detyrim shpenzimi për vëllezërit, xhaxhallarët e dajallarët. Dikush e ka pyetur Imam Sadikun (*Paqja qoftë mbi të!*): “Për cilin kam detyrim të shpenzoj?”

Imam Sadiku (*Paqja qoftë mbi të!*) është përgjigjur: “Për dy prindërit, fëmijën dhe gruan.”

Fjala “dy prindërit”, përmbledh gjyshërit e gjyshet, kurse fjala “fëmija”, me fjalën e përbashkët të fukahave përfshin edhe fëmijët e fëmijëve.

Kushti

Për këtë shpenzim nuk është detyrim që i afërmi për të cilin bëhet shpenzimi të jetë njeri i drejtë, ose të jetë mysliman. Autori i librit “El-Xhevahir” ka thënë: “Është detyrim shpenzimi për origjinat e për degët, madje edhe sikur origjina të jetë mëkatore, ose mohuese. Është kështu pa asnjë kundërshtim, për shkak se argumentet që e bëjnë detyrim shpenzimin për të afërmin, janë të

pakushtëzuara, në mënyrë të veçantë, shpenzimi për të dy prindërit, për të cilët urdhërohet të respektohen e të trajtohen me mirësi, edhe nëse ata të dy janë mohues të fesë.” Kjo gjë theksohet në ajetin 15 të sures “Lukmàn”:

”وَإِنْ جَاهِدَاكَ عَلَىٰ أَنْ تُشْرِكَ بِي مَا لَيْسَ لَكَ بِهِ عِلْمٌ فَلَا تُطِعْهُمَا ۖ وَصَاحِبُهُمَا فِي الدُّنْيَا مَعْرُوفًا ۚ

“Nëse ata të dy (baba e nëna) përpiqen që ti të bësh për Mua shok, megjithëse ti për këtë s’ke asnjë dijeni, ti mos iu bind atyre, por në punët e kësaj bote shoqëroi ata me mirësi...”

Siç shihet, ajeti i nderuar nuk e ka ndaluar njeriun që ai t’i trajtojë me mirësi prindërit e tij idhujtarë, në të kundërt, ajeti i nderuar ka bërë detyrim që fëmija t’i trajtojë me mirësi në punët e kësaj bote prindërit e tij idhujtarë. Fjalët e tekstit të ajetit e bëjnë fare të qartë detyrimin e fëmijës për t’i trajtuar me mirësi prindërit e tij, edhe kur prindërit janë idhujtarë.

Kushti themelor që e bën detyrim shpenzimin për të afërmin, është që ky i afërm të jetë i varfër dhe i pafuqishëm që të sigurojë ushqimin e mjetet e jetesës, kurse ai që shpenzon, të jetë i pasur dhe ka fuqi të shpenzojë edhe për të tjerët. Vetëkuptohet që mundësia në detyrimet është kusht me Librin e Allahut, me hadithin profetik dhe me fjalën e përbashkët të fukahave.

Pyetje: Që shpenzimi për të afërmin të bëhet detyrim, a është kusht që i afërmi për të cilin shpenzohet, të jetë i pafuqishëm për të fituar, në atë mënyrë që ai s’ka fuqi të punojë, ose nuk gjen një punë të atillë me të cilën të sigurojë nevojat ditore?

Përgjigje: Çdo person që ka fuqi të fitojë dhe të bëjë një punë në përshtatje me gjendjen e tij, për këtë njeri nuk është

detyrim të shpenzohet, qoftë ky person baba, ose fëmija, ashtu siç është fjala e të Dërguarit më të madh (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*): “Në sadakanë s’ka pjesë as për të pasurin e as për të fuqishmin që fiton.”

Autorët e librave “Esh Sher’au” dhe “El Xheuahir” kanë thënë: “Në të vërtetë, shpenzimi është bërë detyrim për të plotësuar nevojën, kurse ai që ka mundësi të fitojë, është si i pasuri. Për këtë arsye, atij nuk i jepet prej zekatit e prej sadakave, pasi dhënia e zekatit dhe e sadakave është e kushtëzuar me varfërinë.”

Më sipër, në lidhje me këtë çështje, kemi folur me hollësi në pjesën e tretë të këtij libri, në vëllimin 2, në kapitullin “Ata që kanë të drejtë të marrin zekat”, në paragrafin “Ai që pretendon se është i varfër”.

Kuptimi i fjalës “fuqia e shpenzuesit për të shpenzuar për të afërmin e tij”, do të thotë teprica prej prodhimit të tij, ose ajo që tepron prej shpenzimeve vetjake për shpenzuesin dhe për gruan e tij, domethënë, ajo që tepron prej shpenzimit që bën burri për veten e tij dhe për gruan e tij. Pikërisht kjo tepriçë është detyrim t’i shpërndahet nënës e babait dhe fëmijëve.

Shpenzimi për të afërmin dhe martesë

Detyrimi për të shpenzuar për të afërmin është plotësimi i nevojave të dorës së parë, si: buka e gjella, veshmbathja e banesa, sepse këto janë prej domosdoshmërive për të ruajtur jetën e për të

sprapsur dëmin. Vetëkuptohet që domosdoshmëria vlerësohet me vetë domosdoshmërinë.

Djali s'ka detyrim të martojë babain e tij, por as babai s'ka detyrim të martojë djalin e tij, madje as atëherë kur të dy kanë nevojë për martesë, pasi shpenzimi për të afërmin, në asnjë mënyrë, nuk bëhet për martesën e të afërmit, sepse origjina është mosshpenzimi.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Nuk është detyrim heqja dorë prej shpenzimit për një person për të cilin shpenzimi është detyrim, baba ose fëmijë. Për këtë s'ka asnjë kundërshtim me të cilin mund të atakohet detyrimi për shpenzim."

Shlyerja e shpenzimit për të afërmit

Në mënyrë të prerë shlyhet shpenzimi për gruan. Kjo është e barabartë, qoftë kur për këtë shpenzim ka vendosur ose jo gjykatësi, qoftë kur gjykatësi e ka urdhëruar, ose nuk e ka urdhëruar gruan të marrë borxh, kurse shpenzimi për të afërmin nuk shlyhet, as atëherë kur sasinë e shpenzimit e vlerëson gjykatësi dhe urdhëron për këtë shpenzim, sepse vlerësimi i shpenzimit varet nga vetë shpenzimi, prandaj gjykimi i gjykatësit, në lidhje me shpenzimin, nuk mund të jetë më shumë se origjina detyrim për të shpenzuar, vetëkuptohet vetëm nëse gjykatësi urdhëron marrjen borxh, kurse borxhi i marrë për shpenzimet e të afërmit nuk shlyhet, sepse puna e të afërmit është në pozitën e atij që ka një lidhje.

Autori i librit “El Xheuahir” ka thënë: “Nuk shlyhet shpenzimi për të afërmin, sepse ky shpenzim është bamirësi për të plotësuar nevojën dhe nuk bëhet si detyrim, edhe nëse shumë e shpenzimit e cakton gjykatësi. Patjetër që, kur gjykatësi e urdhëron personin që do të shpenzojë për të afërmin të marrë borxh dhe ai merr borxh, borxhi është detyrim të shlyhet në respekt të urdhrit të gjykatësit dhe pozitës së urdhrit të tij si kujdestar për këtë çështje.”

Autori i librit “El Mesalik” bën dallim mes shpenzimit për gruan dhe shpenzimit për të afërmin dhe ka thënë: “Qëllimi me shpenzimin për të afërmin është mëshirë dhe plotësim nevoje dhe nuk është kompensim. Nëse ai që ka pasuri, nuk shpenzon për të afërmin, ka kryer një mëkat, megjithëse nuk e ka detyrim të shpenzojë për të afërmin e tij, për rrjedhojë nuk është detyrim që ai të shlyejë shpenzimin për të afërmin, pasi shpenzimi për këtë të afërm është i ngjashëm me shpenzimin për të ndihmuar një nevojtar, i cili, me të vërtetë, ka nevojë për ndihmë, prandaj shpenzimi për të afërmin është e kundërta e shpenzimit për gruan, sepse shpenzimi për gruan është kompensim kundrejt kënaqësisë që burri përjeton me gruan. Nga kjo pikëpamje është si shkëmbim mallrash. Nëse burri nuk e shlyen shpenzimin për gruan, ai shpenzim mbetet detyrim mbi burrin, prandaj burri patjetër duhet ta shlyejë këtë detyrim.”

Duhet të tërhiqet vëmendja se, kur i afërmi arrin të sigurojë shpenzimin për një ditë, ose edhe për më shumë se një ditë, për shembull, është i ftuar në një dasmë, ose i bëhet një dhuratë, ose i jepet prej zekatit dhe prej të drejtave, ose i jepet prej burimeve të tjera, shpenzimi për këtë të afërm bie në masën e asaj që ai ka arritur të sigurojë prej shpenzimit, madje edhe atëherë kur

gjykatësi ka urdhëruar shpenzimin për këtë të afërm, ose ka urdhëruar që shpenzimi për këtë të afërm të merret borxh.

Në radhë të parë vetja, pastaj grua, pastaj të afërmit

Kur një person ka detyrim të shpenzojë për shumë nevojtarë që kanë nevojë për shpenzim nga ana e tij, por ai s'ka mundësi t'i mbulojë shpenzimet për të gjithë ata të afërm, por ka mundësi të mbulojë shpenzimin vetëm për disa prej tyre, në këtë gjendje, cili prej atyre nevojtarëve ka përparësi që ai të shpenzojë dhe cilin prej atyre duhet të lërë për më vonë?

S'ka dyshim se, kur ai ka fuqi të përballojë shpenzimet për të gjithë, patjetër që e ka detyrim të shpenzojë për të gjithë, ndryshe ai fillon me shpenzimin për vetveten, sepse vetvetja ka përparësi mbi të gjitha të drejtat e tjera, siç është shlyerja e borxhit e të tjera detyrime. Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Pa asnjë kundërshtim e pa asnjë komplikim, për shkak të rëndësisë së madhe që ka vetvetja te Ligjvënësi."

Në qoftë se pas shpenzimit për veten e tij, i tepron ndonjë gjë, ai duhet të fillojë të shpenzojë për gruan e vet, për shkak se shpenzimi për gruan vërtetohet me rrugën e shkëmbimit dhe jo me rrugën e plotësimit të nevojave e të bamirësisë, domethënë veprohet sipas rregullit: "Për të afërmin s'ka asnjë shpenzim, nëse nuk tepron gjë pas shpenzimit për gruan."

Nëse pas shpenzimit për gruan tepron ndonjë send, kjo teprice ndahet në mënyrë të barabartë midis të afërmeve. Babai s'ka të drejtë të preferojë njërin prej fëmijëve të tij më shumë se fëmijët

e tjerë, po kështu s'ka të drejtë djali që të bëjë dallim mes prindërve në shpenzimin për ta. Ky është ligji e gjykimi i fesë, edhe nëse zakoni është në kundërshtim me ligjin e fesë.

Autori i librit "El Xheuahir" ka thënë: "Kur tepron aq sa është e mjaftueshme për babain e për fëmijët, babai e fëmija janë të barabartë në këtë tepricë, pasi detyrimi është që ata të dy kanë të drejtë të shpenzohet për ta, sepse, si nivel afërsie, ata janë të barabartë. Kur supozohet se prej tepricës përfiton vetëm njëri prej të afërmve, në një kohë kur të afërmit janë dy ose më shumë dhe janë të barabartë nga shkalla e afërsisë, në këtë gjendje, i rikthehemi shortit, pasi me short shmanget mundësia që të ndodhë ndonjë anim ndaj ndonjërit prej të afërmve. Shorti do të hidhet, vetëm pasi të vërtetohet barazia në shkallën e afërsisë. Nisur nga ky shpjegim, babai ka përparësi ndaj gjyshit, sepse babai është më i afërm te djali se gjyshi me djalin. Kështu është edhe nëna, e cila për të njëjtin shkak ka përparësi ndaj gjyshes."¹

Personat për të cilët shpenzohet dhe edukimi i tyre

Fukahatë ndajnë një fjalë të përbashkët me dëshminë e autorit të librit "El Xheuahir" dhe autorit të librit "El Mesalik", që shpenzimi për fëmijën është detyrim mbi babain. Nëse babai vdes, ose babai është në gjendje të vështirë, detyrimi për të shpenzuar për fëmijën i kalon gjyshit nga ana e babait. Në qoftë se babai vdes dhe është i pasur, detyrimi për të shpenzuar për fëmijën i kalon nënës së fëmijës dhe pas nënës, sipas radhës, në mënyrë të

¹ Kemi cituar frazën e autorit të librit "El Xheuahir", krahas veprimit me fjalët, por kemi ruajtur kuptimin, me qëllim shkurtimi e qartësimi.

barabartë, vjen: babai i nënës, nëna e nënës dhe nëna e babait. Këta të tre, domethënë gjyshi, gjyshja e nëna, të tre së bashku, marrin pjesë në mënyrë të barabartë në shpenzimin për fëmijën, nëse të tre janë të pasur. Ndryshe, ai që është i pasur prej këtyre të treve, merr përsipër shpenzimet për fëmijën.

Kur i afërmi ka babain së bashku me djalin, ose babain së bashku me të bijën, shpenzimin ai e ndan mes atyre të dyve në mënyrë të barabartë. Gjithashtu, shpenzimi shpërndahet në mënyrë të barabartë, edhe kur janë disa fëmijë, por pa asnjë dallim mes meshkujve e femrave. Në tërësi, në lidhje me përparësinë për shpenzim, patjetër duhet të bëhet kujdes të ruhet renditja sipas afërsisë, më i afërmi, pastaj i afërmi, përveç babait e gjyshit, të cilët ai i jep përparësi para nënës, krahas barazisë në gradën e të afërmve, me përjashtim të nënës e të babait, shpenzimet për të cilët shpërndahen në mënyrë të barabartë pa dallim as mes meshkujve e femrave dhe as mes degëve e origjinave, përveçse duke i dhënë përparësi babait e gjyshit të tij ndaj nënës, ashtu siç u tha më lart.

Ai që pretendon se është i varfër

Më sipër u shpjegua se shpenzimi për të afërmin është detyrim, vetëm nëse i afërmi është i varfër dhe i pafuqishëm për punë. Bazuar mbi këtë fat, ai pretendon se është i varfër. Në qoftë se ky pretendues ka pasuri të dukshme, pretendimi i tij nuk pranohet. Nëse i afërmi i tij i pasur e beson pretendimin e tij, shpenzimi për këtë pretendues mbetet detyrim mbi të afërmin e pasur, por, nëse i afërmi i pasur e përgënjeshton pretendimin e të

afërmit të tij që ai është i varfër, i pasuri ka detyrim të sjellë argumente që pretenduesi është i pasur. Nëse ai s'ka mundësi të sjellë argumente, kërkuesi i shpenzimit betohet, sepse pasuria dhe gjendja e mirë materiale janë gjendje që ndodhin, por si origjinë është mospasurimi. Kur i afërmi betohet, për të afërmin e pasur vendoset që ai të shpenzojë për të afërmin e vet të varfër, vetëm pasi të vërtetohet se ky i afërm, me të vërtetë, ka mundësi të shpenzojë për të. Në qoftë se ai thotë se edhe unë jam i varfër dhe s'ka pasuri të dukshme, kërkuesi i shpenzimit ka detyrim të vërtetojë që personi prej të cilit ai kërkon shpenzimin, është njeri i pasur. Në lidhje me atë që pretendon se është i varfër, kemi folur me detaje në kapitullin "Ai që pretendon falimentimin", në paragrafin "Burgosja e borxhmarrësit", në pjesën e pestë të këtij libri.

Kur për të afërmin bëhet detyrim shpenzimi për të afërmin e tij dhe ai refuzon të zbatojë vendim detyrues të gjykatësit për të shpenzuar për të afërmin e tij, nëse ai këmbëngul të mos shpenzojë për të afërmin, në këtë gjendje, gjykatësi zgjedh mes burgosjes së tij, derisa ai të bëjë shpenzimin e kërkuar dhe mes shitjes së një pjese të pasurive të tij. Shumën e realizuar e shpenzon për të afërmin nevojtar, sipas rrugës që ai e shikon të përshtatshme, sepse shpenzimi është në dispozitën e borxhit dhe gjykatësi është kujdestari për atë që i është ndaluar e drejta.

* * *

PËRMBAJTJA

MARTESA.....	5
Predikimi.....	5
1- Formula.....	7
Fjalë e veçantë.....	9
3- Formula thuhet në kohën e kaluar.....	10
4- Jo në gjuhën arabe.....	12
5- Pa shkëputje.....	14
6- Varësia.....	14
7- Më përpara dhe më vonë.....	15
8- Kushti i përzgjedhjes.....	16
9- Dëshmitarët.....	17
Aftësia e dy kontraktuesve.....	18
I prokuruari marton vetveten.....	21
Gruan e martojnë pa e pyetur.....	23
I prokuruari gabon emrin.....	25
KUSHTET.....	26
Pretenduesi i kushtit.....	31
PERTENDIMI PËR MARTESË.....	32
A vërtetohet martesë për shkak se janë së bashku?.....	32
Pretendimi për një grua të martuar.....	38
Martesa e gruas para përfundimit të pretendimit.....	39
GRATË E NDALUARA.....	40
Ndaluesit.....	44
1. Përkatësia familjare.....	44
2. Krushqia.....	45

3. Ndalimi i bashkimit.....	47
4. Kurvërimi.....	49
Kontrata e martesës për gruan që është në kohën e pritjes ligjore.....	54
Kontrata e martesës me gruan e martuar.....	56
Numri i grave.....	57
Akuzimi i gruas shurdhmemece.....	59
Mallkimi i ndërsjellë.....	61
Sa herë thuhet fjalia: “Të kam divorcuar!”?.....	61
Me fe të ndryshme.....	65
Braktisja e Islamit.....	71
Njëri prej dy bashkëshortëve përqafton Islamin.....	73
Martestat e jomyslimanëve.....	78
Ihrami.....	79
Kapaciteti.....	81
Martesa me ndërrim.....	83
Ekspozimi i fejesës.....	83
USHQIMI I FËMIJËS ME GJI.....	85
Kushtet.....	86
Rezultati.....	100
Baba e motra prej qumështi.....	102
Babai i fëmijës të ushqyer me gji dhe nëna e mëndeshës.....	103
Babai i fëmijës që ushqehet me gji dhe fëmijët e burrit të mëndeshës.....	105
Ndalim i gruas.....	107
Martesa me motrën e vëllait.....	108
Ushqimi me gji pas martesës.....	109
Djali i xhaxhait bëhet xhaxha.....	110
Dëshmia për ushqimin e fëmijës me gji.....	110
Dyshimi i dijetarëve të fesë për vlefshmërinë e gjidhënies.....	111

KUJDESTARIA.....	114
Vajza ka arritur pjekurinë seksuale dhe di të orientohej drejt.....	114
I mituri dhe e mitura.....	122
I çmenduri.....	127
Mendjelehti.....	129
MARTESA E PËRKOHSHME (el mut'atu).....	131
Detyra e dijetarit të fesë.....	131
Kuptimi i fjalës “el mut'atu”.....	132
Martesa e përkohshme.....	134
Barazia mes martesës së përhershme dhe martesës së përkohshme.....	137
Dallimi mes martesës së përhershme dhe martesës së përkohshme.....	142
Martesa e përkohshme me grua të përmbajtur.....	149
TË METAT.....	151
Çmenduria.....	152
Tredhja.....	154
Penisi i prerë.....	155
Impotenca.....	157
Rruga e vërtetimit të impotencës.....	162
Lebrosa dhe gjymtyra e këputur.....	165
Verbimi dhe çalimi.....	166
Kërci, mishi i tepërt, përzierja e dy kanaleve dhe ngjitja.....	167
Menjëherë.....	169
Nuk merret në konsideratë leja e gjykatësit.....	170
Argumentin e sjell pretenduesi i të metës.....	170
Ndërmjet prishjes dhe divorcit.....	171
FSHEHJA E TË METËS (Et tedlijs).....	172
Përzgjedhja për të metën dhe përzgjedhja për fshehjen e të metës.....	172

Kuptimi i togfjalëshit “fshehje e të metës”	173
Fshehja e të metës dhe lejimi i prishjes.....	175
Burri është fshehësi i të metës.....	176
Gruaja fsheh të metën.....	178
Beqarja dhe e martuara.....	180
Çështje.....	181
SHUMA E KURORËS (El mehru).....	183
Shuma e përcaktuar e kurorës.....	183
Kushtet e shumës së kurorës.....	185
Shuma e ngjashme e kurorës.....	187
Autorizimi për caktimin e shumës së kurorës.....	193
Përsheptimi për pagimin e shumës së kurorës dhe vonimi për pagimin e saj.....	196
Vonimi i pagimit të shumës së kurorës së përsheptuar dhe përsheptimi i pagimit të shumës së kurorës së vonuar.....	198
Babai i gruas dhe shuma e kurorës.....	200
Refuzimi i gruas, derisa të marrë në dorë shumën e kurorës.....	202
Pamundësia e burrit për paguar shumën e kurorës.....	206
Babai dhe shuma e kurorës së gruas së djalit.....	206
Divorci para kryerjes së marrëdhënieve intime.....	207
Vdekja para kryerjes së marrëdhënieve intime.....	209
Zhvirgjërimi jo me rrugën e zakonshme.....	213
Qëndrimi në vetmi të plotë.....	215
Konflikti.....	216
DY BASHKËSHORTËT DHE PAJISJET E SHTËPISË.....	223
PËRKASTËSIA FAMILJARE(gjenealogjia).....	229
Marrëdhëniet intime, shtrati dhe rregulli i mundësisë.....	229
Koha më e paktë shtatzënisë.....	232
Koha më e gjatë e shtatzënisë.....	233
Fëmija prej marrëdhënieve intime të dyshimta.....	235

Fëmija i gjetur në rrugë.....	237
Birësimi.....	238
Dy burra kryejnë marrëdhënie intime me të njëjtën grua.....	240
Dyshimi.....	242
Konflikti.....	243
Rrugët e vërtetimit të përkatësisë familjare (atësia).....	245
GJIDHËNIA DHE KUJDESI PËR FËMIJËN.....	246
Qumështi i nënës.....	246
Koha e gjidhënies.....	246
Shpërblimi për gjidhënien.....	248
Kujdesi për fëmijën.....	250
Kush e ka detyrim të kujdeset për fëmijën?.....	250
Kushtet.....	254
Udhëtimi me fëmijën.....	254
Shpërblimi për kujdesin ndaj fëmijës.....	255
Kur fëmija humb të dy prindërit.....	256
Kujdesi për fëmijën rrëzohet me rrëzim.....	257
SHPENZIMI.....	258
Shpenzimi për gruan.....	258
Urrejtja dhe bindja.....	259
Gruaja e vogël në moshë.....	262
Burri i vogël në moshë.....	262
Gruaja e sëmure.....	263
Shpenzimi për gruan për kohën e pritjes ligjore.....	264
Gruaja nëpunëse.....	266
Çështje.....	267
Zakoni dhe shpenzimi për gruan.....	268
Pagesa për mjekim.....	270
Shpenzimi për kohën e lehonisë.....	270
Garancia për shpenzimin e gruas.....	271

Prishja, dhurata, pajtimi.....	273
Shlyerja e shpenzimit për gruan.....	275
E divorcuara pretendon se është shtatzënë.....	275
Konflikti.....	276
Shpenzimi për të afërmit.....	279
Kushti.....	279
Shpenzimi për të afërmin dhe martesë.....	281
Shlyerja e shpenzimit për të afërmit.....	282
Në radhë të parë vetja, pastaj gruaja, pastaj të afërmit.....	284
Personat për të cilët shpenzohet dhe edukimi i tyre.....	285
Ai që pretendon se është i varfër.....	286

فقه الامام جعفر الصادق عليه السلام

مؤلف: محمد جواد مغنية

الجزء العاشر

الترجمة الى اللغة الألبانية: الشيخ الحاج سليم اصطفى

تيرانا: 2018

نام کتاب: فقه الامام جعفر الصادق عليه السلام - الجزء العاشر

مؤلف: محمد جواد مغنیه

الترجمة الى اللغة الألبانية: الشيخ الحاج سليم اصطفی

زیر نظر: وُلُئْتُ مَرِيَا

ویرایش: یریدا کولا

صفحه بندی و جلد: صبریه فزا

ناشر: جمعیت "نسیم"

چاپ: انتشارات "لیلو"

تیرانا: 2018